

Mjeshtër i Edukimit ALEKSANDËR S. BOJAXHI

Historiku i Alpinizmit Shqiptar Fillimet - 1994

SH Ë N I M E



Mjeshtëri i Edukimit A L E K S A N D Ë R S. B O J A X H I

S H Ë N I M E

Historiku i Alpinizmit Shqiptar

Fillimet - 1994

D R A F T

Dy fjalë për lexuesin

Dëshira që kam patur për t'ja përcjellë bashkëmoshatarëve të mi kënaqësitë që më jepte sporti i alpinizmit bëri që një ditë të hedh kujtimet e mija dhe të botoj librin “Nëpër Bjeshkët e Namuna”. Më pas, shumë vite mbasi ishin mbajtur gjatë veprimtarive alpinistike ditarë, i përmbledha disa nga ata në mënyrë kronologjike, si nga ditarët e mi, ashtu dhe ditarët e ekipit të alpinistëve “17 Nëntori” i Tiranës, për vitet që kam qenë trajner i ekipit. Këta ditarë i kam publikuar në përmbledhjen “Ditarët”. Ndërkohë shkruajta për jetën time sportive dhe publikova materialin “Unë Alpinisti Trajner”. Me të gjitha sa më sipër shkarkova kujtesën me veprimtaritë sportive të jetës për këdo që një ditë do ketë interes të di për mua dhe për alpinizmin e brezit tim të alpinistëve.

Për të qenë i patrazuar me veten, vendosa që të mbledh sa të mundem kujtime dhe informacione edhe për alpinistët e tjerë të brezit tim. Dhe po botoj këto shënime gjë që më bën të ndjej se kam bërë detyrën për të ndihmuar në lënien e gjurmës në sportin e alpinizmit për periudhën që e shoqërova këtë sport si dhe për periudhën që po e “shoqëroj” këtë sport.

Për të patur material sa më të plotë (por jo të plotë) në këto shënime kanë dhënë ndihmesën e tyre shumë alpinistë me fotografi, me kujtime, me kërtime informacioni për shokët e veprimtarive alpinistike që na kanë lënë, etj. Janë shumë dhe bëhet listë e gjatë po i përmenda, por po u them: JU falenderoj shumë e shumë për ndihmesën në lidhje me këto shënime!

Ky material ka mangësi dhe nuk mundet të vlerësohet si historik i këtij sporti sepse: Unë nuk jam historian dhe nuk di ta shkruaj këtë material si histori sikundër bën një akademik i fushës. Ka ende alpinistë që jetojnë dhe për arsye të ndryshme më mungon informacioni për ta. Personalisht nuk kam mundur të hulumtoj sa duhet nëpër arkiva dhe biblioteka.

Uroj që sa kam përmbledhur të nxisë të tjerët që të plotësojnë këto shënime ose të ndërmarin diçka të ngjashme.

Kam bindjen që brezat duhet të lënë gjurmë për shumëshka që bëjnë në jetë dhe që do mund të përcillen nga njëri brez tek tjetri, edhe më tutje, me të cilat gjurmë dikush dhe dikur shkruan histori të caktuara. Arkivat janë rëmuar nga çdo brez për të mësuar nga e kaluara, madje për këtë kemi dhe institucione të arkivave. Kam besimin se shënimet e mbledhura në këtë material do i shërbejnë një ditë dikujt si një arkiv i vogël që i takon sportit të alpinizmit

Në vitin 2009 Kozma Grillo nxori në dritë botimin “Alpinizmi Ynë” (1936-1992). Përmbledhi në këtë botim shkrime gazetash, opinione personale dhe jo personale, kujtime dhe histori të ndryshme. Kur lexon këtë libër mëson se sporti i alpinizmit në vendin tonë ka një histori të vetin dhe një historian apo alpinist i ditëve tona mëson mjaft nga ai botim. Uroj që këto shënime të plotësojë hapësirat që ka lënë pa i rokur miku im i ndjerë Kozma Grillo.

Kam në punim e sipër një material që përmban lindjen e turizmit dhe alpinizmit në çdo qytet e klub sportiv të vendit tonë, (periudha Fillimet – 1994), të ilustruar me “biografi” alpinistash dhe fotografi të mbledhura kryesisht nga alpinistët që ndihmuan për këto materiale.

Aleksandër S. Bojaxhi

Kapitulli i Parë


(Fillimet – 1994)

Sportet dhe lojrat sportive lindën në një fazë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë njerëzore dhe patën kulmet e tyre, sikundër na kanë mësuar historianët, në periudhën e antikitetit Helen, kohë kur filluan të organizoheshin olimpiada sportive. Alpinizmi, sporti i ngjitjes së maleve, është relativisht i ri krahasuar, p.sh., me sportin e atletikës; ai lindi më 8 gusht 1786. Kjo datë njëherësh shënon ngjitjen e parë të realizuar nga njeriu në majën më të lartë të Alpeve Evropiane; në Mont Blanc – 4810m. Meqë fillimet e këtij sporti ishin në Alpet e Evropës, ky argëtim, pra sporti i ngjitjes së maleve, mori emërtesën “Alpinizëm”.

Njerëzit, në vende të ndryshme të botës për majat e maleve kishin bestytni nga më të ndryshmet që shkonin nga frika përpara tyre e deri tek adhurimi për to. Ishte adhurimi për to që i shtynte njerëzit të ngjiteshin edhe nëpër itenerarë të vështirë, edhe të llojit alpin, për të arritur majën.

Jo vetëm bestytnitë por edhe gjahu i ka bërë njerëzit që të kalojnë qafa malesh si dhe të ngjiten në maja të ndryshme malesh. Po ashtu edhe nevojat ekonomike, sociale, apo edhe luftërat i kanë shtyrë njerëzit të ngjiten maleve apo qafave të tyre.

Në të gjitha këto raste që përmendëm, por edhe për të tjera që nuk është vendi për t’i përmendur, ***njerëzit nuk ju ngjitën maleve, apo nuk kryenin lehtëza nëpër male, me qëllime agrtimi, me qëllime sportive.*** Ishin kushte historike, ekonomike, sociale etj, që sollën atë ditë kur filloi epoka që të shihej mali si vend argëtimi e shlodhjeje. Dhe këtë ditë, apo epokë, e solli aristokracia, kryesisht ajo angleze, dhe që njëherësh përfshiu aristokracinë e Evropës Perëndimore, që malet e Evropës Qëndrore të shiheshin si vende argëtimi. Dhe kur u kuptua se kishte lindur një sport i ri, sporti i ngjitjes së maleve, argëtuesit e maleve kthyen kokën pas dhe e panë të arësyeshme që të caktonin datën 8 gusht të vitit 1786 “Ditëlindja e Alpinizmit”. Ishte kjo dita kur për të parën herë dy dashamirës të natyrës dhe malit u ngjitën në Mont Blanc.



Itenerari i ngjitjes së parë në majën Mont Blanc



Shkopi ndihmonte ngjitjen nëpër qafa dhe maja malesh




Kazma e parë alpine


Fillimisht, për tu ngjitur në mal, si mjet ndihmës, u përdor një shkop i gjatë me majë metalike. ky shkop u emërtua shkopi alpeve (alpen shtok)

Nga ngjitjet e kryera u pa e nevojshme që këtij shkopi t'i shtohet diçka që të thyente akullin. Për këtë shkopi ju shtua në anën e sipërme të tij një mjet metalik prerës. Kështu lindi kazma e parë alpine.

Edhe në vendin tonë, që në lashtësi, njerëzit i kanë parë malet dhe majat e disa prej tyre me atë sy dhe me ato ndjesi sikundër popujt e tjerë të planetit. Edhe ndër shqiptarët, në bazë të materialeve të shkruara, pati individë që u ngjitën maleve për qëllime argëtimi. Kështu Dora D'Istria frekuentonte Alpet e Evropës. Kështu edhe Eqerem Bej Vlora, një njeri me kulturë të gjërë për kohën e tij, dhe më tej, për qëllime argëtimi në datën 1 tetor 1906 u nis nga Jagodina për në Berat dhe u kthye po në Berat pas 12 ditësh. Ai gjatë këtyre ditëve i erdhi përqark malit të Tomorit me shporën e tij. Përshkoi dhe përshkroi fshatrat nga kaloi dhe u ngjit në majën Abas Ali të Tomorit (2396 m) në datën 8 tetor. Dhe më tej, në datën 11 tetor, i nisur nga Dardha ai synoi dhe u ngjit në majën kryesore të Tomorit (2.416 m).



Harta e përdorur nga Eqerem bej Vlora për udhëtimin e tij. Vërejmë se Çuka e Tomorit është emërtuar Abbas Ali (2.396 m) dhe maja Tomori (2.418 m).



Kreshta e malit Tomor e parë nga mali Shpirag

Nga përshkrimet që na jep duket se ai dhe shoqëruesit e tij përdorën gjatë ngjitjes kazmat alpine të asaj kohe. Në dy raste ai përshkruan:

.....”trualli këtu ishte aq i ngrirë, saqë edhe me shkopin me majë hekuri unë mezi mbahesha”.... dhe në një rast tjetër kur ai me shoqëruesit matën thellësinë e borës në një gropë përshkruan:

....”Ne i mbërthenim shkopat tanë alpinistikë, të mbathur me hekur, njëri me tjetrin dhe këtë shklop të gjatë e fusnim pastaj në vendin më të butë të borës, deri sa ai të takonte në shkëmb.”




Fig.17.-Mekami në msjën Abas Ali të Tomorrit

Mekami në vitin 1906. Foto nga Eqerem Bej Vlora

Nga përshkrimi duket se para orës 12 të datës 11 tetor ai dhe ata pak shoqërues që kishte arritën në pikën më të lartë të Tomorit. Ja përshkrimi i tij për panoramën që soditet nga kjo majë:

“Pa shumë mundim u ngjitëm në majë. Harta Austriake e jep lartësinë e saj 2418 m. Populli e quan maja e Tomorricës. Edhe këtu gjendet një mekam, një mur i ulët rrethor, ngritur me gurë të mbledhur, por që është shumë më i thjeshtë se ai në majën jugore të Abas Aliut. Duhet thënë se ajo vizitohet nga shumë njerëz besimtarë, për të qenë brenda, sepse egziston dyshimi që ka qenë ajo maja më e lartë që ka zgjedhur Abas Aliu si vend të prehjes së tij të përjetëshme. Ndryshimi midis dy majave është 22 metra e megjithatë, siç dihet mirë në Shqipëri, maja e Abas Aliut (2396 m), e parë nga maja veriore, duket shumë më e ulët dhe e pa rëndësishme.

Për të hedhur një vështrim mbi shqipërinë kjo majë është veçanërisht e përshtatëshme, sepse asnjë majë tjetër në Shqipëri nuk qëndron kaq e veçuar. Për më tepër, atë ditë ne patëm fat edhe me motin. Qe një ditë e bukur dhe e kthjellët me erë të lehtë dhe me temperaturë 6° në diell. Nga veriu duket rrafshi i *Karatoprakut*, shihet *porti* i Durrësit dhe Deti Adriatik, më tej kodrinat e *Sulovës*, masivet pyjore të *Dumresë* me liqenet e tyre të vegjël, si dhe malet e *Elbasanit*, *Tiranës*, *Shpatit* dhe *Vërçanit*. Në lindje shikimi pengohet nga vargmali i *Gurit të Prerë*, në juglindje duket maja e zhdërvjellët *Çuka e Frëngut*, malet e *Kolonjës*, *Skraparit* dhe gjithë kreshta e vargmalit të Tomorit, me prerjen e tij më të thellë, *Stradomin e Tomorit*. Më tej rrethi madhështor i kësaj panorame magjike mbyllet me *Labërinë*, *Çikën* dëborëmbuluar me *Çoren* në malet Akroeraune, gjirin e *Vlorës* me ishullin e *Sazanit*, *Myzeqenë* dhe *Shpiragun*. Ishte ora 1 kur vendosëm të ktheheshim.”



Çadër fushimi. Foto nga Eqerem Bej Vlora, tetor 1906

Nga sa kam patur rastin të lexoj për daljet e shqiptarëve në natyrë e veçoj Eqerem Bej Vlorën. Ai në rininë e tij pati shkollim edhe në Austri ku pati rastin të përfshihet me rininë studentore në veprimtari

të herë pas herëshme në natyrë. Kjo duhet të jetë edhe arësyeja që ai ndërmori përsëri udhëtime nëpër Shqipëri. Kështu në kujtimet e tij të mëvonëshme mësojmë se:

“Në maj 1912 nisem nga Vlora, i shoqëruar nga njerëzit e mi me çadra, kafshë barre dhe qen, (një karvan i vërtetë arixinjsh) dhe shkoj në Delvinë, Libohovë, Pogon, Çaraplanë, Konicë, Samarinë, pastaj në Kolonjë dhe së fundi në Korçë.” Dhe më pas vazhdon:

“.... U nisa sërish për udhë, i shoqëruar nga një tufë e tërë djemsh familjesh të njohura, të cilët deshën me doemos të më përcillnin deri në Ohër, nëpër trevën rreth liqeneve të Ohrit dhe të Prespës, tashmë të rrezikshme nga veprimtaria e çetave bullgaro-greke.

Nga Ohri itinerary im vazhdoi për në Strugë dhe në Dibër, prej nga unë bëra një shmangje nëpër Maqellarë e Peshkopi, për tu ngjitur në Korab (2.730 m). Male të bukura siç të ze syri në Zvicër a në Tirol, në Shqipëri nuk ka. Malet e saj janë gëlqerorë dhe mbartin në vetvehte zyminë e natyrës karstike.

Maja të veçanta, rrafshnalta të veçanta, disa lugina (Theth, Lurë, Tomorricë, Samarinë, Shpat, Rugovë, shpatet Lindore të Korabit, brigjet e Himarës dhe të tjera), mund të duken, në krahasim me viset përreth, piktoreske me një romantikë të egër, por gjatë gjithë udhëtimeve të mia të shumta nëpër Shqipëri, unë nuk kam vënë re asgjë nga ato bukuritë natyrore shqiptare të lexuara nëpër libra.”

Eqerem Bej Vlora ishte një rast i vetëm që u argëtua në natyrën dhe malet Shqiptare në krye të shekullit XX. Ndoshta një ditë do dalin dokumenta se edhe ndonjë tjetër shqiptar ka patur argëtime të ngjashme në natyrë. Porse këto, sado që janë shprehje të ushtrimit të sportit të alpinizmit, nga individë të veçantë, këtu e atje, nuk flasin për një lëvizje që përfshin rininë tonë. Në rastin më të mirë Eqerem Bej Vlorën, ne alpinistët, mund ta nderojmë me titullin **Tatëmadhi i Alpinizmit Shqiptar**, sikundër alpinizmi evropian ka nderuar me këtë titull **Francesco Petrarca-n**, filozof, poet dhe udhëtar i shekullit XIV që vet i dytë u ngjiti në malin e Francës, modest për nga lartësia, Ventosux (1912 m).

Në fillimet e shekullit XX, në qytetet tona kryesore si Shkodër, Berat, Korçë, Tiranë, etj filluan të krijohen shoqëri sportive, që veç lojrave me top dhe sporteve e garave të ndryshme, organizonin edhe veprimtari në natyrë, kryesisht të llojit turistik.

Mbas Kongresit të Lushnjës (v. 1920) filloi një periudhë e vrullëshme e jetës sportive dhe mjaft të rinj u organizuan edhe në grupime me synime turistiko-alpinistike, ose në grupime të vogla si dashamirës të natyrës në bazë të njohjes si shokë. Pati prej tyre nga ata që i ranë kryq e tërthor Shqipërisë etnike për ta njohur e për tu ndjerë krenarë me të. Kish të rinj që u ngjitën edhe në male të ndryshme të vendit

Pra tashmë ishin rrethana historike, ekonomike, sociale etj, që sollën ditën kur filloi periudha që të shihej mali si vend argëtimi e shlodhjeje. *Vitet 20-të dhe 30-të të shekullit të kaluar, ringjallën një romantizëm të vonuar evropian në pjesën e Ballkanit, ku jetojmë ne shqiptarët. Për pasojë këto vite gatuan pasione rinore edhe me dëshirën për t'i parë malet si vende argëtimi e kënaqësidhënse.*

Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës i dha që në fillimet e saj rëndësi përhapjes së skautizmit (Aleksandër Xhuvani e Mati Logoreci këtë fjalë e përshtatën në shqip me fjalën Gjurmuesi). Disa numura të “Revista Pedagogjike”, botim i Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës, kanë shkrime mbi gjurmuesinë apo skautizmin. Revista është e pasur me artikuj që lidhen me vlerat e ngjitjeve malore. Ja një nga artikujt e kësaj reviste për Gjurmuesinë.

Skautizma në botë dhe organizimi i sajë në Shqipni

Gjurmësia dhe roli i sajë në botë

Nuk mjafton qi njeriu të jetëm vetëm i ditun. Janë shumë njerëz, qi me anën e ditunis së tyne mërijnë me bamë shumë punë, por mbasi u mungon shëndeti, s'janë kursesi të zotët as për vehte as për punë. "Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë", thojshin Latinët e vjetër.

Prandaj, pra, në ket shekull, ku ka hy qytetnimi, shtetet e përparueme i kanë dhanë ransi të madhe gjurmsis dhe për ket qëllim shpenzojnë sasina të mdha të hollash.

Prindët e pasun, ashtu edhe të vobekët, në vendet e përparueme, u urdhnojnë fmijvet të vet, qi të marrin pjesë në gjurmsi; kështu në botë, mbas statistikave, gjenden ma se tre milion gjurmues. Dihet masandaj se në sportizëm gjurmuesia.....

Përhapja e gjurmsis në Shqipni

Po dhe në Shqipni shofim me gëzim se gjurmsia dita me ditë asht tue përparuem. Në vitin 1920, kur Qeveria e jonë me një dekret-ligjë e pranoi zyrtarisht organizimin e e gjurmuesvet shqiptarë, Këshilli Ministrues dha një ndihmë prej 3 mijë fr. arë për organizimin e kësaj shoqërije me kaq randësi. Po n'at vjet vetëm qyteti i Tiranës me inisjativën e zonjushës Uilliams, mundi me organizuem një trup gjurmues të parën herë në institutin e strehës Vorfnore të Tiranës.

*Në të dytin vjet, Ministria e Arsimit tue çmuem randësin e kësaj shoqnije, lypi prej Qeveris s'Anglis një organizator, pa kaluem shumë kohë, organizoi kursin s.m. (master scout = mjeshtër gjurmues), qi përbahej prej mësuesvet t'ardhun nga 2 prej çdo prefekturë. Po mjerisht ky qëllim nuk u krye e kështu 10 mij fr. arë që shpenzoi Ministria e Arsimit shkuen kot, se shumica nga ata mësues, mbas ktij kursi, nuk u interesuen aspsk për të përhapunit neper vende te ndryshme të Shqipnisë gjurmusinë, e cila për një kohë të shkurtën, porsi një flagë bari, mbaroi tue lanë një shkendi vetëm në Tiranë ku dhe sot gjinden ma se **150 gjurmues**.*

Po prap kshivjet Ministria e Arsimit tue marrë parasyshë se ishte i domosdoshëm riorganizimi i gjurmësis në Shqipni, shtoj në buxhetin e vet një shumë të hollash, për t'i a mërrijtë këtij qëllimi.

Dobinat qi ka sjellë ky organizim në vendin t'onë moralisht dhe fizikisht na japin shpresa të mëdha për kohën e ardhëshme të brezit të ri. Kjo dobi kuptohet prej udhtimesh, qi kan ba nëpër qytete e katunde, tue studjuem afrisht vendet me randësi e tue u praktikuem për të qeverisunit neper male e pyje vehten e tyne simbas mirërritjes ma të re.

Nga kjo pra, merret vesht kjartas se qëllimi kryesor i gjurmësis asht t'i japin njerëzis djem të mbaruenm nga çdo pikpamje: Të ndershëm, të bindshëm në ligjë, atdhetarë të flakët dhe të zotët për t'i shërbyem vehtës e njerzis në çdo rasë.

Shënim

Shih librin "Boiskautizma" mbas gjeneralit Englez Baden Pauelit prej S Papahristos; Drejt të Përgj. t'Arsimit.

Tiranë, 6-VIII-925



*Grupi i mësuesve që u përgatit për të ushtruar detyrën si instruktor gjurmues në shkolla
Kjo foto është bërë/shkrehur në Tiranë. E dëshmon sfondi i fotos: në sfond mali i Dajtit dhe ndërtimet me
qerpiç (baltë e tharë në diell).*


Në cepi djathtas poshtë ka shënimin Ali M Bah n ë Ëien (!!!).

Sipas shkrimit del se kjo foto duhet të jetë e vitit 1921.



Avni Zajmi me Gjurmuesat e parë shqiptarë në vitin shkollor 1920-1921

Revista të asaj kohe të tilla si “Gjurmusia”, organ i lëvizjes Gjurmusia Shqiptare, si dhe revista “Minerva”, krahas organeve të tjera të shtypit, kanë dokumenta dhe informacione të vlefshme për të hetuar fillimet e sportit të ngjitjes së malit në vendin tonë. Edhe fotografë apo studio fotografike si Foto Pici, Foto Jakova, etj., të cilët kanë ilustruar revistat, besoj se duhen konsideruar në një studim të ardhshëm të historisë së alpinizmit në Shqipëri.



Nuk kemi ende një studim të mirëfilltë lidhur mbi historinë e alpinizmit në vendin tonë. Kjo ndoshta ngaqë, diku e dikur në propagandën e kohës së punizmit, u shkrua se ky sport ishte “sport i viteve të partisë” dhe kështu, askush nuk u muarr me të shkuarën e sportit të alpinizmit në vendin tonë. Personalisht, ndjej dhe gjykoj se ia vlen të pranojmë për ditëlindje të alpinizmit shqiptar ditën kur për motive argëtuese u ngjit për të parën herë, madje duke përdorur edhe pajime alpinistike, nga të rinjtë gjurmues shqiptarë maja Çuka e Tomorit, 2.396 metra e lartë. Kjo ndodhi në **21 korrik 1927**.



Avni Zajmi në mes të gjurmuesve të Tiranës



Trupa e gjurmuesve të Shkollës Teknike të Tiranës

Personalisht e konsideroj 21 korrikun e vitit 1927 “Ditëlindja e Alpinizmit Shqiptar”.

Në botimin “Kronikë e një jete shekullore” përshkruhet jeta dhe veprimtaria e të ndjerit Avni Zajmi nga i biri i tij Genci. Nga ky botim po u sjell një fragment i cili, ndër të tjera, na tregon se ku duhet kërkuar zanafilla e thirrjes së kaherëshme triumfuese e alpinistëve shqiptarë që ngjiten në majën e një mali: ***Zig-Zag, Zig-Zag, Hej, hej, hej, Alpinista jemi ne!***

.....në mesditë arritën në Çorovodë, ndërsa natën e kaluan në Barbullas. Të nesërmen arritën në teqenë e Kulmakut, ku pushuan dhe folën mbi qëllimin e udhëtimit të tyre. Ngjitja në majën e malit të Tomorrow, përveç vështirësive, shoqërohej edhe nga emocione. Ishte hera e parë që ngjiteshin në këtë mal të shenjtë.

Gjatë ngjitjes (21 Korrik) filloi një mjegull e dendur që hera-herës jo vetëm i pengonte të shihnin shoku-shokun, por i jepte edhe më shumë madhështi këtij mali. Pas një pushimi të shkurtër vendosën që ngjitjen ta bënin në një shteg shkëmbor, duke vënë në përdorim litarët dhe pajimet alpinistike që kishin marrë me vete. Kjo do të ishte ngjitja e parë alpinistike në vendin tonë. Përsëri një pushim i shkurtër. Sa më lart ngjiteshin aq më tepër u shtoheshin kureshtja për të parë majën e këtij mali, të njohur në tërë Shqipërinë si mal i shenjtë. Si do të jetë vallë maja e malit?! Kur më në fund të gjithë nxënësit arritën në majë, kujtuan se me të vërtetë ndodheshin në prag të qiellit. Për çudi edhe mjegulla ishte fashitur nga rrezet e forta të diellit. Prej kësaj çdo gjë shihej me një qartësi të çuditëshme deri larg, sa të hante syri. Duhet ta keshë provuar që ta besosh këtë ndjesi të pushtetit ndaj natyrës.

Të gjithë nxënësve gjurmues iu krijua një ndjesi krenarie dhe kënaqësie, sikur i gjithë trupi i tyre çlodhet dhe këtë e ndjen më tepër syri i njeriut. Këtë ndjesi vërtet të bukur së bashku me profesorin e tyre e shprehën duke thirrur: “Zigzag, zigzag, alpinistë jemi ne”, që buçiti fuqishëm nga maja e Tomorrow. U mblodhën të gjithë tok rreth mësuesit të tyre dhe secili filloi të meditojë dhe të flasë për llogari të vet. Avniu fillon t’i tregojë nxënësve të tij: “*Nxanës të dashur, shikoni me kujdes dhe mos harroni çfarë po shikoni! Që këtu soditet pothuajse e gjithë Shqipëria*”.....

Vlen të përmendet që Gjurmusia Shqiptare pati edhe një revistë të titulluar GJURMUSIA (1926-1928). Dilte me dy numura (ishte simestrale) në vit por që u mbyll nga Mbreti Zog në vitin 1928. Ishte ky një paradox, sikundër lexojmë në botimin “Kronikë e një jete shekullore”:

.., “që me ligj t’i ndalohej nëpunësve të Shtetit dhe ushtarakëve të merrnin pjesë në shoqëritë sportive jashtë shkollore, që kishin filluar të krijoheshin”....

Avni Zajmi dhe Gjurmusia Shqiptare, nëpërmjet marshimeve nëpër vende e qytete të ndryshme, u bënë përhapëse të turizmit dhe alpinizmit, si dhe spoteve me top nëpërmjet ndeshshjeve ekipore që organizoheshin nëpër qendra të banuara ku kalonin.

Edhe vetë shkollat e hapura nga shoqëritë Italiane (shkolla tregtare), Amerikane (Shkolla Teknike), ajo në Golem të Kavajës, etj u bënë vatra të sportit në vendin tonë, përfshirë sportet malore. Vlen të kujtojmë njëherësh se shkolla franceskane e Shkodrës, me nxënësit e saj gjatë pushimeve verore, organizonte kamping në Theth si dhe ngjitje në malet përreth.

Kopertina përmbyllëse e revistës “Gjurmusia Shqiptare”

VIETI II-të NANDUER 1927 - Nr. 2

K R Y E T A R Ë T

GJURMUSIA SHQIPTARE NËN MBROJTJEN E SHK. SË TIJ

A . Z O G U

Kryetar I i, Republikës Shqiptare

N Ë N D R E J T I M T Ë

Z. XHA FER YPI, Ministri i Arsimit

“ A. DIBRA, Ministri i P. Mbrendëshme

“ XH. ARANITASI, Kom, P . F . Armate

KOMITETI I PËRGJITHTSHËM

Z. MIDHAT FRASHËRI

“ MEHMET KONITZA

“ PERTEF POGONI

“ H. FULTZ

KËSHILLI VEPRUES I QENDRËS

Z. A. ZAJMI, Organizator

“ R. DISDARI, Mjeshtët Gjurmues

“ K. STEFA “ “

“ R. RANXHI “ “

“ B. HAÇI, Sekretar

A N Ë T A R Ë N D E R I

Z. Izedin Beshiri, Izet Dibra, Dr. Sabri Teliku, Z. Thoma Papapano, Gulielm Lluka, Hasan Zogolli, Major Q. Elbasani, Kap. Ali Erebara, Z. Niazi Tirana, Mati Logoreci, Sadi Pejani, Minush Shala, Panajot Beçka, Gjorgj Pano, Myftar Agolli, Ibrahim Tetova, Xhemal Keçi, Vlash Dhora, Bedri Llagami, Zyber Preza, Ramiz Hatibi, Ramazan Dema, Eqerem Stërmasi, Etëhem Tabaku, Hysen Jella.

Ky informacion në kopertinën përmyllëse të Revistës Gjurmuesia na njeh me nivelin e lartë, si intelektualë ashtu dhe si punonjës të shtetit që janë të përfshirë në këtë lëvizje rinore.



Nga viti në vit gjurmuesat krijuan grupime të organizuara të rinjsh që kalonin edhe moshën 18 vjeçare

Në vitet 1925-26 Gjurmuesat ishin një shoqëri sportive e mirëfilltë me të gjitha moshat sepse anëtarë të saj tashmë ishin bërë edhe nxënësit e shkollave të mesme, veçanërisht nga Shkolla Teknike (sot Hary Fultz) e cila stimulonte nxënësit për tu aktivizuar në sporte të ndryshme.

Gjurmusia në vendin tonë nuk u mbështetet vetëm nga intelektualë të shquar, por që në fillimet e qeverisë së dalë nga Kongresi I Lushnjës edhe vetë nga qeveria duke ndatë fonde nga buxheti dhe duke sjellë edhe specialist nga jashtë.

Këto mbështetje ma thotë mendja se erdhën pikërisht sepse program I këtij organizimi për një djalë të ri ishte mëse edukativ dhe njëherësh laik. Dhe pikërisht:

Tog-fjalëshi “Boy-scout” vjen nga anglishtja, që do të thotë “djalë gjurmues”, apo zbulues i natyrës”. Për shqipërimin e këtij tog-fjalëshi, në fillim të viteve 20, ndihmuan personalitete të njohur të letrave shqipe, miqtë e Avniut, si Lumo Skëndo (pseudonimi i Mit’hat Frashërit), Aleksandër Xhuvani e Mati Logoreci. Lumo Skëndo shkroi edhe kryeartikullin e numurit të parë të revistës “Gjurmuesia shqiptare” në nëntor të vitit 1926.

Nën shembullin e kësaj organizate, e cila u përhap me shumë shpejtësi (në fillim në vendet anglo-saksone dhe në Amerikë) edhe në vende të tjera të Evropës filluan të formohen organizata homologe me të, si në Francë “Eclaireurs”, në Itali “Balilat”, në Bashkimin Sovjetik (edhe tek ne pas L2B) “Pionerët”, në Gjermani “Junges-volk”, në Jugosllavi “Izvedaçi”, në Greqi Proskopoi, etj.

Betimi i Gjurmuesit

Betohem në emër të Perëndis dhe mbi nderin tim:

1. T’i shërbej Atdheut dhe t’i bindem ligjit të gjurmësisë.
2. Të ndihmoj të tjerët kurdoherë.
3. Të mbaj trupin të shëndetshëm, mendjen të kthjellët dhe vetitë e mira,

Tre gishtat përpyetë i kujtojnë gjurmuesit tre premtimet e Betimit.

“Ji gati” është parimi i gjurmuesit

Ngritja e tre gishtave mbi tamthin e ballit është përshëndetja e gjurmuesit.

Një gjurmues, kudo që të ndodhet në botë, duhet të zbatojë të 12 ligjet e caktuara për ta. Ai duhet të jetë: i besueshëm dhe besnik, ndihmues dhe miqësor, bujar dhe i urtë, i bibdshëm dhe buzagaz, kursimtar dhe trim, i pastër dhe durimtar. Ai dihejt t’i qëndrojë besnik betimit që:

1. T’i shërbej atdheut dhe t’i bindet ligjit të gjurmësisë.
2. Të ndihmojë kurdoherë të tjerët.
3. Të mbajë trupin e shëndoshë, mendjen e kthjellët dhe vetitë e mira.

Motoja e tyre është:

“Gjurmuesi të jetë gati kurdoherë të kryejë detyrën e tij dhe të përballojë çdo rast të ngutshëm. Parimi i tij është: “Ji gati!”

Ana organizative e kësaj organizate (jo me organizim ushtarak apo rregulla ushtarake) është si më poshtë:

Njësitë bazë të strukturës së saj janë: “Trupi dhe “Patrola”. Përgjithësisht një “Trup” përbëhet nga 3 ose 4 “Patrola”. Çdo “Patrolë” ka 6 ose 7 gjurmues e rrallë 8 ose 9 veta. Pra një “Trup” përmban 24 deri 30 gjurmues.

Zakonisht çdo patrol merr një emër shtaze, dhe shalli, që secili lidh rreth qafës, duhet të jetë me ngjyrën e shtazës, si p.sh.: shqiponja, lepuri, ujku, dhelpra, qeni, etj.

Trupi i gjurmuesave ndahet në tre shkallë:

1. Trupi i ujqërve – për moshat 8 deri 11 vjeç.
2. Trupi i gjurmuesave – për moshat 11 deri 16 vjeç.
3. Trupi i specialistëve – për moshat 16 deri 20 vjeç.

Çdo Trup drejtohet nga një mjeshtër gjurmues, i cili merr emrin e Trupës; ai ka një ndihmës, një sekretar, një arkëtar dhe një kujdestar.

Mjeshtër gjurmuesi është një gjurmues i vjetër dhe zot i punës, ndërsa kryetarët e Patrolave zgjidhen nga më të aftët dhe më simpatikët.

Trupa ka këshillin e vet, ku marrin pjesë edhe drejtuesit e patrolave dhe ka për qëllim organizimin e Trupës dhe plotësimin e materialeve të nevojshme për kamping dhe me organizimin në të të veprimtarive të ndryshme shoqërore dhe sportive.

Gjurmuesi duhet të njohë pesë mënyrat e orientimit në natyrë: me ndihmën e diellit, të një ore dore, të pemëve, me busull dhe me ndihmën e yllit polar (të veriut).

Ai duhet të njohë shenjat konvencionale orientuese në terren (legjendën e hartës) për të gjetur drjtimin e duhur drejt kampingut (fushimit) ujit të pijshëm, shmangien e pengesave natyrale.

Gjurmuesi duhet të njohë dhe zotërojë katër lloje të krijimit të nyjeve së litarëve për tu ngjitur nëpër shkëmbej, për të fiksuar/lidhur tendat (çadrat) apo për të ndihmuar/siguruar shokun në vështirësi.

Gjurmuesi duhet të dijë të nortojë, të njohë rregullat e higjenës. Atij i mësohet një “moral”-“Mos e dëmto veten. Ki nderim të posaçëm për shëndetin tënd dhe çmoje vlerën e tij”.

Gjurmësia i jep fushë të lirë edhe lojrave sportive duke bërë kujdes që performanca personale të kalojë në plan të dytë, pasi shëndeti dhe përparimi i gjithë grupit të gjurmuesve gjykohen si më të rëndësishme sesa arritje e ndonjë “heroi”. Të gjithë në grup duhet të arrijnë të realizojnë me sukses disa prova për tu ngjitur më lart në kualifikim.

Uniforma e gjurmuesit është e njëjtë në të gjitha vendet e botës. Ajo përbëhet nga bluza me mëngë të gjata, pantallona të shkurtëra nën gju, kapelle karakteristike, shalli rreth qafës lidhur përpara si gravatë, çorape të gjata gjer nën gju, këpucë me qafa.

Ndër pajimet personale për të gjithë janë: ranci (çanta e shpinës), litari i mbledhur, stapi prej druri, etj.

Personaaliteti i formuar i një të riu, me paraqitjen e jashtme të rregullt dhe me përmbajtjen e karakteristikave themelore të përmbledhura në “njeri i mirë”, i shëndetshëm dhe “i zoti”, nuk është gjë tjetër veçse një sinonim i një gjurmuesi të vërtetë. Jo vetëm gjurmuesi, por edhe familja e tij dhe e gjithë shoqëria lumturohen kur atij dhe shokëve të tij u formohet ndërgjegja dhe personaliteti.

Një nga organet e shtypit e viteve 30-të ku gjejmë informacion nëpërmjet artikujve të shkruar për veprimtari në natyrë është Revista **Minerva**. Ja përmbledhjet e disa artikujve domethënës për organizimin e sporteve malore:

Numuri 15 shtator 1933

Faqe 14. Artikull i shkruar nga Filip Ndocaj; mësues dhe shkrimtar

Titulli: Djalëria, fuqia organizuese për turizmin e ardhëshëm Shqiptar

Nga shkrimi mësojmë se:

1. Nënpunës, tregtarë, të pasur, çerkeçi verojnë në bjeshkë me familjet e tyre
2. Të huaj, me ranca (ryck-sachk) vinë dhe shëtisin nëpër malet e Alpeve Shqiptare si dhe botojnë e shkruajnë në vendet e tyre për bukuritë e maleve tona.
3. Reklamohet turizmi si mjet shlodhje dhe dobi për shëndetin
4. Ideohet organizimi i turizmit Shqiptar
5. Nga fundi i viteve 20-të familjet Shkodrane kanë filluar të verojnë në Bogë, Vrith, e deri në Vermosh. Ka prej tyre që kanë filluar të ngrenë vila të bukura në këto qendra.
6. Rinia shkodrane është zgjuar dhe po jepet pas turizmit. Grupime të rinjsh i ngjiten shtigjeve të thepisura dhe ngrenë çadrat e argëtohen me këngë, zjarr e gatime pranë zjarrit.
7. Studenta, punëtorë dhe shkartha, të pasur dhe të varfër, me një vllazëri shembullore kalojnë ditë nëpër male apo në natyrë

Vjersha e *poetit kombëtar* që shoqëron shkrimin

Oh! Ju bjeshkët e Shqyptaris
Ku ma mirë shndrit dielli e hana,
E ku logu á i bujaris
E ku riten djelm si Zana!
Un ju kurr s’kam me u harrue
Kahdo t’m’jetë gjykue me u endë,
Derë sat ë muej me ligjirue,
Jue gjithmonë kam me u përmendë....

Më tej artikull shkruesi na njeh me ekskursionin që kanë realizuar 40 të rinj shkodranë ku edhe ai është pjesëmarrës. Këta të rinj nisen nga Shkodra në datën 14 gusht dhe kthehen pasi lehtojnë nëpër male në datën 17 gusht në Shkodër

Dt 14 ora 03 nisen, të pajisur me ranca, me makinë nga Shkodra dhe arrijnë në ora 05:30 në Bogë. Hanë mëngjes dhe kalojnë ca kohë tek Kisha e Bogës ku i mirëpret Dom Lekë Sirdani. Pastaj përsëri udhëtim me kamion deri në Okol ku dhe filloi marshimi i 40 të rinjve. Pas tre orësh ata janë në

Shtegun e Dhenve (1840) [po shënoj lartësitë sikur jepen në shkrim ndonëse nuk janë lartësi të sakta ashtu sikundër i njohim sot-ab]. Autori *Shtegun e Dhenve e quan Thermopilet e Dukagjinit*. Më tej ai përshkruan malet që u hapen marshuesve nga ajo lartësi: Radohina (2500 m), Harapi [jo Arapi-ab], Qafa Pejës (1690 m), Jezera [Jezera, jo JezerCa-ab], Lugu i Plisit (2400m), Boshi (1970 m), Thethi (700 m).

Dt 15 gusht ata shëtisin nëpër Theth si dhe vizitojnë Shushurimën mbi Shkallë të Thethit [ne sot e quajmë Ujvara e Thethit-ab] që e vlerësojnë 25 metra të lartë.



Shushurima e Thethit

Dt 16 gusht ora 02 pas mesnate të rinjtë lënë Thethin dhe duke ndriçuar rrugën/shtegun me 40 pishtarë të ndezur arrijnë ora 6 në Shtegun e Dhenve. Gjatë zbritjes ata takojnë malsorë që punojnë si puntorë duke çarë e thyer shkëmbin për hapjen e rrugës automobilistike [rruga për në Dukagjin u inagurua në verën e vitit 1937-ab]

Dt 17 të hipur në një kamion, të ngjeshur si sardele, udhëtuan për në Shkodër.

Ky shkrim thekson se të tillë marshim rinia shkodrane nuk kishte organizuar më parë. Shkrimi ka dy foto nga Foto Pici.

Numuri 15 shtator 1933

Faqe 17. Artikull i shkruar nga Zef Dema

Alpet e Shqipnis Veriut

Artikullshkruesi është pjesëtar i ekspeditës së Universitetit e Seksionit të “D.U.O. Alpenverein” të Imsbruck-ut. Pasi përshkruan itinerarin dhe bëmat e ekspeditës autori na thotë se kjo ekspeditë herën e parë u ndërmorr në vitin 1930 dhe kaloi nëpër këtë itinerar: Shkodër – Prekal – Guri i Kuq – Shosh – Kodër Sh Ngjergj – Abat – Maja e Ndermajës. Këtu u realizuan disa ngjitje majash dhe itinerari i vetëm që gjetën dhe dolën në majë në Ndermaje i befasoi kur gjetën shënja se aty ishin ngjitur malësorë. Më pas ekspedita u vendos në Theth prej ku u ngjitën Jezera dhe Radoshina.

Për vitin në shkrim (1933) artikullshkruesi thotë se ekspedita ndoqi itinerarin: Shkodër - Hani Hotit – Rapsh – Hani Grabonit – Lumi Cemit – Nikaj – Qafë Pejë – ranxa e Harapit ku u ngrit një kamp dhe u kryen ngjitje alpinistike. Më tej ekspedita doli në Qafë Pejë – Okol - Theth – Qafë Valbonë dhe prej këtu u realizuan disa ngjitje alpinistike. Pastaj itinerari vazhdoi: Qafa e Boshit – Theth – Shtegu Dhenve – Bogë. Në majat afër Shtegut të Dhenve u ngjitën të gjithë. Ekspedita u drejtua nga Profesori i Universitetit Dr. H. Schatz, alpinist dhe glacialgeolog. Shkrimi shoqërohet me gjashtë foto që janë pamje nga Alpet tona. Për këto ekspedita pjesëmarrësit shkruan artikuj në shtypin perëndimor.

Ky artikull shoqërohet me gjashtë foto, pa emër autori.

Numuri 18.2 mars 1934

Faqe 15. Artikull i shkruar nga Turisti

Në malin e Cukalit

Shkrimi flet për ngjitjen në majën e malit të Cukalit nga një grup të rinjesh shkodranë prej 10 vetash (sipas fotografisë-ab). Grupi udhëhiqej nga Z. Kol Krajni (ndoshta udhërrëfyes-ab). Ndodhia e përshkruar i takon muajit gusht të vitit 1933.

Itinerari: Shkodër – Drisht – me autonjet. Më tej: Shllak – Vukaj – Kodra e Kunorës ku kalohet nata – Qafa e Cukalit – Kroni Fushës – Fusha e Liqenit – Shkodër. Shkrimi ka vlera edhe për propagandën e dobisë për të tilla dajë në natyrë. Shoqërohet me 4 foto nga Ded Jakova dhe nënshkruhet Turisti.



**Fusha e Liqenit. (Nji tubë djelmogash shkodranë me Z. Kol Krajinë në mjedis)
(Foto Ded Jakov)**

Foto e v 193



*Kjo është fotografia e parë (V 1934) e gjetur për Shtegun e Dhenve. Ndonëse e dobët në cilësi
ilustron kalimin e një grupi të rinjsh shkodranë në këtë shteg*

Numuri 25 dt 13 nëntor 1934

Zhvillimi i turizmit në Shqipëri

Shkrimi titullohet: Nder maje të panjoftuna të Dukagjinit

Artikullshkruesi thekson se grupi që realizoi verën e shkuar ngjitjen në malin e Cukalit, me përcjelljen e mbresave nga anëtarët pjesëmarrës, kanë bërë një propagandë të mirë që këtë vit “Grupe mbas grupesh ranë në stinën e vapës me kërkue nalsit e afërme të Shkodrës si Boga, Rranza në Vrih, Theth, Pult, etj. Se(pse) i cili do të shifte e të shijonte vetë, shka të tjerët diftojshin a shkrueshin për vizarin e panjoftun deritash t’alpeve të verit.....aq ma tepër u gëzuem, kur pam se turizmi ndiqej me zell prej të gjithë klasave si puntorë, e zejtarë, studenta e mësues, zyrtarë e privat etj, por edhe sa grupe familje marë paten guximin – për të parën herë në Shqipëri – m’u njitë me të madh e me të vogël Shtegut të Dhenve (1850) e me ra mandej në Theth, qendra e natyrshme e turistave.”

Grupi që vjet ju ngjit malit të Cukalit si dhe një grup i dytë u banë bashkë dhe “shetitën Dukagjinin t’organizuem ma së miri e të paisun me të gjitha mjetet e duhuna për një turë të tillë.”

“Me 17 korrik n’oren 4 në nade një grup 10 turistash me Rucksack, qadra, kanopë, karta, aparata fotografije, altometra, etj, u nis për në Prekal.....në Prekal gjejmë edhe një grup tjetër turistash”

Më 18 korrik drejtohen për në Gur të Kuq, mal të Shoshit, Shtupja e Shoshit (kaskadë), Qafa e Kumorës, Kodër Shëngjergj – që është qendra e Nënprefekturës së Dukagjinit.

Më 19 korrik ulemi tek ura e lumit të Shalës, Abretë, ku kalojnë natën tek famulltari.

Më datë 20 pa dalë dita nisen nga Abata për tu ngjit në majë të Ershallit (2250) duke kaluar nëpër Pecaj. Në majë sodisin dhe më pas ulen dhe ndalojnë në Lotaj ku edhe pushojnë të nesërmen (dt 21).


Më dt 22 nisen për në Theth. “kalojm edhe Shkallën e Thethit e bijm në Theth (850). Asht e kotë, të ndalemi ma gjatë e të përshkruejm bukuritë e natyrës së ktij katundi të vogël. Vetë Dr. Heinshejmer, një alpinist i njoftun n’Ausrtri, e ven Thethin mbi Sceld-in, i permendun në tanë botën për alpinizëm e qendër verimesh.”



Jezerca e fotografuar nga Gropat e Bukura më 24 korrik 1934

“Me 24 mbas darke lam çadrat në Theth, për m’u njitë majave Jezerës a Popllukës (2700), malet ma të nalta e Shqypni së veriut.... Te Gurra Shtrasës (1000) pimë për të mramen herë ujë kroni.” Kalojnë natën në stanet e një malcori nga Vukli në lartësitë e Qafë Pejës.

“Ne nesrtret (dt 25 – ab) marrim të zotin e shpis (stanit-ab) e nepër livadhe me lule bjeshkësh – çajë mali, soje gjithfarësh të luleve ‘mos më harro’ genciana – kalojm nëpër gurisht të rranxës të Jezerës. Lugina të vogla e humnere të thella 400-500 m gjatë, shkrepë, rrasa e gurishtë t’imtë, gryka e maje paramalesh shkojnë tue u ndrue gjat rrugës të marun deri sa tuj u kacavjerë e tuej u majë ma tepër me duer se me kambë mrrijm në Jezerë, i pari grup shqyphtar në majën ma të naltën e verit.”



Të rinjtë shkodranë duke u ngjitur në majën e Jezerës më 25 korrik 1934

Më 27 udhëtojnë Theth- Bogë. “Në Bogë gjejm sa e sa familje qytetarësh e kemi rasë me diftue t’interesuemvet përshtypjet, qu kurr s’harrohen.”

Më 28 udhëtojnë Bogë – Qafa e Keqe – Razua e Vrithit ku “gjejm sa e sa të njoftun prej Shkodre e ngrehin çadrat afër një livadhi të haptë. Më tej shkuan në Shkrel e prej atje në Shkodër. Turisti

Shënin: në të gjitha shkrimet në Revistën Minerva, secili prej autorëve të shkrimit nuk lë pa përmendur vlerat e daljeve në natyrë si:

Vlerat e gjithanëshme për shëndetin fizik dhe mendor të njeriut

Vlerat njohëse të kulturës dhe traditës shqiptare

Vlerat e bukurive natyrore të vendit tonë

Me raste artikullshkruesit ironizojnë ata parellinj që shpenzojnë vlerat monetare duke shkuar për pushime në vendet e tjera dhe duke u kthyer me tangërllekun e të qenit jashtë vendit me pushime, ndërkohë që kanë bukuri mahnitëse në vendin e tyre.

Artikulli shoqërohet me shtatë fotografi, pa emër autori.

[Shënim: është artikulli i dytë me veprimtari në malet e Shkodrës që nënshkruhen me autor TURISTI. Kur lexon artikujt bindesh se ky “Turisti” nuk shkon për të parën herë në vendet që përshkruan. Jo vetëm kaq, por më krijon bindjen se “Turisti” duhet të jetë Kol Krajni-ab]



28.08.1935 MAJA E BIGËS, GIMAJ

*Në Gimaj, 28 Gusht 1935 Malsorë të fshatit Gimaj dhe studjues,
e njëherësh alpinistë austriakë në majë të malit.*

Gazeta Sport, Nr. 6 shkruan:

Ekskursion alpinizmi në formë ndeshje

“Sot (12. 01. 1936) filloi prova e parë e ekskursioneve në formë alpinizmi të zhvilluara si ndeshje ndërmjet grupit të shoqërisë jashtëshkolore “Bashkimi Elbasnges” dhe shkollës normmale. Numuri i

ekskursionistëve nxënës ishte 67. Kjo garë u ba nga qendra e qytetit deri në majë të Krastës. Vetëm të shkuem rruga ka qenë 1.200 metra shesh dhe 300 metra përpjeticinë. I pari doli Gani Çela me 10' e 30".

Gazeta Sport Nr. 20, 16 prill - 1936

“Në vitin 1930 Enti Kombëtar i Djelmnisë Shqiptare dërgoi në Itali ma se 150 djelm shqiptarë për me pa malet e Alpeve dhe ndenjën ndër ato vende ma se një muaj. Por ajo organizatë nuk mendoj kurrë me organizue një shëtitje për të njoftë Shqipninë. Deri kur vendi ynë do t'i ngeli gjithnjë në harresë?”

Gazeta Sport, nr. 25, 21 maj – 1936

Maja e Ndreut

Reportazh për bjeshkët e Rrjollit

“... Një pamje e hapët na shtrohet përpara. Në të tana anët të përllan syni Bjeshkët e Dukagjinit prej Rrshellit e deri në Jezerë; lugu i Bogës, me male përreth që nuk mrrijnë me i mlue pamjen Bjeshkëve të Vermoshit: Veleçiku, liqeni, dedi, viset jugosllave, etj”

“... Mjerisht te na nuk i asht dhanë randsia sa duhet ktij sporti kaq të nevojshëm: turizmi të fision shpirtin, të ngjallë ndjesi të reja, të mbushë me guxim e të mson me përballue nevojët e ndryshme që jeta të paraqet.”

Rrok Zojzi



Maja Radohinës, foto e marë nga revista “DRINI”

Gazeta Sport nr 92, 11 shtator 1937

Në muajin gusht vizituen Shkodrën 155 turista jugosllavë, 110 francezë, 59 gjermanë, 57 çekoslovakë, 45 anglezë, 39 italianë, 22 amerikanë, 1 rus, 1 zvicerian.

(Shënim: ky informacion na mëson se ka egzistuar sektori i turizmit në një nga ministritë që e mbulonte këtë sektor).

Gazeta Sport nr 109, 29 shkurt 1938

Rëndësia e sporteve dimërore

Në fund të artikullit shkruhet”

“Në arritjen e qëllimit (skitë) mund të shërbejnë fare bukur degët alpinistike të shoqërive jashtëshkollore, Enti Kombëtar i Turizmit dhe Klubi Turistik-Automobilistik Mbretëror.”

Luigj Shala

Gazeta Sport nr. 112, 18 shkurt 1938

“.... Profesori i edukatës fizike, i simpatizuar prej nxënësve të tij, duke përfituar prej pushimeve të bajramit, organizoi një shëtitje për Maranaj, mali verior i Shkodrës që është 1.700 m i naltë.

... Ai u shoqërua nga 45 nxënës; ndër ta bëri pjesë edhe profesori i mirënjohur zvicerian Goujon.

U nisën nga shkolla në orën 5 të mëngjesit....Në orën 12 mbritën në majën e dëshiruar. ... Neve na pret shëtitja në Cukal – 2000 m mbi nivelin e detit.”

Rustem Buzo

Gazeta Sport, nr 128, 9 korrik 1938

Alpinizëm

Shëtitje për në Cukal

Malet arbënorë na thërrasin

..... 20 nxënës u regjistruan për të marrë lejen e drjtorit. Në orën 5 të mëngjesit të datës 15 prill u nisëm.... Kaluam Fushën e Shtoit. Në orën 16 arritëm në Vukaj, ku kaluam natën tek bamirësi Mhill Pjetri.

Me tu gdhirë u nisëm. Binte borë por pas pak pushoi. Si kaluam shumë vështirësi, më në fund mbritëm në majë ku përsëritëm thirrjen: “ ju thërresim malet arbënore për tu thithur ajrin e pastër e për tu pirë ujin e kulluar të burimeve të ftohta, për të shijuar jetën, për të fituar shëndetin, ato që kurrë nuk fitohen në qytete!”

Gazeta Sport nr 133, 13 gusht 1938

Në shërbim të turizmit malor. Shëtitje nëpër male

Një javë në majat e Nëmërçkës

“.... Siç dihet, në vendin tonë ka munguar në mënyrë sistematike praktikimi i ekskursioneve nëpër maja malesh të lartë.

Pak vjet më parë, një grup i formuar nga djemtë e këtij qyteti (Përmeti) shkoi në majën e Papingut nga ku u kthye me përshtypje të veçanta. Po kjo punë u përsërit edhe vjet prej një grupi tjetër nga gjiri i shoqërisë jashtë shkollore të këtij qyteti, i cili caktoi të shkonte nga një rrugë tjetër për në majë të malit, por nuk e arriti qëllimin, se rruga nuk ishte adapte për tu shkelur nga këmba e njeriut.

Për arësye se nuk u arrit qëllimi, grupi mendoi që këtë vit të vinte në majë të Papingut nga një rrugë më e lehtë. Grupi u nis më 18 korrik, i kryesuar nga zoti Pano Vasili
Grupi mori drejtimin nga ana Magallarit... Mbritën në majë. Kur zbritën qëndruan disa ditë në qafë.
Me nxënësit kishte edhe disa të moshuar që e duan natyrën.

Në shtypin tonë, si dhe në botime të huaja, është shkruar për topografë, gjeologë, alpinistë, antropologë, etj (disa prej tyre kanë qenë njëherësh edhe alpinistë) të cilët i kanë vizituar disa male dhe kanë ngjitur maja malesh të vendit tonë. Kështu p.sh. sipas “Le Petit Journal” (10 gusht 1937, faqe 10) del se edhe Klubi Alpin Francez ka patur interesa të karakterit njohës për Alpet Shqiptare. Këtë e pohon kjo gazetë ku shkruhet:

“Një grup alpinistësh të Klubit Alpin Francez të Parisit, nën drejtimin e Z. Henri Godde, sapo është larguar nga Franca, në drejtim të Shqipërisë së Veriut, me qëllim kalimin e vargmalit ...të Alpeve Shqiptare.

Kësaj ekspedite, të cilës do t’i shtohen ngjitjet e disa mureve gëlqerore dhe eksplorimi i grykës së Drinit, paraqet rreth 150 km, nga Shkodra në Kukës, dhe zhvillohet në një rajon pak të frekuentuar.”
Nuk dimë më shumë rreth kësaj ekspedite.

Në vitin 1936 në revistën MINERVA gjejmë artikullin e parë në të cilin hapet në shoqërinë tonë tema e turizmit si një mundësi që të ndihmohet ekonomia shqiptare; si ajo e zonave malore ashtu edhe ajo e qyteteve tona.



Pjesë e shkrimit të revistës MINERVA në Maj të vitit 1936

Në artikull turizmi shikohet si mjet që jep mundësinë për ndryshim të shpejtë të gjendjes ekonomike: efikas, ma i shpejtë e më i fuqishëm për përmirësimin e gjendjes ekonomike.


Themelet për turizëm në vendin tonë:

1. Të vihet në dukje ajo që ka krijuar dora e njeriut. Kjo e kombinuar me bukuritë natyrore.
2. A janë bukuritë natyrore të tilla që të tërheqin të huajin? Pa dyshim që PO. Janë malet, në veri e në jug, janë liqenet, janë detet dhe brigjet e tyre në Adriatik e në Jon, etj.
3. Qytetet dhe qendrat arkeologjike si: Shkodra, Kruja, Butrinti, Apollonia, Kishat, etj.
4. Orienti Ballkanik. Është karakteristikë e ballkanasve që e bën të huajin të tregojë interes për ta vizituar.
5. Është folklori, jeta e popullit (muzetë përkatës), sjellja me të huajt, mikpritja.

Në artikull theksohet se “përveç pjesës thjesht materiale turizmi ka:

“Rrëndësi të madhe kombëtare, politike, shoqërore dhe kulturore, sepse nëpërmjet turizmit evidentohen më së miri dhe më me efekt mashtimet që krijohen për një vend nga mosnjohja, mosdija ose edhe prirja e njëanëshme; disa herë mundet edhe nga xhelozia....Turizmi ka efekte edukative edhe në vetë popull, prandaj është në interesin e përgjithshëm me e ndihmue me gjithë zemër, qoftë edhe me disa sakrifica të para, që cilat janë të nevojshme thujse në çdo veprimtari të re”.

Në drejtim propagandës për përhapjen e turizmit në vendin tonë rol të veçantë luajti revista DRINI që filloi të botohej (Botime Distaptur Tiranë) në vitin 1940, si organ i turizmit kombëtar. Kjo revistë luajti rol të rëndësishëm, nëpërmjet shkrimeve në të, për njohjen e shqipërisë turistike dhe alpinistike. Vlen të theksohet se kjo revistë kishte një “kolonë” të emërtuar Alpinizëm. Në këtë kolonë nuk kam parë as foto dhe as shkrim për veprimtari alpinistike. Por theksoj se në këtë revistë ka jo pak artikuj të shkruar nga ethnologu ynë i parë Rrok Zojzi (1910-1995). Artikujt e tij për njohjen e Shqipërisë turistike, alpinistike, etj, janë me vlerë edhe sot e kësaj dite. Rrok Zojzi në literaturë përmendet edhe si alpinist, por nuk kam mundur të gjej as edhe një foto të tij, ose foto ku ka pozuar dhe ai si alpinist. Kjo revistë u botua deri në fund të vitit 1944 në sajë të përkushtimit që treguan Drejtori Përgjegjës Demir Alizoti dhe Krye Redaktori Skënder Shkupi..



Revista DRINI 1940-1944

Vlen të përmendim ngjitjet e realizuara në vendin tonë gjatë Luftës së Dytë Botërore nga një ekspeditë italiane me alpinistë (njëherësh studiues me tituj shkencorë) të mirëfilltë. Ata kanë bilancin ma të pasur në sasi të ngjitjeve malore në Shqipëri të realizuara ndonjëherë, deri në ditët tona, nga një ekspeditë. Nga 1 Qershor deri më 27 Shtator të vitit 1940, ata realizuan 54 ngjitje. Alpinistët kryesorë të kësaj veprimtarie kryesorë ishin alpinistët e studjuesit Saturini, Mazzoni dhe Ghiglione, si dhe alpinistë të tjerë Filafarro, Zambelli, Dall'Amri, Cappi, Chiocchetti dhe De martini. U ngjithën në majat nga më të lartat, e më të rëndësishmet e vendit tonë. Në më të shumtat e ngjitjeve ata morën si pjestarë të grupit të ngjitjes edhe malësorë apo banorë vendas, të cilët shërbenin edhe si udhërrëfyes për shtigjet që ata njihnin, por që në të njëjtën kohë, në shumë raste, ata gjithashtu i ngjitën majat bashkë me alpinistët Italianë.

Dy prej anëtarëve të ekspeditës Italiane (në bazë të njohurive të mija) pas përfundimit të ekspeditës na dhanë botime. Botimi i Dr. Luigi Saturini-t "Spedizione alpinistica italiana nelle Alpi Albanesi" 1940 – XIX" u botua në vitin 1941. Për vlerat alpino-turistike të maleve Shqiptare dhe përshkrime të itinerarëve drejt majave (bashkë me një studim që meret me Rapsodët e malevet shqiptare prej Nicola Lo Russo Attoma) u shkrua nga Piero Ghiglione në botimin e tij të përkthyer në shqip "Malet e Shqipnis" (Botime të DISTAPTUR-it në Tiranë).

Në Gazetën Tomori datë 3 tetor 1941 kemi artikullin me titull "Nji libër për apasjonuesit e maleve". Autori i shkrimit bën të ditur botimin e përkthimit të autorit Piero Ghiglione. Në këtë shkrim lexojmë: "Piero Ghiglione asht një entuziast i maleve të shqipnis. Ai lavdëron veprën e Turizmit Shqiptar që ka ndërtue nji streh-bujtinë të Thethit..."

Në gazetën TOMORI, datë 7 nëntor 1941, gjendet një tregim intresant i shkruar nga një alpinist i mirëfilltë, nënshkruar "Drini" (Drini ishte Revistë, Organ i Turizmit Kombëtar, që doli gjatë viteve 1940-44 gjatë pushtimit Italian të vendit tonë). Vazhdoi të dalë, edhe pasi Italia kapitulloi, çdo 1-2 muaj deri në fund të vitit 1944 në sajë të përkushtimit nga Drejtori Përgjegjës i saj Demir Alizoti dhe Kryeredaktorit Skënder Shkupi. Revista lejonte të botoheshin shkrimet e saj në organe të tjera të shtypit me kusht që në fund të shkrimit të shënohej emri i revistës. Me shumë gjasa autor i shkrimit është njëri nga alpinistët që u ngjit në këtë majë (Ghiglione, ose Mazzoni, ose Zambelli, ose Filafarro). Ai, ndër të tjera na jep edhe këtë informacion:

..... *Si nji mburoje e pakalueshme me shkam dolomitik e thepor (njeni i ngjan Crozonit [Zvicër – ab] të Brenta, në Cadro) naltësohet mali i Thatë përmbi Bogën.*

..... *Nji përde e mbinatyrshme na pengoi ecjen. Ishte mali i Thatë, me brijt e tij të thikta. Mbas disa mundimeve dhe ecjes para e mbrapa, vuem litarin në shkambin gëlqeror. Prej këndeje nji punë ma e vështirë për t'arrit në shpinoren e Malit të Thatë 2,500 m. Pamje të mrekullueshme, lugina, borë, e shkamij të thikta. Aty këtu ka edhe fusha për ski.*

..... *Mbi Bogë bjen thikë trupi i malit të Çardakut që më kujton kullat e Kaisergebte. Në pikat ma të thikta takohen pemë të pak kohëshme të rituna si magjikisht. I u ngjita brinjës perëndimore me dy shokë të aftë. Nji trup kroni i përpjet nja 60 metra i lagun.*

Në orën tre masdreke me nji mjegull të shpesht jemi në majë, prej këtu pa dash pash ujnate e Ligenit të Shkodrës.....

Drini

Shënim: kur shkrimet merreshin nga një organ shtypi prej revistës “Drini”, ky organ në fund të shkrimit duhej të vendoste emrin e saj.

Gjatë kohës së pushtimit fashist të vendit tonë pati zhvillime lidhur me institucionalizimin e turizmit komercial. E quaj komercial sepse institucioni shtetëror u mor me hotelerinë, me personelin e shërbimit në to, të mbështetura këto me shkollë ku përgatitej personeli sipas një programi të caktuar. Për këto hotele dhe bujtina u caktuan stanarde (shoqëruar me botime zyrtare) të vlefshme për turizëm masiv komercial. U hap edhe shkollë për hotelieri e turizëm.



MBRETNIA
REGNO



SHQIPTARE
D'ALBANIA

KRYESIA E KËSHILLIT MINISTRUER
PRESIDENZA DEL CONSIGLIO DEI MINISTRI

DREJT. E PËROJË E SHËTYPIT, PROPAGANDËS DHE E TURIZMIT
DIREZIONE GENERALE PER LA STAMPA, PROPAGANDA E TURISMO

Përmbledhja Zyrtare e Ngjave, dekreteve dhe
rregulloreve që i përkesin Drejtorisë së Përgjithshme të Shtypit, Propagandës e Turizmit.

Raccolta Ufficiale delle leggi, decreti regolamenti che riguardano la Direzione Generale per la Stampa, Propaganda e Turismo.

NORMA PËR AKTIVITETIN E HOTELEVET

NORME RELATIVE
ALL'ATTIVITÀ ALBERGHIERA



Dekret Mëkambësues Nr. 120, i datës 26 Shkurtor 1939-XVII, i botuem në "Fletoren Zyrtare",
Nr. 98 të datës 23 Tetor 1939-XVII.

Decreto Luogotenenziale Nr. 180, in data 30 Sett. 1939-XVII, pubblicato nella "Gazzetta Ufficiale",
Nr. 98, in data 23 Ottobre 1939-XVII.

MINISTRIJA E KULTURËS POPULLORE
MINISTERO DELLA CULTURA POPOLARE

ORGANIZIM' I SHERBIMEVE

TË MINISTRIS SË KULTURËS POPULLORE

ORGANIZZAZIONE
DEL MINISTERO DELLA CULTURA POPOLARE



Dekreti Mëkambësues Nr. 10 i datës 12 Janar 1943-XXI, i botuar në „Rikthet
Zyrtarë“, Nr. 14 të datës 8 Pruer 1943 XXI.
Decreto Luogotenentele Nr. 10 in data 12 Gennaio 1943-XXI, pubblicato nella
«Gazzetta Ufficiale» N. 14 in data 8 Febbraio 1943-XXI.



MINISTRIJA E KULTURËS POPULLORE
MINISTERO DELLA CULTURA POPOLARE

SHKOLLA BUJTINORE

SCUOLA ALBERGHIERA

Në botimin e Ghilgiones mësojmë që Thethi ka një bujtinë. Ish mësuesja e Dukagjinit, thethjanja Syke Micani, më ka informuar se në Theth para dhe gjatë L2B ka pas tre bujtina: shtëpia e Lek Currit në qendër dhe në Okol ajo e Can Tahitit dhe e Sadri Lukës.

Ja një ilustrim nga revista Drini që ka të bëjë me bujtinën në Petrelë.

Viti 1942

Qendra e vogël por piktoreske e Petrelës, 13 km prej Tirane, mbi xhaden Tiranë-Elbasan gjatë muajit korrik të çdo viti është një cak tradicional piknikesh kolektive. Këto piknike bahen çdo të premte me pjesëmarrje aq të madhe publiku sa që në ate ditë organizohen rregullisht shërbime të posaçme publike (besoj se është fjala për transport-ab) për ate qendër gazmore turistike. Këtë vit pjesëmarrja e publikut do jetë edhe më e madhe sepse Drejtoria e Trurizmit është kujdesur me e pajos Petrelën me një bujtore - gjelltoe të rehatëshme.

Një shtëpi e vogël që madhësisht mbante emnin Hotel-Kafe Restorant Petrela, e xhveshun nga çdo element estetike e higjene me gjurma të dukshme të mos kujdesjes ma të shkretë, në bazë të projektit e realizimit të Zyrës Teknike të Drejtorisë së Turizmit asht ndrrue në një pallat të vogël modern egazmuer në të cilin do të ketë qendrën e denjë të vet e admisirume nga Drejtoria e permendun.

Bujtinorja-Gjelltorja e re Taverna-Della- Bella Rossellana.

Kjo ndërtesë i paraqitet publikut me një stil të thjesht që nuk bie në kundërshtim me pamjen e mureve të vjetra të këshijellës dhe e qet kryet me një fare madhështie mbi ate luginë me persjanet (besoj e ka fjalën për kanatat-ab) e blerta të saj me një terracë të lulëzume e një ballkon gazmor e të ndritshëm.

Përbrenda përbahe nga një bar e një kthinë-hyemje përveç shërbimeve. Kati parë përfshin dhomat e fjetjes me banja shumë moderne dhe ujë të rrjedhshëm. Të gjitha kthinat janë të stolisura dhe të mobilueme në stil fshatarak.

Bujtorja do të hapet rregullisht në ditët e para të korrikut dhe njëkohësisht do të filloj një shërbim automobilistik Tiranë-Petrelë.

Shënim: Petrela ka patur rrugë automobilistike që në kohën e Mbretit Zog. Mbretit, i çonin ujë të pijshëm nga Petrela dhe Qafë Shtama. Petrela ka qenë nën prefekturë e prefekturës së Tiranës deri rreth vitit 1956.

Koment.

Nga fillimi i shekullit XX-të e deri në përfundim të L2B sportet dhe sportistët në shqipëri nuk ndjenë udhëheqje nga shteti për zhvillimin e tyre. Sportet u përhapën dhe u zhvilluan, për aq sa u zhvilluan, më fort me nisma të të rinjve sportdashës si dhe kryesisht inteligjencës së kohës dhe rinisë shkollore. Mësuesit e edukimit fizik ishin pishtarë të përhapjes së sporteve edhe në shkollat ku ishin emëruar edhe në mënyrë vullnetare. Këto ishin përpjekje e kontribute pasionantësh për sporte të caktuara, njerëzish përgjithësisht të kulturuar të vendit tonë për kohën, Kontributit të tyre financiar si anëtarë të shoqërisë sportive (shoqëritë sportive caktonin një nga anëtarët e tyre me detyrën e arkëtarit) i shtoej edhe ndokush nga shtresat e pasura, që në frymë partiotike e kuptonte rëndësinë e sportit për argëtimin dhe forcimin e shëndetit fizik e mendor të rinisë. Ata ishin vullnetarë modestë që nuk morën shpërblime të ndonjë lloji për aq sa bënë, por që historia e sejcilit sport i kujton dhe i admiron si pishtarë të sporteve në Shqipërinë tonë. Të njohur, nëpërmjet rekordeve, për kontribute në veprimtaritë turistiko - alpinistike janë Avni Zajmi, Sotir Papahristo.

Deri në përfundim të L2B vendi ynë nuk “prodhoi” ndonjë alpinist që të merrete pjesë në veprimtari të ngjirtjes së maleve të larta të Evropës. Sipas dokumentave që gjenden kemi vetëm pjesëmarrje të kufizuar, deri pesë anëtarë, e gjurmuesave tanë në takime ndërkombëtare të skautistave si dhe arritja prej tyre e mjeshtërisë në gjumuesisë që morën titullin MS (Master Scout = Mjeshtër Gjurmues).



Kostaq Stefa mori titullin Mjeshtër Gjurmues në Londër në vitin 1926

Deri para fillimit të L2B nuk kam gjetur material që të dëshmojë se lëvizja sportive e turizmit të kishte një “zyrë” të caktuar në systemin e sporteve në vendin tonë, që të drejtonte këtë lëvizje sportive. Për alpinizmin jo e jo. Por kishte një entitet (sikundër e gjej të shkruar) i cili gjatë pushtimit Italian, por edhe më pas, ishte për turizmin komercial.

Lëvizja turistiko alpinistike u organizua brënda qyteteve kryesore (d.m.th. jo në të gjithë qytetet) me shoqëri dhe në mënyrë vullnetare. Nga këto më të konsoliduara ishin Gjurmuesia e Tiranës dhe ajo e Korçës të cilat patën edhe botime.

Shënim: kam ndjesinë se në botimin “Kronikë e një jetë shekullore” me autor Genc Zajmi ja vlen të shikohen origjinalet e Avni Zajmit për të përmirësuar elementë të veprimtarisë së Gjurmuesave).

Fillimet e Veprimtarieve Sportive Malore të Organizuara mbas Luftës së Dytë Botërore

Mbas L2B qeveria filloi të riorganizojë lëvizjen sportive në vendin tonë. Shprehur më saktë, filloi të organizojë lëvizjen sportive sepse çdo sport u konsiderua që filloi nga e para (nga niveli zero). Ky organizim kaloi nga viti në vit duke u përmirësuar, gjithnjë sipas udhëzimeve të partisë, dhe ndoqi shkallët si më poshtë vijon.

Në vitin 1945 pranë Ministrisë së Arsimit e Kulturës u krijua një seksion i posaçëm i cili do të përgjigjej për fiskulturën dhe sportin.

Për të organizuar dhe vënë në rrugë shtetërore fiskulturën dhe sportin detyra ju caktua Bashkimit të Rinisë Antifashistë Shqiptare (BRASH-it). Me porosi të Partisë BRASH-i krijoi Federatën e Sporteve të Shqipërisë (FSSH).

Më 2 shtator 1945 krijohet/themelohet Federata Sportive Shqiptare. Kjo Federatë ka gazetën e saj: SPORTI, pra me të njëjtin titull si edhe para vitit 1945. Pas tre vjetësh kjo gazetë u quajt Sporti Popullor.

16 shtator 1945 (shkrim nga Gazeta SPORT):

“Konferenca për zgjedhjen e Federatës së Sporteve u zhvillua në 2-3 shtator në një nga sallat e Sekretariatit të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare (Brash-i). Përveç 58 delegatëve të Klubeve të ndryshme mirnin pjesë si dëgjues edhe shumë sportista dhe sportdashës të kryeqytetit dhe midis këtyre qëndronte Prof. Sejfulla Malishova (minister i Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore).

Nënpresidenti Brash-it, Fadil Paçrami, hapi mbledjen. Ai përpara së gjithash ju drejtoi nga ana e Sekretariatit të Brash-it përshendetje të gjithë delegatëve. Pastaj vuri në dukje interesin dhe kontributin e madh që organizata e Brash-it ka treguar për ringjalljen e një lëvizje sportive sa më të madhe në vendin tonë.

Ai tregoi se kjo organizatë e ka parë sportin si problemin e saj të lidhur ngushtë me jetën e rinisë që vlen jo vetëm për bashkimin dhe zhvillimin fiziko-moral, por edhe për dëfrim dhe zbavitje. Brash-i ka ndihmuar mjaft në ngritjen e sportit dhe është munduar që ta vërë këtë në rrugë të drejtë. Ai e mbylli fjalën duke premtuar se Brash-i do jetë një ndihmë edhe më e madhe në të ardhmen për zhvillimin e sportit dhe të Federatës së Sporteve derisa kjo të marri formën e duhur.”

Më 11 janar 1946 vendi ynë u shpall republikë; Republika Popullore e Shqipërisë. Në Statutin e Republikës thuhej: **“Shteti kujdeset për edukimin fizik të popullit**, sidomos të të rinjve, me qëllim që të përmirësohet shëndeti dhe të shtohet fuqia e popullit për punë dhe për mbrojtjen e shtetit”

Me porosi të K.Q. të Partisë, Qeveria vendosi të krijohej Komiteti i Kulturës Fizike e Sportit. Ky organ do të drejtonte të gjithë punën në rrugë shtetërore: administrimin e fondeve për fiskulturë (fizikulturë/a = kalitje e gjithanëshme e trupit të njeriut nëpërmjet ushtrimeve fizike; kulturë fizike; edukim fizik) e sport (sport-i = veprimtari për zhvillimin dhe kalitjen e trupit nëpërmjet ushtrimeve fizike; lojrave të ndryshme, etj; çdo lloj i veçantë i kësaj veprimtarie), shtimin dhe përmirësimin e bazës materiale, përgatitjen, kualifikimin dhe shpërndarjen e kuadrit, hartimin e prograameve për edukimin fizik në shkolla, etj. Federata e Sporteve e Shqipërisë do të vazhdonte për një kohë si organizatë masash, duke u marrë kryesisht me veprimtaritë sportive lokale, kombëtare e ndërkombëtare, sipas kalendarëve sportivë të caktuar.

Federata Sporteve Shqiptare në datë 22 mars 1946 zgjodhi Këshillin dhe Kryesinë e saj. Këshilli i Federatës përbëhej prej 41 vetash. Midis tyre ishin: Kiço Karaguni, Kristaq Bimbli, Alfred Kazanxhi, Thoma Nushi, Telemak Anastitiadhi, Sami Kerkini, Qemal Mandia, Zef Hila, **Luigj Shala** (si specialist i sportit të skive), Anton Mazreku, Anastas Shundi, Skënder Begeja, Adem Karapici, Hajdar Jakupi, Selman Stërmasi, Niko Opari, Sali Nallbani, **Kostaq Stefa** (përfaqësues i Gjurmuesave), Luigj Pojani, Spiro Shuteriqi, Nefise Kokobobo, Vasil Naqi, etj.

Konferenca njëherësh, nga anëtarët e Këshillit të Federatës, zgjodhi edhe Kryesisë së saj.

Në Kryesi u zgjodhën:

Kryetar Andon Mazreku

Sekretar Kristo Papajani

Anëtarë: Galpi Hatibi, Hulo Hadëri, **Minella Kapo**, Hajdar Jakupi

Në vitin 1949 Komiteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve kaloi pranë Këshillit të Ministrave me synim që të forcohej **drejtimi shtetëror** i sporteve.

Në vitin 1950 doli vendimi për punë me orar të reduktuar për sportistët. Ky vendim kishte kufizime/ përcaktime në llojin e sporteve ku do të zbatohesh, si edhe në kategorinë (cilësinë) e sportistit. Në fund të viteve 70 dhe gjatë viteve 80 vendimi përfshiu edhe alpinistët e kategorisë së dytë sportive (edhe me pak trajtim ushqimor) dhe lart (me më shumë trajtim ushqimor).

Në vitin 1951 Këshilli i Ministrave miratoi titujt sportivë që nisnin me sportistët e rinj dhe vazhdonin me sportistë të rritur: kat III, Kat II, Kat I dhe Mjeshtër Sporti.

Në vitin 1957, me porosi të KQPP Këshilli i Ministrave doli me një vendim të posaçëm për shkrirjen e shoqërive sportive egzistuese dhe për krijimin në vend të këtyre të një organizate të vetme: Bashkimi i Fiskulturistëve dhe Sportistëve të Shqipërisë (BFSSH).

Ilustrim nga Gazeta Sporti Popullor:

Me vendim të Këshillit të ministrave datë 30.12.1957, në sektorin e fiskulturës dhe sportit u bë organizim i ri. Shkrihen disa shoqëri sportive dhe krijohet/formohet organizata e vetme :Bashkimi i Fiskulturistëve dhe Sportistëve të Shqipërisë (BFSSH). Njëherësh krijohet Komiteti Shtetëror i Kulturës Fizike dhe Sporteve. Në këtë kohë miratohet edhe emri përfundimtar për ekipet e qyteteve të ndryshme. (Kështu, p.sh.

emërtesa Klubi Sportiv Flamurtari përmbledhite nën një drejtim dhe administratë të gjitha sportet e qytetit të Vlorës)- (ab).

Me këtë rast u afruan të gjithë ata sportistë që deri atëherë kishin dhënë kontributin e tyre në sporte të ndryshme, përfshirë alpinizmin.

*Në këtë periudhë i jepet rëndësi e veçantë **sporteve ushtarake si alpinizmi**, qitja e radioamatorizmi. (Kujdes: alpinizmi përcaktohet si sport ushtarak!!).*

Në v 1958 në Tiranë u mbledh Konferenca e parë Kombëtare e BFSSh. Në këtë kohë në vendin tonë numëroheshin: 135 Mjeshtra Sporti; 650 sportistë të kat I-rë. Edhe rekordet e para L2B të sportistave tanë ishin thyer që të gjitha. Tashmë vendi ynë kishite rekordmenë dhe rekorde të reja.

Në vitin 1958 filloi nga Puna Instituti i Kulturës Fizike e Sporteve “Vojo Kushi”, sot Universiteti i Sporteve Tiranë. Ky institucion nuk ka patur, dhe ende nuk ka, program për sportin e alpinizmit që të mund të ndiqet nga studentët e tij.

Zhvillimet si më sipër u shoqëruan dhe u pasqyruan në masën e sportistëve dhe popullit me endjen e një filozovie të re të menduarit dhe të vepruarit. Pra sportin e mori nën kontroll, në të gjitha drejtimet, shteti. Dhe shteti i ri nuk harroi që pa filluar dhe pa bërë punët e reja të shpërfillte atë që bënë sportistët dhe sportdashësit e vendit tonë deri në këtë kohë. Kështu në shtypin e kohës gjejmë shkrime ku të habisin denigrimet (nxirjet, shpërfilljet, përçmimi, nënvlerësimi). Ja pak fjalë ilustruese të nxjerra nga shtypi i viteve 1945-1946.

Për sportin në vendin tonë më tepër kemi të bëjmë me diçka sporadike, të veçuar, të rrallë, me një aktivitet të zbehtë që bëhej në një shkollë a lagje.

Midis 1.200 anëtarëve të klubeve sportive që numëroheshin në atë kohë (para L2B), shumica i përkiste shtresave të privileguara të regjimeve në fuqi, që kishin kohë dhe mundësi të merreshin me sport. (Filloi kështu “lufta e klasave” në sport. Por nga kjo fjalë ne mësojmë se në vendin tonë kemi pasur 1.200 anëtarë të shoqërive sportive! Jo pak për Shqipërinë tonë të atyre viteve!(ab).

U ironizuan edhe thënie të Mbretit Zog si: “*I tanë kujdesi em i kushtohet djelmënisë të dishiplinueme*” (sigurisht jo rrugaçërisë- ab).

U ironizuan edhe thënie të Princeshës Myzejen, si në këtë rast: *Në dekalogun e saj për/të djalit sportist shqiptar në pikën 4 shkruhej: “Asnji kolektivitet s’mundet me qëndruar pa disiplinë. Për djelmërinë kjo ndjenjë duhet të jetë një instikt”.*

Shtypi i kohës pas vitit 1945 na tregon se ka një veprimtari të zbetë për sportet në natyrë. Organizohen veprimtari lokale me ekskursione dhe ndonjë ngjitje malore a kodrinore. Ja disa artikuj tipik për veprimtari turistiko-alpinistike të cilat, **për mendimin tim kanë vlerë sepse i mundësojnë veprimtaritë në natyrë të përmenden si terma dhe më shumë janë shkrime që e propagandojnë turizmin dhe alpinizmin.**

30 korrik 1945

*“Seksioni i Kulturës Fizike pranë Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore ka përgatit kalendarin (sportiv-ab) për sivjet. Në muajin maj kanë qenë parashiku **ekskursione alpinistike në formë pikniku ose në formë garash lokale** (e habitëshme për konceptin- ab).*

*Kronikat e botueme që flasin mbi shëtitje të tilla të bame pothuajse në të gjitha krahinat tona na kanë dhanë me kuptue se **ky sport turmash** ka gjet një pritje të nxehtë edhe në vendin tonë.*

Jemi të bindun se ekskrsione aq të këndëshme e të dobishme do të shkojnë tue u bamun gjithnji ma të shpeshta. Ajri i pastër dhe natyra e bukur e fushave dhe e maleve tona do të tëheqin turma gjithnji e ma të mdhaja me flladitë trupin e lodhun nga jeta e qytetit tue ngjallë e tue përtëri energji të reja në një ambient të përbashkët shplodhje, dëfrimi e bashkëpunimi.”

12 janar 1946

“Veçanërisht në ditë moti të mirë i shërbehet mirë qëllimit për t’ia mrrijtë propagandës sportive edhe në degë t’alpinizmit tue organizue grupe që dalë nga dalë t’i arrihet interesimit të turmave të rinisë dhe miqve të sportit, në fillim qoftë vetëm në trajtë shetitjesh të shkurtna jashta qytetit. Mbas një veprimtarie të tillë nuk do jetë e vështirë me përfitue nga rasti, në mënyrë që të nxitet rinija për ecje në kambë dhe në pjesë malore a vende të tjera, ku paraqitet bukuri natyrore të stinës dimërore, qendra me vlera peligrinazhi patriotik, etj.

Shetitje të tilla marin vlerë të posaçme në lidhje me zhvillimin trupor të sportistave dhe të turmave sportdashëse. Ato japin rast për të vu në dukje gjithashtu dhe për të shtue aftësit atyne që do të paraqiten të gatshëm për të marrë pjesë në formë provash për nxitje morale. Kësisoj mund te arrihet fare mirë edhe provave për ngjitje në pjesë shkëmbore, etj.”

Në qendrat ku ka mundesi pështatet fort bukur organizimi i eskursioneve nëpër kodrina dhe pjesë malore ku të marin pjesë grupe skiatoresh.

Shetitje te tilla me ski lypsen me u ba në vende të përshtatëshme.

Ne raste të tilla nevoiten me parapa dhe ndalime të shkurta në pjesë vendesh ku të mund të kryhen veprimtari reshkitje, veçanërisht me ma të aftët e grupit, në trajt mësimi për të tjerët që mund të jenë fillestar.

Komiteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve (1949-1992). Organi më i lartë shtetëror që drejtonte veprimtaritë në fushën e kulturës fizike dhe sporteve në vendin tonë. Bërthama e KKFS u krijua me Seksionin e Kulturës Fizike dhe Sporteve pranë Ministrisë së Kulturës dhe Propagandës (1945); më 1947 u kthye në KKFS pranë Këshillit të Ministrave; më 1953 kaloi në ministrinë e Shëndetësisë dhe nga viti 1958 deri sa u suprimua (1992) funksionoi pranë Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës.

Veprimtaritë sportive u politizuan në forma të ndryshme, por më e dukshmja ishte me temën **“Për nder të kujt organizohej”**.

Kështu, për veprimtaritë alpinistike më të përsëritura ishin:

Ngjitje për nder të shpalljes së Republikës. Organizohet në data të tilla që ngjitja e majës, mundësisht, të realizohet në 11 janar.

Ngjitje për nder të Ushtrisë së Kuqe (në BRSS). Organizohej në data të tilla që ngjitja e majës, mundësisht, të realizohej në 23 shkurt.

Ngjitje për nder të Ditës së 8 Marsit (festa e grave). Organizohej në data të tilla që ngjitja e majës, mundësisht, të realizohej në datën 8 mars.

Ngjitje për nder të 23 nënrorit (data e krijimit të Rinisë Komuniste Shqiptare). Organizohej në data të tilla që ngjitja e majës, mundësisht, të realizohej në 23 Nëntor, etj.

Kishte edhe të llojit tjetër, si “Për nder të festës së kufirit”; “Për nder të përvjetorit të krijimit të Ushtrisë Popullore”, etj etj.

Mbi riemërtimet e majave të maleve

Në vendin tonë, pas L2B u ndryshuan, ndër të tjera, shumë emërtime rrugësh. Emërtimet e maparëshme u zëvendësuan me emërtime që lidheshin me luftën N. Çl. si dhe me systemin e ri shoqëror që filloi të ndërtohej në vendin tonë. Patën përparësi datat historike të luftës si dhe emra dëshmorësh të rënë gjatë luftës.

Edhe me emrat e maleve ndodhi diçka e ngjashme. Kjo histori emërimesh filloi në datën 21 Maj 1950. Në veprimtarinë e organizuar për ngjitjen në majën **Çuka e Tomorit** (2396 m), pjesëmarrësit e ngjitur në majë organizuan një ceremoni me fjalime të rastit dhe me valëvitje të flamurit kombëtar dhe e pagëzuan këtë majë me emrin **Çuka Partizan**.

Pas kësaj, në korrik të po këtij viti u organizua ngjitja në malin e Marroces dhe maja e këtij mali, Maja e Hekurave, u pagëzua me emrin **Maja e Paqes**.

Kjo risi e kohës vazhdoi edhe më tej në vite dhe kemi më poshtë listën me këto pagëzime:

Maja e Popllukës u pagëzua Maja 8 Marsi. Kjo sepse maja u ngjit për herë të parë në dimërin e vitit 1960 nga një grup alpinistash, meshkuj e femra, që udhëhiqej nga një femër, nga Tefta Zguro. Kjo datë njëherësh na kujton 8 Marsin, që është dita ndërkombëtare e grave (festa e grave).

Maja e Jezerës/Jezercës u pagëzua pas dy ditësh me emrin Maja e Rinisë. Kjo majë në harta dhe mësimet e gjeografisë, si në arësimin para universitar edhe në arësimin univesitar shkruhet dhe njihet me emrin maja e JezerCës (2. 694 m). Të habit fakti që banorët që e shohin atë e quajnë maja e Jezerës (pa C) dhe me fjalën jezerë ata nënkuptojnë mjegullën. Tre alpinistët e parë që janë ngjitur në majën e Jezercës (10 mars 1960) janë: Minella Kapo, Vasil Stambuli dhe Mustafa Selenica.

Kemi fatin që kjo treshe na solli një foto nga maja. Në foton si më poshtë kanë Minella Kapo (me dorën lart) dhe Vasil Stambuli me kazmën alpine të ngritur. E fotografoi Mustafa Selenica.



Maja e Tomorit mbi fshatin Tomor, 2.175 m e lartë, u pagëzua Maja 11 Shkurti, në shkurtin e vitit 1965. Në këtë datë ishte caktuar nga P. P. Sh. “Dita e Novatorëve”. Pra, ishte shkurt i vitit 1965 dhe ngjitja në (një) majë të malit Tomor, me nisje nga fshati Tomor. Kjo bëri që në Shoqatë (e organizuar një vit më parë) kjo majë të regjistrohej si një ngjitje e bërë në majën kryesore të Tomorit. Maja kryesore e malit Tomor, 2.416 m mbeti e pa cënuar me emërtime. Për habi sot shikojmë që në hartat e reja topografike kjo majë të shënohet me emërtesën Maja Partizan. Si duket edhe Instirtuti i Topografisë Ushtarake ka bërë emërtimet e tij!!!!



Alpinistë elbasanas në majën 11 shkurti v. 1965

Maja e Radohinës u pagëzua Maja Shkurte Pal Vata, në përkujtim të vajzës nga fshati Pecaj i Dukagjinit që ndërroi jetë teksa punonte si aksioniste (në sektorin e Lushnjës) në ndërtimin e hekurudhës për në Vlorë.

Maja Sqeta e Cjapit u pagëzua me emrin Maja 25 Gushti. Kjo datë ishte caktuar nga PPSH “Dita e Shtypit” (ka mundësi që të ketë qenë data e daljes së numurit të parë të gazetës “Zëri i Popullit” (ab). Kjo majë është “shoqe” me majën e Prozhmit, në Runicë. Lidhen të dy majat me një kreshtë të mprehtë.

Në malin e Shnikut, Maja e Madhe u pagëzua me emrin Maja Skënderbe. Kjo ndodhi në janar të vitit 1968 në kuadër të festimeve në 500 vjetorin e vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.


Maja Gryk e Hapt u pagëzua me emrin Maja Ismet Sali Bruçaj. Ky ishte emri i mësuesit shëmbullor, i cili ndërroi jetë teksa shkonte në shkollë (në ditë kombëtare pushimi) për një kënaqësi patriotike për nxënësit e tij. Ai kishte një radio marëse të mirë (Iliria) dhe do të shkonte tek shkolla e fshatit ku jepte mësim, që nxënësit të dëgjonin (meqë dëshironin) në radio paradën që do organizohej para tribunës së udhëheqjes për festën në Ditën e Çlirimit. Kjo majë në hartat topografike ushtarake është shënuar me lartësinë 2.625 m, lartësi kjo që i takon Majës së Madhe (apo ndryshe Maja Lugbat), emërtesë që e kanë dhe e përdorin banorët e luginës së Valbonës. Kjo majë (dhe bjeshka e saj) njihet me emërtesën Maja/Bjeshka Lugbatit nga malsorët e luginës së Currajve (geghysenasit e kanë bjeshkën e tyre).

Maja e Vishensit u pagëzua me emrin Maja e Dritës, në vitin 1970. Kjo, ngaqë ishte koha që përfundoi elektrifikimi në të gjitha fshatrat e vendit tonë.



Në këtë foto janë: Vullnet Zylyftari (majtas, lart) Vangjel Zeno, Vangjel Polo, Vullnet Kalemi,

Ndërsa sa më sipër ishin pagëzime të ideoeshin nga Kryesia e Federatës, me emërtesën Maja e Dritës u pagëzuan edhe maja të tjera bazuar në inisiativa lokale. Një emërtesë e tillë, p.sh., ju bë majës së Papingut në malin e Nëmërçkës, etj.



Tre alpinistë kacavarës të ekipit korçar Ferdinand Koça, Irena Nika dhe Llambi Nika, në majën e Dritës në vitin 1973

Është rasti të kujtojmë se ne **nuk** kemi patur institucion topografik para L2B. Kjo ka bërë që hartat tona të jenë bërë nga austriakët si dhe ndërkombëtarë të tjerë për të përcaktuar vijën kufitare me shtetet fqinje: nga italianët, rusët dhe më pas nga vetë ne shqiptarët.

Opinion për hartat tona topografike: Duke patur të huaj që kanë dëgjuar emërtesat e majave nga vendasit, me raste ata i kanë shkruar emrat ashtu si i ka dëgjuar veshi i tyre (ne, si askush tjetër në Evropë, kemi alfabet me 36 gërma), apo me hamendje për tingujt e gërmave që ata nuk i kanë. Po ashtu duke i kaluar hartat nga një gjuhë në një tjetër ne kemi edhe “përplasje” në emërtesa si dhe pasaktësi në lartësitë e vendosura mbi to.

Me këto përmasa që po zhvillohet sot turizmi malor mendoj se duhet një rishikim i duhur i hartave topografike si për emërtesat ashtu edhe për lartësitë. Dhe mos harrojmë se ka maja dhe “nën maja” malesh që janë edhe pa lartësitë përkatëse, sidomos ato që në hartë nuk kanë as emër.

Vijojnë vitet e pas Çlirimit

L2B kudo në Evropë i rrudhi apo edhe i mbylli veprimtaritë sportive. Por ndërsa sportet e tjera filluan të “Ri mbijnë” aty këtu (lojnat me top ishin më të “privileguara”) lëvizja turistiko-alpinistike nuk u ndje fare. Arësyeja, për mendimin tim, spjegohet nga rrethanat e krijuara si më poshtë:

- Ishte e frikëshme në atë system politik që u ngjirrit të organizohesh me grupime të vogla sikundër bëhej për daljet në natyrë, sepse po të dilje malit a kodrës me shoqëri do të shikonin me sy të keq “vigjilentët” e sistemit punist. Fare lehtë ai shtet të bënte gjygj duke të vënë etiketën (e zezë të kohës) grup i organizuar për veprimtari kundër Pushtetit Popullor. Dhe kjo jo vetëm në vitet e para të pas pas L2B, por edhe më pas. Nga përvoja personale sjell këto fakte:
- 1. Në vjeshtën e vitit 1960 duke ecur në rrugën e vjetër këmbësore Tiranë-Krujë shkëputem aksidentalisht nga grupi dhe në rastin më të parë 47ret që takova një grup të rriturish kalimtarë si unë, i pyeta nëse jam apo jo në rrugën Tiranë-Krujë, apo kam devijuar. Komunikova me ta ashpër sepse më konsideruan diversant! Fitova sepse, pata fat, ata u bindën se diversant nuk mund të jetë një 17 vjeçar që me të parë në rrugë njerëz pyet nëse jam apo jo në shtegun e duhur.
- 2. Në 23 dhjetor 1968 (jam i saktë për këtë datë) ishim të detyruar të braktisim synimin për të kaluar kreshtën e malit të Tomori nga maja jugore në atë veriore dhe zbresim për të kaluar natën në një stan me dele ku ishin dy barinj. Mbi fshatin Ujanik. Një nga barinjtë gjeti mundësinë të shkojë deri në Gjerbës dhe lajmëroi operativin e zonës që në stan kishin ardhur 4 diversanta. Operativi erdhi me nxitim me një dyzinë, a më shumë, pushkatarë dhe na rrethuan. U desh debat dhe prova që ata të bindeshin se ne jemi alpinista.
- 3. Në korrikun e vitit 1972, me mbi 100 pionerë dhe me më shumë se një dyzinë instruktorë, nisemi nga Liqenet e Lurës për në Peshkopi. Ndalemi në fushën e shkollës së fshatit Fushë Alie për të kampuar, për të kaluar natën. Aty, në një nga klasat e shkollës zhvillohej mbledhja e organizatës së partisë së fshatit dhe kur na panë nga dritaret e klasës, dolën të alarmuar dhe na “rrethuan”. Kur u pajtuam ata na treguan se kur na panë menduan që “kan ra sërëbët n’katun”. Po të ishte kjo histori në jug të vendit tonë do thonin “na ka hyrë greku”. Dhe kjo sepse ne ishim me veshje turistike: bluzë dhe pantallona të shkurtëra.
- 4. Me shoqatat sportive dhe sidomos me ato të Gjurmuesisë (ishin organizime të rinjve nga ata që shkonin në shkollë) ishin djem që u vunë në krye të punëve të vendit pas L2B dhe për nivelin arsimor të kohës këta ishin shumica e inteligjencës së viteve 30-të dhe më pas. Por kjo kategori ishte ajo që e mundësonte anën financiare për tu marrë me kënaqësitë që të jep natyra. POR, intelijenca ishte shënjestra e kohës për tu goditur me persekutime e ndëshkime nga më absurdet dhe më të ndryshmet nga partia që erdhi në pushtet. Intelijenca jonë ishte përgatitur në Evropën Perëndimore, ose në shkollat e mesme të vendit me programe (me raste edhe mësues të ardhur nga jashtë) e mëndësi perëndimore. Partia në pushtet mori masa kriminale që koka e intelektualve që shikonte nga Perëndimi të lëvizte dhe të kthehej nga Lindja. Po e konkretizoj këtë me një shëmbull:

Foto në vijim është marrë nga arkivi i Sigurimit të Shtetit. Të katër këta të rinj ishin anëtarë të Trupës Republikane; Gjurmuesia e Tiranës. Nuk kam bërë ende verifikimet e duhura por kam bindjen se të paktën njëri prej tyre është anëtar i atij grupi të rinjsh që për të parën herë nga maja e Tomorit brohoritën: **zigzag, zigzag, hej hej, alpinista jemi ne.**



Kjo foto është bërë rreth vitit 1925 dhe tre prej tyre janë nxënës të Shkollës Teknike të Tiranës (sot Instituti Hary Fultz) të diplomuar: numuri 1 në vitin 1926 dhe 48 të tjerët në vitin 1928.

Nga Instituti i Dosjeve, sot mësojmë se:

Nr 1 është Kostaq Stefa. Ishte mësues bashkë me të shogën në një shkollë në Berat kur u arrestua në vitin 1947. Në 02.03.1948 u pushktua si “Armik i Popullit”. Historia e tij është bërë subjekt i një filmi dokumentar, që presim ta shikojmë, për persekutimet komunisto-enveriste të intelektualëve.

Nr 2 Spiro Minga; vdiq në internim.

Nr 3 Ibrahim Laçi (Frashëri) “shpëtoi”. Punoi si drejtor i Bibliotekës “Qemal Baholli”, etj., në Elbasan.

Nr 4 Neki Radovicka, vdiq nga torturat në hetuesi më 29.5.1947.

Por nuk ishin vetëm këta skautista, gjurmuesia, që e pësuan. Të kuptohemi, këto shënime nuk janë për të treguar persekutimet që u bëri intelektualëve ai sistem. Sa më sipër është një nga ilustrimet që flet për keqtrajtimin e sportistëve intelektualë të asaj kohe. Dhe ky keqtrajtim ndikonte negativisht në psikologjinë popullore.

E si mund të riorganizohej Gjurmuesia Shqiptare kur lajme të llojit si më sipër u bënë krejt të zakonata pas vitit 1944!?

Marshimet Partizane

Duke filluar nga viti 1946 në shtyp lexon për marshime e stafeta partizane. Të krijohet përshtypja se ata që luftuan kundër pushtuesve nazi-fashistë, një pjesë e tyre, ende jetonin me skenat e asaj lufte.

Në numurin 51 të vitit 1946 të gazetës Sport lexojmë një paragraf për veprimtari në natyrë, ku mësojmë se: Minella Kapo, delegat i rinisë, qarku i Vlorës, në komisionin e sportit të Kongresit të tretë të Rinisë (komuniste) (i pari kongres ishte mbajtur në Helmes të Skraparit gjatë luftës më 8 gusht 194?) **në referat**in e tij flet edhe për alpinizmin dhe marshimet turistike. Vetëm kaq.

Në numurin 53 të kësaj gazete në artikullin “Ekipet e Marshimit Partizan të nisur nga rrethet më të largëta, nga vendet e fillimit të kryengritjes popullore i sjellin KOMANDANTIT përshtendjet e reparteve të tyre dhe të popullit të vendeve ku kaluan”. Në artikull mësojmë se 450 të rinj e të reja do përshkojnë 1.330 km rrugë në “*Stafetën Çlirimtare*”. Kjo d.m.th se çdo rreth më vete, Tirana, Shkodra, Korça, Durrësi, Peshkopia, Elbasani, Berati, Vlora dhe Gjirokastra do organizonin stafeta brënda tyre dhe në mbyllje stafetistë të nisur në ditë dhe orë të ndryshme do vraponin drejt Tiranës që në mbasditen e 29 nëntorit të arrinin para tribunës së udhëheqjes.



Në numurin 55 të së njëjtës gazetë lexojmë se porositet që: “të edukojmë masat me *sporte luftarake*”. Kurse në numurin 56 të gazetës, në temën e sporteve dimërore, bëhet “thirrje për të zhvilluar edhe alpinizmin.”

Informacin tjetër kemi nga Gazeta SPORT nëntor 1946

Marshim partizan 45 km.

Itenerari: Stadiumi Qemal Stafa – Rr. Kavajës – Pezë e Vogël – Shehslugë – Pluht – Kashar – Rr. Durrësit – Tiranë.

Në datën 2 tetor u bënë provat e përgjithëshme të marshimit partizan. Do zgjidhen më të mirët për të marrë pjesë në Ballkaniadë (pa Greqinë dhe Turqinë).

Itenerari: Stadiumi Qemal Stafa – Rr. Elbasanit – Ura e lumit të Farkës – Petrelë – futja në rrugën e vjetër të Elbasanit (rrugë për mushka) – Ura e lumit të Farkës – Rr. Elbasanit – Kazermat e Xhenjos – Kodrat e Hil Berishës – Kazermat e Ali Rizait - Tiranë – Stadium.

Ky itenerar ka 1/3 e rrugës të asfaltuar dhe 2/3 e tij nëpër shtigje.

Do formohen dy skuadra dhe do të konkurojnë/garojnë me Bullgarë, Jugosllavë, Rumaninë. Shumica e pjesëmarrësve në ekiye do jenë ushtarë.

Në vitet 1945/6 nuk pasqyrohet në shtypin e kohës ndonjë veprimtari turistike apo alpinistike. Gjurmësia Shqiptare, që u krijua në krye të viteve 20-të dhe ishte e njohur edhe nga organizata botërore e Skautizmit që në lindjen e saj, si dhe që pati fillesa të qëndrueshmërisë në saj të organizimit në qytetet ku lindi, tashmë ishte në heshtje. (!!)

Filloi një periudhë e pasluftës që ekskursioni mori emrin marshim partizan; shpesh edhe duke përsëritur marshime të mirëfillta partizane të kryera gjatë kohës së luftës çlirimtare nga nazi-fashistët. Madje dhe zjarri që do të ndizej në kompinge u quajt, jo zjarr, por *zjarr partizan*. Tashmë veprimtaritë kryheshin vetëm të organizuara nga shteti dhe grupimet shoqërore, as edhe për piknik, nuk u riorganizuan. Në sport, në këtë fillim të pas L2B morën përparësi lojrat me top, të cilat patën vazhdueshmëri sepse ishin argëtuese edhe për qytetarët spektatorë në qytetet ku zhvilloheshin.

Sipas opinionit tim në media filloi të shkruhej me një gjuhë të re, gjuhë e cila përcillte një mentalitet “komunist” ende të papjekur. Ja disa shëmbuj:

“T’i stërvitim dhe t’i kalitim muskujt e të riut, jo me sporte delikate, zbavitëse, por me një **fiskulturë revolucionare** që të ndezë në zëmrat e tyre flakën e kolektivitetit e t’atdhedashunisë, të shoqnimit e të bashkimit”

“Me fiskulturën duhet të përgatisim ushtarin dhe puntorin e ardhshëm, të pajisur me shpirt sakrifice dhe me dashuri për atdhe dhe popull.

Këtu del nevoja e ushtrimit nga brezat e reja të sporteve me karakter të theksuar ushtarak si, për të përmendur vetëm disa, vrapime lufte, vrapime me pengesa natyrale dhe artificiale, ekskursione dhe

alpinizëm, marshime të gjata kolektive, hedhje precizioni dhe largësie granate, qitje me armë lufte dhe gjahu, sporte me kuaj dhe n'ujë, manovra dhe vrapime të shkurtëra dhe të gjata, marshime partizane, piknike ndër male.”

“Në muejin Maj kan qenë parapamë ekskursionet alpinistike në formë pikniku ose në formë garash lokale. Kronikat e botueme që flasin mbi shetitje të tilla të bame pothuajse në të gjitha krahinat tona, na kanë dhanë me kuptue se ky **sport turmash** ka gjetë një pritje të nxehtë edhe në vendin tonë. Jemi të bindun se ekskursionet, aq të kandshme e të dobishme, do të shkojnë tue u bamë gjithnji ma të shpeshta. Ajri i pastër dhe natyra e bukur e fushave dhe maleve t'ona do të tërhekin turma gjithnji e ma të mdhaja tue flladitë trupin e lodhun nga jeta e qytetit, tue ngjallë e tue përtëri energji të reja në një ambient të përbashkët shlodhjeje, defrimi e bashkëpunimi.”

Deri në verën e vitit 1949 nuk kemi patur veprimtari të mirëfillta/qëna turistike dhe alpinistike. Deri në këtë kohë në shtyp gjejmë artikuj që flasin për **nisma**, **premtime** dhe **programime** për veprimtari, por asgjë konkrete nuk organizohet në teren veç marshimeve partizane. **Vetëm fjalë dhe fjalë.**

Ja dy shëmbuj ilustrues për këtë të marra nga shtypi i kohës:

Kryesia e Sport -klub 17 Nandorit
Organizon një eskursion
në masë në malin e Dajtit
me 25 Dhetor

Me 25 Dhetor ora 3 të mëngjesit në sheshin Skenderbej do të mbledhen të gjithë pjesëmarrësit n'eskursion, ndersa gjuetarët në lulshiten para Këshillit të Përgjithshëm Sindikal.

N'eskursion marrin pjesë të rinj e të reja sportive: konviktorë, kursistat, nxënësit e shkollave, nga fabrikat, diskasteret, ushtria dhe nga shkolla e kadetve.

Nisja do të bahet n'oren 4 me këtë itinerar:
Grupi i zgjedhur për në malin e Dajtit.
Të gjithë të tjerët për në fushën e Dajtit.
Gjuetarët e derrave në Berzhitë
Gjuetarët e leprave në Farkë
Gjuetarët e shepkave në Domen

P R O G R A M I

Me të mbërritun, lojta në bore ose gjimnastikë. — Nji oficer i Ushtrisë Kombëtare do të mbajë një konferencë mbi strategjin dhe topografin. — Lojta e delrim. — Dreka — Konferencë mbi fiskulturen e masave dhe ndihma e madhe e Pushtetit për këtë qëllim.

Lojta të ndryshme, valle e këngë. — Ora 15.30 kthimi për qytet t'organizuem e duke kënduar.

ASNJË NUK DUHET TË MUNGOJË N'ESKURSIONIN E PARË NË MASË.
TË GJITHË PA PERJASHTIM N'ESKURSIONIN E 25 DHETORIT.

Kryesia e Sport Klub 17 Nandorit

Kalendari sportiv i t

(1. I. 1946 -- 31. III. 1946)

KALLNDUER *Janor*

Kampionate krahinore dhe ma vonë Kampionati Kombëtar i lojës së SHAHUT.

Kapionate krahinore, si për meshkuj ashtu edhe për femna, të lojës PING - PONG.

Veprimtari eskursjonesh alpiniste edhe ski (në qendrat ku ka mundësi).

Kampionate Krahinore të rëshqitjes me ski (ku ka mundësi për meshkuj e femna).

Kupa të Fedratës: Ylorë, — Fier, — Berat
Elbasan, — Kavajë
Tiranë — Shkodër — Durrës

SHKURT

Gara cikliste lokale

Veprimtari alpinizmi në formë ekursjonesh dhe gjahu

Kampionate Krahinore box-it dhe mundje,

Gara Krahinore vrapimi fushor.

Ndeshje foot-ball it në mes të shoqnive e sport klubeve tona.

MARS

Gara cikliste lokale

Ndeshje foot ball-it

Vrapime fushore dhe fillime garash atletike.

Ndeshje Woley ball-it, basket-ball-it dhe Hend ball-it.

Në rreshtat në vijim do lexoni hera-herës edhe fjalën ekip dhe/ose trajner. Ekipi i parë shqiptar i alpinistëve u krijua në Universitetin Shtetëror të Tiranës (me emër dhe me buxhet) në vitin 1958. Ekipet e tjera u krijuan mbas vitit 1964 (vit kur u krijua Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar). Fjala trajner (trajner në kuptimin profesional nuk kishte) në këtë sport u përdor për instruktorët që kryenin të paktën një nga shkollat verore ose dimërore ku mësohej sporti i alpinizmit. Kishte kategorizim për këta instruktorë në bazë të përvojës së tyre, nëpër këto shkolla dhe nëpër veprimtari. Kur filluan të krijohen ekipet, anëtari më me përvojë në male (por dhe me biografi të pranueshme) **caktohej** "Trajner i Ekipit". Gjatë viteve 70-80, thuajse për çdo vit organizoheshin seminare për kualifikimin e këtyre trajnerëve.

Viti 1949 është viti që shohim *shkrimin e parë në organet e shtypit për veprimtari të mirëfillta turistiko - alpinistike* si dhe viti në të cilin fillonin shënime/rekorde për veprimtaritë e organizuara nga sektori i sporteve të rënda të Komitetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve. Rekordet e sektorit të sporteve të rënda ju kaluan zyrës së Sekretarit të Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar, e cila u bë funksionale në qershor të vitit 1964, dhe ishte në godinën e Ministrisë së Arësimit dhe Sporteve.

Pra, viti 1949 është viti nga i cili gjenden dokumenta, që dëshmojnë se tashmë shteti ka filluar të mendojë dhe të organizojë veprimtari edhe në sportin e turizmit dhe alpinizmit.

Gazeta Sport, gusht 1949, shkruhet:

PËR NDER TË HERONJVE TË RINJ PARTIZANË

NË MAJË TË TOMORIT NGULET NJË FLAMUR

Në mëngjesin e datës 27 korrikut nga disa drejtime të ndryshme, arritën në Teqenë e Kulmakut ekipet e ndryshme të alpinistëve, të ardhur nga shumë vende të Shqipërisë: nga Ushtria Popullore 4 veta, nga Berati 11, nga Tirana 3, nga Elbasani 5, nga Policia Popullore 3, nga axhensia telegrafike 1, nga artileria 1 toger dhe ? ushtarë, nga Kapinova 5.

E gjithë kompania e ekspeditës, e ndarë në tre toga: njëra ushtarake dhe dy të tjera komandohej, në aksionin e sulmit mbi Çukën e Tomorit, nga inspektori i sporteve të rënda Luigj Shala. Ekspeditës ju shtua edhe plaku Baba i Teqesë, 50 vjeçar.

Ekskursionistët kaluan natën e 27 korrikut në Teqenë e Kulmakut të pritur me dashamirësi.

Aty nga mesnata e 28 korrikut kompania e ekspeditës nga tre drejtime të ndryshme, e ngarkuar me ushqime të bollëshme, filloi sulmin e fundit për të zaptuar Çukën e Tomorit. Maja u arrit në orën 04:30, pak kohë para lindjes së diellit.

Të shëndetshëm, pak të lodhur nga vrulli i ngjitjes, por plot gjak dhe entuziasëm, si të rinjtë dhe pleqtë, me këngë, valle muzikë festuan fitore.

Pas pushimit çlodhës u mbajt një konferencë përkujtimore dhe një minutë zi për dëshmorët e rinj të rënë në luftën N. Çl. Pas konferencës u përpiluan dy telegrame përshëndetje dhe falenderimi për Sekretarin e Përgjithshëm të P.P.Sh. shokun Enver Hoxha dhe për Komitetin e Kulturës Fizike dhe Sporteve të Republikës..

Në kthim ekspedita mori një rrugë shkëmbore të pa provuar ndonjëherë që e nxori në Kapinovë. Si gjatë ngjitjes dhe zbritjes alpinistët, si dikur partizanët, janë pritur me përzëmëri prej stanarëve.

Kompania hyri në Berat me këngë dhe me muzikë.

Ekspedita është një aksion i madh fiskulturor, i pari i këtij lloji i zhvilluar në vendin tonë (!!!!) dhe që hedh hapat e para (!!!!) të këtij sporti në Shqipëri.

Ky aksion u kurorëzua me sukses për hir të vullnetit të alpinistëve, të punës drejtuese të Komitetit të Fiskulturës të Republikës, të ndihmës së dhënë nga katundarët dhe këshillat e komunave nga përshkoi itinerari i ekspeditës.

Telegram nga Çuka e Tomorit.

K. K. F. S. (Komiteti Kombëtar i Fiskulturës dhe Sportit) të Republikës i ka ardhur telegrami që vijon:

Ne pjesëmarrësit e ekspeditës alpiniste, nga maja më e lartë e Tomorit, ju shprehim falenderimet tona të përzëmërta për mundësinë që na u dha, për të marrë pjesë në këtë ekspeditë, që shënon hapat e para të depës (degës – ab) së alpinizmit në Republikën tonë popullore. Jemi të kënaqur që plotësuam me sukses detyrën që na u ngarkua dhe ju premtojmë se jemi të gatshëm për të plotësuar të gjitha detyrat që do t'na ngarkohen, për ta zhvilluar edhe alpinizmin ashtu na mëson Partia e Punës dhe shoku Enver Hoxha.

43 alpinistët e ekspeditës Tomori.

Shënime: a. Shkrimi dhe telegrami, nuk flasin vetëm për veprimtarinë, por shprehin edhe ideologjinë e kohës e cila i shoqëroi veprimtaritë në natyrë, dhe jo vetëm, deri në vitin 1991.

b. Fjalja e këtij shkrimi “*Ekspedita është një aksion i madh fiskulturor, i pari i këtij lloji i zhvilluar në vendin tonë dhe që hedh hapat e para të këtij sporti në Shqipëri.*”, është një e pa vërtetë për historinë e ngjitjeve malore në vendin tonë.

- Veprimtaritë do të zhvilloheshin në kuadrin e një përkujtimi: feste, kongresi, votimeve dhe të ngjashme.
- Veprimtaritë ishin rezultat i kujdesit të PPSH për kalitjen e rinisë.
- Komandanti ynë ishte i kujdesëshëm që sporti të zhvillohej dhe rinia të forcohej.
- Veprimtarët i ishin mirënjohës P.P.SH. dhe udhëheqjes së saj për kujdesin që tregonte dhe mundësinë që krijonte për argëtimin e rinisë dhe zhvillimin e sporteve. Etj, etj.

Shënim: në informacionet si ma poshtë, të marra nga arkivi i Sporteve të Rënda dhe librat e shënimeve (rekordeve) që dispononte Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar (SHTASH), teksa i kam kopjura rreth vitit 1968, nga listat e pjesëmarrësve kam marrë kryesisht emrat e alpinistëve të cilët e vazhduan këtë sport edhe gjatë viteve 60-të, si dhe emrat e alpinistëve nga Tirana (qyteti im) dhe Fieri (rreth ku punova; 6 vjet në Patos i Ri).

Ekspedita në malin e Tomorit

E para veprimtari me ndërmendje alpinistike në formë të organizuar e kryer mbas luftës së dytë botërore MUND të jetë ekspedita në malin e Tomorit e organizuar nga Komiteti i Kulturës Fizike e Sporteve nëpërmjet inspektoriatit të sporteve të rënda dhe që u realizua më 27-28 Korrik 1949.

Alpinistë të ekipeve Tirana Rreth, Elbasanit, Beratit, Partizanit të Ushtrisë Popullore, Ministrisë së Punëve të Brëndëshme, Kapinovës e Borgullasit nën drejtimin e udhëheqjes së inspektorit të sporteve të rënda Luigj Shala u nisën më 27 Korrik nga Berati, fjetën atë natë në Teqe të Kulmakut e në mbasditen e datës 28 Korrik u kthyen në Berat.

Itinerari i kryer prej tyre ishte: Berat –Vërtop- Kapinovë- Qafa e Çapokut – Teqe e Kulmakut – Çuka e Tomorit – zbritje në Kapinovë – Berat. Veprimtaria u konsiderua ‘një provë e rezistencës për ngjitje malore’. Pjesëmarrësit nuk kishin veshje dhe paisje a mjete të nevojshme. Gjatë kësaj ‘ekspedite’ u dhanë njohuri bazë për mënyrat e veprimit për ekskursionet në mal si dhe propagandimit të alpinizmit me synimin për ta masivizuar atë.

Pjesëmarrësit:

1. Luigj Shala
2. Ali Bonka

3. Baba Abdurahman Hoxha i Teqesë së Kulmakut
4. Hasan Rama – Tirana
5. Daut Dervishi – Tirana
6. Xhaferr Shabani – Tirana
7. Partizani 14 vetë, 11 prej të cilëve nga Reparti 70.
8. Ministria e Punëve të Brëndëshme 3 vetë.
9. Elbasani: Grigor Perikliu dhe katër të tjerë.
10. Berati: Petraq Kuli, Vangjel Mëlëngu dhe pesë të tjerë.
11. Hysen Pasholli – Kapinovë
12. Jakup Koci – Kapinovë
13. Njazi Dragoli – Kapinovë
14. Safet Dragoti – Kapinovë
15. Nuredin Shahini – Kapinovë
16. Muharrem Kullusi – Borgullas
17. Isuf Margjoni – Borgullas.

Garat Kombëtare në Alpinizëm: 19 Qershor, 1949.

Gara e parë. Sheshi Skënderbej – Maja e Dajtit. Veshja e pjesëmarrësve: e lirë (si të dëshirojnë).

Pjesëmarrësit nënshkruajnë kur nisen si dhe kur arrijnë të përfundojnë garën.

Pjesëmarrësit janë nga: Korça, Berati, Elbasani, Pogradeci, Vlora, Tirana Qytet, Tirana Rreth, U komb. (ndoshta Ushtria Kombëtare?).

Në listën e pjesëmarrësve shihen emrat e alpinistëve të cilët më pas bënë emër në këtë sport si: Grigor Perikliu i klasifikuar i dyti me kohën 1 orë 54 minuta e 5 sekonda, si dhe Petraq Kule e Vangjel Mëlëngu të pa klasifikuar.

Aktivite lokale:

Më 29 Maj 1949 organizohet një ngjitje në lartësinë 1808 metra në Korçë.

Më 29 Maj 1949 organizohet në Tropojë një ngjitje malore.

Më 6 Qershor 1949 kryhet një provë marshimi alpinistik në Ersekë.

Më 20 Nëntor 1949 organizohet një garë alpinistike nga Korça deri në majë të malit Shën Konstandin të Drenovës.

1950

Gara Kombëtare në Alpinizëm, 2 Prill 1950.

Gara: Sheshi Skënderbej – Maja e Dajtit. Rregull: gara mbyllet 30 minuta mbas arritjes së të parit. Koha matet. I pari fiton aq pikë sa ka edhe pjesëmarrës në garë, i dyti një pikë më pak, e kështu me rradhë. Ndër pjesëmarrësit është edhe Vangjel Mëlëngu i cili e mbulon garën me kohën 2 orë e 11 minuta. Pjesëmarrja: Korça, Berati, Elbasani, Pogradeci, Vlora, Tirana Qytet, Tirana Rreth, U komb. (ndoshta Ushtria Kombëtare?), Shkodra, Përmeti, Partizani, Dinamo.

Klasifikimi: vendi i parë Tirana Rreth; vendi i dytë Tirana Qytet; vendi i tretë Partizani.

Veprimtari lokale: **Më 9 Korrik 1950** organizohet një ekskursion me 70 Sh.N.U.M.-ista në itinerarin Tiranë – Sauk.

Ekskursion Kombëtar për nder të Zgjedhjeve

Ekskursioni u ndërmor për nder të zgjedhjeve në malin e Tomorit në majën e Çukës më **21 Maj 1950**. Morën pjesë 49 vetë dhe u organizua nga Komiteti i Kulturës Fizike e Sporteve. Veprimtaria u udhëhoq nga alpinisti Luigj Shala. I deleguar nga K.K.F e Sporteve ishte Minella Kapo, i cili në këtë veprimtari kryesoi ceremoninë e rastit të organizuar në Çukën e Tomorit të cilës ju dha emri Çuka Partizani.

Nisja nga Berati më 20 Maj më ora 14:00, arritja në Kapinovë më 19:00. Të nesërmen, nisja nga Kapinova më ora 06:30 dhe u arrit në majë të Çukës më ora 12:00. Gjatë marshimit kryeshin pushime e gjatë këtyre pushimeve jepeshin udhëzime për teknika të ndryshme rreth veprimeve në marshim dhe në alpinizëm. Pra ky ekskursion kishte formën e një seminari mësimor në lëvizje.

Pjesëmarrësit:

1. Luigj Shala
2. Minella Kapo
3. Enver Shabani – Tirana
4. Stavri Zisi – Tirana
5. Korça : 2 pjesmarrës
6. Lazar Sota – Fieri
7. Namik Laze – Fieri
8. Halim Gjojdeshi – Fieri
9. Ibrahim Marina – Fieri
10. Berati: Vangjel Mëlëngu dhe 19 pjesmarrës të tjerë.
11. Kapinova: tre pjesmarrës
12. Elbasani: Agim Kajanaku dhe dy pjesmarrës të tjerë.
13. Vlora: dy pjesmarrës
14. Partizani: 7 pjesmarrës
15. Dinamo: dy pjesmarrës.

Ekskursion Alpinistik në Lurë.

Kjo veprimtari ishte e paraparë në kalendarin e veprimtarieve dhe u zhvillua me sukses nga data 9 deri më

11 Qershor 1950. Vlejtje veçanërisht ‘për propagandë e popullarizim të ekskursioneve masive alpinistike’. Itenerari. 9 Qershor: Peshkopi – Lurë; 10 Qershor: Lurë – Liqeni i Zi – Pyje të Masdejës – Fshati Llukam; 11 Qershor: Fshati Llukam – Burrel.

U realizua edhe ngjitja në Kunorën e Lurës e cila nuk ishte e parashikuar. Pjesëmarrësit:

Luigj Shala, udhëheqës.

Tirana: Enver Shabani; Teodor Siliqi; Viktor Vokopola; Ferid Gjinia; Tirana Rreth: Hasan Rama; Ali Kaziu; Peshkopia 9 pjesëmarrës; Elbasani dy pjesëmarrës; Rësheni 5 pjesëmarrës; Burreli 7 pjesëmarrës; Korça 3 pjesëmarrës; Lura 2 pjesëmarrës; Partizani 1 pjesëmarrës; Dinamo 6 pjesëmarrës.

Ekspedita Alpinistike në Malin e Hekurave.

Ekspedita u zhvillua nga data **27 deri më 31 Korrik 1950**. Kjo ekspeditë ishte një provë e rëndë në kushte të mungesës së ujit të pijshëm dhe dëborës për shkak të thatësisë jo të zakonit të asaj vere. Në afërsi të Qafë Droçës, disa alpinistë, veçanërisht për arsye të mungesës së ujit të pijshëm, nuk janë në

gjendje të vazhdojnë itinerarin e të arrijnë në zonën e dëborës. Kjo bëri që të ndryshohet itinerari e të zbritet në Curraj të Epërm.

Instruktori i alpinizmit zoti Luigj Shala u detyrua të drejtojë grupin për në Curraj duke qënë i shtrënguar nga këmbëngulja e rreth nëntë pjesëmarrësve të cilët nuk ishin në gjendje të bënin asnjë hap të mëtutjeshëm. Zbritja në Curraj u bë që të mos ndahej grupi si dhe për të mbyllur shtegun e ndonjë fatkeqësie të mundëshme.

Ekipet e nisura nga Tirana e Shkodra që zbritën në Curraj të Epërm, bënë ngjitje direkte nga faqja shkëmbore e Currajve në Qafë Droçe, gjë që shënoi ngjitjen shkëmbore më të vështirë të bërë deri në atë kohë në alpinizmin tonë. Ekipet e tjera të ardhura nga itinerari Kolgecaj (sot Qyteti Bajram Curri) Dragobi, janë ngjitur nga faqja e veriut, itinerar ky shumë më i thjeshtë dhe pa rrezeqe. Në majë u ngjitën 87 vetë nga 106 pjesëmarës. Në majë të malit u organizua ceremonia e emërimit të majës së Hekurave “Maja e Paqes”, ceremoni e cila edhe u filmua.

Itinerari: 26 Korrik në Theth; 27 Korrik: Theth- Fushë Dënell; 28 Korrik: Fushë Dënell- Va Shtjefën- afërsi e Qafë Droçes – Curraj i Epërm; 29 Korrik: Curraj i Epërm – Maja e Paqes- Tella Vishkuqeve; 30 Korrik: Dragobi – Valbonë – Ragam; 31 Korrik: Ragam – Qafë Valbonë – Livadhet e Bukura –Theth. Ekipet e ardhura nga Kolgecaj më datën 29 Korrik u kthyen direkt për në vendet e tyre. Në përbërje të ekipeve të Veriut morrën pjesë edhe tre femra ndër të cilat partizanja e moshuar Mine Micele. Nga ekipet e ardhura nga Tirana e Shkodra 19 pjesëmarrës nuk u ngjitën deri në majë por u ngjitën deri në Qafë Droçe.

Ndër pjesëmarrësit:

Luigj Shala Udhëheqës i veprimtarisë; Tirana Qytet: Vasil Stambuli; Bastar Ruli (Kinoperator); Gjergj Ashta; Enver Kinjau; Agim Dizdari; -Tirana Rreth: Hasan Rama; Xhafer Elezi; -Ndërmarja Kinematografike: Riza Shehu, Hamdi Ferhati; -Elbasani: 5 pjesëmarrës; -Berati: Vangjel Mëlëngu dhe 4 pjesëmarrës të tjerë; -Peshkopia 2 pjesëmarrës; -Korça: 4 pjesëmarrës; -Shkodra 6 pjesëmarrës; etj.

Viti 1951

I pari ekskursion alpinistik dimëror

Ekskursioni i parë alpinistik dimëror u realizua me ngjitjen në majën Çuka Partizane në periudhën **22 deri 25 Shkurt 1951**. Ky ekskursion u konsiderua si i tillë që shënoi hapin e parë në aftësitë e alpinistëve tanë të rinj. Megjithëse pa paisje e veshmbathje të duhur për sezonin dimëror, në kushte të dëborës së ngrirë e akullit, alpinistët i përballuan vështirësitë dhe nga 48 pjesëmarrës 28(23?) prej tyre arritën të ngjiten në majë, dhe “ngritën flamurin për nder të 23 Shkurtit, ditës së Ushtrisë së Kuqe “(dita e ushtirisë në ish Bashkimin Sovjetik).

Itinerari i ndjekur: Poliçan – Novaj; më 24 Shkurt nga Novaj u nisën për në majë më ora 04:15 dhe u arrit në majë më ora 13:30. Në majë u ngjitën 28(23?) vetë më ora 16:15.

Pjesëmarrësit:

Luigj Shala, udhëheqës i veprimtarisë; -Shoqata Puna (Tirana): Aleks Ruci, Hasan Rama, Faredin Myslimi, Meleq Sheme, Halo Mediu, Ali Kaziu, Arshi Aliu; -Shoqata Spartak (Tiranë): 5 pjesëmarrës; -Shkolla e fiskulturës: Muharrem Sinoimeri, Piro Angjeli, Skënder Dedja, Dan Doçi, Thanas Gjika, Mikel Dhaskali; -Berati: Vangjel Mëlëngu dhe 4 pjesëmarrës të tjerë; Fshati Novaj: tre pjesëmarrës; – Dinamo: 9 pjesëmarrës; -Partizani 11 pjesëmarrës.

Ekskursioni alpinistik në Jezerë.

Ekskursioni Alpinistik në malin e Jezerës u realizua në periudhën nga **7 deri më 11 Korrik 1951**. Veprimtaria ishte e paraparë në kalendarin sportiv dhe ishte ndërmendur në kuadrin e veprimtarieve të parashikuara në kuadrin e 10 vjetorit të krijimit të Partisë së Punës së Shqipërisë.

Itenerari: 7 Korrik me autobus pjesëmarrësit u transportuan deri në Qafë Thore e më pas duke marshuar në këmbë në muzg të ditës u arrit në Theth; 8 Korrik: Theth – Q. Pejë – Gropat e Bukura; 9 Korrik: ngjitje në majë të Jezerës. Në majë u ngjitën 10 pjesëmarrës nën drejtimin e inspektorit të Alpinizmit Luigj Shala. Nëntë vetë nuk u ngjitën për arësye të lodhjes që ndjenin si dhe për arësye të mungesës së guximit që treguan për të kaluar pjesët shkëmbore e me dëborë të ngrirë të itenerarit.

Pas vendosjes së pllakës përkujtimore të bronxtë në majë të Jezerës, alpinistët janë ulur tatëpjetë duke përdorur mënyra rëshqitje nëpër lugje me dëborë. Kështu që u bënë edhe mësimet për mënyrat e veprimit në relief me dëborë gjatë udhëtimit. Një alpinist u sëmur në ngjitje e sipër.

Më 9 Korrik në mbrëmje alpinistët u kthyen në Theth. Më 10 Korrik alpinistët arritën në Bogë duke kaluar nëpër Shtegun e Dhenve.

Pjesëmarrësit që u ngjitën në majën e Jezerës:

Luigj Shala, drejtues i veprimtariit; Grigor Perikliu (Elbasani); Dodë Çota (Broj – Kelmend); Halit Hoxha (Dinamo e Shkodrës); Dan Brahimaj (Dinamo e Shkodrës); Ferid Gjinia (Puna e Tiranës); Ramadan Doçi (Spartaku i Tiranës); Sotir Lakuriqi (Spartaku i Tiranës); Kozma Vasili (Puna e Shkodrës); Thoma Mazreku (Puna e Shkodrës); nuk arritën të ngjiten: 2 pjesëmarrës nga Elbasani, 3 pjesëmarrës nga Tirana, 3 pjesëmarrës nga Shkodra, 1 pjesëmarrës nga Lezha.

Në shkëmbin e majës së Jezerës alpinistët vendosën pllakën e bronxit ku shkruhej: "Lavdi 10 vjetorit të P.P.Sh." Nga Alpinistët Partizanë të Paqes. Jezerë më 10-08-1951.

Gara Kombëtare në Alpinizëm, 6 Maj 1951.

Pjesëmarrësit mbajnë nga një armë tek ngjiten duke ecur apo vrapuar drejt majës. Marrin pjesë këto grupe sportive: Korça, Berati, Elbasani, Pogradeci, Vlora, Tirana Qytet, Tirana Rreth, U komb. (ndoshta Ushtria Kombëtare?), Shkodra, Përmeti, Partizani, Dinamo, Fieri dhe Kukësi.

Klasifikimi: vendi i parë Korça; vendi i dytë Vlora; vendi i tretë Kukësi.

Veprimtariet lokale:

Në Krujë organizohet një garë alpinistike më 18 Shkurt 1951 ku marrin pjesë 9 vetë.

Në Ersekë organizohet një ekskursion e njëherësh një provë shpejtësie në ecje më datën 18 shkurt 1951.

Në Kukës organizohet ngjitja në Gjallicë të Lumës më 26 Gusht 1951.

Itenerari : Kukës – Gostil – Shtiqen – Kroj i Pasatit afër staneve – ngjitje në majën e Livadheve – Kroji i Kishës – Kroj Tenzot – Maja e Gjallicës – Kthimi nëpër të njëjtin itenerar.

Pjesëmarrësit : Luigj Shala, qytetarë nga Kukësi dhe fshatarë nga fshatrat përreth. Veprimtaria u organizua me inisjativë të Luigj Shalës i cili ishte në Kukës në kuadrin e veprimtarieve të garave të mundjes.

Viti 1952

Ekskursion alpinistik në majën Çuka Partizane.

Ekskursioni u realizua në periudhën nga **22 deri më 24 Shkurt 1952**. Veprimtaria ishte e paraparë në kalendarin kombëtar të veprimtarieve dhe në të morën pjesë 36 vetë.

Itenerari: 22 Shkurt, nga rruga automobilistike deri në Nishovë- Novaj ku u organizua fjetja; 23 nisja nga Novaj më 04:10 e ngjitje në Majën Çuka Partizane dhe kthim. U ngjitën të gjithë.

Ndër pjesëmarrësit:

Luigj Shala, udhëheqës, Novaj-dy pjesëmarrës; Borgullas 1 pjesëmarrës; Dinamo e Beratit 5 pjesëmarrës; Teknikumi i Fiskulturës: Ismet Bellova, Pipi Nati, Zisi Çabeli, Mikail Qipo; -Fieri: Vangjel Kordheshi, Gor Villi; Vlora 4 pjesëmarrës; Korça 5 pjesëmarrës; Gjirokastra, 2 pjesëmarrës; -Përmeti 2 pjesëmarrës; -Berati: Petraq Kuli, Vanngjel Mëlëngu dhe tre pjesëmarrës të tjerë; -Lushnja, 3 pjesëmarrës.

Ekskursion Alpinistik në Liqenet e Lurës

Kjo veprimtari ishte e paraparë në kalendarin kombëtar sportive dhe u krye në periudhën nga **22 deri më 24 Shkurt të vitit 1952**. Në të morën pjesë 21 vetë.

Itenerari: 22 Shkurt nga Peshkopia në Leshgjë; 23 Shkurt Leshgjë – Arras deri në zonën e Liqenit të Madh e kthim. Liqeni ishte shumë i ngrirë e me mbi 1.5 metra dëborë. Nuk arritën të ngjiten në Kurorë të Lurës për arsye të dëborës, ngricës dhe mungesës së paisjeve në veshje. Grupi i pjesëmarrësve i nisur nga Burreli ka udhëtuar nëpër itenerarin: Burrel – Macukëll – Lurë e kthim.

Pjesëmarrësit:

Skënder Bardhi, Komiteti i Kulturës Fizike e Sporteve; Tirana Qytet: Dhori Hanxhari, Elez Maha, Ferid Gjini, Enver Shabani; Tirana Rreth: Hasan Rama, Daut Dervishi, Ali Dervishi; Kruja 3 pjesëmarrës; Peshkopia 6 pjesëmarrës; Burreli 6 pjesëmarrës.

Ekskursion Alpinistik në Paping (Nëmërçkë) i Shoqatës Puna

Kjo veprimtari u realizua në periudhën **22 Mars deri më 24 Mars 1952**. Pjesëmarrësit: Puna e Tiranës: Dhori Hanxhari, Elez Maha, Enver Shabani, Ferid Gjini; Lushnja 2 pjesëmarrës por njëri u kthye; Kuçova 1 pjesëmarrës; -Kruja 1 pjesëmarrës; -Korça 3 pjesëmarrës por një u kthye; -Vlora 2 pjesëmarrës; Durrësi 2 pjesëmarrës; -Gjirokastra 4 pjesëmarrës; -Elbasani: Ligor Perikliu dhe një pjesëmarrës tjetër; -Përmeti 2 pjesëmarrës; Fieri: Namik Hysa, Mit Dhima; Fshati Poliçan 1 pjesëmarrës; si edhe 2 kufitarë.

I deleguar i Komitetit të Kulturës Fizike e Sporteve, Mjeshtri i Sportit Luigj Shala. Nga dokumentat, kjo është hera e parë që i shkruhet një alpinisti titulli sportiv “Mjeshtër Sporti.” Pjesëmarrësit më 23 Mars në mëngjes u nisën nga Gjirokastra dhe arritën në Suk të Poliçanit. Fjetja u organizua në Skore. Ngjitja, nga Skore në Paping. Pranë majës Luigj Shala dhe dy Gjirokastritë kanë hapur gjurmë në dëborë. Grupi ishte i dobët dhe u deshtën 6 orë për të arritur majën. Në majë ngjitësit kanë ngritur flamurin dhe Dhori Hanxhari e Luigj Shala kanë mbajtur fjalë të rastit.

Ekskursion Alpinistik në malin e Çikës nga Shoqata Spartaku

Veprimtaria u organizua nga **20 deri më 22 Prill 1952**. Pjesëmarrësit: Spartaku i Tiranës: Avni Zajmi, Skënder Shehu, Hysni Deliu (ky u ndal në majën e parë të malit); Gjirokastra 3 pjesëmarrës; -Delvina 3 pjesëmarrës; -Fieri: Tafil Grëmi, Mahmud Sefa, Arif Beqiri; -Kavaja 3 pjesëmarrës (njëri u ndal në majën e Qores); -Korça 3 pjesëmarrës (njëri u ndal në Dukat); Pogradeci 3 pjesëmarrës nga të cilët 2 nuk u ngjitën; -Durrësi 3 pjesëmarrës nga të cilët dy nuk u ngjitën; Berati 3 pjesëmarrës nga të cilët 1 nuk u ngjit; -Vlora 3 pjesëmarrës nga të cilët 2 nuk u ngjitën.

Udhëheqës i veprimtarisë ishte Luigj Shala. Më datë 20 Prill lëvizën nga Vlora në Dukat; më 21 Prill nga Dukat në Qafë Llogora – Maja e Çikës – Dukat; më 22 Prill nga Dukat në Vlorë.

I pari ekskursion alpinistik i të rinjve u realizua nga **9 Korrik deri më 12 Korrik 1952**.

Itenerari: 9 Korrik, Elbasan – Labinot i Sipërm; 10 Korrik, Livadhet e Teqesë – Kaptinë e Martaneshit; 11 Korrik, Kaptinë e Martaneshit e kthim nga Biza në Shëngjergj; 12 Korrik, Shkalla e Priskës – Hidrocentrali i Surrelit – Tiranë.

Pjesëmarrësit: Luigj Shala udhëheqës, -Tirana: Avni Zajmi, Guxim Hamzaraj, Genc Zajmi, Ahmet Golemi, Sali Sulejmani, -Tirana Rreth: Vehbi Dervishi, Jakup Dervishi, Abdulla Sadiku, Ismail Hysa, Ibrahim Aliu; -Korça, 3 pjesëmarrës; -Shkodra 3 pjesëmarrës.

I pari ekskursion alpinistik për femrat.

Kjo veprimtari u organizua në Korçë prej datës **14 Gusht deri më datë 17 Gusht 1952**. Itenerari: 14 Gusht, Korçë – Vithkuq, 15 Gusht, Vithkuq – Shtyllë (tek vendi i formimit të Brigadës së Parë ku marshuesit morën pjesë në festimin e 9 vjetorit të krijimit të kësaj Brigade); 16 Gusht, Stratobërdë – Katund – Sharë – Selenicë e Pishës – Lubonjë – Bellovodë; 17 Gusht, Pulahë – Qatrom – Korçë. Pjesëmarrëset: Tirana, Shpresa Kodra, Lavdie Çausi, Pranvera Seseri, Dafina Zoto; -Korça, 6 pjesëmarrëse; -Gjirokastra, 2 pjesëmarrëse; -Berati, 4 pjesëmarrëse; -Elbasani, 2 pjesëmarrëse. Përgjegjës e drejtues të veprimtarisë: Luigj Shala nga Komiteti Kulturës Fizike e Sporteve dhe Korçari Raqi Mandi.

Kampionati kombëtar i Alpinizmit, 1952.

Ky kampionat u zhvillua nga 21 Qershor deri më 27 Qershor 1952. Itenerari i garës: Bogë – Kolgecaj. Itenerari: 21 Qershor, Shkodër – Kolgecaj me autobus; 22 Qershor, Kolgecaj – Qafa e Kolqit – Mbi Mulaj – Shtegu i Dashit e fjetje në brezin pyjor mbi shteg; 23 Qershor, ngjitje në rëzë të Majës së Paqes; zhvillimi i garës dhe zbritje brënda po asaj dite nëpër shteg të Dragobisë dhe fjetje në Dragobi; 24 Qershor, garë shpejtësie: ngjitje malore nga lumi i Valbonës deri tek Shpella e Dragobisë; 25 Qershor, kthim në Valbonë – Ragam – Qafë Valbonë – Theth; 26 Qershor, ngjitje deri në afërsi të Shtegut të Dhenve duke filluar prej aty garën rezistente deri në Bogë. Pjesëmarrësit janë klasifikuar në vendet nga i pari deri tek i gjashti.

Ngjitja në Majën e Paqes me udhëheqës Luigj Shala: Puna e Tiranës me, Ferid Gjeniu, Muharrem Hoxha, Zejnulla Strazimiri, Bashkim Lubonja, përgjegjës ekipi, Elmaz Maha; Spartaku i Tiranës, përgjegjës Dhimosten Adam dhe anëtarë, Xhavit Xhikani, Llazi Qirjaqi, Nikolla Çollaqi, Ali Çausi, Jorgji Karamita; Dinamo 10 pjesëmarrës; Partizani 10 pjesëmarrës.

Viti 1953

Gara Kombëtare në Alpinizëm, 11 Janar 1953.

Veprimtaria u zhvillua më 11 Janar 1953. Klasifikimi: Tirana 33 pikë; Vlora 19 pikë; Korça 18 pikë. Nga Tirana morën pjesë: Hasan Rama, Ferid Gjini, Napolon Shtylla. Duket se si individë duhet të ketë qënë ky klasifikim (ab): 1. Aleks Ruci, Vlora; 2. Tomor Lenja, Korçë; 3. Andrea Berberi, Korçë; Ferid Gjini, Tiranë, etj.

Viti 1954

Gara Kombëtare në Alpinizëm, 11 Janar 1954

Pjesëmarrja: Tirana, Korça, Elbasani, Dibra, Berati, Durrësi, Gjirokastra, Kruja. Moti është i mirë. Qyteti i Tiranës ka 15 centimetra dëborë. Ora e nisjes 09:05. I pari mbërrin Hasan Rama i Qarkut të Tiranës duke e mbuluar distancën Sheshi Skënderbej – Maja e Malit të Dajtit në 2 orë e

44 minuta, pastaj Ramazan Roshi i Krujës, dy nga Korça, një nga Dibra, një nga Korça, etj. Vendi i parë, Korça me 26 pikë, vendi i dytë, Tirana me 21 pikë, vendi i tretë Dibra me 12 pikë.

Viti 1956

Kam bindjen se që në vitin 1955, për sportin e alpinizmit (por edhe të turizmit) udhëheqja e Komitetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve do ketë bërë marrëveshje me qeverinë dhe me Ministrinë e Punëve të Brëndëshme që alpinistët të pajiseshin me Leje Hyrje për në zonat kufitare, nga rrethi/qyteti nga niseshin. Po bëj një ilustrim duke sjellë përvojën time nga koha kur drejtoja ekipin e alpinistëve Apollonia e Fierit.

Përpiloja listën e anëtarëve të ekipit, me gjeneralitetet e sejcilit dhe vetes, që do merrnin pjesë në veprimtari dhe ja dorëzoja udhëheqjes së klubit rreth dy javë para se të niseshim për në zonat kufitare.

Klubi i drejtonte një shkresë Degës së Punëve të Brëndëshme të qytetit, bashkëngjitur me listën e pjesëmarrësve, duke përcaktuar vendin ku do të shkojë ekipi (p.sh. në Theth). Dega e Punëve të Brëndëshme i pajiste me lejen përkatëse ata anëtarë të ekipit që ajo i gjykonte si të besueshëm për të shkuar në zonën në fjalë (mua më është refuzuar Leja Hyrëse për në zonë kufitare dy herë gjatë periudhës 21 vjeçare që ishta trajner i ekipit të alpinistëve 17 Nëntori i Tiranës). Interesohej udhëheqja e Klubit Sportiv për procesin e nxjerrjes së lejeve, dhe kur Dega e Punëve të Brëndëshme thoshte se lejet janë gati, shkoje dhe i merrje.

Ekipi në datën e caktuar nisej dhe një ditë do e kalonte në Shkodër. Dorëzoheshin Lejet (alpinistët i quanin Leje Kufitare) në Degën e Punëve të Brëndëshme në Shkodër, bashkë me pasaportën (sot quhet kartë identiteti) dhe do të shkoje t'i merrje të nesërmen të firmosura nga Dega. Kishte raste që një gërmë e emrit në Leje Hyrëse nuk përputhej me atë të pasaportës, apo ishte tepër a mangut, dhe detyroheshe të ktheheshe (i ndodhi në vitin 1963 Vasil Stambulit kur isha me të për tu ngjitur në majën e Jezercës. Dhe më ngeli mua të jem komandant (!) ndërkohë që unë e kisha ngjitjen në këtë mal për herë të parë).

Pas kësaj (nuk po shkruaj për problemet me hotelin dhe transportin) niseshim për në Theth. Do kontrolloheshim për pasaportë e Lejen Hyrëse tek Çesma e Koplikut, pastaj në Koplik [nganjëherë vetëm në një nga këto pika] dhe kur të arrinin në Theth pasaportat dhe lejet e kufirit dorëzoheshin në postën kufitare aty. Pasaporta merrej para nisjes për kthim.

Posta kufitare të linte porosi që të lëvizje nga kampimi për veprimtari kur del dielli (lejoheshin edhe përjashtime të para njoftuara) e do ktheheshe kur perëndon dielli. Për lëvizjet ditore në mal duhej që të vije në dijeni njësitin kufitar pranë kampingut, i cili kamping duhej ngritur jo përtej kësaj pike/njësitit (sepse më pranë vijës kufitare duhej të ishte Posta Kufitare). **Më duket** se ky rregull (ose diçka e ngjashme) ishte edhe për ata punonjës që vinin me fletë kampi në Shtëpinë e Pushimit në Theth, apo edhe individë të përcaktuar si pushues në familjet Thethjane.

Ja një ilustrim. Ahmet Osja, nga Shkodra, shok i imi gjatë studimeve universitare, ishte mësues i lëndës së biologjisë dhe kimisë në atë qark. Ai ishte pasionant i shquar dhe i përkushtuar si biolog. Më kërkon që të vinte me ekipin tim (17 Nëntori) që t'i mundësoja që të mblidhte e të bënte herbariume me bimësinë përreth Thethit, sepse nuk i mundësohej sigurimi i Lejes Hyrëse për në zonat që ishin shpallur kufitare. Në ato vite ekipi i alpinistëve Vllaznia e Shkodrës nuk e kishte ekipin të plotësuar me 12 alpinistë, dhe rashë në ujdë me trajnerin e ekipit shkodran (Hasan Temalin ose Gëzim Oruçin) që ai të bëhej anëtar i ekipit. Dhe kështu ai u bë anëtar i ekipit të alpinistëve shkodranë. Pra, biologu Ahmet Osja u desht të bëhej alpinist, dhe vërtet u bë, dhe fitoi kategorinë e dytë sportive më 1974, që të merej me pasionin e tij. Dhe kjo, që të studjonte bimësinë e Thethit e më gjërë në Alpet tona.

Ministria e Punëve të Brendshme

LEJE — HYRJE

Për në Zonën Kufitare

Nr. 051050

Lëshuar: Ndeshja e Kufirit

Shtetësi: Shqiptar

Lindur më: 1943

(date, muaji, viti)

Vendi i lindjes: Berat

(Fshati, Qyteti, Lokaliteti, Rrethi)

Vendi i banimit: Shkup

Profesia: Student

Pasaporta: A.B. 243636

(serie, numri, data)

Vendi ku do shkojë: Shkup

Qëllimi i vizitës: Shkup

E vlefshme deri më: 31-7-1963

(data e skadimit)

Wane më 15-7-1963

Kryetari Degës P. Br. Rrethit

Ndeshja e Kufirit

(Grua, emri i gruas)

Bilby

P.S. — U paraqit në organet kufitare më datën

Shoqëria largua më datën

U lejua të shkojë në kufirin kufitar, më

deri më

1956

62

Viti 1956 është një vit batinë e një rëndësie të veçantë në historinë e zhvillimit të alpinizmit në vendin tonë. Që nga viti 1945 e deri në vitin 1956, për të gjithë të rinjtë që përfshiheshin në veprimtaritë turistike dhe alpinistike të organizuara, mësimet për elementë teknikë të ngjitjes, kalimit të relievit, kacavarjes, etj., jepeshin gjatë minutave të pushimeve ose në veprimtari të sipër. Duke filluar nga ky vit këto elementë, mësimet për alpinizmin, filluan të jepen nëpërmjet grumbullimeve (të quajtura n'ato fillime ZBOR) deri dy javore dhe të dejtura nga një instruktor, duke patur një program të paramenduar mësimor me tema teorike dhe praktike. Këtë vit filloi “epoka” e alpinizmit cilësor. Personi që e ideoi, organizoi dhe realizoi këtë shkollë ishte alpinisti Minella Kapo.

Në shkurt të vitit 1956, nën drejtimin e Minella Kapos u ndërmorr ngjitja në majën e Korabit me 13 pjesëmarrës. Udhëtimi Peshkopi Radomirë zgjati gjithësej 13 orë dhe u mori dy ditë (kujtojmë se në këto vite nuk kishte rrugë automobilistike për t’ju afruar malit të Korabit-ab).

Në datën 21 mars grupi niset i ndarë në katër nën grupe (katër litarë). Synimi për ngjitjen e majës dështon, kryesisht për arësye të borës së madhe. Grupi kthehet në fshat me qëllim që të nesërmen të marrë rrugën e kthimit për në Peshkopi.

Shpërdorimi pas kthimit nxiti kërkesën për një tentativë të dytë. Kjo bëri që në datën 23 të synojnë ngjitjen e majës 10 vetë. Nisen në orën 2 pas mesnate dhe në orën 10 ata janë në majë. Komandant Minella Kapo. Kjo është ngjitja e parë dimërore në majën e Korabit nga alpinistë Shqiptarë.

Më 18 korrik të vitit 1956, trembëdhjetë vetë, nën drejtimin e Minella Kapo-s, për gjatë dy javëve, mësuan, për të parën herë në vendin tonë në mënyrë të organizuar, për pajimet alpinistike dhe përdorimin e tyre, si dhe teknika të ndryshme të kalimit të relievit. Ishte shkolla e parë **verore** e alpinizmit shqiptar.

Pjesëmarrësit, më të shumtët, ishin sportistë alpinistë të cilët kishin marrë pjesë në ngjitjen e maleve tona, kryesisht pa pajime, madje as dhe me veshje të përshtatshme, si dhe ndonjë dashamirës për veprimtaritë në natyrë. E kam të lehtë të përpiloj listën e tyre falë botimit “Alpinizmi Ynë” me autor Prof. Dr. Kozma Grillo dhe memories së të ndjerit Koço Qafzezi (për emrin Andrea Berberi në këtë listë): Minella Kapo, organizator dhe drejtues i veprimtarisë; Luigj Shala, Vasil Stambuli, Petraq Kule, Manol Bozaxhiu, Myftar Marku, Grigor Perikliu, Vehbi Seiti, Bardhyl Saqillari, Dhimitër Banushi, Kozma Grillo, Koço Qafzezi, Andrea Berberi.

Telegram nga alpinistët

“Theth. Më 18 korrik, buzë lumit të Thethit, u zhvillua ceremonia zyrtare e çeljes së kampit të parë alpinistik në vendin tonë. Përveç 18 alpinistëve ishin të pranishëm mbi 100 fshatarë dhe nxënës. Pas ceremonisë filloi mësimi teorik mbi alpinizmin. Në rradhë të parë u fol për ecjet, përdorimin e kazmës, përdorimin e litarëve, sigurimin në ngjitje e zbritje shkëmbore, etj.

Dje, sipas programit, alpinistët kanë filluar udhëtimin për të vajtur në Shtrëgun e Dhenve, Radohimë, Qafë Pejë, e kthim. Gjatë këtij itinerari ata do të mësojnë ecjen në dëborë dhe akull.

Alpinistët gëzojnë shëndet të plotë”

Korespondenti i “Sportit Popullor” 25 Korrik 1956.

Disa nga këta pjesëmarrës u bënë “bërthama të dijeve” alpinistike dhe i përcollën njohuritë e marra në shkollë të tjera alpinistike që u organizuan më pas.

Shënime:

1. Për “shkollën” e trajnimit të mësuesve gjurmues, në vitin 1922 e kemi vendosur foton më sipër.
2. Për shkollën e alpinizmit të vitit 1956 kam pas parë foton ku kanë pas pozuar të gjithë pjesëmarrësit. Nuk gjej sot një të tillë.
3. Në veprimtaritë e pas L2B burim ilustrimesh për veprimartitë e zhvilluara kam bindjen se është Minella Kapo. Ai ka patur aparat fotofrafik, po unë nuk kam qasje në arkivin e tij.

1957

Në muajin shkurt të vitit 1957 në zonën e Llixhave të Peshkopisë organizohet shkolla e parë alpinistike **dimërore** nën drejtimin e Minella Kapos. Gjatë ditëve të kësaj shkolle u organizua një grup për ngjitjen e majës së Korabit. Kjo përpjekje u kurorëzua me ngjitjen e majës. Midis pjesëmarrësve të kësaj arritje shtatë prej tyre ishin pjesëmarrës që e kishin realizuar ngjitjen e kësaj maje edhe një vit më parë.

Ngjitja e majës u bë me nisje nga fshati Zimur. Në zbor dhe në ngjitje morën pjesë alpinistë të Shkodrës, Tiranës, Beratit, Korçës, Elbasanit, Vlorës dhe Peshkopisë; gjithsej 18 veta.

1958

Në vitin 1958 e më pas katedra e fiskulturës së Universitetit të Tiranës zhvilloi rregullisht shkolla dimërore të alpinizmit (31 janar-1 shkurt, peridha e pushimeve dimërore të studentëve dhe pedagogëve). Më pas këto shkolla, si dhe shkollat verore, u organizuan jo vetëm nga Universiteti i Tiranës, por edhe nga Bashkimet Profesionale (sot Sindikatat) në Malin e Dajtit, në Theth, në Razëm, në Voskopojë; por edhe në njësi të veçanta ushtarake.

Më 28 janar 1958 në kampin e punëtorëve në malin e Dajtit (sot King Park) u hap shkolla e parë e alpinizmit me studentë (meshkuj e femra) të Universitetit Shtetëror të Tiranës. U realizua falë bashkëpunimit të Rektoratit të Universitetit të Tiranës, Bashkimeve Profesionale (sindikatat për kohën) dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Komandant i shkollës (aso kohe quhej ZBOR) ishte Minella Kapo. Instruktorët (këta quheshin komandant toge; toga kishte jo më shumë se 15 anëtarë) e parë ishin pjesëmarrësit e shkollës së parë alpinistike të organizuar në Theth. Vasil Stambuli e Kozma Grillo; pedagogu i katedrës së fiskulturës së këtij universiteti Andon Tapia, si dhe punëtori (zdrukthtar) Petraq Kule nga Berati, njëherësh pjesëmarrës i shkollës së parë alpinistike.

Në Janar të vitit 1958 studentë, dekanë dhe pedagogë nga të gjithë fakultetet e universitetit ju drejtuan malit të Dajtit. Në këto shkolla kaluan plot pedagogë dhe studentë të fakulteteve të ndryshme. Disa prej tyre u bënë alpinistë me emër, me kontribut të veçantë në lëvizjen alpinistike shqiptare. Janë për tu përmendur: Vasil Vreto, Tefta Zguro, Mustafa Selenica, si dhe Petraq Kule, Vasil Stambuli, Kozma Grillo, Aleksandër Bojaxhi, Vullnet Zylyftari, Piro Liko, Eqerem Shehu, etj., që krijuan dhe/ose drejtuan ekipe alpinistike.

Për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti u morën të gjitha masat e nevojshme:

1. U përgatitën programet stërvitore për 12 ditë.
2. U siguruan instruktorët.
3. U siguruan, me ndihmën e ushtrisë (SHNUM-Shoqëria në Ndihmë të Ushtrisë dhe Mbrojtjes): xhupa, këpucë, pantallona, kokore dhe doreza për 100 pjesëmarrës.
4. U siguruan çadra, karabina, kunja/plenga akulli, litarë personalë dhe kolektivë, ski, etj.
5. Shkolla do të zhvillohej në barakat e kampit të punëtorëve në malin Dajt (më vonë në godinën e re në Fushën e Dajtit). Akomodimi dhe ushqimi u siguruan nga Bashkimet Profesionale, përkundrejt një pagese prej 400 lekë (monedhë e asaj kohe).

6. Drejtues i shkollës (për disa vjet) do të ishte Minella Kapo dhe instruktorë do të ishin: Vasil Stambuli, Kozma Grillo dhe Andon Tapija të Klubit Sportiv “Studentit” dhe Petraq Kule nga qyteti i Beratit. Më pas u shtuan si instruktorë edhe studentë të cilët u përfshinë në ekipin e alpinistëve të Klubit Sportiv Studenti.
7. Në këto shkolla të përvitëshme merrnin pjesë rreth 80 studentë dhe pedagogë.

Këto shkolla/kampe/zbove organizoheshin pasi mblidheshin studentët në mëlin e Dajtit dhe drejtoheshin nga një shtab ku merrnin pjesë tre deri pesë alpinistë, ata më me përvojë dhe drejtuesit e togave. Veprimet e ditës përcaktoheshin nga shtabi (në mbrëmje) dhe lexoheshin para pjesëmarrësve pas gjimnastikës së mëngjesit dhe para hyrjes për në mence.

Ja një model për ilustrim:

Urdhër dite Nr 6
Datë 5/II/1961


- 1) Programi i datës 4/II/1961 u realizua plotësisht.
- 2) Përgëzojmë shokët e togës I-rë dhe të II-të për ngjitjen që bënë në majën e Dajtit.
- 3) I hiqet verejtje shokut Ferit Sikaxhiu i cili nuk shkoi dje në ngjitje por shkoi për të bërë ski pa lejen e Shtabit.
- 4) Kritikohet alpinisti Astrit Shahini që nuk zbatoi urdhërin për pastrimin e nevojtove, urdhër të cilin ngarkohet ta zbatojë sot para buke.
- 5) Mbasi kryen punën në Tiranë u kthyen në këmbë shokët Bardhyl Xhako, Miço Llamushi dhe Hilmi Balla.

Për datën 5/II/1961
U R D H Ë R O J

- 1) Toga e I dhe e II të bëjnë zbritje Dylfer dhe ngjitje e zbritje sportive.
- 2) Toga e III të bëjë ski në Fushën e Dajtit.
- 3) Dezhurn për datën 5 caktohet toga e I ndërsa për datën 6 toga e II.
- 4) Sot të përfundojë
- 5) Të bëhen përgatitje për marshimin një ditor.
- 6) Toga e I të organizojë mbrëmje vallëzimi.
- 7) Toga specilale të ndezë zjarrin partizan.

Komandanti i Kampit
Alpinisti i kat. I
Vasil Stambuli

Dajt 5/II/1961



Shënim: ky urdhër dite dhe ai i datës 4 më janë dhënë për ruajtje nga ish alpinisti i mirënjohur i kohës, student i fakultetit të mjeksisë, Mustafa Selenica.

Në përfundim të shkollës së parë të alpinizmit në malin e Dajtit pjesëmarrësit fituan: 3 kategori të para sportive, 2 tituj “Instruktur i ri i Alpinizmit”, 9 kandidatë për instruktorë, 3 Turist i RPSH” dhe pjesa tjetër “Alpinist i RPSH”.



*Andon Tapia dhe dy studente, shkurt 1958
Fillimi ishte me “uniforma shtëpie”*



*Fillimi i shkollave në malin e Dajtit, 1958,
“me uniforma shtëpie”*



*Rreshtimi para nisjes për marshim dy ditë me fjetje jashtë.
Dajt 1958*



Shkolla e alpinizmit Dajt 1958. Mësim për lidhjet e litarit

Kujdes lexues: a. Në foto të veprimtarisë së parë në këtë mal do shikoni edhe rreshtime me veshje “nga shtëpia”. b. Në fotot e kampeve studentore të viteve të para, veshjet që siguronte për pjesëmarrësit katedra e fiskulturës së universitetit ishin “mbetje” të veshjeve për partizannët e luftës NAÇL të dhuruara nga SHNUM-i. Por kishte edhe individë (sidomos vajzat) që përdornin ndonjë veshje personale.



*Rreshtimi para nisjes për marshim dy ditor me fjetje jashtë.
Dajt 1960*

1959

Gjatë shkollës dimërore në Dajt ndodhi një histori që ja vlen të kujtohet.

2 shkurt 1959. Togat e studentëve nisen për të kryer veprimet e ditës sipas Urdhërit të Ditës (programit). Pas pak fillon një shi i madh që më pas u kthye në dëborë. Pjesëmarësit janë pranë zjarrit duke treguar përshtypjet e ditës, por njëra togë, e katërta, nuk është kthyer në kamp. Presin deri ora 23.....

Të nesërmen herët në mëngjes, një grup alpinistësh, nën udhëheqjen e mjeshtrit të sportit Minella Kapo, u nis për të kërkuar shokët e humbur. Ky fakt shënon një faqe të re në historinë e alpinizmit tonë: për herë të parë krijohet skuadra e kërkim-shpëtimit. Pjesëtarët e kësaj skuadre, kur u kthyen, dhanë lajmin e gëzuar se anëtarët e togës së katër ishin mirë....

Shënim nga AB: gjatë viteve, në veprimtari apo në shkolla të alpinizmit, gjithnjë brënda pjesëmarrësve krijohej një bërthamë e grupit/togës së shpëtimit i cili përdorej kur lindte nevoja. Një shëmbull i mirëpërcaktuar gjendet në botimin "Nëpër Bjeshkët e Namuna" në faqen 138.

Muaji Mars. Synohet ngjitja në majën e Jezercës. Nga Shkodra janë 7 djem (ndër ta Gjon Simoni, Vehbi Seiti) dhe tre vajza; Vasil Stambuli dhe 3 studenta me të. Gjatë ngjitjes lindën divergjenca ngaqë u lodhën vajzat. Vajtën deri tek Jezera e Vogël.

Informacioni si më poshtë është nxjerë nga relacionet që përgatiti Minella Kapo për të paraqitur veprimtaritë ndërkombëtare alpinistike që u organizuan në vitet 1959 dhe 1960.

1959

Veprimtaria ndërkombëtare që u organizua në Theth u quaj Olimpiada e Parë Shqiptare e Alpinizmit. U aktivizuan 10 sportistë nga Republika Demokratike Gjermane, 3 nga Republika e Çekosllovakisë dhe 8 alpinistë shqipëtarë. Bashkë me alpinistët tanë ata kryen ngjitje në zonën e Alpeve. Në këto veprimtari ra në sy përgatitja superiore e alpinistëve gjermanë (nga Republika Demokratike Gjermane). Ata u shquan si atletë kacavarës të shkëlqyer dhe teknikat e tyre të kacavarjes si dhe itenerarët e ngjitjeve që realizuan u bënë modeli që udhëhoqi alpinizmin shqiptar, dhe sidomos kacavarësit, për shumë vite.

Mbi zborin ndërkombëtar të alpinizmit që u zhvilluan në Theth 16-30 korrik 1959.

- Dhjetë alpinistët gjermanë ishin të kualifikuar në shkëmb, por me dobësi në ecjet me kazëm në borë e akull.
- Alpinistët Çekosllovakë (shkurt çekë) ishin më të dobët në kacavarje (erdhën tre ditë më vonë), por kishin përgatitje të gjithëanëshme alpinistike.
- Alpinistët shqiptarë kishin përgatitje të përgjithëshme alpinistike, por ishin dobët në teknikën e lartë të kacavarjes në shkëmb me mjete.
- Veshmbathja e të huajve shumë e mirë; e jona shumë dobët.
- Pajimet tona ishin të varfëra; të huajve të mira.
- Ushqimi i mirë.
- Ndihma e shpejtë aspak e organizuar dhe me shumë pak nga gjithëshka.
- Koha bëri shumë e mirë. Ra pak shi që nuk e pengoi programin.
- Tefta Zguro rezistoi shumë mirë.

Ekipi Çekosllovak (nga qyteti Brno)

1. Milan Lasak
2. Alica Losakova
3. Jozef Mazanrek
4. Anton Tapia shoqërues dhe anëtar i grupit të tyre nga ekipi Shqiptar. Njëherësh edhe përkthyes.

Ekipi Gjerman:

- | | |
|------------------------|------------------------------|
| 1. Dürichen Harry | 19.10.1910 (Trajneri i tyre) |
| 2. Däveritz Karl | 27.09.1940 |
| 3. Grabs Christov | 25.06.1935 |
| 4. Gladum Alexander | 07.03.1937 |
| 5. Heineman Rolf | 09.01.1937 |
| 6. Lóbe Harald | 17/02.1937 |
| 7. Schmidt Eckehart | 18.10.1935 |
| 8. Schönberger Günther | 04.02.1936 |
| 9. Stengel Konrad | 16.08.1938 |

Ekipi Shqiptar

1. Minella Kapo
2. Vasil Stambuli
3. Vasil Vreto
4. Belul Hatibi
5. Tefta Zguro
6. Andon Tapia
7. Grigor Perikliu
8. Vangjel Melengu

Ekipi Sovjetik

Me tre alpinista (anëtarët e këtij ekipi ishin të llojit turista me kategori sportive dhe nuk lanë mbresa alpinistike).



Pjesëmarrës të Olimpiadës së parë Shqiptare në Theth



Koço Qafzezi (djathtas poshtë) me dy gjermanë dhe lart dy sovjetikë

Veprimtaria

Dita e parë, para dite njohëm njëri tjetrin dhe këmbyen përvojë. Mbasdite u nisëm për në Qafë të Harapit. Dita e dytë: udhëtuam deri në Qafë të Vishensit dhe aty u ndamë në shtatë grupe, sulmuam Vishensin në shtatë drejtime. Itenerari VL më i vështiri. Litarët e punës si më poshtë:

Hari – Hotast – Minella; Aleks – Ligor (Grigor Perikliu); Kristov – Vangjel Melëngu); Ralf – Jorgji – Vasil (itenerarin e kat IV të vështirësisë); Kom – Andoni ngjitën kategorinë e III të vështirësisë; Ekjard – Belul Hatibi, itenerar i kat II të vështirësisë; Karl – Genti – Tefta Zguro – Vasi Stambuli kat III vështirësisë.

Ditën e tretë shkua në Radohinë, kurizit të saj e në majën e Vishensit. Itenerar pa vështirësi teknike.

Dita e katërt: ngjitje në majën e Harapit në katër drejtime:

Hori – Minella - Horat nga VL Kat III vështirësisë; Konj – Belul – Ekjard nga perëndimi, kat V e vështirësisë; Ralf – Vreto – Jorgji nga veriu kat IV e vështirësisë; Stambuli – Tefta – Andoni nga JP kat III e vështirësisë. Një grup me Aleksin, Karklin Gent, Kristov u ngjitën në malin e Rushkullit (2.496 m). Mbasdite zbritën në Theth ku u takuam me grupin Çek.

Dita e pestë. Bëmë pushim.

Dita e gjashtë përgatitje për udhëtim gjashtë ditor. Shkuam tek Gropat e Bukura.

Dita e shtatë. Shkuam në Jezercë (2.693 m), në Popllukë (2.569 m). Vështirësi të shkallës I A ose I B. Konj, Aleks, Belul, Ligor dshkuan në malin e Prozhmit (2.452 m).

Vasili, Alica, Vangjeli bënë një ngjitje shkëmbore e vështirësisë V ose VI dhe u kthyen sh vonë: ora 21:30. Për këtë vonesë (gabim i përsëritur) Vasilit ju hoq e drejta e ngjitjes në ditën e nëntë.

Dita e tetë. Shkuam në Valbonë, dolëm në Qafë të Alisë dhe u ngjitëm në majë. Kampi u ngrit në pyll pranë burimit mbi Rrogam

Dita e nëntë. U nisëm për ngjitje më të vështira:

Hari – Minella – Horst për në malin e Boshit nga VP (2.415 m).

Grupi Çek: Milan – Alica – Josef – Andon – Vangjel për në malin e Brijasit (2567 m). Të tjerët do të studjonin vendin për ngjitjet e ditës së dhjetë.

Grupi I për për të arritur majën punoi 14 klitarë kacavarje si dhe disa litër ngjitje pa kacavarje. Ora 20:10 arritën në majë të Boshit ku dhe kaluan natën. Ngjitja e shkallës VI të vështirësisë.

Dita e dhjetë. Grupi i majës së Boshit zbriti në Qafë e prej aty në Rrogam.

Konj – Beluli – Karl – Gent – Tefata u nisën për në majën e Valit (2237 m). Treshes ku ishte Tefta ju këput litari nga një shkëmb që ra mbi të dhe u kthyen.

Grupi Çek me Vangjelin dhe Andonin e filluan dje ngjitjen për në brijas. Pas 2-300 metra ngjitje i zuri nata dhe fjetën aty, të lidhur me litarë e gozhdë të ngulura. Filluan ngjitjen në mëngjes por mungesa e ujit dhe vështirësia e itinerarit bënë që të fillojnë zbritjen. Në kamp i sollën rojet e kufirit në ora 21:00.

Dita e njëmbëdhjetë: Hori – Vasili – Horati u ngjitën në majën e Valit.

Ora 13:00 të gjithë nisemi për në kampin e Thethit. Vetëm Hori mbeti në kampin e Valbonës sepse i humbi një objektiv aparati.

Dita e dymbëdhjetë: kthimi Theth Shkodër me autobus.

Gjermanët shumë të kënaqur. Thanë që këtu duhet të rrish me vite për të bërë gjith këto ngjitje që të afrohen. Gjermanët ishin të etur për kacavarje dhe nuk u shkonte programi ynë (ata ishin më liberal me veprimet ndërmjet anëtarëve të ekipit. Ne më të rreptë; më afër me rregullat ushtarake.

Shënime:

1. Ndoshta kjo është arsyeja që në vitin 1960 ata erdhën dhe punuan pa shqiptarë.
2. Emrat e pjestarëve të litarëve të punës janë bunime të emrave origjinalë.

Në mbyllje të veprimtarisë kemi këtë tabelë të rritjes në kategori sportive të anëtarëve të ekipit tonë:

Emri Mbiemri	Kategoria sportive që kishte	Kategoria sportive që fitoi	Mosha
Minella Kapo	Mjeshtër Sporti	Mjeshtër Sporti	37
Vasil Stambuli	I	I	30
Vasil Vreto	II	I	20
Belul Hatibi	II	I	37
Tefta Zguro	Distiktiv	III	22
Andon Tapia	III	II	29
Grigor Perikliu	II	II	33
Vangjel Melëngu	III	II	28

Shënim: pesë nga anëtarët e ekipit patën rritje në kategorit sportive.

Ekipi gjerman kishte 4 alpinistë me kategori të parë sportive, 4 alpinistë me kategori të dytë sportive dhe 2 alpinistë me kategori të tretë sportive.

Të tre alpinistët e ekipit Çek kishin kategori të dytë sportive.

Në këtë material mungon emri i alpinistit korçar Koço Qafëzezi. Ai u aksidentua që ditën e pare të veprimtarisë. Udhëtonte me alpinistë gjermanë dhe rrëshqiti (ishte me këpucë të pa përshtatëshme) në një pjesë të ngrirë. Përfundoi në Shkodër, në spital.

Duket që ideja që sundonte se “në sportin tonë socialist nuk ndodhin aksidente”, ka bërë që nuk e kanë paraqitur në relacion (ab).

Në muajin korrik në malin Kaukaz me ekipin tonë kombëtar të kohës.

Emri Mbiemri	Kategoria sportive që kishte	Kategoria sportive që fitoi	Mosha
Luigj Shala	Mjeshtër Sporti	Mjeshtër Sporti	
Petraq Kule	I	I	
Kozma Grillo	I	I	
Koço Qafëzezi	II	I	
Thanas Vasili	III	II	

Shënim: Vetëm Thanas Vasili pati rritje në kategori sportive

Në muajin korrik të vitit 1959 një ekip alpinistësh nga vendi ynë mori pjesë në shkollën e alpinizmit në kampin “Alibeg” të Kaukazit Perëndimor (në ish BRSS). Ekipi përbëhej nga Luigj Shala, Petraq Kule, Kozma Grillo, Koço Qafzezi, dhe Vasil Thanasi. Ky ekip, krahas seancave mësimore, realizoi edhe dy ngjitje alpinistike të mirëfillta: në majën e malit Sufruxhu (3.785 m) dhe në Dombain e Vogël (3.800 m). Lartësia 3.800 metra mbeti për një kohë të gjatë lartësia më e madhe që ju mundësua alpinistëve shqipëtarë (deri sa erdhi koha e demokracisë) që të ngjiten.



Ekipi ynë 1959 në Kaukaz



Ekipi që u ngjit në majën Dubai

Po në këtë vit, alpinisti Andon Tapia, pedagog i edukimit fizik në Universitetin e Tiranës dhe njëherësh alpinist i Klubit Sportiv Studenti u dërgua në Republikën Demokratike të Çekosllovakisë ku realizoi disa ngjitje me alpinistët atje në malet Tatra.

Muaji Nëntor. Synohet ngjitja në majën e Jezercës nga një grup ku është edhe Andon Tapia. Dështuan.

Relacione

Minella Kapo

Mbi zborin Ndërkombëtar të Alpinizmit

Theth 16-30.VII.1959

Viti 1959 është me një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të alpinizmit në vendin tonë.

Kampi ndërkombëtar i Thethit ku erdhi ekipi kombëtar Gjerman i përbërë prej 10 vetësh alpinistë të kualifikuar, tre alpinistë Çek (*në fakt Çekosllovakë, por në gjuhën e folur ne thonim Çek – ab*) dhe 8 shqiptarë si dhe i dërguari i 5 alpinistëve në Kaukaz të Bashkimit Sovjetik (*ndërkohë në BS ishte ekipi ynë me pesë alpinistë – ab*), janë eveniment me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare për alpinizmin Shqiptar.

Alpinistët Gjermanë ishin të kualifikuar në ngjitjet shkëmbore, por jo të përgatitur në ecjet me kasma, në akull e ngjije alpinistike, gjë të cilën e pranonin edhe vetë ata.

Alpinistët Çekë erdhën tre ditë më vonë, por mendojmë se kualifikimi i tyre në ngjitjet shkëmbore është më i ulët se i gjermanve, por kishin një përgatitje të gjithanëshme alpinistike.

Grupi shqiptar kishte përgatitjen e përgjithshme alpinistike, por akoma dobët në teknikën e lartë të ngjitjes shkëmbore me mjete. Megjithë mungesën e stërvitjes vjetore, grupi i alpinistëve shqiptarë mundi t'i bëjë ballë të gjithë programit, i cili ishte shumë i ngarkuar dhe i një kualiteti të laartë.

Shëndeti fizik i të gjithëve është i mirë, veshmbathja e të huajve e mirë. Ushqimi shumë i mirë në kamp, pothuaj i mjaftueshëm në mal. Ndihma e shpejtë aspsk e organizuar dhe me shumë pak gjëra. Koha bëri shumë e mirë, ra disa herë shi por nuk pengoi zbatimin e prorogramit. Femra shqiptare Tefta Zguro ka rezistuar shumë mirë.

Dita e parë vlejti për njohjen e aftësive të njëri tjetrit, për ndrimin e eksperiencës; mbasdate u nisëm për në Qafë të Harapit.

Dita e dytë kemi bërë ngjitje kurizore nga Qafa Harapit deri në Qafë të Visnjes. Këtu bëmë ndarjen e grupeve dhe ju ngjitëm majës shkëmbore të Vishnjës në 7 drejtime nga veri-lindja. Zonë më e vështirë, 2517 m.

Grupet dhe kategoritë e vështirësisë së itenerarit

Nr	Grupi	Vështirësia e itenerarit
1	Hari - Horast – Minella	
2	Aleks Ligor (G Perikliu)	
3	Kriston V Melengu	
4	Ralf – Jorgji – V Vreto	IV
5	Kon – Andoni	III
6	Ekjard – Belul Hatibi	II
7	Karl – Genti – Tefta – V Stambuli	III

Nga 7 drejtimet, 4 u muarnë, dy të tjerët u dretuan në rrugën tonë. Por edhe ne nuk e kaluam një zonë shumë të vështirë, megjithse u përpoqëm 2-3 orë. Ora 6 të darkës vendosëm të kthehemi duke lënë 3-4 gozhdë/plenga në shkëmb.

Përshtypjet tona qenë shumë të mira, për punën e kujdesëshme, teknike e me sigurime të shokëve gjermanë. Me ata u krijua besimi se mund të ngjitesh i sigurtë.

Ditën e tretë shkuam në Radohimë, 2569 m, pastaj kurrizit në majën e Vishnjës dhe kthim. Nuk kishte vështirësi shkëmbore.

Ditën e katërt ju ngjitëm mali të Harapit, 2217 m në katër drejtime:

Nr	Grupi	Vështirësiaa
1	Hori – Minella – Horat nga veri-lindjaa	III
2	Konj – Beluli – Ekjard nga perëndimi	V
3	Ralf – Vreto – Jorgji nga veriu	IV

4	Stambuli- Tefta – Andoni nga j-perendimi	III

Sukses qe se këtë rradhë vetë shqiptarët bënë ngjitje shkëmbore të kategorisë së III, por u kritikuan mbasi bënë ngjitje pa lejen e duhur dhe para kohe; kjo nga dëshira për të treguar aftësitë e tyre.

Një grup me Aleksin, Karlin, Gent, Kristov u ngjitën në malin e Rushkullit 2496 m. Mbasdite zbritëm në Theth ku u takuam me shokët Çekë.

Ditën e pestë bëmë pushim

Dita e gjashtë, përgatitje për udhëtimin 6 ditor. U nisëm për në Qafën e Pejës, tek Gropat e Bukura ku është burimi.

Ditën e shtatë, shkuan në Jezercë, 2693 m, Popllukë 2569 m. Vështirësi e I A ose e I B. Konj, Aleks, Beluli, Ligor shkuan në malin e Prozhmit, 2452 m.

Vasili, Alica, Vangjeli bënë një ngjitje shkëmbore të vështirë, të V ose të VI; u vonuan shumë, deri ora 9 e 30 e natës. U kritikuan për vonesën dhe për një ngjitje të tillë (të vështirë – ab). Vasilit, si gabim i përsëritur, ju hoq e drejta që të ngjitet në mal ditën e nëntë. **Koment** ab: në këtë periudhë, që në fillim të tubimeve caktoheshin rregulla strikte për zgjimin, etj e deri tek një orë e caktuar për kthim si dhe për fjetje. Por llogjika thotë se kur bëhet një ngjitje premierë, për herë të parë, askush nuk e di se sa do zgjasë. Për rastin, të realizosh me sukses një ngjitje që doli, rezultoi e shkallës së lartë të vështirësisë dhe të kthehet grupi shëndoshë e mirë në kamp është jo llogjike të dënohet drejtuesi i grupit. Nuk di raast tjetër si ky)

Dita e tetë, shkuan në Valbonë dhe kur dolëm në qafën e Alisë, u ngjitëm sipër në majë. Në Valbonë u sistemuam në pyll, tek burimi mbi Rrogam.

Dita e nëntë, u nisëm për ngjitje të vështira:

1. Hari-Minella-Horat për në malin e Boshit, nga VP, 2415 m.
2. Grupi Çek: Milan, Alica, Josef, Andon, Vangjel M për në malin e Brijasit, 2567 m.
3. Grupet e tjera do të studjonin vendin për ngjitjet e ditës së dhjetë.

Grupi Horat-Minella-Heri dualën në Qafë të Valbonës, nga e majta e qafës; me litarë dolën në qafë rrëzë shkëmbit shkuan në vendin më të vështirë dhe filluan ngjitjen ora 13. Itenerari ishte i vështirë. U punua me dy litarë nga 45 metra. U bënë gjithsej 14 litarë ngjitje, pa përmendur vendet ku nuk u përdor litari. U bë një ngjitje shkëmbore rreth 500 metra lartësi. Litari IV, VII, VIII, dhe sidomos litari XII qenë etapat më të vështira. Ora 8 pa 10 e darkës arritëm në majë të Boshit (atëhere nuk bëhej ndrimi i orës; Mars – Tetor që bëhet thashmë prej vitesh -ab). Fjetëm në majë të Boshit.

Ditën e dhjetë në ora 3 e 30 të mëngjesit filluam ngjitjen nga mali I Boshit, por në drejtim të lindjes dhe duallëm në qafën e Valbonës-Curraj i Sipërm afër malit të Briosit (Brijasit-ab) dhe zbritëm në Rrogam e në orën 9 e 30 të natës u gjendëm në kamp.

Ndërkohë Konj, Beluli, Karl, Gent, Tefta u nisën për në malin e Valit, 2237 m. Grupit të Teftës ju pre litari nga një shkëmb (që u shkëput dhe ra mbi litar – ab). Kjo fatkeqësi bëri që grupi të kthehet.

Grupi Çek me Andonin dhe Vangjelin M filluan qysh dje ngjitjen dhe pas 2-300 metra i zuri nata. Ora 8 ndaluan, dhe të siguruar, lidhur me litar e me kunj/gozhdë shkëmbi kaluan natën. Ditën e dhjetë filluan ngjitjen, por nuk kishin ujë, oreksi u ishte prerë, forcat i kishin lënë, gjatë rrugës (itenerarit) gjetën vështirësi. U detyruan të kthehen që në 10 të mëngjesit. Në Rrogam zbritën në errësirë. Rojet e kufirit i prunë në kamp. Ishin shëndoshë.

Dita e njëmbëdhjetë Hori, Vasili Horati u ngjitën në malin e Valit 2237 m, e kategorisë II A të vështirësisë. Ora 10 erdhën në kamp.

Ora 13 të gjithë shëndosh e mirë nisemi për në kampin e Thethit. Horit në kampin e Valbonës i humbi një objektiv aparati.

Ditën e dymbëdhjetë kthehemi me autobus nga Thethi në Shkodër. Të nesërmen shkuam në Shirokë dhe mbasdite arritëm shëndoshë në Tiranë.

Kampi alpinistik deri sa mbaroi programin me sukses dhe nuk ndodhi asnjë fatkeqësi. Kaluam shumë mirë, pati mjaft sukses dhe miqt u kënaqën jo vetëm për ngjitjet e bëra, por edhe për malet tona, që janë të mrrerkullueshme. Ata u shprehën se “duhet të rish me vite për të bërë gjithë këto ngjitje”. Për pritjen, ushqimin, shoqërimin mbetën shumë të kënaqur. Por me gjithë ate duhet vu në dukje disa gjëra:

1. Në kamp të kishte një parullë “Mirë se ardhët” në të tre gjuhët; qoftë edhe në shqip do ishte shumë mirë.
2. Në kamp të bëhej ceremonia e çeljes së kampit ku të ngriheshin flamurët e tre vendeve pjesëmarrëse. Ose në kamp të ishin vendosur tre flamurët.
3. Ne kemi krijuar kondita shumë të mira të disiplinës personale, të rregullit, të organizimit, etj., gjatë ngjitjeve. Meqë ishte hera e parë e një organizimi të tillë, me që shkollën e tyre nuk e njihnim fare dhe duke parë se ata ishin alpinistë të kualifikuar, ne u rezervuam për faktin se do të kishim përplasje e mos kënaqësi. Por kjo qe hera e parë, neve u bindëm se ne kemi të drejtën e rregullave tona. Edhe ata u bindën se kështu duhet. Ata e justifikuan se nuk janë nisur ashtu për vetë konditat e vendit të tyre, të cilët shkojnë me motorçikleta deri në rrëzë të shkëmbit. Shokët Çekë i jepshin më tepër rëndësi kësaj ane. Mbas ngjitjeve të tre ditorit të parë grupi shqiptar vuri shumë rregull, mori inisiativën dhe lanë përshtypje të mira. Në të ardhmen në kamp duhet të punohet në bazë të traditave tona, të marruna nga shkolla Sovjetike duke plotësuar kërkesat e miqve.

Koment -ab: “të marruna nga shkolla Sovjetike”. Shëmbulli Sovjetik, më vonë shëmbulli Kinez dhe më parë shëmbull Jugosllav ishin “sevilizma” të gjuhës së partisë tonë. I përsëritnim edhe ne, populli, kur vinte rasti. Alpinizmi është unik si sport në teknikë për arritjen e synimit, ngjitjen e një itenerari. Kudo në botë njëlloj. Ndryshimet nga një shtet në tjetrin, nëse dikush i ndjen a kupton, janë të diktuara nga malet, klima dhe vendosen rregullat. Kurrë nuk kam dëgjuar termin shkollë Gjermane, Kineze a çarë. Literatura të mëson teknika dhe askund shkolla.

4. Ngarkesa e programit ishte parashikuar drejt nga ne, por e konkretizuar kur shkuam në vend. Shokërt gjermanë ishin shumë të etur për ngjitje shkëmbore. Por shpejt kuptuan se metodika e tyre e grafikut të punës gjatë kampit ishte jo e drejtë. Ata lakmuan sa më shumë ngjitje. Në tre

ditët e para bënë 11 ngjitje shkëmbore, nga të cilat 8 me sukses; u ngjitën në 4-5 maja. Por në gjashtëditorëshin grafiku u ul shumë, u bë vetëm një ngjitje shkëmbore, ajo e jona (Hori-Minella-Horart) në malin e Boshit e kategorisë së VI ndërkombëtare (që është dhe kategoria më e vështirë ndërkombëtare), kurse të tjerat, të gjitha dështuan. U ngjitën 6 maja. Të gjithë kapitulluan fizikisht në kuptimin e fjalës. Në këtë gjëndje zakonisht gjejnë shkas edhe fatkeqësitë.

Grupi ynë i pa stërvitur u lodh shumë ditët e para. U vendos që tanët të shkojnë me turne. Por praktika tregoi se tanët e morrën veten shpejt dhe në fund ishin plot energji.

Në të ardhmen mendoj se ne, vendi organizonjës, të jemi më të matur. Tashmë ne njohim mirë shkollën Sovjetike, Çekoslllovakë e Gjermane. Besoj se për analogji e njëjta shkollë është edhe tek alpinistët e tjerë të kampit tonë (socialist-ab). Neve duhet të dijmë planin e alpinistëve që vijnë dhe në bazë të aftësive që kanë dhe ditëve në dispozicion të caktojmë sasinë e ngjitjeve shkëmbore e të tegorive të tyre. Të mos u lëmë atyre liri të plotë, mbasi për çdo fatkeqësi përgjigjemi neve.

Në këtë tubim, ne karshi të huajve nuk morrëm asnjë masë. Masa ndaj Vasil Stambulit, si alpinist i hedhur dhe që kërkon lavdi, atyre në fillim ju duk si habi, pastaj u bindën se ishte e drejtë. Kjo masë sikurse thanë ata u vlejti edhe atyre që të jenë më të përmbajtur, e të përfundojnë me sukses.

Koment - ab: hamendësoj se “ngurtësia” që ka treguar Minella Kapo (ishte drejtues dhe organizator) me rregullat e tij, si dhe i gjithë komunikimi në veprimtari, kanë qenë arsyeja që kur erdhën alpinistët gjermanë një vit më vonë, në 1960, ata bënë ngjitje të mrekullueshme vetëm me dyshe dhe treshe alpinistësh të ekipit të tyre. Asnjë shqiptar.

Edhe sot e kësaj dite, që nga koha e shembjes së monizmit, në malet dhe shkëmbejtë e maleve tona vinë alpinistë me kombësi e shtetësi nga më të ndryshmet dhe realizojnë ngjitje bazuar në njohuritë teknike që kanë dhe nuk duan t’ja dinë për “shkollë” alpinizmi.

Meqenë se ne ende nuk i kemi ngjitur të gjitha faqet shkëmbore, mendoj që gjatë programit të bëjmë dy kategori ngjitjesh:

- a. Ngjitje të njohura në bazë të vështirësisë.
- b. 2-3 ngjitje të tjera të reja, të pa njohura.

Për të shpejtuar njohjen e faqeve shkëmbore, duhet që në një faqe të shkojë një grup dhe jo të gjithë, sikundër ndodhi në faqen shkëmbore të Vishensi ose të Harapit. Në çdo grup alpinistash të ndarë të caktohet dhe një alpinist i kualifikuar i jonë, i cili edhe i drejton edhe përfiton.

5. Në kampe të tilla duhet me doemos një kirurg dhe qendër saniteti. Sporti i alpinizmit është sport burëror, sporti i guximtarëve. Bashkë me sukseset motër e vëlla janë edhe fatkeqësitë. Tek neve s’ka ndodhur asgjë. Kjo spjegohet me kujdesin e madh, organizimin e mirë, por edhe nga shansi. Andaj në të ardhmen duhen marrë masa serioze.
6. Mos ngjitja e gjermanëve në itinerarin thikë të Vishnjës dhe e alpinistëve çek në malin e Brijasit, tregon se në vendin tonë ka faqe mali jo të lehta. Faqja jugore e majës së Harapit, mali i Boshit, mali i Brijasit, Gryk e Hapt, Mali i Thatë, mali i Kollatës, malet rreth Bogës, janë me faqe shkëmbore shumë interesante si për studim edhe për ngjitje.

.....

Neve fituan një eksperiencë shumë të madhe, u njohëm me shkollën e shteteve Europiane dhe u kualifikuam

Një eksperiencë të madhe fituan edhe 5 shokët që shkuan në Kaukaz të Bashkimit Sovjetik. Ata ndenjën 17 ditë në kamp, u njofën me punën organizative atje, treguan përgatitjen e tyre dhe bënë 2-3

ngjitje në akullnajën Ali-Beg ku përfituan shumë. Bënë ngjitje në malin Sufraxhu të kategorisë Sovjetike I B dhe ngjitje në Dombazën e Vogël vështirësia II A. gjatë ngjitjes së dytë moti u prish dhe nga rrufeja kanë shpëtuar kot. Ata panë organizimin e garave të olimpiadave, etj.

Shkolla jonë është mbështetur krejtësisht në atë Sovjetike (Koment: përsëri “parullë”. Në këtë kohë “shkolla Sovjetike” kishte në bazë të saj ngjitjen e majave 7000 metroshe të cilat janë jo pak në masivin e Pamirit, etj. Ndërkohë ata përgatiteshin, që bashkë me kinezët të realizonin ngjitjen në majën Everest. Ky plan u prish kur partitë në pushtet prishën mardhëniet midis tyre). Këtë e treguan shumë mirë 5 alpinistët tanë që shkuan në Kaukaz (Koment: lartësia e majave që ngjiten alpinistët tanë në Kaukaz ishin Sufraxhu 3785 m dhe Dumbai i Vogël 3800m. Lartësia 3800 m mbeti lartësia më e madhe e ngjitur nga alpinistët shqiptarë deri në mesin e viteve 90, ngaqë asnjë alpinist nuk doli jashtë kufijve të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ku maja më e lartë është maja kufitare Korab/Golem i Madh/Maja e Madhe 2751 m).

Me ardhjen e gjermanëve dhe çekëve, ne pamë se atje i japin shumë rëndësi ngjitjeve shkëmbore, aq sa ata na thanë se ne alpinista s’kemi sepse edhe alpe nuk kemi; ne kemi kacavarës. Lidhur me sa pamë jemi të mendimit, që edhe ne në të ardhmen t’i japim rëndësi edhe profilit të ngjitjeve shkëmbore me mjete. Në këtë drejtim është punuar për njohuritë bazë dhe sigurimet.

Shokët gjermanë nuk i zhvillonin garat shkëmbore. Neve kemi zhvilluar dhe mendojmë se duhen zhvilluar (koment: është fjala për veprimtaritë më vehte, ose si pjesë e ngjitjeve malore, që organizoheshin me synimin “kush del i pari” në një majë a qafë ku drejtues e organizator i tyre rezultojnë se ishte Luigj Shala).

Edhe në të ardhmen ne duhet të mbështetemi kryesisht në shkollën sovjetike (koment: pas rreth 1-2 vjet nga shkrimi i këtij raporti partia jonë sdhe ajo sovjetike i prishën mardhëniet dhe termi “shkolla sovjetike” nuk u përmendën dmë. Ndryshe.....hë! Madje nuk u fol apo shkrua për asnjë lloj shkolle alpinizmi).

Por me alpinistët e kualifikuaro të ishte mirë të punohej në vend të orëve për akullnaja (ngaqë tek ne mungojnë) t’i zëvendësojmë me teknikën e lartë të ngjitjeve shkëmbore. Kjo edhe për faktin se malet tona kanë mjaft faqe shkëmbore.

Koment: a. Po të synosh majën e Jezercës/Jezerës/Mëcekun e Alpeve Shqiptare nga ana veriore, aty shikon se ne kemi një “copë” akullnajë disa qindra metrishe. b. dashur padashur kjo pjesë e relacionit tregon se alpinizmi ynë do zhvilluar sikundër na e diktojnë malet tona.

Për sa më sipër propozojmë:

1. Me rastin e 15 vjetorit të çlirimit të atdheut të bëhen 5 ngjitje në majat më të larta si: Korab, Jezercë, Maja e Paqes (mali Morroces, maja e Hekurave), Çuka Partizane (d.mth. maja Abaz Ali ose ndryshe maja e Kulmakut), dhe Paping. Me këtë rast ftojme edhe 5 alpinistë sovjetikë për të bërë ngjitje të përbashkëta.
2. Kampi i Dajtit në dimër të kthehet tërësisht në kamp alpinistik me dy turne. Në turin e parë të vijmë alpinistë nga rrethet, drejtorët e kampeve turistike dhe sidomos instruktorët e kampeve turistike (koment: në kampet e punëtorëve si në Theth, Razëm, Voskopojë, Lurë, etj në organikë gjatë funksjonimit, si rregull në sezon të ngrohtë, kishin një instruktor që drejtonte pushuesit nëpërmjet marshimeve në vendet më interesante të zonës). Me elementët e avancuar të përpilohet një program special, i cili të vazhdojë gjatë dy turneve. Kjo do të ngrejë shumë mjeshtërinë dhe përgatitjen fizike të alpinistëve tanë. Këtu do të ishte mirë të përfshihen edhe alpinistët të cilët mendohet se do të shkojnë vitin e ardhshëm në Gjermani, Çekosllovakia dhe në Bashkimin Sovjetik. Në këtë kamp mund të ftohen edhe alpinistë të huaj fillestarë, studentë. Turni i parë të

bëhet me alpinistët e rretheve, kurse turnui i dytë të jetë për studenta. Mundësisht banimi të jetë në ndërtesën me gurë (në këtë kohë ishte në ndërtim e sipër-ab).

3. Për shokët që do të shkojnë në Mars në Çekosllovakia, duhet të bëhet me doemos grumbullimi i tyre për të bërë stërvitje intensive. Po kështu edhe grupet që do të shkojnë në Gjermani dhe Bashkimin Sovjetik. Duhet thënë se grupi gjerman kishte bërë stërvitje vjetore, plus një muaj grumbullim.
4. Kampi i Thethit jemi të mendimit që të bëhet kryesisht kamp alpinistik, qoftë për fillestarë, qoftë për alpinist të rinj ose të kulifikuar; qoftë për alpinistë të huaj. Kampi alpinistik të jetë turn tre javësh.

Për elementin që vjen i pa studjuar, jemi dakort që me të të formohen grupe turistash. Thethi i ka të gjitha mundësitë dhe konditat të kthehet në një shkollë alpinizmi për vendin tonë, prej ku të përgatiten kuadro për alpinizmin dhe turizmin lokal.

Me këtë rast theksojmë se program turistik që zhvillohet në kampet turistike është aq formal e minimal, sa ky program duhet të zhvillohet në çdo kamp (për punonjësit me fletë kampi – ab) të zakonshëm.

5. Që alpinizmi të marrë proporcione të gjëra dhe të rritet kualiteti, duhet me doemos të sigurohen nga Bashkimet Profesionale (sot emërtohen sindikata-ab) pajimet e veshmbathjet me kohë:

1. Këpucë me gozhda (d.m.th. këpucë ku shojet janë me godhda/thumba)	Palë 100
2. Këpucë gome me qafa për shkëmb	Palë 60
3. Kazma alpine	copë 100
4. Çelsa gjoksi (karabina)	copë 200
5. Kunja për shkëmb	copë 200
6. Çanta shpine/ranca	copë 100
7. Litar personal 100x5m	metlin 500
8. Litar kryesor 45 metrosh x30 copë	metlin 1350
9. Doreza cohe	palë 100
10. Pajimet e ndihmës së shpejtë	-----
11. Çadra	copë 40
12. Thes alpin për fjetje	copë 40

PROGRAMI I KAMPIT ALPINISTIK NDËRKOMBËTAR (Theth 16-30 korrik 1959)

Datë		orë
16. VII	Tiranë – Shkodër	-----
17. VII	Në kalanë e Rozafatit	2

Mungon faqja 8 e Relaacion-it

M. Kapo V A (VI)

B. NGJITJE MAJASH

1. Visens	(I A)	2517 m	të gjithë
2. Radohimë	(I A)	2569 m	të gjithë
3. Harapi	(-----)	2217 m	të gjithë
4. Maja Shtegut	(I B)	2246 m	-----
5. Jezercë	(I B)	2693 m	Kapo, Stambuli, Vreto, Zguro, Tapia Melengu
6. Papllukë	(I A)	2569	Kapo
7. Prozhmi	(I A)	2412	Hatibi, Perikliu
8. Alie	(I B)	2471 m	Kapo Melengu
9. Boshit	(I B)	2415	Kapo
10 Valit	(II A)	2237	Stambuli

C. TABELË PËRMBLEDHËSE

	Ngjitje shkëmbore	Maja
M. Kapo	2	7
V. Stambuli	2	5
V. Vreto	2	4
B. Hatibi	2	4
T. Zguro	2	4
A. Tapia	2	4
L. Perikliu	--	4
V. Melengu	--	5

SHUMA	12	37

Kategoritë sportive të fituara nga Shqiptarët

Alpininisti	Kategoria që kishte	Kategoria që fitoi
M Kapo	Mjeshtër Sporti	Mjeshtër (e përsëriti)
V. Stambuli	I	I
V. Vreto	II	I
B. Hatibi	II	I
T. Zguro	Distinktiv	III
A. Tapia	III	II
L. Perikliu	II	II
V. Melengu	II	II

Nga shokët që shkuan në Bashkimin Sovjetik

Luigj Shala	Mjeshtër Sporti	Mjeshtër
-------------	-----------------	----------

P. Kule	I	I
K. Grillo	I	I
K. Qafëzezi	II	II
Th. Vasili	III	II

Kategoritë sportive sipas ekipeve

	Mjeshtra	I	II	III	Distiktiv
Gjermanët	-----	4	4	2	-----
Çekët	-----	-----	3	-----	-----
Shqiptarët	1	1	3	2	1

Sipas profesioneve

	Nënpunës	studentë	inxhinjerë	punëtorë	pedagogë
Gjermanët	1	6	1	1	1
Çekët	-----	-----	2	1	----
Shqiptarët	1	3	-----	1	3

Më tej relacioni ka pasqyra të majave dhe faqeve shkëmbore në zona të Alpeve tona si dhe lartësitë e majave: nga Boga, nga Livadhet e Bogës, nga Gropat e Bukura, nga Valbona, nga Selimaj (kështu quhej dikur fshati që sot quhet Valbonë), nga Thethi, nga Dragobia. Koment: n'atë kohë këto informacione vlenin sepse gjendeshin në hartat topografike ushtarake dhe këto harta quheshin secrete. Duhej të siguroje autorizim për t'i patur. Në mbyllje të këtij informacioni të fundit Relacioni ka këtë

SHËNIM:

Në këto 43 maja që kanë një lartësi po thuaj se mbi 2400 mt paraqesin interes për ngjitje malore, por shumica e tyre paraqet interes për ngjitje shkëmbore. Pastaj çdo mal ka drejtime të ndryshme dhe mjaft interesante për varjacionin dhe shkallën e vështirësisë.

Qendra e kampit do të jetë Thethi dhe prej këtu do nisen grupet e organizuara për në kampet e tyre lëvizëse.

Tiranë, 6.VIII.1959

Minella Kapo

1960

Në muajin Janar. Synohet ngjitja në majën e Jezercës. Drejton Minella duke patur 10-12 alpinistë. Ngjitja nuk realizohet.

Muaji Mars. Në datën 8 mars, u ngjit të parën herë në sezonin dimëror maja e Popllukës. Kjo ngjitje u udhëhoq nga Tefta Zguro dhe maja u pagëzua me emrin "Maja 8 Marsi". Të nesërmen, tre nga pjesëmarrësit e kësaj veprimtarie, Minella Kapo, Vasil Stambuli dhe Mustafa Selenica ndërmorrën dhe arritën të ngjiten në majën e Jezerës (2.694 m), pullazi i maleve tona. Ngjitja e këtyre dy majave rezultoi të jetë ngjitja për të parën herë e tyre nga alpinistë shqiptarë në sezonin dimëror.

Në verën e vitit 1960 erdhi në vendin tonë një ekip alpinistësh gjermanë, ku kishte edhe anëtarë nga të ekipit nga të vitit 1959, që realizoi disa itinerarë shkëmborë në Alpet tona. Në këmbim, Minella Kapo, Tefta Zguro dhe Vasil Vreto shkuan në Republikën Demokratike Gjermane dhe realizuan kacavarje bashkë me alpinistët gjermanë. Viti 1960 ishte dhe viti i fundit që alpinistët tanë realizuan ngjitje me alpinistë të huaj.

Veprimtaria në Republikën Demokratike Gjermane (11/VI/ deri 1/VII/1960)

Përbërja e grupit: Vasil Vreto, Tefta Zguro, Minella Kapo.

Grupi nuk u përgatit si duhet për dy arsye:

- U nis me nxitim.
- Neglizhenca e Komitetit të Kulturës Fizike e Sporteve për arsye të mosnjohjes së këtij sporti duke arsyetuar se “që të grumbullojmë alpinistët atëhere mbetet që të grumbullojmë dhe delegatët që dalin jashtë shtetit. (Neglizhencë absurde dhe injorancë e habitëshme e drejtuesve të sportit. (ab)

Grupi u nis pa veshjen e duhur sportive si dhe me mungesa në këpucë për kacavarje dhe pajime teknike.

Në aeroport i pritë Fred Borch, i caktuar si trajner për ekipin tonë (kështu quhet shoqëruesi i alpinistëve) i cili ishte trajner i shtetit për ekipin e të rinjve në RD Gjermane. Të nesërmen shkuan në Drezden. Këtu ekipin e pritë Harry Derychen, përgjegjësi i alpinistëve Gjermanë që erdhem në vendin tonë në vitin 1959 dhe 1960. Kaluan disa orë në Drezden me vizita në qytet dhe mbasditë me tren shkuan në Bend-Chandau dhe prej aty në kampin Ostrava të alpinistëve.

Në kamp vetëm Tefta u sistemua mirë. Ushqimi fillimisht i mirë por më pas ra cilësia. Nuk kishin përkthyes. U dhanë pajisje të përdorura, sa për të bërë ngjitje (edhe ata “Kamp Socialist” ishin-ab).

“Më 13 Qershor dita e parë e punës tonë. Trajneri i tyre na solli disa vjetërsira si këpucë dhe robe për të veshur. Kjo gjë neve na çuditi: shokët nuk donin t’i vishnin, por duke ditur rëndësinë e vajtjes sonë atje, i veshëm. Tëftës i dhamë këpucët e mija, çeke të reja. Nga ditët e fundit na prunë dy palë këpucë për ngjitje, nga më të këqiat, të cilat me një ngjitje dolën jashtë përdorimit. Mungesa e veshmbathjes dhe sidomos e këpucëve speciale ka ndikuar negativisht për rezultate edhe më të mira”. (M. Kapo).

Që në kacavjerjet e para trajneri u bind se ne mund të bënim edhe ngjitje të kategorive të vështira. Ja tabela e ngjitjeve që realizuam.

Kategoria e Vështirësisë

Emrat	II	II	IV	V	VI	VII	Shuma
Minella Kapo	2	4	5	2	5	5	23
Vasil Vreto	2	4	5	-	6	6	23
Tefta Zguro	2	3	4	1	3	1	14
Shuma	6	11	14	3	14	12	60

“Në fillim s’kishim besim në ngjitjet, e sidomos në zbritjet nëpër shkëmbij të çarë. Por me të mësuar teknikën e zbritjes nëpër to u bëmë më të sigurtë.

Për Tëftën trajneri u shpreh shumë optimist. Ky na tha se ndërsa vajzat gjermane në ngjitjet shkëmbore me oxhaqe të kategoria të IV mezi e bëjnë, qajnë dhe duan të kthehen mbrapsht, Tefta edhe në kategoritë më të larta të vështirësisë, lufton deri sa ja del mbarë. Është shumë e vendosur, si djalë.” (Shënim ab: shkëmbenjtë në këtë pjesë të Gjermanisë nuk janë të lartë dhe janë disi shtuforë. Zbriteshin nëpër parete duke marrë pozicion të trupit vertikal, por duke i vendosur këmbët si në këmbë kryq. Ne nuk kemi shkëmbej të tillë të njohur për kacavarje në vendin tonë.

Nga 60 ngjitjet e kryera, 14 u udhëhoqën nga alpinistët e ekipit tonë.

Ekipi mësoi që shkolla Gjermane ishte shumë e fortë në kacavarje.

Pasqyra e ngjitjeve shkëmbore të bëra në R.D Gjermane
11/VI - 1/VII/1960

Data	Vendi	Shkëmbi	Drejtimi	Kategoria	Faqja e 6rit	Harta	NGJITJE			DREJTIME		
							Minella	Vasili	Tefta	Minella	Vasili	Tefta
13-VI-1960	Falkenstein	Falkenstein-Hauptgipfel	Schusterweg	III	151	2	+	+	+			
15-VI-60	Zackenkrone	Eisenspitze	Nordostweg	VII	126	VI	+	+	+			
16-VI-60	Kleine Steinschleuder	Steinschleuder	Südweg	VI	28	3	+	+	+			
17-VI-60	Schrammsteingebiet	Dreifingerturm	Alter Weg	III	138	2	+	+				
18-VI-60	"	Meurerturm	Südweg	IV	123	2	+	+	+			
17-VI-60	"	Vorderer Torstein	Perry-Smith-Variante	III	120	VI	+	+	+	+		
17-VI-60	"	Spitzer Turm	Südkamin	II	128	2	+	+	+		+	+
17-VI-60	"	Kesselturm	Nordweg	IV	124	2	+	+	+	+		
18-VI-60	Affensteingebiet	Blaustock	Fehrmannweg	VI	129	2		+				
18-VI-60	"	"	Alter Nordweg	V	132	VI	+		+			
18-VI-60	"	Amboss	Nordostkante	VII	124	VI	+	+				
18-VI-60	"	Brosinnadel	Alter Weg	IV	123	2			+			
21-VI-60	Schmilkaer Gebiet	Rauschenstein	Alter Südweg	II	211	VI	+	+	+		+	+
21-VI-60	"	Winkelturm	Südwand	VI	216	VI	+	+	+	+		
21-VI-60	"	Fluchtwand	Südweg	VII	224	VI	+	+	+			
22-VI-60	Schrammsteingebiet	Zahnsgrundwächter		VI	120	2	+	+			+	
24-VI-60	Affensteingebiet	Flachhöpfe	Talweg	VII	120	2	+	+				
24-VI-60	"	Amboss	Alter Weg	IV	121	2	+	+				
25-VI-60	Schrammsteingebiet	Westlicher Schrammturm	Alter Weg	VII	132	2	+	+				
25-VI-60	"	Südlicher Schrammturm	Südweg	VII	136	2	+	+				
26-VI-60	Kleiner Zechand	Heringstein	Osternweg	VII	255	VI		+				
26-VI-60	"	"	Hohes Winkel	2	255	VI	+					
26-VI-60	"	Gleitmannstürme	Südwestweg	IV	252	VI	+	+	+	+	+	
26-VI-60	"	"	Alter Weg	IV	252	VI	+	+	+	+	+	
27-VI-60	Gebiet der Steine	Barbarine	Alter Weg	VII	28	VI	+	+	+	+	+	
27-VI-60	"	Südt. Pfaffenschluchspitze	Nordkante	IV	80	VI	+	+		+	+	

Kjo pasqyrë e ngjitjeve të kryera në R D Gjermane na mësoi se gjermanët kishin një katalog për itinerarët e ngjitjeve, i cili për çdo itinerar përmbantë: Vending, Emërtesën e shkëmbit, Drejtimi që u realizua ngjitja, Kategoria e vështirësisë së itinerarit, Faqja në "katalog".

Kjo ide filloi të zbatohet nga ne në fillim të viteve 70 por nuk dha një product të plotë për pamjaftueshmëri të kapaciteteve intelektuale.

Relacion

Mbi grupin e alpinistëve që shkuan në

R. D. Gjermane

11/VI deri 1/VII/1960

Grupi përbëhej pre tre vetash: Vasil Vreto, alpinist i kategorisë së parë, Tefta Zguro, alpiniste e kategorisë së dytë dhe prej meje.

Grupi nuk bëri asnjë përgatitje para nisjes, gjë që ndodhi ngaqë u bënë përgatitjet të shpejta, si dhe për mendimin e disa shokëve udhëheqës në K.K.F. e Sporteve se gjoja "po të grumbullojmë alpinistët

atëhere mbetet të grumbullojmë edhe delegatët që dalin jashtë shtetit”. Koment: mendoni vetë se sa “pro sport” ishin disa anëtarë të Komitetit të Kulturës Fizike e Sporteve të vendit tonë! Njëkohësisht, mendoj se, kishte drjtues të lëvizjes fiskulturore që e konsideronin alpinizmin baraz me një ekskursion në mal,).

Sporti i alpinizmit është një degë e sporteve sikundër janë sportet e tjera dhe që kërkon me doemos një përgatitje të madhe fizike e teknike. Sikur grupi të kishte ikur në fund të muajit Maj, mbas grumbullimit që u fillua në Dajt, atëherë rezultatet e ngjitjeve të grupit do të ishin më të mira e më të shumta dhe pa avaritë e shpeshta që ndodhën.

Grupi u nis i pa pajisur me vesh mbathjen e nevojshme për ngjitjet shkëmbore, si këpucë e roba. Tutat që morëm ishin vetëm për paraqitje, sepse për ngjitje ato ishin jo vetëm të pa përshtatëshme, por pas 2-3 ngjitjeve delnin jashtë përdorimit. Neve i ruajtëm (I kërkonte magazinieri për arësye inventari-ab). Këpucët tona të gomës ishin aspak të përshtatëshme. Por meqë shokët gjermanë kishin marrë angazhim për pajisjen tonë, u nisëm të qetë. Unë megjithatë kisha marë vesh mbathjet e mija personale (kilota, bluzë, këpucë çeke, etj.)

Shokët gjermanë na pritën në aeroport. Vetë shoqëruesi ynë Fred Barch ishte (caktuar) edhe trajneri ynë, i cili ishte trajneri i shtetit për ekipin kombëtar të rinisë. Me të zbritur na shpuri jashtë Berlinit në Grunau për të kaluar natën. Prej këtu telefonuam ambasadën tue i njoftuar mbërritjen.

Të nesërmen kaluam nëpër Berlin dhe u nisëm për Dresden. Këtu na priti Harry Derychen, përgjegjësi i ekipit të alpinistëve gjermane, që ishin vjet dhe sivjet në vendin tonë. Ky kish dalur me gjithë të shoqen. Atë ditë e kaluam së bashku në Drezden, vizituam vendet me më shumë rëndësi, kaluam drekën bashkë dhe mbasdite vonë u nisëm me tren për në Band-Chandau, ku ndodhej kampi i turistëve dhe alpinistëve.

Në kamp Tefta u sistemua shumë mirë, kurse neve jo dhe aq mirë, pse kishte mundësi të ishte edhe më mirë. Ushqimi në fillim ishte shuë i mirë, por pastaj filloi të pakësohej. Mungonte përkthenjësi, kjo bëri që për shumë gjera ne të mos merreshim vesht. Kërkuam të kemi përkthenjës- pse donim të sqaroheshim për shumë probleme, që na dilnin përpara, si për organizimin e alpinizmit, të turizmit, të kampeve, shpenzimeve, etj. Por deri në fund ikëm pa u marë vesht. Neve filluam të kuptonim gjërat më të nevojshme në ngjitje dhe me shenja e zëra kafshësh.

Më 13 qershor dita e parë e punës tonë, trajneri na pruri disa vjetërsira, si këpucë dhe roba për të veshur. Kjo gjë neve na çuditi; shokët nuk donin t'i vishnin, por duke ditur rëndësinë e vajtjes sonë atje i veshëm. Teftës i dhashë këpucët e mija mija çeke. Nga ditët e fundit na prunë dy palë këpucë për ngjitje, nga më të këqiat, të cilat me një ngjitje dolën jashtë përdorimit. U a treguam dhe atyre për t'i bindur. Mungesa e veshmbathjes dhe sidomos e këpucëve specile (e ka fjalën për këpucë për kacavarje -ab), ka ndikuar negativisht për rezultate akoma më të mira. Me që neve nuk njiheshim me ngjitjet e gjermanëve dhe ata nuk njihnin aftësitë tona, kërkuam që grafiku të vinte duke u rritur, nga ngjitjet e lehta në më të vështirat; si t'i shikonte forcat tona trajneri. Në fillim u njojtëm me një pjesë të shkëmbejve, pastaj bëmë mësim praktik në shkëmbej të vegjël dhe po atë ditë bëmë ngjitjen e parë të kategorisë së tretë të vështirësisë. Tefta Zguro qe e dyta në litar, pas trajnerit, pra qe e para alpiniste shqiptare që bëri ngjitje në shkëmbijtë gjermanë. Në mbas dite bëmë analizën e ditës dhe të ngjitjes. Trajneri na tregoi se neve pa frkë mund të bënim edhe ngjitje të kategorive më të vështira. Çfarë ngjitje bëmë po ju a paraqes në formularin bashkëngjitur. Këtu dua të theksoj disa gjëra rreth ngjitjeve.

1 Për ngjitjet duhej një përgatitje e madhe fizike. Neve kjo na mungonte; kështu gjatë kësaj periudhe bëmë edhe ngjitje edhe përgatitjen e nevojshme fizike. Asnjë ditë nuk lamë pa bërë gjimnastikën e mëngjjesit. Por me gjithë atë mund të them se me qenë se ngarkesa shkonte vazhdimisht duke u rritur, neve çdo ditë e më shumë ndjenim lodhje, se nga fundi filluam të ndjejmë lodhje të tmershme, të vuanim

nga pagjumësia dhe oreksi. Dëshira për ngjitje filloi të bjerë, por detyra të bënte që asnjë ngjitje të mos e lëmë pa kryer. Bile në luftë me lodhjen ishte dëshira për të provuar sa më shumë ngjitje. Kjo në kundërshtim me shkollën sovjetike të alpinizmit. Për forcë Vasili u paraqit shumë më mirë nga neve.

2 Përgatitjen teknike, neve e kishim jo të keqe, sa ata nuk e besonin se neve jemi në këtë nivel. Mjaft elementë të rinj u kapën shpejt dhe në këtë drejtim bëmë përparime të dukëshme. Fakti që qysh ditën e dytë bëmë ngjitje të kategorisë së gjashtë (VI) të vështirësisë tregon besimin e trajnerit tek përgatitja jonë teknike. Po kjo rrugë vazhdoi edhe për ditët e tjera.

Pasqyra si më poshtë tregon sasinë dhe llojet e ngjitjeve që kemi bërë neve:

Emrat	II	III	IV	V	VI	VII	Shuma
Minella	2	4	5	2	5	5	23
Vasili	2	4	5	--	6	6	23
Tefta	2	3	4	1	3	1	14
Shuma	6	11	14	3	14	12	60

Në fillim s'kishim besim në ngjitjet e sidomos në zbritjet në shkëmbinj të çarë. Por sa mësuam teknikën, ato na u bënë ngjitje më të sugurta. Për Teftën trajneri u paraqit shumë optimist. Ay u shpreh se ndërsa vajzat gjermane në ngjitjet shkëmbore me oxhaqe/tymtaja në kategorinë e IV të vështirësisë, qajnë dhe duan të kthehen mbrapsht, Tefta edhe në kategoritë më të larta lufton deri sa i del mbanë; është shumë e vendosur, si djalë. Në përdorimin e litarëve, të sigurimeve, etj, kemi shkuar shumë mirë.

3 Drejtimi i ngjitjeve nga neve. Në ditën e pestë neve bëmë 5 ngjitje, përgatitje për ngjitjet e kategorisë së VII, që janë ngjitjet më të vështira.

Për tashti ne e ndjejmë veten shumë të sigurtë në ngjitje kur udhëhiqeshim nga trajneri. Tashti filloi problem që neve vetë të drejtojmë ngjitje. Kjo detyrë u krye me shumë sukses sa që dhe vetë nuk e besonim.

Pasqyra si më poshtë flet se $\frac{1}{4}$ e ngjitjeve, sasinë dhe shkallën e vështirësisë së ngjitjeve të drejtura nga vetë neve:

Emrat	II	III	IV	V	VI	VII	Shuma
Minella	--	2	3	--	1	--	6
Vasili	2	--	3	--	1	--	6
Tefta	--	2	--	--	--	--	2
Shuma	2	4	6	--	2	--	14

Në fund të veprimtarisë filluam që të kishim besim drejtimin e ngjitjeve të kategorisë IV, V, VI. Për kategorinë VII nuk kishim besim, por ndonjë ngjitje të kategorisë së VII nga ato që kishim bërë, na e

hante syri se e bënim. Me gjithë atë na u krijua besimi i drejtimit për kategoritë V-VI, neve, kurse Teftës në kategorinë III-IV.

4 Tek ne ngjitjet i bëjmë pas një udhëtimi të gjatë (afrimi tek shkëmbi – ab) e të lodhshëm, kurse këtu lodhja është relativisht më e vogël. Por ka patur edhe ngjitje që duhej bërë 2-3 orë udhëtimin e pastaj të fillonim ngjitjen. Shkëmbijt këtu ishin 40-120 m të lartë, por kategoria e vështirësisë nuk varej nga lartësia, por kryekëput nga vështirësia e itenerarit. Kishte shkëmbinj të lartë që nga një drejtim ishte i kategorisë së VII, dhe kishte itënerarë që ngjiteshin edhe turistë. Ose kishte shkëmb 12-14 m të lartë dhe ishte i kategorisë super. Përcaktimi i vështirësisë përcaktohej, varej, nga nga pjesa më e vështirë e itenerarit. Mund që 2 apo 3 apo 4 metra të ishin të kategorisë së VII, kurse pjesa tjetër e kategorisë V. por kjo quhej ngjitje e kategorisë VII. (Koment: itenerari merr kategorinë e vështirësisë që ka fragmenti më i vështirë i tij-ab).

5 Nga sa thamë më sipër duhet pranuar që për grupin ngjitjet nuk kanë qënë të lehta, bile duhet pranuar, që ishin shumë të vështira. Çdo ditë që mbaronte me sukses ishte fitore e madhe për neve. Por nuk kishte ditë dhe ngjitje që neve të mos shijonim impresionim, pse s’kishte ngjitje të vështirë që mos të kishte ndonjë gërvishtje sa do të vogël ose rrëshqitje nga shkëmbi. Aksidenti më i rëndë që ndrydhe e këmbës së Tefta Zguros. Në kohën që unë drejtoja një ngjitje të kategorisë VI dhe ajo më siguronte mua, në një segment të vështirë më rrëshqiti këmba dhe rashë. Tefta më siguronte, por nga forca e tërheqjes ajo u përkul dhe ndrydhi këmbën, kurse unë shpëtova duke pasur disa gërvishtje në gishtërinj, që më pengonin mjaft në ngjitjet e ardhme dhe shëmbje të vrari në shpatull dhe në dorë. Shokët të gjithë u dobësuan gjatë kohës së ngjitjeve, secili humbi 2-4 kg.

Krahas punës si më sipër neve vizituam Bad Shandeun, Drezdenin, Leipzigin, qytetin Hajnshtajn etj. Në qytetin Hajnshtajn u bë takim turistësh dhe gara turistike. Në Leipzig vëmë në Institutin e Fiskulturës ku na pritën shumë mirë, si Rektori edhe zv/Rektori. Në Berlin nuk patëm as një takim me as një njeri nga sekretari i turizmit, ose dhe i Dojçaraizbiu që kishin marrë autorizim nga Albturizmi i këtushëm, që alpinistët të vijnë me linjën e tyre.

Më 20 qershor me shumë vështirësi morëm në telefon Komitetin, ku doli shoku Pandi, të cilit i folëm për problemet tona, por na bënë përshtypje tre shprehje jo shumë të matura: 1) kur neve i thamë punën tonë, ai u shpreh “more paskeni shkuar shumë lart” por kur neve i thamë plot gjëra për informacion që mund t’i jepeshin gazetës, ay u shpreh “more se ne s’na duhen këto”. Këtu (në Shqipëri – ab) morëm vesh se gazetës nuk i kishte dhënë as gjë pse në kohën që flisnim në telefon në zyrën e tij ishte një nga shokët e gazetës. Kur i folam për punën e çadrave që do sjellin gjermanët, ay u shpreh “ne, ti këto gjëra na thuaj...” D.mth. ato të tjerat që ishin më të rëndësishme për shëndetin e njerëzve dhe lëvizjen alpinistike tonën, ishin pa interes. Ky bisedim më vrau shumë shpirtërisht.

Për neve, me gjithë mungesat, me vështirësitë e hasura, luftuam jo vetëm për realizimin e programit më së miri, por lamë një përshtypje jo të keqe për nivelin e alpinizmit Shqiptar, megjithëse mjaft i ri.

Koment – ab-: Në kohën e monizmit sportet u konsideruan se u lindën dhe zhvilluan pas 29 Nëntorit 1944. Një konkretizim: Edhe sporti i futbollit që para kësaj date kishte zhvilluar gjashtë kampionate kombëtare, këto kampionate filluan të numurohen nga e para me ato që u organizuan pas kësaj date. Për sportin e alpinizmit, në opinion, si datë e fillimit të këtij sporti konsiderohej Korriku 1956. Kjo ishte data kur filloi shkolla e alpinizmit në Theth, e dyta në rradhë (ndonëse u konsiderua e para) dhe nuk u kosi drurua, dhe as u fol ndonjëherë, ajo që u organizua në Tiranë me mësues nga shkolla të ndryshme të vendit tonë, etj.).

Për të gjitha ça kishim me shokët gjermanë, kur u kthyem në Berlin i a thamë shokut Ambasador, i cili u revoltua. Edhe më keq akoma për pritjen që na bënë kur u kthyem në Berlin. Na shpunë shumë, shumë larg Berlinit, e fjetëm në një vend pa çarçafë e jastëk e shumë keq.

Ambasadori mbajti shënim dhe na autorizoj tua themi atyre, me të cilët do të kishim takim. Por takim nuk patëm. Kur erdhëm këtu i raportuam me gojë. Gjermanët kanë vendosur që vitin e ardhëshëm të ftojnë 4 shqiptarë.

Lidhur me problemin se në shtator do kishte kamp ndërkombëtar, ky nuk ishte i vërtetë. Kjo ishte e trilluar vetëm nga përgjegjësi i ekipit gjerman, të cilit, për të mos dështuar ekspedita e tij në Shqipëri, u bë pengesë që të mos shkonte delegacioni jonë në kohë; ay është bërë pengesë besoj unë edhe për punën e veshjes dhe të përkthenjës. Ky qëndrim u pa edhe kur ata ardhën këtu (për këtë do fles në relacionin e Thethit). Koment: nuk ka ndeshur, apo dgjuar asgjë për ekipin Gjerman 1960 në vendin tonë, veç një lajmi të thjeshtë në gazetë).

Perveç sa thamë më sipër konstatuam:

- 1) Zona ku ishim neve ishte më e bukura dhe qendra kryesore turistike dhe alpinistike. Kampi që ishim neve ishte më shumë si formë hoteli e mence. Aty vinin grupe të vegjëlish dhe të rriturish në formë të organizuar, merrnin çarçafë dhe rregulloheshin për të fjetur. Menca i furnizonte me ushqim që gatuate. Grupet rrinin 1-2 dhe 5-6 ditë. Këtu vinin edhe grupe të huajsh, turistke, nga Demokracitë. Për dëfrimin e tyre Drejtoria nuk kishte përgjegjësi; këtë e bënte çdo grup vetë. Në kamp kishte radio, ping-pong, shah dhe lojra të tjera tavoline.
- 2) Në zona të caktuara buzë Elbës (lumi Elba-ab) ka zona të caktuara që vendosen çadra e njerëzit instalohen për tu çlodhur; aty ai fut mskinën e tij. Të tilla pika kishte mjaft.
- 3) Kishte kampe të thjeshta me 2 dhoma, sallon, guzhinë, gardrobë, që drejtoheshin nga qendra të ndryshme pune. Aty vinin njerëzit e tyre (qëndës së punës) dhe kalonin ditët e pushimit. Krevatet ishin të bashkuara rrjesht.
- 4) Transporti ishte shumë i organizuar dhe në çdo stacion, po thuaj, kishte kafene, restorant e hotel. Kjo lehtësonte shumë turistët.
- 5) Zona turistike ishte e përshkruar në harta të detajuara. Në tabela që ishin vënë kudo në vend kryq, ishin me shenja konvencionale të gjitha spjegimet (ku ka ujë, shkëmb, kafene, rrugë, drejtimi, kamp, etj).
- 6) Në takimin e turistëve të 8 shteteve u bë stafeta veç për meshkuj e veç për femra. Mbas dite u bë ceremonia. Me këtë rast **kori i alpinistëve prej 80 vetësh** dha një program në çelje e mbyllje të ceremonisë. Fitonjësve ju shpërndanë dhurata e diploma.
- 7) Çarçafët në kamp ishin në formë këllëfi dhe anës me lidhësa që lidheshin në anët e krevatit; kjo formë ishte shumë ekonomike dhe natën mbulesat nuk lëviznin.

Vajtja e grupit tonë në Gjermani na vlejti shumë ne, jo vetëm që neve përfituam mjaft, por se njoftëm nga afër shkollën e alpinizmit të R.D. Gjermane, e cila ishte shumë e fortë.

Për efekt të klasifikimit tanë sportiv, atje ka 7 kategori (vëshirësie – ab) ngjitjesh -II-II-IV-V-VIa-VIb-VIIa-VIIb-VIIc dhe super. Grupi bëri të gjitha kategoritë e ngjitjeve, me përjashtim të kategorisë I, që ishin shumë të lehta, dhe kategorisë super, që ishin tej forcave tona për këtë rradhë. Lidhur me klasifikimin, unë mendoj që kategoria e VII gjermane të jetë baraz me kategoria të V tonë e kështu me rradhë. Njëkohësisht këto të jenë vetëm për ngjitje verore dhe mos të llogariten për ngjitjet dimërore.

Shokët gjermanë ftuan 4 vetë për vitin 1961, morën angazhim që t'i presin shumë më mirë se neve. Ata kanë shumë interes për malet tona, mbasi janë të virgjër dhe shumë interesante. Ata duan të


kenë si qendrim kryesor të ngjitjeve të tyre alpinistike. Kjo duhet të shfrytëzohet dhe lidhur me interesin tonë alpinistik duke përfutur si këtu, ashtu dhe duke shkuar në Gjermani. Ata janë të gatshëm
Tiranë, korrik 1960
Minella Kapo

Shënim: ky material shoqërohet edhe me pasqyrat e hollësishme të ngjitjeve të realizuara.

Në muajin korrik erdhi një ekip alpinistësh nga R D Gjermane. Në përbërje të tij kishte edhe alpinistë të ekipit të vitit 1959. Ata i realizuan ngjitjet pa kombinime me alpinistët tanë. Ngjitja më madhështore e tyre ishte ngjitja në faqen Veriore të majës së Brijasit.

Për këtë ngjitje u shkrua dhe një artikull nga mjeshtri i sportit Peter Popp. Ai përshkruan ngjitjen e malit të Brijasit 2.567 m/lmd, në Alpet Shqiptare, përmes faqes veriore, saktësishtë përmes vijës ngjitëse të pagëzuar nga ekipi gjerman me emrin “Valboneçand – Muri Valbonës” (shih skicën 1: është vija ngjitëse e mesme). Këtë ngjitje Peter Popp e ka realizuar në skuadër me alpinistin Rudolf Rudi Pimper, më 17 korrik 1960.


Nga këto tre itenerarë të shënuar në këtë skicë kjo dyshe realizoi itenerarin e qendrës. Itenerari më i vështirë ishte ai i kruut të djathtë i realizuar nga Fritz Eske dhe Herald Lobe.
Itenerari në skicën e majtë u reaalizua nga dyshja Nirsche dhe Sohler.



Fotot si më poshtë janë të ekipit gjerman 1960.




Tre anga anëtarët e ekipit gjerman



Fritz Eske climbing Mt. Briaset in 1960.

Kacavarësi gjerman që u vlerësua më shumë nga alpinistët tanë: Fritz Eske.





Am 1. Juli 1961 fuhr ich mit dem Auto nach...
 In der ersten...
 Am 1. Juli 1961 fuhr ich mit dem Auto nach...
 In der ersten...
 Am 1. Juli 1961 fuhr ich mit dem Auto nach...
 In der ersten...

Fotografie des Berges


Am 1. Juli 1961 fuhr ich mit dem Auto nach...
 In der ersten...
 Am 1. Juli 1961 fuhr ich mit dem Auto nach...
 In der ersten...



Fotografie des Berges

Fotografie des Berges

Fotografie des Berges



Fotografie des Berges

Fotografie des Berges

Fotografie des Berges

Këtë material e pruri për ne zoti Abdurahim Abdushi, alpinist i Shoqatës Bjeshkatore Sharri të Prizrenit. Ing në elektronikë në një kompani Gjermane në Mynih.

Në vijim të zbatimit të orjentimeve të K.Q.P.P.Sh. Këshilli i Ministrave morri vendimin Nr.349, dt. 11/08/1960 “Mbi zhvillimin e matejshëm të Kulturës Fizike dhe Sportit”. Në të vihej në dukje shtrirja e organizatave të B.F.S.Sh. në 1262 qendra pune, shkolla e fshatra; rritja 11 herë më shumë e kuadrove dhe 37 herë e fondeve për zhvillimin e kulturës fizike e sporteve në krahasim me periudhën e paraluftës, etj. Mbi bazën e sukseseve kërkohej arritja e rezultateve akoma më të larta sportive, kryerja e një pune më të kualifikuar, etj.

Këshilli i Ministrave, ndër të tjera, vendosi t’i kushtohej kujdes zhvillimit masiv të fizikulturës, zgjerimit të pjesëmarrjes në turizëm dhe i rekomandoi Këshillit Qëndror të B.P.Sh. që të zhvillojë turizmin e brendëshëm dhe alpinizmin si dhe vendosi që të ndërmerren aksione masive në drejtim të ekskursioneve. Këshilli i Ministrave porosiste në këtë vendim që të shfrytëzohen sa më mirë ditët e pushimit të punonjësve nëpërmjet organizimit të pushimeve aktive me ekskursione e marshime që edhe i shlodhin edhe i kalisin pjesëmarrësit.

Kështu, në vitet 60-të, në vijim të plotësimit të orientimeve të partisë e qeverisë, si në gjithë sportet, edhe në sportet e turizmit dhe alpinizmit pati një shtrirje të gjërë lëvizja masive e turizmit dhe ngjitjeve malore. Malet, kodrat, vendet e betejave për liri e çlirim nga pushtesit nazi-fashistë u bënë shëtitorët nëpër të cilat me këngë në gojë drejtohej rinia e fshatit dhe qytetit.

Nga data 15 Nëntor deri në datën 15 dhjetor organizohet në Alpe një veprimtari gjatë të cilës u arrit të ngjiten 11 maja. Pjesëmarrës: Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Petraq Kule, Mustafa Selenica.



*Petraq Kule (m), Mustafa Selenica, Kozma Grillo
Fotografoi Vasil Stambuli*

1961

Ngjitja në majën e Jezerës u përsërit më 11 janar 1961. Ngjitja u drejtua nga Andon Tapia. Në këtë grup mori pjesë dhe alpinisti nga Shkodra Vehbi Seiti.

Gjithashtu u ringjit maja e Popllugës (8 Marsi) e udhëhequr nga Petraq Kule dhe me anëtarë Taxhedin Shehu, Themistokli Garuli, Gjyljana Bakrina (studente e fakultetit të mjeksisë), Eleni Isak (pedagoge e fiskulturës në Katedrën e Fiskulturës në Universitetin e Tiranës).

Në mbyllje të kësaj veprimtarie Mefo Myftiu, Kryetare e Organizatës së Grave Shqiptare, priti një grup nga alpinistët më të njohur të vendit tonë në atë kohë bashkë me pjesëmarrësit e kësaj ngjitje.




1960 takimi me alpinistë. Rreshti poshtë: Pranvera Verzivolli, Tefta Zguro, Mefo Myftiu, presidente e organizatës së grave shqiptare, etj.

1962



*Pedagogë universitarë në godinën e re në malin e Dajtit
Shkolla e alpinizmit 1962*

Pranë fshatit Bozdovec ndodhet një shkëmb i veçantë që njihet me emrin Guri i Capit. Historia dhe gojëdhanat e njihnin këtë shkëmb natyror si të pangjiteshëm. Por ja që në 7 gusht të viti 1962 në luginën e Devollit, në Korçë dhe në Shqipëri u përhap lajmi se tre alpinistë vunë këmbët MBI Gurin e Capit. Këta ishin Vasil Stambuli, Tefta Zguro dhe Kozma Grillo. Nga larg, me dy flamurë, ndihmonte të orjentoreshin për itinerarin e ngjitjes Minella Kapo. Ai edhe e fotografoi treshen mbi Gurin tashmë jo më të pangjiteshëm. Në këtë kohë ne nuk kishim ekupe alpinistësh nëpër rrethe. Treshja në fjalë përfaqësonte Klubin Sportiv Studenti i cili klub ishte strumbullari i zhvillimit të alpinizmit në vendin tonë pas vitit 1956 e deri rreth vitit 1966.



*Në Gurin e Capit më 7 gusht 1962
Fotografoi Minella Kapo*

1963



*Kjo foto, e muajit shkurt të vitit 1963, ilustron masën e pasionit për tu ngjitur në male. Në foto janë:
Stefan Grillo, Genc Kurti, Aleksandër Bojaxhi, Qazim Liço. Fotografoi Xhovani Kajana.*

Për ngjitjen e majës së Tomorit grupi u nis nga qyteti i Gramshit për në Dardhë. Rreshjet e shumta kishin bërë që gjatë itinerarit të kishte shumë përrën, rrëqe e pellgje. Këpucët nuk kishin cilësi për të përballuar këtë lloj itinerari dhe u desht që të udhëtohej zbathur e me këpucë të mara në dorë.

Zgjerimi i shpejtë i lëvizjes turistike dhe alpinistike solli si pasojë trajtimin e veçantë të këtyre sporteve nga partia në pushtet. Kështu Sekretariati i K.Q.P.P.Sh. morri vendimin nr. 55, dt 16/03/1963” Mbi organizimin më të mirë të turizmit dhe alpinizmit të brendëshëm” për t’i dhënë një hov më të madh lëvizjes turistike e alpinistike në vendin tonë.

Për rrjedhojë, po në vitin 1963, qeveria doli me “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 265, dt 06/07/1963 mbi ngritjen e shoqatës së turizmit dhe alpinizmit shqiptar (SHTASH)”, ku ndër të tjera u vendos:

1. Të bëhen përpjekje për zhvillimin masiv të turizmit e alpinizmit në vendin tonë që të bëhet nevojë për masat e veçanërisht për rininë. Të përdoren si mjet nxitje titujt: “Turist i R.P.Sh.”, “Dëshmi 100 km partizane”, “Miku i Natyrës”, si dhe forma të tjera nxitjeje.
2. Të përdoren të gjitha format e turizmit si: shëtitje në këmbë një e shumë ditore, me biçikletë, varka, etj., duke i dhënë rëndësi shëtitjeve në këmbë në kushtet e vështira të relievit, duke pasë parasysh përgatitjen fizike të pjesëmarrësve.
3. Të shfrytëzohen bazat materiale egzistuese. Drejtoria e Ekonomisë Komunale të caktojë zonat turistike që të përdoren nga shoqata, qendra pune, shkolla, etj., për përgatitjen e përkohëshme të kampeve turistike me çadra.
4. Të vendoset një bashkëpunim i ngushtë midis organizatave të masave, shoqatës së turizmit dhe alpinizmit e organeve të interesuara shtetërore.

Për këtë:

- a. Ministria e Industrisë dhe Bashkimi Qëndror i Kooperativave të Artizanatit të prodhojnë e të tregtojnë artikuj turistikë si: çanta, çadra, këpucë, pajisje, etj.
- b. Të ketë zbritje çmimesh për turistët e inkuadruar në transport 30%, ushqim 10%, fjetje 20%.
5. Ministria e Arsimit të sigurojë pajisje turistike për grupet turistike të institucioneve të larta arësimore dhe pallatet e pionerëve; Ministria e Industrisë për qendrat e mëdha industriale, si p.sh. Kombinatin e Tekstileve “Stalin”, Kombinatin e Drurit Elbasan, etj., Komitetet Ekzekutive të Rretheve për shtëpitë e pionerëve.
6. Shoqata të tërheqë rininë në këto sporte me axhitacion e propagandë.
7. Për centralizimin dhe drejtimin e lëvizjes turistike dhe alpinistike në vendin tonë, për të çuar atë me hapa më të shpejtë përpara, të ngrihet në gjirin e organizatës së B.F.S.Sh. Shoqata e Alpinizmit dhe Turizmit në rangun e Federatave sportive të sotme. Shoqata e Alpinizmit dhe Turizmit Shqiptar të ketë statutin e saj të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.
8. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave, etj.

Shkolla dimërore



Në kthim nga maja e malit



Ngritja e kampit nën majën e Radohimës



Një kujtim në majën e ngjitur

Shkolla verore



Ky harc (shkëmb apo gur i madh) ka shërbyer si një poligon i thjeshtë, por i pasur, për të mësuar elementë të teknikës së alpinizmit si: ngjitje sportive (nëpërmjet litarit) zbritje/lëshime me metodën Dylfer, kacavarje nëpër plasa, kacavarje me tre pika mbajtje, etj.



Andon Tapia, Genc Kurti, Mustafa Selenica, Taxhedin Shehu Tefta Zguro, ?? . Fotografoi Qazim Liço

Këta alpinistë organizuan të parën veprimtari të veçantë alpinistike e cila nga viti 1965 e më tej do të emërohej “Ngjitjet e Kualifikuara Verore”.

1964

Kalendari kombëtar parashikonte:

- Në muajin janar shkollë dimërore të alpinizmit (zbor).
- Për nder të 11 janarit, Dita e Republikës, ngjitje në majën e Jezercës.
- Nga 1 në 8 mars ngjitje në majën “8 Marsi” (Popllukë).
- Nga 16 në 30 korrik ngjitje në zonën Theth-Valbonë. (Kjo ndryshoi dhe më poshtë keni spjegimin për ekspeditën alpinistike).
- Më 28 dhe 29 nëntor ngjitje në 5 majat më të larta për nder të 20 vjetorit të çlirimit të Atdheut.

Më 9 maj 1964 u mbledh Konferenca e Parë Kombëtare [*në fakt për konferencë të parë duhet të njohim atë të muajit shkurt 1936 të organizuar në Korçë*] për zhvillimin masiv të turizmit dhe alpinizmit. Raportin në këtë konferencë e mbajti Vasil Konomi, Kryetar i Komitetit të Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH-së (Ky ishte i vetmi funksionar që kishte dy fëmijë, Gaqon dhe Luljetën, pjesëmarrës në veprimtari alpinistike të kohës). Kjo konferencë mori një sërë vendimesh të rëndësishme dhe aprovoi Statutin e Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar. U zgjodh këshilli i shoqatës dhe kryesia e saj.

Kryetar i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar u zgjodh Kiço Ngjela, nënkryetarë Jorgjia Peçini, Pasko Milo dhe Qemal Bylyku, sekretar Muharrem Sinoimeri dhe anëtarë: Engjël Kolaneci, Minella Kapo, Dhorë Hanxhari, Osman Palushi, Nadide Dinazi, Merdali Tafili, Kozma Grillo, Luigi Shala, Petrit Kamba dhe Thanasi Nika. SHTASH filloi nga puna në muajin qershor të vitit 1964.

Shoqata ndikoi pozitivisht në lindjen e ekipeve të alpinizmit pranë klubeve sportive të qyteteve e rrethëve të vendit tonë. Shkollat e alpinizmit, si ato të sezonit veror edhe ato të sezonit dimëror, tashmë nuk ishin më “pronë” vetëm e Klubit Sportiv Studenti me poligon malin e Dajtit dhe zemrën e Alpeve, Thethin. Ato u shtrinë edhe në Razëm e Voskopojë me pjesëmarrës nga gjithë klubet sportive egzistuese duke krijuar nëpërmjet këtyre shkollave edhe ekipet e alpinizmit. Kështu që rrethet e ndryshme filluan të përfaqësohen në veprimtaritë alpinistike jo më me individë, por me ekipe.

Në fillim të muajit korrik ju bë thirrje të gjithë alpinistëve, si atyre më me përvojë dhe atyre që mendoheshin se janë me perspektivë, për të marrë pjesë në një ekspeditë alpinistike në veri të vendit tonë. Synimi i kësaj ekspedite ishte që të jepej një vlerësim për zonat më alpine të Alpeve tona.

Ekspedita do vazhdonte 17 ditë dhe mundësi për tu shkëputur nga puna patën vetëm 12 alpinistë. Mbetën pa marrë pjesë alpinistë si Kozma Grillo, Petraq Kule, Tefta Zguro, Vasil Stambuli, etj të cilët do të mundësonin një përbërje edhe më cilësore të grupit.

Si strategji pune u vendos ndarja në katër nën grupe me nga tre alpinistë (ngjitjet u realizuan duke u lidhur në një litar 40 ml tre alpinistë) me drejtues Minella Kapo, Vangjel Melëngu, Andon Tapia, e Vasil Vreto. Alpinistët u vendosën fillimisht në Vermosh dhe aty u ndanë në katër zona: Seferçe, Bashkimaj, Qendër, pjesa perëndimore e luginës (Velipoja). Në ditën e fundit të qëndrimit në Vermosh u realizua një ngjitje simbolike në Kujin e Vermoshit me pjesëmarrje edhe të disa të rinjëve e të rejave të fshatit si dhe kufitarë.

Në fazën e dytë grupet u vendosën në zonat: Sheu i Bardhë (me kampim në rrëzë të malit Sqeta e Cjapit), Qafa e Droçës me kampin aty, Zona e Vuklit dhe zona e Tamarës. Data 13 gusht ishte dita e fundit e ngjitjeve dhe të nesërmen të gjithë grupet u mbledhën në Theth ku u bë analiza e veprimtarisë.

Konkluzionet:

- Vermoshi është vend shumë i bukur turistik.
- Zona e Sheut të Bardhë u vlerësua si zonë me vlera alpinistike (në gjuhën e alpinistëve kjo zonë u quajt përgjithmonë “Tek Posta Kufitare Verore”).
- Zonë tjetër me vlera alpinistike u konsiderua ajo e Qafë Droçes (koha tregoi se ishte më mirë të ngrihej kampi në Klllogje).
- Dy zonat e tjera nuk u vlerësuan si zona me interes alpinistik.

Në përfundim, mesatarisht, volumi i punës ishte:

- Alpinistët udhëtuan 9 ditë (Fusha e Zezë – Vermosh – Qafë Mrizë – Jamë – Gropat e Koprishtës - Qafa Langojve – Posta Verore - Qafë Pejë – Theth).
- Ngjitje shkëmbore 6 ditë.
- Pushim – 4 ditë.
- Udhëtim 50 orë, nga të cilat 14 orë të ndihmuar për ngarkesën me kafshë bare (n’atë kohë nuk kishte dyqane apo restorante në të gjithë veriun, dhe ushqimi ishte në çanta apo ranca).
- Udhëtimi rreth 200 km (pa marrë parasysh afrimin tek shkëmbi apo rrëza e malit).
- U realizuan 38 ngjitje, ndër të cilat 6 ishin të kategorisë më të lartë.



Vasil Vreto, Aleksandër Bojaxhi, Genc Kurti. Treshja e alpinistëve që realizoi ngjitje në zonën e majës së Langojve. Gusht 1964

Shënime në një fletë blloku shënimesh:

Në vitin 1964 me kategori sportive kemi:

5 Mjeshtra Sporti (Luigj Shala, Minella Kapo, Kozma Grillo, Petraq Kule, Vasil Stambuli), 8 me kategori të parë, 10 me kategori të dytë sportive.

1965

Në bazë të Kalendarit Sportiv Kombëtar dhe në kuadrin e festës së 20 vjetorit të shpalljes së Republikës më 10 janar një grup alpinistësh prej 31 vetë “sulmoi” dhe u ngjit në majën e Korabit (2.751 m).

Alpinistët përfaqësonin rrethet Tropojë, Peshkopi, Shkodër, Tiranë (qytet dhe rreth), Elbasan, Berat, Vlorë dhe klubet sportive “Universiteti” dhe “Partizani”. Veprimtaria u filmua nga Mit’hat Fagu regjisor në “Kinostudio Shqipëria e Re” dhe njëherësh alpinist.

1966

Në vitin 1965 kuadri **trajner** përbëhej nga: 3 alpinista (trajnerë) me kategorinë e parë, 13 me kategori të dytë, 24 me kategori të tretë.

Tashmë kanë kaluar 2 vjet nga krijimi i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar (SHTASH) dhe 10 vjet nga organizimi i shkollës së parë dyjavore të alpinizmit në Theth. Për të matur arritjet po sjell tre të dhëna:

1. Kalendar Sportiv Kombëtar për vitin 1966 për sportin e Alpinizmit.
 - a) Janar: ngjitje kombëtare në Korab. Pjesëmarrja: Klubi Sportiv Universiteti, Partizani, rrethet Tiranë, Shkodër, Kukës, Peshkopi, Tropojë, Telbasan, Berat, Vlorë, qyteti i Tiranës me nga 3 veta çdo grup.
 - b) 10 mars. Ngjitje në majën e Hekurave (maja e Paqes). Pjesëmarrja: Klubi Sportiv Universiteti, Partizani, rrethet Tiranë, Shkodër, Kukës, Peshkopi, Tropojë, Telbasan, Berat, Vlorë, qyteti i Tiranës me nga 3-6 veta çdo grup.
 - c) 16-30 korrik. Zbori turistik-alpinistik në Theth i Këshillit Qëndror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë dhe Komitetit Shtetëror të Kulturës Fizike dhe Sporteve. Pjesëmarrja dhe organizimi: sipas udhëzimeve të lëshuara nga Këshilli Qëndror i B.P.Sh dhe Komiteti Shtetëror i Kulturës Fizike dhe Sporteve.
 - d) 1 deri 15 gusht. Ngjitje alpinistike kombëtare në zonën e Valbonës. Pjesëmarrja: Universiteti, Partizani, qyteti Tiranë, Vlora, Shkodra, Peshkopia, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Berati me nga 3-6 vetë çdo grup.
 - e) Më 20 gusht. Ngjitje kombëtare në gurin e Capit në Korçë. Pjesëmarrja: nga një grup alpinistësh të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe “Skënderbeut”
 - f) Datat 6 e 7 nëntor: ngjitje kombëtare në 5 maja malesh; Pjesëmarrja: Universiteti, Partizani, Dinamo, qyteti i Tiranës, Vlora, Fieri, Elbasani, Berati, Korça, Elbasani, Gjirokastra, Shkodra, Kukësi, Peshkopia, Tropoja me nga 3-6 veta çdo grup.
2. Fragment nga një reportazh në gazetën Sporti Popullor për nder të 10 vjetorit të shkollës së parë të alpinizmit.

“Një mbrëmje korriku, 45 alpinistë të rretheve dhe klubeve sportive të vendit tonë, futbollistët e “Vllaznisë” së Shkodrës, si dhe miq të tjerë kishin zënë vend në sallë. Midis tyre ishin edhe ministri i Shëndetësisë Ciril Pistoli, Kryetari i Komitetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve të RPSH,

Rexhep Doda, poeti Llazar Siliqi, sekretari i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Muharrem Sinoimeri, Shefi i Seksionit të Arësimit dhe Kulturës për rrethin e Shkodrës Palokë Kraja, kompozitori Albert Paparisto, etj”.

Pra, lëvizja alpinistike kishte arritur ta konsideronin në veprimtaritë e saj përkujtimore institucione e personalitete të kohës.

3. Për kontribut në përhapjen dhe zhvillimin e alpinizmit dhe turizmit Presidiumi i Kuvendit Popullor të R. P. Sh. bëri një sërë dekorimesh, të cilat **u dhanë** në mars 1967 si më poshtë:

1. Universiteti Shtetëror i Tiranës u dekorua me Urdhër Pune të Klasit II-të”.
2. Shoqata Lokale e Turizmit dhe Alpinizmit Berat u dekorua me “Urdhër Pune të Klasit II-të”.
3. Alpinistët Luigj Shala (pas vdekjes) dhe Minella Kapo u dekoruan me “Urdhër Pune të Klasit II-të”.
4. Alpinistët Petraq Kule, Vasil Stambuli, Kozma Grillo, Vangjel Mëlëngu u dekoruan me “Urdhër Pune të Klasit III-të”.
5. Klubi Turistik i Pallatit të Pionerëve Tiranë u dekorua me “Urdhër Pune të Klasit III-të”.
6. Alpinistët: Grigor Perikliu, Agim Kajanaku, Vangjel Ristani, Roza Gjergji, Astrit Omeri u dekoruan me “Medaljen e Punës”.

1967

Kalendari sportiv kombëtar për sportin e alpinizmit:

- Nga 1 deri 14 shkurt kursi dimëror i alpinizmit në Razëm
- Më 8 mars: ngjitje në majat Popllukë dhe Jezercë
- Më 1 Maj: ngjitje në majat Nëmërçkë, Shkëlzen, Guri i Capit me pjesëmarrje nga klubet dhe rrethet me 3 deri 6 alpinistë.
- Nga 16 në 30 korrik kursi kambëtar me kuadro fillestarë në Theth,
- Nga 1 në 15 gusht ngjitje të kualifikuara shkëmbore në Alpe.
- Më 28 nëntor ngjitje kombëtare në tre maja malesh: Çikë, Tomoricë, Shebenik.

Krijimi i SHTASH-it ndikoi pozitivisht për përhapje të planifikuar dhe drejtuar të lëvizjes alpino turistike. Në një reportazh të shkruar nga komentatori i njohur sportiv Ismet Bellova në gazetën Sporti Popullor lexojmë: “Lart nga 50 vetë, midis të cilëve punëtorë, arsimtarë, inxhinjerë, nxënës, mjekë e studentë nga shumë rrethe të vendit tonë, kryen për 15 ditë me rradhë kurs kombëtar (në Theth), duke marë njohuri fillestare teorike e praktike për turizmin dhe alpinizmin, duke kryer ngjitje të thjeshta alpinistike dhe duke zhvilluar mësimë rreth këtyre sporteve të dobishëm e të bukur”.

Komisioni Teknik i Sh.A.T.Sh-it u ngrit në vitin 1967.

Klasifikimi unik sportiv

1968 ALPINIZEM

1. Mjeshtër sporti: Të bën ngjitje sipas pasqyrës; të ketë fituar kategorinë e parë sportive; të drejtojnë dy ngjitje të shkallës së parë të vështirësisë, të jetë instruktor alpinizmi i kategorisë së dytë dhe të ketë punuar në kurs për përgatitjen e alpinistëve nga të cilët 1 në rreth, 20 bëjnë rreth 4 km. marshim në dëborë, ski të ditë të notojë, të përshkruajnë duke e pasqyruar në hartë një ngjitje të shkallës së parë të vështirësisë, të drejtojnë të paktën 2 ngjitje të kualifikuara, nga të cilat njera dimërore.

2. Kategorja e parë: Të bën ngjitje sipas pasqyrës; të ketë fituar kategorinë e tretë sportive; të drejtojnë një ngjitje të shkallës së parë të vështirësisë, të ketë punuar për përgatitjen e alpinistëve të rinj në një kurs kombëtar, të bëjnë një ngjitje të shkallës së dytë në një rrugë të re, të përshkruajnë duke e pasqyruar në hartë një ngjitje të shkallës së parë të vështirësisë, të ketë punuar në dy ngjitje të kualifikuara nga të cilat një në dimër, të ketë ngjitur «Gurin e Capit» ose një nga të së njëjtës vështirësi, duke qenë në krye të litarit.

3. Kategorja e dytë: Të bëjnë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar kategorinë e tretë sportive, të drejtojnë një grup fillestarësh në një shkallë të parë të vështirësisë, të përshkruajnë duke e pasqyruar në hartë një ngjitje të shkallës së parë të vështirësisë, të ketë punuar në dy ngjitje të kualifikuara nga të cilat një në dimër, të ketë ngjitur «Gurin e Capit» ose një nga të së njëjtës vështirësi, duke qenë në krye të litarit.

4. Kategorja e tretë: Të bëjnë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar distinktivin e alpinistit të RPSH. Ky titull jepet vetëm mbasi të ketë kaluar në kurs kombëtarë e lokale që njihen nga shpalla. Të ketë bërë pjesë rregullisht në stërvitjet e gruve alpinistike të klubit sportiv që përfaqëson.

Shënimi: Për mjeshtër dhe tri kategoritë sportive:

1. Për plotësimin e kërkesave nuk ka afat të caktuar, mjafton që të mos ketë ndërprerje të aktivitetit në mënyrë të drejtë.

2. Në një ngjitje plotësimi i dy kërkesave nuk njihet.

3. Drejtimi qubet i vlefshëm konvencionalisht i organizuar dhe që njihet nga shoqata.

4. Të paktën 20 grupet alpinistike duhet të kenë jo më pak se 3 litare.

5. Grupet e tjera që ngjiten në mënyrë masive, nuk duhet të kenë më shumë se 20 vetë.

Kategoria	Shkalla e vështirësisë						Gjithsej	
	1A - 1B Varë-Dimër	2A - 2B V. D.	3A - 3B V. D.	4A - 4B V. D.	5A - 5B V. D.	6A - 6B V. D.		
Mj. Sporti	—	—	—	—	5 3	3 2	1 1	15 maja
E parë	—	—	—	2 2	3 2	2 1	—	12 maja
E dytë	—	—	3 2	3 2	1 1	—	—	12 maja
E tretë	—	2	1 2	1	—	—	—	8 maja
Alp. i RPSH	2	1	1	—	—	—	—	8 maja

Fragment nga Gazeta Sporti Popullor, 30 janar 1968

Kalendari Sportiv për sportin e alpinizmit

- Më 10 janar. Ngjitje në majën e Madhe, Shnik, kushtuar 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut.
- Më 1 deri 14 shkurt kursi kombëtar I kualifikimit dimëror në Razëm
- Nga 4 deri më 8 mars ngjitje të kualifikuara dimërore në Alpe
- Në qershor ngjitje kombëtare në Gurin e VCjapit kushtuar 25 vjetorit të themelimit të Ushtrisë Popullore.
- Nga 16 në 30 korrik kursi I përgatitjes së kuadrove në Theth,
- Nga 1 në 14 gusht ngjitje kombëtare të kualifikuara në Majën e Hekurave, Korabit dhe Papingut.

ALPINIZEM

1. - 9 janar: Ngjitje kombëtare dimërore, me rastin e 11 janarit.

2. - 1-14 shkurt: Kurs kombëtar i përgatitjes së kuadrit alpinistik në Razëm.

3. - 8-15 mars: Ngjitje kombëtare të kualifikuara dimërore.

4. - 16-30 qershor: Kurs kombëtar i përgatitjes së kuadrove të alpinizmit nga IKF «Vojo Kushi» në Theth.

5. - 23-29 qershor: Ngjitje kombëtare shkëmbore.

6. - 1-14 korrik: Kursi veror i përgatitjes së kuadrove të Universitetit në Theth.

7. - 16-30 korrik: Kursi kombëtar veror i përgatitjes së kuadrove të alpinizmit në Theth.

8. - 1-14 gusht: Ngjitje kombëtare të kualifikuara.

9. - 7-14 nëndor: Ekspedita kombëtare alpinistike kushtuar 25-vjetorit të çlirimit.

ATLETIKE

1. Gara kontrolli zyrtare në çdo muaj, përveç gushtit.

2. Gara masive me korespondencë

ti kombëtar i kategorisë së parë për moshat deri në 12 vjeç dhe 13-14 vjeç, në Durrës,

Kalendari Kombëtar Alpinizëm 1969 i shpallur në gazetën Sporti Popullor

Ja një shkrim në gazetën Sporti Popullor, për kujdesin e organizuar për përhapjen sportive malore lexojmë: “Është viti i 13-të që Thethi dhe qendra turistike e tij do të presë alpinistët e rinj, kuadro të ardhshëm për kolektivat punonjëse dhe rrethet. Sivjet këtu zhvillohet kursi i 13-të veror me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Partizanit, Dinamos, Dajtit, Studentit, Apollonisë, Flamurtarit, Tomorit, Luftëtarit, Skënderbeut, Yllit të Kuq (Pogradec), Labinoti, Korabi, Përparimi, Valbona dhe Vllaznia”.

Rreth 70 pjesëmarrës do të marrin njohuri fillestare për udhëtime dhe ngjitje teknike malore, do të aftësohen si kuadro për drejtimin e grupeve alpinistike e turistike në kolektiva dhe rrethe.”

SHAH

1. 13-27 mars: Turneu i më të mirëve, në Tiranë.

2. 26 qershor - 9 korrik: Kampionati kombëtar i të rinjve, në Berat.

3. 17-31 korrik: Gjysmë-finalet e kampionatit kombëtar, në Durrës.

4. 1-20 nëndor: Finalet e

kampionatit kombëtar, në Tiranë.

Pjesëmarrja: 15 shahistët e kualifikuar në gjysmëfinalet, kampioni i vitit 1968 dhe 2 të tjerë, që do të caktohen nga komisioni.

Programi: Sistem rrethi me një takim.

TURIZEM

1. 7-9 shkurt: Garat kombëtare të skive, në Vosko pojë.

Pjesëmarrja: «Studenti», IKF «Vojo Kushi», «17 Nëntori», «Korabi», «Përparimi», «Partizani», «Skënderbeu», me 5 veta çdo ekip.

2. 28 shkurt - 2 mars: kampionati kombëtar i ski-

ve, në Shishtavec.

Pjesëmarrja: Si në garat kombëtare.

3. 24-30 qershor: Takimet kombëtare zonale të pionierëve turistë, në Shirokë, Belsh dhe Llogora.

4. 3-10 gusht: Takimi kombëtar i pionierëve turistë në Lurë.

VOLEJBOLL

1. 2 mars - 27 prill: Kampionati kombëtar i meshkujve për sezonin 1968 - 1969 (faza e dytë).

2. 16 mars - 27 prill: Kampionati kombëtar i femrave për sezonin 1968-1969 (faza e dytë).

3. 16 mars - 27 prill: Ka-

8. 26-29 qershor: Kampionati kombëtar i të rejave, në Vlorë.

9. 16-20 korrik: Kupa e Republikës për femra, në Korçë.

Pjesëmarrja: Skuadrat që zënë gjashtë vendet e para në kampionatin kombëtar

Kalendari Kombëtar Turizëm 1969 i shpallur në gazetën Sporti Popullor

Një burim i vlefshëm për të mësuar rreth nivelit organizativ të Sh. T. A. Sh. është ai me numur shtatë. Këto janë informacione të mbledhura në fund të dhjetëvjeçarit 1960. Sipas tij:

Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit
Material Teknik-Organizativ
Buletin Nr. 7 Mars 1970

Kërkesat dhe Normat e klasifikimit unik sportiv (për sportin e alpinizmit)

Kategoria portive	Shkalla e vështirësisë												Gjithsej
	I		II		III		IV		V		VI		
	D	V	D	V	D	V	D	V	D	V	D	V	
Mjeshtër sporti							5	3	3	2	1	1	15 maja malesh
Kateg I-rë					2	2	3	2	2	1			12 maja malesh
Kateg II-të			3	2	3	2	1	1					12 maja malesh
Kateg III-të		2	1	2	1	2							8 maja malesh
Alpinist R.P.Sh	2	1	1	1	1								6 maja malesh

Shënim – ab: një majë e realizuar në një itenerar të kategorisë më të lartë të vështirësisë pranohej për të plotësuar numurin e ngjitjeve në kategori vështirësie më të ulët.

Kërkesa plotësuese:

1. Mjeshtër Sporti: të bëjë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar kategorinë e parë sportive, të drejtojë dy ngjitje të shkallës së katërt të vështirësisë, të jetë insrtuktor i alpinizmit i kategorisë së dytë dhe të ketë punuar në tre kurse për përgatitjen e alpinistëve, nga të cilat një në rrethin e tij, të bëjë rreth 5 km marshim në borë me ski, të dijë të notojë, të përshkruaj duke e pasqyruar në hartë një ngjitje të shkallës së dytë të vështirësisë, të drejtojë toga alpinistash në 2 ngjitje të kualifikuara nga të cilat një në dimër.
2. Kategoria e parë: të bëjë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar kategorinë e dytë sportive, të drejtojë një ngjitje të shkallës së tretë të vështirësisë, të ketë punuar për përgatitjen e alpinistëve të rinj në një kus kombëtar, të bëjë një ngjitje të shkallës së dytë në një rrugë të re duke e pasqyruar në hartë, të ketë marrë pjesë në dy veprimtari të ngjitjeve të kualifikuara, njëra në dimër, të ketë ngjitur “Gurin e Capit” ose një tjetër itenerar me të njëjtën vështirësi duke qenë në krye të litarit.
3. Kategoria e dytë: Të bëjë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar kategorinë e tretë sportive, të drejtojë një grup fillestarësh në një itenerar të shkallës së parë të vështirësisë, të përshkruaj ose

skicojë një ngjitje të shkaallës së parë të vështirësisë, të ketë marrë pjesë në një ngjitje të kualifikuar.

4. Kategoria e tretë: të bëjë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar titullin Alpinist i R.P.Sh. Ky titull jepet pasi të ketë kaluar në kurse kombëtare ose lokale që i njihet nga Shoqata. Të ketë bërë pjesë rregullisht në stërvitjet e grupit alpinistik të klubit sportive që përfaqëson.

Shënim: për mjeshttrat e sportit dhe tre kategoritë sportive:

- a. Për plotësimin e kërkesave nuk ka afat kohor, mjafton që të mos ketë ndërprerje të aktivitetit në më shumë se dy vjet.
- b. Në një ngjitje plotësimi i dy kërkesave nuk pranohet/njihet.
- c. Drejtimi quhet i vlefshëm kur grupi është i organizuar dhe njihet nga Shoqata.
- d. Togat ose grupet alpinistike duhet të jenë jo më pak se tre litarë (nëntë veta).
- e. Grupet e tjera që ngjiten në maja malesh nuk duhet të kenë më shumë se 20 veta.

Shënim (ab): ngjitje të kualifikuar konsideroheshin ato veprimtari që emërtoheshin të tilla. Si rregull ishin veprimtari me alpinistët më cilësor të çdo ekipi.

Ky buletin na njih edhe me formularin (kartelën) që do ketë sejcili alpinist.

Kartelë Personale e Alpinistit

Emri mbiemri

Datëlindja e vendlindja

Klubi

Profesioni

Nr	Vendi i zhvillimit	Data e Zhvillimit	Detyra gjatë Ngjitjes	Maja që Ngjiti	Drejtimi	Sa orë	Sa litarë	Sa gozhdë	Kategoria Vështirësisë

LISTA E SPORTISTËVE TË KATEGORIZUAR NË ALPINIZËM PËR VITET 1968-1969

1. Minella Kapo	Mjeshtër Sporti	Tiranë
2. Vasil Stambuli	“	Partizani
3. Petraq Kule	“	Tomori
4. Kozma Grillo	“	Studenti
5. Grigor Perikliu	“	Labinoti
6. Vangjel Melengu	“	Tomori
7. Andon Tapia	“	Studenti
8. Vangjel Ristani	“	Flamurtari
9. Aleksandër Bojaxhi	“	Apollonia
10. Agim Kajanaku	“	Labinoti
11. Myftar Marku	Kategoria e I-rë	17 Nëntori

12. Vasil Vreto	“	Studenti
13. Agim Tabaku	“	Studenti
14. Tefta Zguro	“	Skëndërbeu
15. Koço Qafëzezi	“	“
16. Koço Ziso	“	“
17. Taxhedin Shehu	“	Korabi
18. Mihal Bozdo	“	17 Nëntori
19. Astrit Omeri	“	“
20. Genc Kurti	“	Perparimi
21. Vilson Braja	“	Luftëtari
22. Llazar Zhori	“	“
23. Niko Stamo	“	17 Nëntori
24. Maridon Hito	“	Dajti
25. Azem Hyka	“	Partizani
26. Qazim Liço	“	“
27. Stefan Grillo	“	“
28. Toli Biçiku	“	Tomori
29. Manol Bozaxhi	Kategoria II-të	“
30. Kristaq Korçari	“	17 Nëntori
31. Fejzi Liço	“	Dajti
32. Petrika Tallabashi	“	Skëndërbeu
33. Llazo Teneqexhi	“	“
34. Xhelil Bakiri	“	Gramsh
35. Koço Qirici	“	Labinoti
36. Hiqmet Kuka	“	Flamurtari
37. Konstandin Kola	“	“
38. Shkumbin Ramadani	“	“
39. Jani Agaraj	“	“
40. Bashkim Çela	“	“
41. Agim Haxhia	“	Vllaznia
42. Angjelin Kola	“	“
43. Gani Kurti	“	“
44. Zenulla Strazimiri	“	17 Nëntori
45. Ferhat Sela	“	Korabi
46. Themistokli Garuli	“	Tomori
47. Viktor Melengu	“	“
48. Mustafa Xhake (Selenica)	“	Rrëshen
49. Roza Gjergji	“	Labinoti
50. Flamur Milova	“	Studenti
51. Janaq Ziso	“	“
52. Mira Hyseni	“	“
53. Vullnet Zylyftari	“	“
54. Piro Liko	“	“
55. Fatos Harito	“	“

56. Leonidha Druga	“	“
57. Vangjel Polo	“	“
58. Përparim Vula	“	Ersekë
59. Ismail Hoxha	“	17 Nëntori
60. Agron Lame	“	Skëndërbeu
61. Feim Xhebraj	“	Partizani
62. Sabit Hoxha	“	Korabi
63. Ali Ago	“	Dinamo
64. Viliam Kosturi	“	“
65. Kadri Musta	“	Labinoti
66. Mustafa Kungulli	“	“
67. Theodori Qako	“	Luftëtari
68. Kujtim Dobrolishti	“	17 Nëntori
69. Bajram Hysa	“	Dajti
70. Gaqo Sterio	“	Skëndërbeu
71. Thanas Veriga	“	“
72. Eqerem Reso	“	Luftëtari
73. Jani Qendro	“	Tomori
74. Shpëtim Droboniku	“	“
75. Arqile Shyti	“	“
76. Viron Velaj	“	Partizani
77. Gazmend Shaba	“	“
78. Vladimir Kodra	“	“
79. Shemshedin Memija	“	“
80. Ilia Lilia	“	Apollonia
81. Petraq Rista	“	“
82. Vangjel Zeno	“	“
83. Nasi Shtëmbari	“	“
84. Sulejman Poda	“	17 Nëntori
85. Shefki Juma	“	“
86. Mikel Shoshi	“	“
87. Mario Trinkero	“	Dajti
88. Mit hat Fagu	“	17 Nëntori/Partizani
89. Petrit Çaushti	“	Dinamo
90. Gjon Simoni	“	Vllaznia

Shënime (nga-ab): Aleksandër Bojaxhi u propozua për Mj Sporti në vitin 1967, Agim Kajanaku në vitin 1968.

Genc Kurti mbasi mbaroi UT u caktua me punë mjek në Kukës dhe Komisioni Teknik i Shoqatës në këtë listë e shënoi si alpinist në Kukës.

Xhelil Bakiri mbasi mbaroi UT u caktua me punë mjek në Gramsh dhe Komisioni Teknik i Shoqatës në këtë listë e shënoi si alpinist në Gramsh.

Mustafa Xhake mbasi mbaroi UT u caktua me punë mjek në Rrëshen dhe Komisioni Teknik i Shoqatës në këtë listë e shënoi si alpinist në Rrëshen.

Përparim Vula mbasi mbaroi UT u caktua me punë në Ersekë dhe Komisioni Teknik i Shoqatës në këtë listë e shënoi si alpinist në Ersekë.

Agron Lame kur mbaroi shërbimin ushtarak u largua për në familje dhe u shënuar si alpinist tek ekipi Skëndërbeu i Korçës. Nuk u aktivizua.

LISTA EMËRORE E INSTRUKTORËVE TË ALPINIZMIT (TRAJNERËVE) PËR
VITIN 1969 E VLEFSHME EDHE PËR VITIN 1970

1. Minella Kapo	Kategoria I-rë	Tiranë
2. Vasil Stambuli	“	Partizani
3. Petraq Kule	“	Tomori
4. Kozma Grillo	“	Studenti
5. Andon Tapia	Kategoria II-të	“
6. Vasil Vreto	“	“
7. Agim Tabaku	“	“
8. Avni Zajmi	“	17 Nëntori
9. Koço Qafëzezi	“	Skëndërbeu
10. Agim Kajanaku	“	Labinoti
11. Astrit Omeri	“	17 Nëntori
12. Myftar Marku	“	“
13. Vangjel Ristani	“	Flamurtari
14. Aleksandër Bojaxhi	“	Apolonia
15. Vangjel Melengu	“	Tomori
16. Grigor Perikliu	“	Labinoti
17. Genc Kurti	kategoria III-të	Përparimi
18. Stefan Grillo	“	Partizani
19. Qesar Kurti	“	Studenti
20. Mihal Bozdo	“	17 Nëntori
21. Xhelil Bakiri	“	Gramsh
22. Tefta Zguro	“	Skëndërbeu
23. Taxhedin Shehu	“	Korabi
24. Llazar Xhori	“	Luftëtari
25. Angjelin Kola	“	Vllaznia
26. Gjon Simoni	“	“
27. Vangjo Boboshtica	“	Skëndërbeu
28. Llazo Teneqexhi	“	“
29. Koço Ziso	“	“
30. Petrika Tallabashi	“	“
31. Kristo Qendro	“	Aplollonia
32. Azem Hyka	“	Partizani
33. Feim Xhebraj	“	“
34. Maridon Hito	“	Dajti
35. Mario Trinkera	“	“

36. Niko Stamo	“	17 Nëntori
37. Kristaq Korçari	“	“
38. Ilia Gjergji	“	Flamurtari
39. Arqile Shyti	“	Tomori
40. Agim Haxhia	“	Vlaznia
41. Naun Boba	“	Ylli Kuq Pogradec

LISTË MBI NDRYSHIMIN E NORMATIVAVE TË MATERIALEVE TË ALPINIZMIT TË APROVUARA ME SHKRESË N.40/13 DATË 17/III/1967 DHE CAAKTIMI I NORMAVE PËT AKTIVITETIN E TURIZMIT

Normativa për çdo individ dhe për çdo ekip

Nr	Lloji i materialit	Normative për stërvitje ditore për çdo sportist	Normative që duhet të ketë çdo ekip për aktivitet
1.	Këpucë alpine	1 palë për dy vjet personi	6 palë për ekip për dy vjet
2.	Këpucë gome me qafa	1 palë personi	6 palë për ekip në vit
3.	Xhakovento me kapuç (e gomuar)	1 copë për person në dy vjet	6 copë për ekip në dy vjet
4.	Kostum alpinistik prej stofi (pantallona e xhakovento)	—	6 palë për ekip në dy vjet
5.	Xhup pambuku	-	6 palë në tre vjet për ekip
6.	Tuta komplet (trikotazhi)	1 palë personi	-
7.	Kofshore/benevrekë	-	6 palë për ekip
8.	Triko leshi	-	6 copë në dy vjet për ekip
9.	Bluze pambuku	1 copë në vit	-
10.	Çorape leshi	1 palë personi	6 palë në vit për ekip
11.	Kokore (leshi ose tip ushtarake)	1 copë personi	6 copë në tre vjet për ekip
12.	Pantallona të shkurtëra doku	1 palë për person	6 palë për ekip në dy vjet
13.	Doreza (leshi ose lëkure)	1 palë për person në dy vjet	6 palë për ekip në tre vjet

Shënim: grupi alpinistik në bazë klubi do të përbëhet deri në 12 vetë së bashku me trajnerin.

NORMA ORIENTUESE E INVENTARIT TEKNIK Ë PËRPËRDITËSHME QË DO TË PËRDORET
NË AKTIVITETIN KOMBËTAR, LOKAL DHE NË STËRVITJET ALPINISTIKE

A. Kolektiv për treshe dhe për grup

Nr	Artikulli	Sasia
1.	Çadër	1 copë për 3 veta
2.	Litar kolektiv (45 m)	2 copë për 3 veta
3.	Litar ndihmës (45 m me Ø 6 mm)	1 copë për 3 veta
4.	Sopatë	1 copë për 3 veta
5.	Çantë me barnat e ndihmës së shpejtë	1 komplet për grup
6.	Enë për gatim kolektiv gjelle	1 komplet për grup
7.	Apparat fotografik	1 për çdo grup
8.	Harta topografike për zonat e ngjitjeve	2 copë për çdo zonë
9.	Dylbi	1 copë për 3 vetë
10.	Radio e vogël për marje-dhënie	1 për grup
11.	Busull	1 për çdo 3 veta
12.	Altimetër	1 për çdo grup
13.	Fenerë të vegjël	1 për çdo 3 veta
14.	Primus për zjarr	1 për çdo 3 veta
15.	Lopatë e vogël xhenjere	1 për çdo 3 veta

B. Vetiake

Nr	Artikulli	Sasia
1.	Kazëm alpine	1 copë
2.	Çekiç alpin	1 copë
3.	Litar personal (4-5 m Ø 6 mm)	2 copë
4.	Kthetra akulli	1 alë
5.	Gozhdë shkëmbi (vertikale e horizontale)	10 copë
6.	Çelsa gjoksi (karabina)	5 copë
7.	Dyshek alpin	1 copë
8.	Çantë alpine	1 copë
9.	Pagure uji	1 copë
10.	Gavetë	1 copë
11.	Thikë alpine	1 copë
12.	Elektrik dore	1 copë
13.	Ski komplet	1 palë
14.	Size për borë	1 palë

C. Turizëm

Nr	Artikulli	Sasia
1.	Kostum turizmi prej stofi (pantallona e xhakovento)	6 palë për ekip në 3 vjet
2.	Tuta komplet	6 palë për ekip në tre vjet
3.	Këpucë turistike me qaafa	6 palë për ekip në 2 vjet

Shënim: ekipi do përbëhet me deri 10 veta për stërvitje dhe në aktivitet deri me 6 veta.

Ministri i Financave
Aleks Verli d. v.

Ministri Arsimit dhe Kulturës
Thoma Deljana d. v.

Vërtetohet njësia me origjinalin
DREJTORI
Rexhep Doda d. v.

Shënim:

Grupi alpinistik me bazë klubi do të përbëhet prej 12 vetash dhe në aktivitetin kombëtar deri në 6 veta. Materialet si më sipër janë pa afat skadimi. Për rastet kur ato prishen si: gozhdët e shkëmbit, kazmat, çekiçët, kthetrat, thikat etj, do të bëhet një process verbal i nënshkruar nga komandanti i grupit në vend dhe pastaj të legalizohet edhe nga inspektori përkatës në aparatën e fiskulturës në rreth. Materialet teknike do të nxirren jashtë përdorimit vetëm atëherë kur ato janë të skaduara, gjë që do e konstatojë Komisioni Teknik që do të formohet nga vetë grupi i alpinistave dhe një punonjës i aparatit.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE KULTURËS
DREJTORIA E KULTURËS FIZIKE DHE SPORTEVE
Drejtori
d.v. (Rexhep Doda)

1970

Pas krijimit të Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar dhe caktimit të një sekretari (Muharrem Sinoimeri) pas një pesë vjeçari lëvizja alpinistike ishte futurë në rrugë të mirëfilltë institucionale: kishte një Kryesi që ishte organi më sipëror i lëvizjes alpino-turistike dhe një Komision Teknik. Ishin rishikuar kriteret për paisjet e alpinistëve, ishte vendosur sistemi I punës prej 5 orë në ditë për alpinistët e kategorisë së parë e lart (punojnë jo 8 por 5 orë dhe 3 orë e shkëputjes nga puna llogariteshin stërvitje. Filluan të organizohen seminare kualifikimi për trajnerët e ekipeve alpinistike, si edhe seminare kualifikimi për punonjës të ndërmarrjeve për organiimin e lëvizjes turistikë nëpër qëndrat e punës. Klasifikimi unik sportive edhe duke i rritur kërkesat për marrje të kategorisë sportive si dhe titujve Mjeshtër Sporti, Kandidat për mjeshtër sporti, etj.

Ja disa ilustrime të nxjerra nga buletini i Federatës i viteve 70-të:

Buletin i veprimtarive 1977

Materialet si më poshtë na informojnë rreth veprimtarive në terren si dhe mbi strukturën/ndërtimin institucional të lëvizjes alpinistike.

KLASIFIKIMI UNIK I ALPINIZMIT PËR PERIU DHËN 1976-1980

	I		II		III		IV		V		VI		Shuma	
	V	D	V	D	V	D	V	D	V	D	V	D	V	D
Mj Sporti								2+	5 +++	2+	2+		7	4
K Mj Sporti								2+	4 ++	2+	2+		6	4
Kateg 1						2+	5++	3+	3+	1	1		9	6
Kateg 2				1	3++	2	3+	2	2				8	5
Kateg 3			1	1	3+	2	2	1					6	4
Kat 1 të rinj			1	1	3	2	1						5	3
Kat 2 të rinj		1	2	1	2	1							4	3
Kat 3 të rinj	1	1	1	1	1								3	2
Pionieri	1	1	1										2	1
Shuma e ngj	2	3	6	5	12	9	11	10	14	5	5	-	50	32

Shënim: shënja + tregon që alpinisti duhet të jetë filltar (udhëheqës) në atë ngjije.

Kërkesa plotësuese për të fituar kategori sportive në alpinizëm

A. Kërkesa të përbashkëta:

1. Për fitimin e çdo kategorie duhet të jetë fituar më parë kategoria paraardhëse.
2. Ngjitja quhet e realizuar kur alpinisti arrin në majën kryesore të itinerarit
3. I njëjti itinerar vlerësohet dy herë n.q.s. alpinisti herën e dytë që ngjitet në të është filltar/udhëheqës. I njëjti itinerar po të kryhet për herë të tretë nuk vlerësohet për rritje në kategorinë sportive të alpinistit, qoftë edhe sikur alpinisti të jetë filltar.
4. Alpinisti në rolin e filltarit/udhëheqës të itinerarit, duhet ta udhëheqë atë në pjesën më të vështirë të tij.
5. Për kategorinë e parë sportive e lart kërkohet që në ngjitjet dimërore 30% e ditëve të veprimtarisë të jenë me fjetje në tenda ose shpellë ose guvë.
6. Çdo alpinist i kategorisë së dytë e lart duhet të dijë të përshkruajë e të skicojë itinerarin që udhëheq.
7. Çdo alpinist gjatë veprimtarive verore të çdo viti duhet të mbledhë tre kompionë gurësh mineral në zonën e veprimtarisë dhe të shënojë vendin se ku i gjeti.
8. Femrat përjashtohen nga ngjitjet verore të kategorisë së gjashtë dhe të kategorisë së pestë dimërore që përmban tabela. Gjithashtu ato në kategorinë e pestë verore mjafton të udhëheqin dy herë.
9. Kryqet e shënuara përbri kategorive të ndryshme të ngjitjeve tregojnë se sa herë alpinisti duhet të jetë detyrimish filltar/udhëheqës i saj.

B. Për Mjeshtër Sporti

1. Një ngjitje e kategorisë së gjashtë verore duhet të jetë detyrimisht një nga sa më poshtë:
 - a) Në Paping: - Masivi qëndror
- Maja e Kripës
 - b) Maja Harapit: - nga veri-lindja

- Nga Perëndimi

- c) Maja e Malësore nga veri-lindja
 - d) Kullat e Kolajve, itinerari numër katër.
2. Filltar/udhëheqës
- a) Filltar/udhëheqës ngjitjesh sipas tabelës të shënuar me + (plus).
 - b) Të jetë drejtues i një toge në dimër dhe në verë në veprimtari të kategorisë së parë (gjatë ngjitjeve të kualifikuara).
 - c) Të jetë anëtar i shtabit në një ngjitje të kategorisë së dytë
 - d) Të ketë drejtuar pesë grupe në veprimtari masive me karakter lokal.
3. Të ketë përgatitje të gjithëanëshme fizike në bazë të “Gatishmërisë Fiziko-Ushtarake” në bazë moshe e me rezultate sa më të mira.
4. Kërkesa teknike:
- a) Të dijë kërkesat teknike të kategorisë më të ulët.
 - b) Të zotërojë pasarelin, lavjersin, guvat.
 - c) Të ketë njohuritë fillestare me elementët e topografisë.
 - d) Të dijë të përdorë dhe të punojë me dy litarë (paralelë).
 - e) Të dijë të përdorë kalimin e sqetave/ballkoneve.
 - f) Të dijë të bëjë relacion për ngjitjet.
5. Demonstrime: të bëjë një demonstrim në terren duke përdorur teknikën e kërkuar.
6. Kualifikim si kuadër: të kalojë në kurs me kontroll.
- C. Për kandidat Mjeshtër Sporti:
1. Një ngjitje të kategorisë së gjashtë verore të detyruar në:
- a) Në Paping tek katarakti.
 - b) Tek Shtegu i Dhenve itinerarin Lindor.
 - c) Tek M Kolajet në itinerarin I2(I dy).
 - d) Mali Boshit (nga qafa e Valbonës nëpër derën e kalasë).
2. Filltar/udhëheqës:
- a) Në bazë të kategorisë të shënuar në tabelë me shënjën + (plus).
 - b) Të ketë drejtuar togë të kategorisë të dytë, një në dimër e një në verë.
 - c) Të jetë anëtar shtabi në ngjitjet me të rinjtë.
 - d) Të ketë drejtuar tre veprimtari masive me karakter lokal
3. Të ketë përgatitje të gjithëanëshme fizike në bazë të “Gatishmërisë Fiziko-Ushtarake” në bazë moshe e me rezultate sa më të mira.
4. Kërkesa për njohuri teknike:
- a) Të zotërijë kërkesat e kategorisë më të ulët
 - b) Të zotërojë pykat, shkallët, teleferikun, guvat.
 - c) Të organizojë fushimin/kampingun.
 - d) Të njohë hartën dhe busullën..
 - e) Të evidentojë punën e togës së tij.
5. Demonstrim: të bëjë një demonstrim në teren duke përdorur teknikën e kërkuar më sipër.
6. Kualifikim si kuadër: të kalojë në kurs me kontroll.
- D. Për alpinistët e kategorisë së parë:
1. Një ngjitje të kategorisë së pestë të vështirësisë të detyruar verore në:
- a) Paping: - Maja e shpellës

- Maja e Qypit.
 - Paping nga ana jugore
 - b) Sqeta e Capit, itenerari numër pesë (I 5)
 - c) Në malsore
 - d) Shtegu Dhenve itenerari shtatë (I 7).
2. Udhëheqës:
- a) Në bazë të tabelës shënuar me + (plus).
 - b) Të drejtojnë togë me alpinistë të rinj në dimër dhe në verë.
 - c) Të ketë drejtuar dy grupe të rinjsh në veprimtari masive lokale.
3. Të ketë përgatitje të përgjithshme fizike në bazë të “Gatishmërisë Fiziko-Ushtarake” në bazë moshe e me rezultate sa më të mira.
4. Kërkesa për njohuritë teknike:
- a) Të zotërojnë njohuritë e kategorive më të ulta.
 - b) Të zotërojnë sigurimet, vetsigurimet, vendosjen e plengave/gozhdëve, rrëshqitjen në borë, kalimin mbi lumë, ngritjen e tendës/çadrës.
5. Demonstrim: të bëjë një demonstrim në teren duke përdorur kërkesat që i duhen.
6. Kualifikim si kuadër: të zotërojnë njohuritë që përmban libri “TURISTI”.
- E. Për alpinistët e kategorisë së dytë:
1. Të realizojë një ngjitje të kategorisë së katër verore, të detyruar e të kontrolluar në:
- a) Ulluku jugor në Paping.
 - b) Sqet e Capit.
 - c) Malësorja
 - d) Koka e Kalit
 - e) Shtegu i Dheve itenerarët I 1, I 2, I 3, I 4, I 6, I 7.
 - f) Maja e Markut, Itenerari dy (I 2).
2. Udhëheqës:
- a) Në bazë të kategorisë të shënuar në KUS me shënjën + (plus).
 - b) Të drejtojnë me të rinjtë një tereshe në verë e një në dimër.
 - c) Të ketë çuar në mal një grup punëtorësh.
3. Të ketë përgatitje të përgjithshme fizike në bazë të “Gatishmërisë Fiziko-Ushtarake” në bazë moshe e me rezultate sa më të mira.
4. Kërkesa për njohuri teknike:
- a) Të zotërojnë teknikën e lidhjeve, përdorimin e kazmës, të ecjeve, pikat e mbështetjes, sigurimet dhe vetësigurimet.
 - b) Të organizojë dhe të dijë të kalojë lumin, zbritjen Dylfer, ngjitjen dhe zbritjen sportive.
 - c) Të dijë për pajimet alpine dimërore e verore.
 - d) Të dijë të organizojë fjetjen jashtë në kondita rrethore, të dijë të mbajë ditar personal.
5. Demonstrim: të bëjë një demonstrim në terren duke përdorur teknikën e kërkuar më sipër.
6. Kualifikim si kuadër: të zotërojnë njohuritë që përmban libri “TURISTI”.
- F. Për alpinistët e kategorisë së tretë:
- Për të marrë titullin Alpinist i Kategorisë së Tretë, duhet që në rreth ose klub sportive t’i kërkojnë alpinistit po ato kërkesa që i duhen alpinistit të kategorisë së dytë.
 - Alpinistët e kategorisë së tretë që vinë në aktivitet kombëtar dhe nuk zotërojnë këto njohuri teorike e praktike, kthehen.

K R I T E R E T
Për ngjitjet alpinistike në periudhën dimërore
(20 nëntor deri 30 mars)

Kateg vështi r	Lartësi a	Bor ë	Zefi r	Akul l	Akul l e shkë	Pjerrë si	Këpuc ë	Kaz m	Kth e	Si g	Vet ë sig	Lita r
I	1200	+	+				+	+				
II	1400		+			vogël	+	+				+
III	1600			+	+	mesat	+	+	+	+		+
IV	2000			+	+	madhe	+	+	+	+	+	+
V	2200					sh madhe	+	+	+	+	+	+

Klasifikimi i majave dhe itinerarëve dimërorë për alpinistët

1 Maja e Rinisë (Jezera)	2693.5	nga qafa e Pelës	5 (pestë)
2 Maja 8 Marsi (Popllukës)	2569	nga qafa ë Jezerës	3 (tretë)
3. Maja 8 Marsi	2569	nga qafa e Alisë	4 (katër)
4. Maja 8 Marsi	2569	nga Gropat e Bukura	5 (pestë)
5. Maja e Alisë (Lugu i Plisit)	2471	nga Qafa e Alisë	5+ (pestë)
6. Maja e Harapit	2217	nga Qafa e Pejës	4 (katër)
7. Maja e Kolajet	2490	nga Gropat e Bukura	5+ (pestë)
8. Maja e Kolajet	2198	nga Posta Verore	4 (katër)
9. Maja VP e Kolajet	24??	Nga posta verore	5 (pestë)
10. Maja e Prozhmit	2452	nga lindja ose nga perëndimi	4 (katër)
11. Maja e Qafës Langojve	2428	nga qafa e Langojve	5 (pestë)
12. Maja e Madhe (Shnik)	2554	nga Nikshi (lagje Nenza)	4 (katër)
13. Maja e Madhe (Shniku)	2554	nga Prozhmi ose Q Dobraçe	3 (tretë)
14. Maja e Valit	2237	nga jugu	5 (pestë)
15. Maja Rragamit	2472	nga jugu	4 (katër)
16. Maja e malit të Thatë (V)	2237	nga shtegu	5 (pestë)
17 Maja e Roshit	2524	nga jugu	4 (katër)
18. Maja Kollatës	2556	nga Selimaj (J-P)	4 (katër)
19. Maja e Boshit	2416	nga stanet e Dënellit	4 (katër)
20. Maja e Kakisë	2360	nga stanet e Dënellit	4 (katër)
21. Maja e Drenit	2004	nga stanet	3 (tretë)
22 Maja e Brijasit	2567	nga Boshi	5 (pestë)
23. Maja Gryk e Hapt (I.S.B.)	2525	nga Buni Ziçit	5 (pestë)
24. Maja Gavnit	2530	nga Buni Ziçit ose nga Motina	5 (pestë)
25 Maja Qet Harushe	2423	nga Buni Ziçit	4 (katërt)

26.Maja e Paqes (Marrocës)	2561	nga Motina, Malaj, Liqeni	4 (katërt)
27.Maja e Alshizës	2295	nga Motina, etj	3 (tretë)
28. Maja Vishensit	2517	nga Q e Radohinës	4 (katër)
29. maja e Zhabores	2339	nga Rragami	4(katërt)
30.Maja Zhabores	2339	nga Curraj i Epërm	3(tretë)
31. Maja Krasniqes	2399	nga Rragami	5 (pestë)
32.Maja e Krasniqes	2399	Nga Curraj i Epërm	4 (katër)
33.Maja Radohinës	2569	nga të dy qafat	4 (katër)
34. Maja e Markut (B Bogës)	2....	nga Shtegu i Dhenve	4 (katër)
35 Maja Zag (B Thethit)	2...	nga Shtegu Dhenve	4 (katër)
36.Maja Shtegut	2...	djadhtas Shtegut të Dhenve	4 (katër)
37.Maja 2184 m majtas Mark	2184	nga perëndimi Markut	5 (pestë)
38.Maja e Çardakut	2250	nga Boga, Raba	5 (pestë)
39.maja 2026	2026	nga veriu Rabës	3 (tretë)
40. Maja e Rabës	2222	nga Ducaj	4 (katër)
41.Maja Pishtrecit	2033	nga Ducaj	4 (katër)
42. Maja Mardomit	2179	nga Ducaj	3 (tretë)
43.Maja Kamsholit	2016	nga Ducaj	3 (tretë)
44. Maja 2305	2305	Nga Ducaj	5 (pestë)
45.Maja 2263	2263	nga Ducaj	4 (katër)
46.Maja 2175	2175	nga Ducaj	4 (katër)
47.Maja Troshanit	1890	nhga Ducaj	3 (tretë)
48.Maja Bridashe	2322	nga Boga	5 (pestë)
49.Maja Rosës	1777	nga Boga	3 (tretë)
50. Çuka Partizane	2396	nga Teqja	3 (tretë)
51. Maja e Tomorit	2417	nga Dardha	4 (katër)
52.Traversa Tomorit	2417	Tomor Çukë ose anasjelltas	5 (pestë)
53.Maja Papingut	2485	nga Kaluthi	4 (katër)
54. Maja Ostrovicës	2352	nga Qafa Martës	4 (katërt)
55. Maja Çikës	2045	nga llogoraja	3 (tretë)
56. Maja Valikarës	2373	nga çdo drejtim	3 (tretë)
57. Maja Sopotit (Elb)	2....	nga çdo drejtim	3 (tretë)
58.Maja e Dajtit	1612	nga mbrapa	3 (tretë)
59. Maja Korabit	2751	nga Tejza, stanet, etj.	4 (katërt)
60. Maja Gjallicës	2410	nga Bicaj, Kukës ,etj.	4 Katërt)
61. Maja Dejës			

Pesë vjet pasi u krijua Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar

Në qershor të vitit 1964, kohë kur filloj nga puna Muharrem Sinoimeri si sekretar i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar (SHTASH), lëvizja alpinistike kishte ekip alpinistësh vetëm në Klubin Sportiv Studenti. Disa qytete apo rrethe të vendit tonë dërgonin sportistë në veprimtaritë alpinistike që organizoheshin, por të paktë ishin ata që i ndiqnin rregullisht veprimtaritë (konkretisht e fillimisht ishin:

Grigor Perikliu, Vangjel Ristani, Petraq Kule, Vangjel Melengu) dhe kështu ende nuk ishte lidhur një ekip i dytë, e me rradhë, alpinistësh.

Tashmë Shoqata duke patur një sekretar të emruar si dhe ngritja/krijimi i Komisionit Teknik të Alpinizmit që ushqente Kryesinë e Shoqatës me ide dhe sygjerime, sporti alpinizmit morri zhvillim dhe u përhap nga viti në vit në qytete të ndryshme në vendin tonë. U krijuan ekiye alpinistike në shumë qytete, por për fat të keq jo në fshatrat alpine.

Që në vitet 20-të ajo pak lëvizje alpinistike e turistike që lindi kishte rregulla të cakruara lidhur me organizimin e veprimtarive në natyrë. Ato u shkruan edhe në Revista Gjurmusia si dhe në Gjurmusi e Korçës. Por ato shkuan edhe gojë më gojë gjatë viteve (ndoshta kanë qenë të hedhura në shkresa zyrtare si vendime ose si material që u dërgohej Komiteteve të Kulturës Fizike në rrethe, por unë nuk disponoj ndonjë – ab) dhe kur ishin grupime të organizuara (deri në institucionale) këto rregulla përcillehin edhe me shkresa të herë-pas-herëshme.

Pas L2B për herë të parë të gjitha këto rregulla i hasim të grupuara pesë vjet pas krijimit të SHTASH. Të dhënat e mëposhtëme janë një dokument për të mësuar se çfarë kishte arritur deri në fund të vitit 1969 SHTASH (marrë nga buletini i BFSSH – Shoqata Turizmit-Alpinizmit; Mars 1970).

Rregullorja e parë e sportit të alpinizmit

Rregullorja e brëndëshme e aktivitetit kombërat alpinistik pasqyroj se si do ishin organizimet e veprimtarive alpinistike në vendin tonë.

Aktiviteti kombëtar alpinistik i parashikuar në kalendarin sportiv kombëtar drejtohet nga SHTASH-i në bashkëpunim me komitetet dhe shoqatat lokale të rretheve.

Kriteri i pjesëmarrjes dhe aktivizimit në aktivitetet kombëtare alpinistike do të jetë si më poshtë:
Mbi shkollat e alpinizmit

- Nga aktiviteti lokal masiv turistik-alpinistik, në grupin e alpinistëve të klubit; pastaj në ngjitje lokale, në zbor veror dhe në atë dimëror (me togë fjalëshin “zbor veror” apo “zbor dimëror” kuptohej një shkollë 12-14 ditore në vënde të përshtatëshme të zonave malore ku sipas një programi jepeshin njohuri për pajimet alpinistike, veshjet, format e relievit dhe kalimi i tyre me përdorimin e pajimeve alpinistike, si dhe ngjitje majash të maleve apo itenerarëve shkëmborë të tyre përreth vendit ku organizohej shkolla).
- Në shkollën verore ose në atë dimërore marrin pjesë ata persona që kanë kaluar disa herë në ekskursione, marshime dhe ngjitje lokale, që marrin pjesë rregullisht në stërvitjen e grupit alpinistik të klubit dhe që mbajnë qëndrim të mirë moralo-politik.
- Çdo pjesëmarrës në shkollë duhet të ketë kaluar më parë kontrollin mjekësor. Në këto shkolla nuk duhet të dërgohen njerëz me të meta trupore, të sëmurë nga zemra, nga tensioni, nervat, etj.
- Në shkolla pranohen njerëz me mosha të reja dhe jo më të vegjël se 17 vjeç.
- Çdo rreth apo klub sportiv duhet të pajisi pjesëmarrësit për në shkolla me komplet me materialet sportive, teknike dhe ato të veshmbathjes. Kjo e fundit do të realizohet në vartësi me normat e dërguara nga dikasteri i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës dhe ai i Financave. Kjo kërkesë është e detyrueshme edhe për të aktivitetet kombëtare ku aktivizohen alpinistët.
- Çdo alpinist ka të drejtë të marrë pjesë në dy shkolla kombëtarë verore dhe një shkollë kombëtare dimërore, për të gjithë kohën e aktivizimit të tij në këtë degë sporti.

Mbi ngjitjet e kualifikuara verore dhe dimërore

- Alpinistët pjesëmarrës në ngjitjet e kualifikuara verore duhet të ketë kaluar të paktën dy shkolla verore dhe të jenë të aktivizuar në veprimtaritë lokale dhe kombëtare. Të jenë nënshtruar rregullisht stërvitjes në grupin alpinistik, si dhe ata që mbajnë kategori të larta sportive.
- Në ngjitjet e kualifikuara dimërore alpinistët pjesëmarrës duhet të kenë kaluar shkollën dimërore, të kenë jo më pak se kategorinë e tretë sportive dhe të kenë patur stërvitje të rregullta me grupin alpinistik të klubit.

Kërkesa të tjera të përgjithshme

- Kur veprimtaritë zhvillohen në zonat kufitare, alpinistët duhet të jenë të pajisur me leje nga Dega e Punëve të Brëndëshme e rrethit nga ku dërgohen.
- Klubet sportive dhe shoqatat lokale në zonën e të cilës do të zhvillohet veprimtaria alpinistike kombëtare, duhet të marrin masa për pajisjen e alpinistëve me armë zjarri, raketa shënjë dhënëse, etj. Kur ngjitjet janë të kualifikuara dhe kryhen në zona të thella, këto pajisje duhet të sigurohen edhe nga klubet që dërgojnë grupe alpinistësh në këto veprimrari.
- Në rast të mos realizimit të ngjitjes në datat e planifikuara në kalendar, grupet alpinistike sipas një arsyetimi të posaçëm, gëzojnë të drejtën të zgjasin ditët e veprimtarisë deri në realizimin e plotë të ngjitjes..
- Klubet sportive për arësye të papritura në aktivitetin kombëtar janë të detyruara të pajisin alpinistët me fonde rezervë (lekë). Fonde rezervë do të jepen edhe për transport me kuaj kur del nevoja e transportit të materialeve në rrugë dhe zona të caktuara.
- Programi alpinistik realizohet në përputhje me datat e parashikuara në kalendar. Ditët në udhëtim do të jenë plus ditëve të parashikuara për realizimin e aktivitetit.
- Në rrethet ku zhvillohen aktivitetet duhet të merren masa të rregullta për pritjen dhe përcjelljen, vendet e fjetjes, transportit, etj. Ceremonitë e përshëndetjes do të bëhen zakonisht në mbarim të aktivitetit.
- Për grupet alpinistike që kalojnë transit nëpër Tiranë, duhet detyrimisht të dërgohen me kohë lekët për sigurimin e vendeve të fjetjes dhe të prenotimit të biletave të udhëtimit për shkuarje dhe kthim dhe jo më vonë se tre ditë më parë.
- Për drejtimin e ngjitjeve/veprimtarive si dhe të shkollave caktohet, nga ana e Kryesisë së Shoqatës, shtabi i veprimtarisë, që është autoriteti më i lartë dhe që përgjigjet për të gjitha çështjet teknike, organizative, materiale dhe disiplinore. Në mbarim të aktivitetit, shtabi është i detyruar të bëjë analizën e punës dhe konkluzionet t'ja dërgojë Kryesisë së Shoqatës. Ky relacion do t'i përshtatet modelit të dërguar nga Shoqata.
- Për të mbajtur ndërlidhje me qendrën, shtabi i drejtimit duhet të informojë nëpërmjet linjave të ndryshme telefonike në telefonat 44-10 të Shoqatës, 34-14 të Sektorit të Organizimit të BFSSH-së dhe 34-89 të dezhurnit të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës.
- Çdo alpinist gjatë një viti ka të drejtë të aktivizohet në jo më shumë se dy veprimtari kombëtare.
- Shënimi: Titulli Mjeshtër Sporti mund të jepet vetëm atëherë kur kandidati të ketë të paktën një stazh prej dy vjetësh nga koha e marrjes së kategorisë së parë sportive.
- Kryesia e Shoqatës, në çaste të caktuara dhe që nuk parashikohen në rregullore, ka të drejtë të vendosë për çështje të tjera të domosdoshme që diktohen nga rrethanat në jetën alpinistike.

Nga Kryesia e Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit të R.P.SH.

Lista e Alpinistëve të Kategorizuar (me kategori sportive) në Alpinizëm për Vitet 1968-1969

Nr.	Emri Mbiemri	Kategoria	Klubi Sportiv
-----	--------------	-----------	---------------

01	Minella Kapo	Mjeshtër Sporti	Studenti
02	Vasil Stambuli	“	Partizani
03	Petraq Kule	“	Tomori
04	Kozma Grillo	“	Studenti
05	Grigor Perikliu	“	Labinoti
06	Vangjem Melëngu	“	Tomori
07	Andon Tapia	“	Studenti
08	Vangjel Ristani	“	Flamurtari
09	Aleksandër Bojaxhi	“	Apollonia
10	Agim Kajanaku	“	Labinoti
11	Myftar Marku	Kategoria Parë	17 Nëntori
12	Vasil Vreto	“	Studentii
13	Agim Tabaku	“	Studenti
14	Tefta Zguro	“	Skëndërbeu
15	Koço Qafëzezi	“	Skëndërbeu
16	Koço Ziso	“	Skëndërbeu
17	Taxhedin Shehu	“	Korabi
18	Mihal Bozdo	“	17 Nëntori
19	Astrit Omeri	“	17 Nëntori
20	Genc Kurti	“	Kukësi
21	Vilson Braja	“	Luftëtari
22	Llazar Zhor	“	Luftëtari
23	Niko Stamo	“	17 Nëntori
24	Maridon Hito	“	Dajti
25	Azem Hyka	“	Partizani
26	Qazim Liço	“	Partizani
27	Stefan Grillo	“	Partizani
28	Toil Biqiku	“	Tomori
29	Manol Bozaxhiu	Kategoria Dytë	Tomori
30	Kristaq Korçari	“	17 Nëntori
31	Fejzi Liço	“	Dajti
32	Petrika Tallabashi	“	Skëndërbeu
33	Xhelil Bakiri	“	Gramshi
34	Llazo Teneqexhi	“	Skëndërbeu
35	Koço Qirici	“	Labinoti
36	Hiqmet Kuka	“	Flamurtari
37	Kostandin Kola	“	Flamurtari
38	Shkumbin Ramadani	“	Flamurtari
39	Jani Agaraj	“	Flamurtari
40	Bashkim Çela	“	Flamurtari
41	Agim Haxhia	“	Vllaznia
42	Angjelin Kola	“	Vllaznia
43	Gani Kurti	“	Vllaznia
44	Zenulla Strazimiri	“	17 Nëntori
45	Ferhat Sela	“	Korabi
46	Themistikli Garuli	“	Tomori
47	Viktor Melengu	“	Tomori
48	Mustafa Xhake	“	RrëshënR
49	Roza Gjergji	“	Labinoti

50	Flamur Milova	“	Studenti
51	Janaq Ziso	“	Studenti
52	Mira Hyseni	“	Studenti
53	Ilia Lilia	“	Apollonian
54	Vullnet Zylyftari	“	Studenti
55	Piro Liko	“	Studenti
56	Fatos Harito	“	Studenti
57	Leonidha Druga	“	Studenti
58	Vangjel Polo	“	Studenti
59	Përparim Vula	“	Gramozi
60	Ismail Hoxha	“	17 Nëntori
61	Agron Lame	“	Skëndërbeu
62	Feim Xhebraj	“	Partizani
63	Sabit Hoxha	“	Korabi
64	Ali Ago	“	Dinamo
65	Viliam Kosturi	“	Dinamo
66	Kadri Musta	“	Labinoti
67	Mustafa Kungulli	“	Labinoti
68	Theodhori Qako	“	Luftëtari
69	Kujrim Dobrolishti	“	17 Nëntori
70	Bajram Hysa	“	Dajti
71	Gaqo Sterjo	“	Skëndërbeu
72	Thanas Veriga	“	Skëndërbeu
73	Eqerem Reso	“	Luftëtari
74	Jani Qendro	“	Tomori
75	Shpëtim Droboniku	“	Tomori
76	Arqile Shyti	“	Tomori
77	Viron Velaj	“	Partizani
78	Gazmend Shaba	“	Partizani
79	Vladimir Kodra	“	Partizani
80	Shemshedin Memija	“	Partizani
81	Petra Rista	“	Apollonia
82	Vangjel Zeno	“	Apollonia
83	Nasi Shtëmbari	“	Apollonia
84	Sulekman Poda	“	17 Nëntori
85	Shafki Juma	“	17 Nëntori
86	Mikel Shoshi	“	17 Nëntori
87	Mario Trinkera	“	Dajti
88	Mit’hat Fagu	“	Partizani
89	Petrit Çausi	“	Dinamo
90	Gjon Simoni	“	Vllaznia

(Shënim: alpinisti i parë me titullin mjeshtër Sporti ka qenë Luigj Shala. Mendoj se arësyeja që ai nuk është i përfshirë në këtë listë është ngaqë ai ndërroi jetë në vitin 1966 – ab)

Lista Emrore e Instruktorëve të Alpinizmit (Trajnerë) për vitin 1969
e vlefshme edhe për Vitin 1970

Nr.	Emri Mbiemri	Kategoria	Klubi Sportiv
01	Minella Kapo	Parë	Studenti
02	Vasil Stambuli	“	Partizani
03	Petra Kule	“	Tomori
04	Kozma Grillo	“	Student
05	Andon Tapia	Dytë	Student
06	Vasil Vreto	“	Student
07	Agim Tabaku	“	Student
08	Avni Zajmi	“	17 Nëntori
09	Koço Qafëzezi	“	Skënderbeu
10	Agim Kajanaku	“	Labinoti
11	Astrit Omeri	“	17 Nëntori
12	Myftar Marku	“	17 Nëntori
13	Vangjel Ristani	“	Flamurtari
14	Aleksandër Bojaxhi	“	Apollonian
15	Vangjel Melengu	“	Tomori
16	Grigor Perikliu	“	Labinoti
17	Genc Kurti	Tretë	Kuksi
18	Stefan Grillo	“	Partizani
19	Qezar Kurti	“	Student
20	Mihal Bozdo	“	17 Nëntori
21	Xhelil Bakiri	“	10 Korriku
22	Tefta Zguro	“	Skënderbeu
23	Taxhedin Shehu	“	Korabi
24	Llazar Xhori	“	Luftëtari
25	Angjelin Kola	“	Vllaznia
26	Gjon Simoni	“	Vllaznia
27	Vangjo Boboshtica	“	Skënderbeu
28	Llazo Teneqexhi	“	Skënderbeu
29	Koço Ziso	“	Skënderbeu
30	Petrika Tallabashi	“	Skënderbeu
31	Kristo Qendro	“	Apollonian
32	Azem Hyka	“	Partizani
33	Feim Xhebraj	“	Partizani
34	Maridon Hito	“	Dajti
35	Mario Trinkera	“	Dajti
36	Niko Stamo	“	17 Nëntori
37	Kristaq Korçari	“	17 Nëntori
38	Ilia Gjergji	“	Flamurtari
39	Arqile Shyti	“	Tomori
40	Agim Haxhia	“	Vllaznia
41	Naum Boba	“	Ylli Kuq

Shënim (ab): qytetet Kukës, Rrëshen dhe Gramsh në këto dy pasqyra/tabela si më sipër “u bënë” me alpinistë apo instruktorë për arsye të emrimeve të kuadrove universitare që ishin marrë me sportin e alpinizmit në Klubin Sportiv Studenti, apo edhe të ndonjë klubi tjetër dhe u emëruan me punë në këto qytete. Në fakt deri në këto vite, sepse më pas këta alpinistë nuk e zhvilluan më tej karrierën e tyre sportive. Kjo, sepse nuk u mundësohej shkëputja nga puna për aq ditë sa kërkonte veprimtaria alpinistike.

Kalendari sportiv kombëtar për sportin e alpinizmit

Egzistenca e një kalendari kombëtar për veprimtaritë sportive në vendin tonë, me mundësitë që kemi deri më sot për të shfletuar dokumenta për sportin e alpinizmit, gjenden vetëm për vitet kur sporti i alpinizmit doli si shoqatë/federatë më vete. Kalendari i veprimtarive gjithnjë formulohej nga Komisioni Teknik i Alpinizmit. Ky kalendar jetësohej vetëm pasi e aprovonte Kryesia e Shoqatës/Federatës. Si rregull kalendari i përcillej ekipeve alpinistike, fillimisht jo zyrtarisht, sapo ideoej, si rregull në muajin nëntor, që ato të përshtatnin stërvitjen me veprimtarinë që do të synonin. Për të krijuar idenë se si ishin këta kalendarë, zbatimi i të cilëve ishte një nga treguesit e nivelit cilësor të këtij sporti, po sjellim për lexuesin dy të tillë.

Kalendari Sportiv i vitit 1970

ALPINIZËM

1. 3-15 janar Shkolla dimërore e alpinizmit për Universitetin Shtetëror të Tiranës.
Vendi i zhvillimit: në Voskopojë
Pjesëmarrja: çdo fakultet me 10 veta (4 vajza)
2. 16-30 janar Shkolla dimërore e alpinizmit nën patronazhin e Këshillit Qëndror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.
Vendi i zhvillimit: në Voskopojë
Pjesëmarrja: Partizani, 17 Nëntori, Dinamo, Dajti, Labinoti, Ylli i Kuq, Skënderbeu, Korabi, Vllaznia, Tomori, Lokomotiva, Valbona, Përparimi, 24 Maj, Luftëtari, Flamurtari, Apollonia, Sopot, Erseka, Minatori, Butrinti, Kastrioti, Gramshi; me grupe/ekipe nga 5 veta (2 vajza).
3. 7-15 mars Ngjitje kombëtare të kualifikuara kushtuar 25 vjetorit të forcave të kufirit
A. Vendi i zhvillimit: Alpet jug-lindore. B. Curri, Valbonë, Gryk e Hapt, Briaset, Krasniqe, Bosh, Theth, Bogë.
Pjesëmarrja : Partizani, Studenti, Skënderbeu, Valbona, Labinoti, Apollonia, Përparimi.
B. 3-8 shkurt vendi i zhvillimit: Tiranë – Dajt – Bizë – Martanesh – Batër – Burrel për nder të 25 vjetorit të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë
Pjesëmarrja: 17 Nëntori, Studenti, Flamurtari, Dinamo, Vllaznia, Tomori, Dajti, Korabi, Fakulteti i Mjeksisë.
C. 3-8 shkurt Vendi i zhvillimit: Berat – Dardhë – Maja 11 shkurti – Çuka Partizan – Barbullas – Berat.
Pjesëmarrja: Tomori, Ylli i Kuq, 24 Maj, Luftëtari, Minatori, Sopot, Butrinti.
4. Ngjitje kombëtare 5 ditore në zonat e reja jashtë rretheve.
Vendi i zhvillimit: ngjitje në bazë të programit të klubit sportiv.
Pjesëmarrja: çdo klub me dy deri tre treshe alpinistësh.
5. 16-30 korrik shkolla verore e Universitetit Shtetëror të Tiranës.
Vendi i zhvillimit: Theth
Pjesëmarrja: çdo fakultet me 10 veta (4 vajza)
6. 1-14 korrik shkolla verore kombëtare e alpinizmit
Vendi i zhvillimit: në Theth.
Pjesëmarrja: Partizani, Dinamo, 17 Nëntori, Dajti, Vllaznia, Valbona, Përparimi, Përparimi, Korabi, Labinoti, Ylli i Kuq, Skënderbeu, Sopot, Gramshi, Erseka, Lokomotiva, Traktori, Apollonia, Flamurtari, Tomori, Luftëtari, 24 Maj, Minatori, Butrinti, Kastrioti, Beslidhja me grupe deri në 5 veta (2 vajza).
7. 1-14 gusht Ngjitje të kualifikuara verore

Vendi i zhvillimit: në Alpe, Theth

Pjesëmarrja: Partizani, Dinamo, 17 Nëntori, Dajti, Studenti, Fakulteti Mjeksisë, Vllaznia, Valbona, Korabi, Përparimi, Ylli i Kuq, Skëndërbeu, Tomori, Aplollonia, Flamurtari, Luftëtari; me grupe deri në tre veta

8. 26 nëntor Ngjitje kombëtare dimërore me këto vende zhvillimi
Në Shnik nga Nikçi: Vllaznia, Partizani, 17 Nëntori, Përparimi.
Në Jezerë nga Valbona: Valbona, Korabi, Studenti 1, Kasrtrioti, Dinamo.
Në Ostrovicë: Labinoti, Ylli i Kuq, Skëndërbeu, Sopot, Gramozi, Studenti 2 (Fakulteti i Mjeksisë).
Në Tomor nga fshati Tomor: Tomori, Flamurtari, Luftëtari, Minatori, 24 Maj, Dajti, Butrinti, Apollonia.
Pjesëmarrja në grupe me një deri dy treshe.
9. Shkolla dimërore alpinistike ushtarake. Vendi i zhvillimit në Theth. E organizon Ministria e Mbrojtjes Popullore.

TURIZËM

1. 22-28 qershor Takim kombëtar pranveror me zona në:
 - a) Në Elbasan (Labinot): Elbasani, Lushnja, Durrësi, Tirana (Pallati i Pionerëve), Peshkopia, Librazhdi, Gramshi, Dajti, Dinamo.
 - b) Në Korçë (Bozdovec). Korça, Partizani, 17 Nëntori, Pogradeci, Gjirokastra, Përmeti, Tepelena, Burreli
 - c) Në Berat: Berati, Fieri, Vlora, Shkodra, Kruja, Lezha, B Curri, Kukësi, Rrëshëni, Saranda
 Shënim: pjesëmarrja do të jetë si më sipër me grupe me 10 veta
2. 4-12 gusht Takimi kombëtar final i pionerëve
Vendi i zhvillimit: në Lurë
Pjesëmarrja: të gjithë rrethet dhe klubet sportive si në takimin e muajit qershor me grupe deri 10 vetë.

(Shënim: viti 1970 ishte viti i fundit që në Kalendarin Kombëtar u planifikua veprimtari Turistike. Turizmi nuk u konsiderua më tej si sport ku kërkohej cilësi. Por shkresat dhe tabelat për bazë materiale nuk u shfuqizuan. Shoqata (SHTASH) në këtë kohë mori emërtesën Federata e Alpinizmit Shqiptar. Kur sekretarit të federatës ju shtua puna edhe për ndjekjen e sportit të çiklizmit ajo u quajt Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Çiklizmit. Mirëpo meqë sporti i çiklizmit kishte edhe veprimtari ndërkombëtare erdhi një ditë dhe Federata u quajt: Federata Shqiptare e Çiklizmit dhe Alpinizmit. Kur u shtua në këtë zyrë edhe sporti i Skive Federate u emërtua Federata Shqiptare e Çiklizmit, Alpinizmit dhe Skive-ab).

Kërkesat dhe normat e klasifikimit unik sportiv

ALPINIZMI

Kategoria	Shkalla e vështirësisë												Gjithsej
	I		II		III		IV		V		VI		
	D	V	D	V	D	V	D	V	D	V	D	V	
Mjeshtër Sporti							5	3	3	2	1	1	
Kategoria e					2	2	3	2	2	1			

parë													
Kategoria e dytë			3	2	3	2	1	1					
Kategoria e tretë		2	1	2	1	2							
Alpinist i R.P.SH.	2	1	1	1	1								

D = ngjitje në sezonin dimëror (20 nëntor – 31 mars); V = ngjitje në sezonin veror

Kërkesa plotësuese

1. Mjeshtër Sporti: të bëjë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar kategorinë e parë sportive, të drejtojë dy ngjitje të shkallës së katër të vështirësisë, të jetë instruktor alpinizmi i kategorisë së dytë dhe të ketë punuar në tre kurse për përgatitjen e alpinistëve, nga të cilat një në rrethin/qytetin e tij, të bëjë rreth 5 km marshim në borë me ski, të dijë të notojë, të përshkruaj në hartë duke pasqyruar një ngjitje të shkallës së dytë të vështirësisë, të drejtojë toga alpinistash në dy ngjitje të kualifikuara, nga të cilat një në dimër.
 2. Kategoria e parë: të bëjë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar kategorinë e dytë sportive, të drejtojë një ngjitje të shkallës së dytë të vështirësisë, të ketë punuar për përgatitjen e alpinistëve të rinj në një kurs kombëtar, të bëjë një ngjitje të vështirësisë së dytë në një itinerar të ri, të përshkruaj duke e pasqyruar në hartë, një ngjitje të shkallës së dytë të vështirësisë, të ketë marrë pjesë në dy ngjitje të kualifikuara, nga të cilat një në dimër, të ketë ngjitur Gurin e Capit, ose një itinerar tjetër me të njëjtën vështirësi, duke qenë në krye të litarit.
 3. Kategoria e dytë: të ketë bërë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar kategorinë e tretë sportive, të drejtojë një grup fillestarësh në një itinerar të shkallës së parë të vështirësisë, të ketë marrë pjesë në një nga ngjitjet e kualifikuara.
 4. Kategoria e tretë: të bëjë ngjitje sipas pasqyrës, të ketë fituar distiktivin Alpinist i RPSH. Ky titull jepet vetëm pasi të ketë kaluar në kurse kombëtare ose lokale që njihen nga shoqata; të ketë bërë stërvitje të rregullta me ekipin e alpinistëve të klubit që përfaqëson.
- Shënim: për titullin Mjeshtër Sporti dhe për tre kategoritë sportive.
- a. Për plotësimin e kërkesave nuk ka afat të caktuar, por mjafton që të mos ketë ndërprerje në aktivitet më shumë se dy vjet.
 - b. Në një ngjitje plotësimi i dy kërkesave nuk njihet.
 - c. Drejtimi është i vlefshëm kur grupi është i organizuar dhe njihet nga shoqata.
 - d. Togat ose grupet alpinistike duhet të kenë jo më pak se tre litarë (dmth 9 vetë)
 - e. Grupet që ngjiten në maja malesh duhet të kenë jo më shumë se 20 anëtarë.

(Shënim: jo gjithnjë merreshin parasysh të gjitha kërkesat si më sipër. Arësyeja: ishte e pamundur që Federata të ndiqte apo të kqyrte plotësimin e tyre – ab).

Emërtimet e majave të maleve

Në vendin tonë, pas L2B u ndryshuan shumë emërtime rrugësh. Emërtimet e maparëshme u zëvendësuan me emërtime që lidheshin e systemin e ri shoqëror që filloi të ndërtohej në vendin tonë, e sidomos me emra datash historike të luftës si dhe emra dëshmorësh të rënë gjatë luftës.

Edhe me emrat e maleve ndodhi diçka e ngjashme. Kjo histori emërimesh filloi në datën 21 Maj 1950. Në veprimtarinë e organizuar për ngjitjen në majën **Çuka e Tomorit** (2396 m), pjesëmaarrësit e ngjitur në majë organizuan një ceremoni me fjalë të rastit dhe me flamurin kombëtar dhe e pagëzuan këtë majë me emrin **Çuka Partizan**.

Pas kësaj, në korrik të po këtij viti u organizua ngjitja në malin e Marroces dhe maja e këtij mali, Maja e Hekurave, u pagëzua me emrin Maja e Paqes.

Kjo risi e kohës vazhdoi edhe më tej në vite dhe kemi këto pagëzime:

Maja e Popllukës u pagëzua Maja 8 Marsi. Kjo sepse maja u ngjit për herë të parë në dimër nga një grup alpinistash që udhëhiqej nga një femër, nga Tefta Zguro dhe kjo datë njëherësh na kujton 8 Marsin që është dita ndërkombëtare e grave.

Maja e Jezerës u pagëzua me emrin Maja e Rinisë. Kjo majë në harta dhe mësimet e gjeografisë, sin ë arësimin para universitar edhe në arësimin univesitar shkruhet dhe njihet me emrin maja e JezerCës (2. 694 m). Të habit fakti që banorët që e shohin atë e quajnë maje e Jezerës (pa C) dhe me fjalën jezerë ata nënkuptojnë mjegullën dhe /ore renë.

Maja e Tomorit mbi fshatin Tomor, 2.175 m, u pagëzua Maja 11 Shkurti. Në këtë datë ishte caktuar nga PPSH Dita e Novatorëve. Ishte shkurt i vitit 1965 dhe ngjitja në (një) majë të malit Tomor, me nisje nga fshati Tomor, bëri që në Shoqatë të rregjistroj si një ngjitje e bërë në majën kryesore të Tomorit. Maja kryesore e malit Tomor, 2.416 m mbeti e pa cënuar me emërtime. Për habi sot shikojmë që në hartat e reja topografike kjo majë të shënohet me emërtesën Maja Partizan. Si duket edhe instirtuti i topografisë ushtarake ka bërë emërtimet e tij!!!!

Maja e Radohimës u pagëzua Maja Shkurte Pal Vata, në përkujtim të vajzës nga fshati Pecaj i Dukagjinit që ndërroi jetë teksa punonte (në sektorin e Lushnjës) në ndërtimin e hekurudhës për në Vlorë.

Maja Sqeta e Cjapit u pagëzua me emrin Maja 25 Gushti. Kjo datë ishte Dita e Shtypit. Kjo majë është “shoqe” me majën e Prozhmit, në Runicë. Lidhen të dy majat me një kreshtë të mprehtë.

Në malin e Shnikut, Maja e Madhe u pagëzua me emrin Maja Skënderbe. Kjo ndodhi në janar të vitit 1968 në kuadër të festimeve në 500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut.

Maja Gryk e Hapt u pagëzua me emrin Maja Ismet Sali Bruçaj. Ky ishte emri i mësuesit shëmbullor, i cili ndërroi jetë teksa shkonte në shkollë (në ditë kombëtare pushimi) për një kënaqësi partriotike për nxënësit e tij. Ai kishte një radio marëse të mirë (Iliria) dhe do të shkonte tek shkolla e fshatit ku jepte mësim, që nxënësit të dëgjonin (meqë dëshironin) në radio paradën që do organizohej para tribunës së udhëheqjes për festën në Ditën e Çlirimit. Kjo majë në hartat topografike ushtarake është shënuar me lartësinë 2.625 m, lartësi kjo që i takon Majës së Madhe (apo ndryshe Maja Lugbat), emërtesë

që e kanë banorët e luginës së Valbonës. Kjo majë (dhe bjeshka e saj) njihet me emërtesën Maja/Bjeshka Lugbatit nga malsorët e luginës së Currajve.

Maja e Vishensit u pagëzua me emrin Maja e Dritës, në vitin 1970. Kjo ngaqë ishte koha që përfundoi elektrifikimi në të gjitha fshatrat e vendit tonë.

Ndërsa sa më sipër ishin pagëzime të ideoeshin nga Kryesia e Federatës, me emërtesën Maja e Dritës u pagëzuan edhe maja të tjera bazuar në inisiativa lokale. Një emërtesë e tillë, p.sh., ju bë majës së Papingut në malin e Nëmërçkës.

Është rasti të kujtojmë se ne nuk kemi patur institucion topografik para L2B. Kjo ka bërë që hartat tona të jenë bërë nga austriakët, ndërkombëtarët për të përcakruar vijën kufitare me shtetet fqinje, nga italianët, rusët dhe nga vetë ne shqiptarët.

Duke patur të huaj që kanë dëgjuar emërtesat e majave nga vendasit, me raste ata i kanë shkruar emrat ashtu si i ka dëgjuar veshi i tyre, apo me hamendje për tingujt e gërmavë që ata nuk i kanë. Po ashtu duke i kaluar hartat nga një gjuhë në një tjetër ne kemi edhe “përplasje” në emërtesa si dhe pasaktësi në lartësitë e vendosura mbi to.

Me këto përmasa që po zhvillohet sot turizmi malor mendoj se duhet një rishikim i duhur i hartave topografike si për emërtesat ashtu edhe për lartësitë. Dhe mos harrojmë se ka maja dhe “nën maja” malesh që janë edhe pa lartësitë, sidomos ato që në hartë nuk kanë as emër.

Kartela personale e alpinistit

Nevoja për të nxjerrë në pah përvojën dhe kategorinë sportive që arrinte të fitonte alpinistit, një ditë u pa se ishte e vështirë që kjo të vihej në dukje me shënime që mbaheshin nëpër blloqe rekordesh të Federatës për veprimtaritë. Andaj, në pamundësi financiare që alpinistët të pajiseshin me librezë personale, fillimisht u ideua formulari si më poshtë ku regjistroheshin arritjet e alpinistit. Pas përfundimit të veprimtarive, shtabi drejtues dorëzonte në Federatë një relacion përmbledhës si dhe një pasqyrë ku shënoheshin arritjet e çdo pjesëmarrësi në veprimtari. Jo gjithnjë kështu. Kishte raste që drejtuesi I veprimtarisë nuk dorëzonte arritjet e alpinistëve. Madje edhe në vitet 80-të. Kjo gjë krijonte pakënaqësi në rradhët e alpinistëve që “e pësonin”. Arritjet e alpinistit regjistroheshin në formularin si më poshtë (është marrë një shëmbull ilustrues):

KARTELË PERSONALE E ALPINISTIT

Emri Mbiemri: Leka Besnik Dushku

Datë lindja: (qyteti/rrethi) Tiranë

Klubi Sportiv: Dajti

Profesioni: normist

Nr.	Vendi zhvillimit	Data zhvillimit	Detyra në ngjitje	Maja e ngjitur	Drejtimi	Sa orë	Sa litarë	Sa plenga	Kategoria vështirësisë
01	Q Pejë	17.07.69	Filltar	Kolaj	Verior	4	3	21	V - B

Lista Emrore e Alpinistave
Për efekt evidentimi dhe aktivizimi për vitin 1978 e më tej
(por e pavlefshme për efekt të trajtimit ushqimor)

Kjo tabelë do hidhet pa dy kollonat e fundit të saj ngaqë evidentimi i tyre nuk ka vlerë sot. Por për të treguar se si është materiali i plotë në bulletin po marrim vetëm një shëmbull ilustrues, por që nuk i përgjigjet realitetit.

Nr.	Emri Mbiemri	Kategoria sportive	Kur e ka fituar	Ngjitje rezervë	Shuma e rezervës
01	Aleksandër Bojaxhi	Mjeshtër Sporti	1968	V: 11/3; 8/4; 4/5; 5/6 D: 13/3; 6/4; 2/5	49

Shënim. **V:11/3** ka kuptimin si vijon: gjatë sezoneve verore (V) ka kryer 11 ngjitje të shkallës së tretë të vështirësisë, pas marrjes së titullit Mjeshtër Sporti; etj.

I. Apollonia e Fierit

01. Nasi Shtëmbari	I	1972
02. Piro Liko	II	1969
03. Eqerem Shehu	II	1974
04. Vangjel Zeno	II	1969
05. Ilia Lilia	II	1969
06. Petraq Rista	II	1969
07. Vladimir Mane	III	1971
08. Leonidha Druga	II	1969
09. Vullnet Kalemi	III	1971
10. Kozma Zako	III	1971
11. Agim Shehu	III	1971
12. Arqile Mile	III	1972
13. Viron Gega	III	1972

II. K.S. Beslidhja e Lezhës: nuk ka asnjë alpinist të kategorizuar

III. K.S. Butrinti i Sarandës: nuk ka asnjë alpinist të kategorizuar

IV. K.S. Dajti i Rrethit të Tiranës

01. Sulejman Dule	III	1972
02. Bajram Hysa	II	1969

V. K.S. Dinamo e M.P.B.

01. Petrit Çausi	I	1977
02. Jorgaq Grabocka	II	1972
03. Gëzim Bundo	II	1972
04. Vangjel Haxhinasta	III	1971
05. Ali Ago	II	1969
06. Viliam Kosturi	II	1969
07. Jani Stefa	III	1971

VI. K.S. Sopot i Librazhdit: nuk ka asnjë alpinist të kategorizuar

VII. K. S. Flamurtari i Vlorës

01.	Vangjel Ristani	Mj. Sporti	1967	
02.	Viron (Venigjar)Velaj	K. Mj. Sporti	1977	
03.	Kristaq Gega	I	1974	
04.	Servet Aliko	I	1976	
05.	Shkumbin Ramadani	I	1977	
06.	Besnik Mustafaraj	I	1977	
07.	Agron Devolli	II	1974	
08.	Fatmir Bitri	III	1976	
09.	Shkollar Xhelili	III	1976	
10.	Alfred Selimi	III	1976	
11.	Romeo Sheqeri	III	1976	
12.	Ilia Gjergji	III	1973	
13.	Kristaq Maçi	III	1973	
14.	Jorgaq Kapore	III	1972	
15.	Besnik Dervishi	III	1975	
16.	Aleksandër Tafili	III	1975	
17.	Gramoz Rustemi	III	1976	
18.	Astrit Ferko	III	1971	
19.	Fatos Breshani	III	1972	
20.	Jani Agaraj	II	1969	
21.	Bashkim Çela	II	1969	
22.	Hiqmet Kuka	II	1969	
23.	Kostandin Kola	II	1969	
VIII. K.S. Gramozi i Ersekës				
01.	Përparim Vulo	II	1969	(është arsimtar)
IX. K.S. Kastrioti i Krujës: nuk ka asnjë alpinist të kategorizuar				
X. K.S. Korabi i Peshkopisë				
01.	Taxhedin Shehu	K. Mj. Sporti	1977	
02.	Rushit Reçi	K. Mj Sporti	1977	
03.	Agim Tabaku	I	1967	u transferua nga Tirana në Peshkopi
04.	Azem Muda	I	1975	
05.	Qemal Hakorja	I	1977	
06.	Adil Manga	I	1976	
07.	Abdulla Merdini	I	1986	
08.	Zabit Tusha	II	1973	
09.	Asllan Hoxha	II	1969	
10.	Zabit Hoxha	II	1969	
11.	Ferhat Sela	II	1967	
12.	Bastri Elezi	II	1967	
13.	Besnik Kica	II	1975	
14.	Shkëlqim Kuçi	III	1973	
15.	Përparim Çorollari	III	1973	
16.	Islam Cenka	III	1975	
17.	Shaqir Lusha	III	1975	

	18. Petrit Kuçi	III	1975
	19. Dali Hakorja	III	1974
	20. Iljaz Neli	III	1974
	21. Jahja Ashiku	III	1971
	22. Halil Trupja	III	1971
XI.	K S Labinoti i Elbasanit		
	01. Grigor Perikliu	Mj Sporti	1966
	02. Agim Kajanaku	Mj Sporti	1970
	03. Qemal Biçaku	I	1977
	04. Refik Kamara	II	1976
	05. Nikolla Toçi	II	1973
	06. Agim Ceka	II	1973
	07. Isuf Dine	II	1973
	08. Kadri Musta	II	1969
	09. Robert Bici	II	1971
	10. Koço Qirici	II	1969
	11. Mustafa Kungulli	II	1969
	12. Roza Gjergji	II	1968
	13. Banush Sulkia	III	1974
	14. Seit Gajdja	III	1976
	15. Pëllumb Bici	III	1975
	16. Kujtim Hoxha	III	1973
	17. Xhevat Osmani	III	1974
	18. Edmond Abazi	III	1976
XII.	K S Lokomotiva e Durrësit		
	01. Ilia Berberi	III	1970
XIII.	K S Luftëtari i Gjirokastrës		
	01. Vilson Braja	I	1969
	02. Llazar Zhori	I	1969
	03. Eqerem Reso	II	1969
	04. Hysen Kore	II	1971
	05. Osman Zani	II	1971
	06. Theodhori Qako	II	1969
	07. Siri Dudumi	III	1972
	08. Hysen Kovaçi	III	1976
	09. Thoma Shajko	III	1976
	10. Besnik Qazo	III	1976
	11. Vilson Kore	III	1970
	12. Ramadan Cenke	III	1976
	13. Agim Hoxha	III	1975
	14. Agron Kore	III	1975
	15. Lutfi Musta	III	1970
	16. Gëzim Cenke	III	1971
	17. Perikli Bezhani	III	1971

	18. Selim Pulaj	III	1971
	19. Mahmut Biçaku	III	1972
	20. Fatmir Idreizi	III	1970
XIV.	K S Minatori i Mirëditës	Nuk ka alpinistë që kanë fituar kategori sportive.	
XV.	K S Minatori i Tepelenës	Nuk ka alpinistë që kanë fituar kategori sportive.	
XVI.	K S 24 Maji i Përmetit		
	01. Dhimitraq Qerimi	II	1977
	02. Isuf Beja	II	1976
	03. Tlli Mullaraj	III	1972
	04. Bardhyl Çaçi	III	1972
	05. Medi Nurka	III	1974
	06. Ylli Tuçi	III	1974
	07. Fatmir Cenko	III	1976
	08. Pëllumb Muke	III	1976
	09. Odise Kote	III	1976
	10. Kamber Çaushi	III	1976
	11. Edmond Konomi	III	1976
	12. Vladimir Cafa	III	1972
	13. Besnik Bektashi	III	1972
XVII.	K S Partizani		
	01. Vasil Stambuli	Mj Sporti	1962
	02. Qazim Liço	K Mj Sporti	1976
	03. Kujtim Onuzi	K Mj Sporti	1977
	04. Azem Hyka	K Mj Sporti	1977
	05. Stefan Grillo	I	1969
	06. Robetr Llabani	I	1974
	07. Pullumb Llabanishti	I	1977
	08. Aleksandër Kapo	I	1977
	09. Eduard Sheldia	I	1976
	10. Vladimir Kodra	II	1969
	11. Gazmend Shabani	II	1969
	12. Feim Xhebraj	II	1969
	13. Spiro Ciko	II	1977
	14. Fejzi Liço	II	1969
	15. Hasan Duro	II	1973
	16. Xhavit Cani	II	1973
	17. Skënder Serani	III	1970
	18. Irfan Musallari	III	1974
	19. Bardhyl Blloshari	III	1975
	20. Petrit Xhindolli	III	1975
	21. Edmond Bani	III	1975
	22. Uran Gashi	III	1975
	23. Abdulla Shabani	III	1971
	24. Duk Gjergji	III	1974

XVIII. K S 5 Shtatori i Skraparit

01. Budjon Nasha	II	1973
02. Ylli Shaka	II	1973
03. Përparim Myftari	III	1973

XIX. K S Përparimi Kukës

01. Ymer Alija	II	1976
02. Ajet Krasniqi	III	1976
03. Berzat Mane	III	1973
04. Muharrem Manaj	III	1976
05. Kasem Krasniqi	III	1976
06. Halim Islami	III	1976
07. Ramadan Manaj	III	1976
08. Bajram Xheta	III	1976
09. Rasim Beqiri	III	1974

XX. K S Skëndërbeu

01. Koço Qafëzezi	I	1960
02. Tefta Zguro	I	1961
03. Koço Ziso	K Mj Sporti	1976
04. Genc Lika	I	1977
05. Gjergji Kostandini	I	1962
06. Perika Tallabashi	I	1969
07. Gaqo Sterio	I	1970
08. Agron Lame	II	1969
09. Thanas Veriga	II	1969
10. Llazi Teneqexhi	II	1969
11. Ferdinand Koça	II	1972
12. Lame Nika	II	1977
13. Gaqo Skorovoda	II	1977
14. Thoma Furxhi	III	1973
15. Apostol Boba	III	1974
16. Anesti Qirio	III	1976
17. Përparim Çollaku	III	1976
18. Kostaq Përmeti	III	1974
19. Zhani Bica	III	1974
20. Mihallaq Çollaku	III	1973
21. Dhimitër Postoli	III	1974
22. Ibrahim Haxhillari	III	1974
23. Gaqo Kote	III	1971
24. Ilia Balli	III	1971
25. Stavri Treska	III	1971
26. Andrea Pode	III	1972

XXI. K S Sopoti i Librazhdit: nuk ka asnjë alpinist të kategorizuar**XXII. K S Studenti**

01. Minella Kapo	M M Sporti	1969
------------------	------------	------

02. Kozma Grillo	Mj Sporti	1961
03. Andon Tapia	Mj Sporti	1964
04. Vladimir Memisha	K M Sporti	1976 ekipi Studenti filloi të plotësohej me punto
05. Vasil Vreto	I	1960
06. Maridon Hito	I	1969 ekipi Studenti filloi të plotësohej me punto
XXIII. K S Shkëndia i I.K.F. Vojo Kushi: nuk ka alpinistë të kategorizuar		
XXIV. K S 17 Nëntori i Tiranës		
01. Luigj Shala	Mj Sporti	1959
02. Aleksandër Bojaxhi	Mj Sporti	1969
03. Astrit Omeri	Mj Sporti	1976
04. Mario Trinkera	Mj Sporti	1977
05. Kristaq Korçari	K M Sporti	1976
06. Myftar Marku	I	1967
07. Mihal Bozdo	I	1967
08. Niko Stamo	I	1968
09. Dashamir Fejzo	I	1976
10. Shefki Juma	I	1976
11. Sulejman Elmazi	II	1973
12. Ylber Juma	II	1972
13. Abdurrahman Kuka	II	1972
14. Mikel Shoshi	II	1969
15. Ismail Hoxha	II	1968
16. Mit'hat Fagu	II	1968
17. Zejnulla Strazimiri	II	1968
18. Kujtim Dobrolishti	II	1968
19. Sulejman Poda	II	1969
20. Arjan Duma	II	1975
21. Niko Petro	II	1977
22. Romeo Manxhari	II	1977
23. Shkëlqim Terpo	III	1974
24. Fatmir Bozdo	III	1974
25. Theodor Thanasi	III	1973
26. Fatos Idrizi	III	1974
27. Krenar Dobi	III	1974
28. Ylli Meçe	III	1972
29. Agim Mema	III	1971
XXV. K S Tërbuni i Pukës: nuk ka alpinistë të kategorizuar.		
XXVI. K S Tomori i Beratit		
01. Petraq Kule	M M Sporti	1969
02. Vangjel Melëngu	Mj Sporti	1968
03. Jani Qendri	K M Sporti	1977
04. Toil Biqiku	k M Sporti	1977
05. Vullnet Ziliftari	I	1973
06. Arqile Shyti	I	1976

07.	Stefan Kule	I	1976	
08.	Maliq kasemi	II	1977	
09.	Koço Maqina	II	1976	
10.	Nëntor Veleshnja	II	1973	
11.	Manol Bozaxhiu	II	1962	
12.	Themistokli Garuli	II	1968	
13.	Viktor Melëngu	II	1969	
14.	Shpëtim Dobroniku	II	1969	
15.	Kristaq Simitxhiu	III	1976	
16.	Ilia Shyti	III	1976	
17.	Kastriot Hoxha	III	1976	
18.	Vlash Koxhaku	III	1976	
19.	Bardhyl Nako	III	1976	
20.	Riza Çullai	III	1973	
21.	Petraq Prifti	III	1973	
22.	Shkëlqim Hoxha	III	1972	
23.	Përparim Korani	III	1973	
XXVII. K S Traktori i Lushnjës				
01.	Metan Liçka	II	1972	
02.	Hamdi Poçi	II	1973	
03.	Nevzat Dervishi	III	1970	Mësues i gjuhës angleze i cili ngizi ekipin.
04.	Llazar Kovaçi	III	1973	
05.	Bajram Saraçi	III	1973	
06.	Jorgji Merlika	III	1972	
07.	Hamdi Risto	III	1972	
XXVIII. K. S. Sopoti I Librazhdit: nuk ka alpinistë të kaategorizuar.				
XXIX. K S 31 Kurriku i Matit: nuk ka alpinistë të kategorizuar.				
XXX. K S Valbona e Tropojës				
01.	Hajdar Hasa	II	1973	
02.	Nuredin Seci	II	1977	
03.	Petrit Doçi	III	1974	
04.	Kujtim Matoshi	III	1976	
05.	Abedin Kartoçi	III	1976	
06.	Isuf Milushi	III	1976	
07.	Bajram Idrizi	III	1973	
08.	Gjon Mici	III	1972	
09.	Rexhep Nexha	III	1974	
XXXI. K S Vllaznia e Shkodrës				
01.	Gëzim Uruçio	K M Sporti	1976	
02.	Hasan Temali	I	1976	
03.	Agim Haxhia	II	1969	
04.	Njazi Paçrami	II	1972	
05.	Burhan Kurti	II	1973	

06. Shuaip Isufi	II	1974
07. Kujtim Gjylbegu	II	1974
08. Abdulla Rëshketa	II	1977
09. Qemal Zagonjari	II	1976
10. Luigj Malaj	III	1972
11. Ahmet Osaj	III	1973
12. Ali Galica	III	1976
13. Tonin Roku	III	1976
14. Ibrahim Dibra	III	1976
15. Avni Ramadani	III	1976
16. Sabah Luigji	III	1976

XXXII. K S Ylli Kuq i Pogradecit

01. Nuçi Boba	II	1971
02. Dhimitraq Çomo	III	1971

V.O. – ky material është themelor që klubet sportive të kenë evidencën e alpinistëve të tyre, për historik dhe ecurinë nga viti në vit të ecurisë së tyre.

- në këtë evidencë çdo alpinist ka të shënuar kategorinë sportive të fituar, vitin kur e ka fituar si dhe ngjitjet rezervë që ka (të cilat në këtë material nuk janë hedhur- shënim i ab) për të fituar kategori më të lartë sportive, në bazë të klasifikimit unik sportive.

- nëse do të riaktivizohen alpinistë të cilëve nuk u janë hedhur ngjitjet rezervë, çdo trajner ose klub, mund t'i kërkojë në Komisionin Teknik ose në Federatën e Alpinizmit.

- këto evidenca janë nga kartelat dhe dokumentat që ka deri më sot Federata. Nuk është bërë asnjë lëshim. Po të jetë se ndonjë alpinist pretendon për ngjitje që nuk i janë quajtur a hedhur, duhet të paraqesë dokumenta në Komisionin Teknik, të shqyrtohet kolegjisht dhe mund të bëhet ndryshimi pasi të merret vendimi kolegjal.

- në evidencën e rrethit apo klubit sygjerohet të shtohen edhe alpinistët që ka përgatitur vetë klubi sportiv, të cilët nuk janë evidentuar nga ana jonë (është koha që përgatitja e alpinistëve nuk kryhej nëpër shkollat e alpinizmit. Klubet sportive duhej të përgatisnin vetë alpinistë të kategorisë së tretë sportive. Tashmë veprimtaritë kombëtare organizoheshin që alpinistët të merrni kategorinë e dytë e lart –shënim nga ab).

Në buletin janë shënuar edhe rezultatet e alpinistëve, sipas ekipeve, gjatë veprimtarive të vitit. Po marrim shëmbuj për ilustrim.

Ngjitjet dimërore të kategorisë së parë në Alpe 5-16 mars 1977; ekipi Flamurtari

Nr.	Maja	Kat vështir	V. Velaj	K. Gega	S. Aliko	B. Mustafaraj
01	Harapit	V	Po	Po	Po	Po
02	Popllukës	V	Po	Po	Po	Po
03	Alisë	V	-	Po	Po	Po
Shuma		11	2	3	3	3

Ngjitjet dimërore të kategorisë së dytë; zona e Bogës, 22-30 mars 1977; shembull Ekipi Flamurtari

Nr.	Maja	Kategori vështir	Shkumbin Ramadani	Agron Devolli	Ramo Shaqiri	Alfred Selimi	Shkollar Xhelili	Fatmir Bitri
01	Bridash	IV	Po	Po	Po	-	Po	Po
02	2026 m	III	-	Po	-	-	Po	Po
03	2128 m	IV	Po	-	-	-	-	-
04	2132 m	III	Po	Po	Po	-	Po	Po
05	2098 m	III	Po	Po	Po	-	Po	Po
06	2305 m	V	Po	Po	-	-	-	-
07	1803 m	III	Po	Po	-	Po	Po	Po
Shuma		25 maja	6	5	3	1	5	5

Shënim (nga ab): në rastet që para ose gjatë veprimtarive nuk ishte i sigurtë emërtimi i majës, shënohej lartësia e saj. Ky rregull vlente edhe për majat të cilat nuk kishin një emër në hartë.

Ngjitjet alpinistike verore 18-27 korrik 1977, zona e Papingut; shembull Ekipi Labinoti

Nr.	Maja apo Shkëmbi	Kateg vështir	Grigor Perikliu	Qemal Biçaku	Isuf Dine	Xhevat Osmani	Kujtim Hoxha	Pëllumb Bici	Seit Gajdja	Edmond Abazi
01	Brezi Turqve	IV	Po	Po	Po +	Po +	Po	Po	Po	Po
02	Vrima e Çpuar	V	Po	Po	Po	Po +	Po +	Po	Po	Po
03	Paping Veri	III	Po +	Po	Po +	Po	Po	Po	Po	Po
04	Zhavori Jug	III	Po	Po +	Po	Po	Po	Po +	Po	Po
05	Lugu jugor	IV		Po	Po +	Po	Po	Po +	Po	Po
06	Poligoni Nr 2	VI			Po	-	-	-	-	-
07	Poligoni Nr 5	V				Po +	Po +	Po	Po	Po
08	Poligoni Nr 8	IV				Po +	Po	Po +	Po	Po
	Shuma	50	4	5	6	7	7	7	7	7

Ngjitjet dimërore të kategorisë së parë në Alpe, 5-16 mars 1977; shembull Ekipi 17 Nëntori

Nr.	Maja	Kateg vështir	Astrit Omeri	Kristaq Korçari	Dashamir Fejzo	Shefki Juma	Arjan Duma
01	Kolajve	IV	-	Po	-	Po	Po
02	Popllukës	V	-	-	-	Po	-
03	Langojve	V	-	Po	Po	Po	Po
Shuma	8		-	2	1	3	2

Shtysa nga lart (shtetërore) për përhapjen e alpinizmit ndikoi në çdo rreth të vendit tonë, por disa rrethe nuk arritën të kishin qëndrueshmëri. Kështu në fund të vitit 1977 merrnin pjesë në veprimtaritë kombëtare 21 ekipe alpinistike si më poshtë.

Deri në vitin 1978 në lëvizjen sportive alpinistike merrnin pjesë këto ekipe:

Apollonia e Fierit në të cilën kishin fituar kategori sportive 13 alpinistë.

Dajti i rrethit të Tiranës të cilin kishin fituar kategori sportive 2 alpinistë

Dinamo e Min P Brendshme të cilën kishin fituar kategori sportive 7 alpinistë.

Flamurtari i Vlorës të cilën kishin fituar kategori sportive 23 alpinistë.

Gramozi i Ersekës të cilën kishte fituar kategori sportive 1 alpinist.

Korabi i Peshkopisë të cilën kishin fituar kategori sportive 22 alpinistë

Labinoti i Elbasanit të cilën kishin fituar kategori sportive 19 alpinistë.

Lokomotiva e Durrësit të cilën kishte fituar kategori sportive 1 alpinist.

Luftëtari i Gjirokastrës të cilën kishin fituar kategori sportive 20 alpinistë.

24 Maj i Përmetit në të cilën kishin fituar kategori sportive 13 alpinistë.

Partizani i Min Mbrojtjes në të cilën kishin fituar kategori sportive 24 alpinistë.

5 Shtatori i Skraparit në të cilën kishin fituar kategori sportive 3 alpinistë.

Përparimi i Kuksit në të cilën kishin fituar kategori sportive 9 alpinistë

Skënderbeu i Korçës në të cilën kishin fituar kategori sportive 26 alpinistë.

Studenti i Universitetit të Tiranës në të cilën egzistonin me kategori sportive 7 alpinistë.

17 Nëntori i Tiranës në të cilën kishin fituar kategori sportive 29 alpinistë.

Tomori i Beratit në të cilën kishin fituar kategori sportive 22 alpinistë.

Traktori i Lushnjës në të cilën kishin fituar kategori sportive 6 alpinistë.

Valbona e Tropojës në të cilën kishin fituar kategori sportive 10 alpinistë.

Vllaznia e Shkodrës në të cilën kishin fituar kategori sportive 15 alpinistë.

Ylli i Kuq i Pogradecit në të cilën kishin fituar kategori sportive 2 alpinistë.

Ja dy fragmente shkrimesh, nga Kozma Grillo, që na flasin për arritje të alpinizmit në drejtim të itinerarëve që ndërmarrin ata si dhe për të mësuar se tashmë alpinistët me emër nuk janë më të treguar me gisht, por kemi një brez të ri, dhe jo pak.

27 shkurt 1979

Ngjitja në faqen veriore të majës së Jezerës: “Ndodhemi rreth 20 metra larg majës. Ora është 16 e 30 minuta. Na pushton një gëzim i papërshkrueshëm. Detyrohemi të ngulim kazmat alpine për të mos na flakur era e lemerisësme. Përpiqemi të fotografojmë me duar gjysëm të ngrira. Sipas zakonit, po të kishim kushtet e duhura atmosferike, në majë do të linim kutinë me letrën ku do shkruhej: Pas 7 orësh mbërritëm në majë nga itinerari verior. Jemi të gëzuar për suksesin e arritjes së kësaj fitoreje. Grupi ynë përbëhet nga alpinistët: Mario Trinkera, Viron Velaj, Servet Aliko, Kristaq Gega, Aleksandër Bojaxhi, Eduard Sheldia, Kristaq Korçari, Kujtim Onuzi, Shefki Juma, Kozma Grillo. Zbritjen e bëmë nga ana e Gropave të Bukura. E filluam kur po errësohej....”

3 korrik 1979

“Nga alpinistët tanë janë realizuar me sukses ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë. Le të kujtojmë midis tyre ngjitjen në murin shkëmbor në faqen jugore të majës së Harapit, marrjen e Jezerës nga ana veriore në dimër, faqen shkëmbore të Papingut, e kështu me rradhë. Do të duhej një listë e gjatë për tu njohur me alpinistët tanë të talentuar, por 1960 po mjaftohemi duke përmendur një për çdo ekip: Azem Hyka, Viron Velaj, Maridon Hito, Stefan Kule, Shefki Juma, Qemal Hakorja, Koço Ziso, Nuredin Seci, Gëzim Oruçi.”

Pas vitit 1975 doli udhëzimi për krijimin e ekipeve të sistemit zinxhit: pionerë, të rinj dhe të ritur (ky egzistonte). Jo të gjitha klubet sportive kishin mundësi financiare për të mbështetur sistemin e plotë të ekipeve zinxhir. Njëherësh, me kalimin e kohës, fondet për sportin që ndaheshin nga buxheti shtetëror erdhën duke u tkurrur. Si pasojë e kësaj, fillimisht në vitin 1982, u mbyllën ekipet e pionerëve dhe nga fundi i këtij dhjetvjeçari u mbyllën edhe ekipet e të rinjve.

Ekipet e të rriturve mbijetuan deri në vitin 1991, vit në të cilin u organizuan veprimtaritë e planifikuara të sezonit dimëror, por kur u organizuan ngjitjet e kualifikuara të sezonit veror, për arsye nga më të ndryshmet ekipet nuk u paraqitën për të filluar veprimtaritë e planifikuara. Përfundim bëri ekipi 17 Nëntori i cili kur arriti në Theth, por dhe pas arritjes, nuk u paraqit asnjë ekip tjetër. Me ushqimet dhe dietat që kishin vetë organizuan një program turistik. Arritja më “e madhe” e këtij programi ishte ngjitja në majën e Jezerës nga Adrian Kurti dhe Aleksandër Bojaxhi. Më tej alpinizmi si sport, sikundër edhe sportet e tjera, ra. Viti 1992 ishte viti sportiv alpinistik pa kalendar kombëtar veprimtarishë. Veprimtaritë sportive, për arsye sigurie, u ndërpre në rang kombëtar.

Për fat kemi një dokument të rrugës nga Aleksandër Bojaxhi i cili na jep një pasqyrë të ekipeve dhe alpinistëve që mban datën dhjetor 1989. Ky është një material i vlefshëm për të parë disa tregues të nivelit të alpinizmit në vendin tonë. Në tabelat e përmbledhura prej tij kemi emrat e alpinistëve aktivë, kategorinë që kanë në trajtimin ushqimor, kategorinë sportive që fiton (ata që fitojnë rritje në kategori sportive) si dhe kategoria e trajtimit ushqimor që do të ketë alpinisti për vitin 1990. Në këto tabela nuk janë shënuar ata alpinistë (shumë pak) të cilët edhe në ishin aktivë, nuk arritën të plotësojnë normat për të fituar trajtim ushqimor.

Këto tabela do pasqyrohen në vijim, për secilin ekip, në kapitullin mbi historikun e alpinizmit për secilin qytet të vendit tonë që kishte ekip alpinistësh në vitin 1989.

Disa Veteranë të FSHALTM

Apollonia:

Nasi Shtëmbari, Vangjel Zeno, Petraq Rista, Piro Liko, Eqerem Shehu, Vladimir Mane

Dajti:

Maridon Hito, Marjo Trinkera, Bajram Hysa, Eqerem Prokopuca

Dinamo:

Ali Ago, Jorgaq Grabocka, Petrit Çausi, Gëzim Bungo, Vangjel Haxhinasta, Viliam Kosturi

Flamurtari:

Vangjel Ristani, Viron Velaj, Servet Aliko, Shkumbin Ramadani, Aleksandër Tafili, Hiqmet Kuka, Kostandin Kola

Peshkopia:

Rushit Reci, Adil Manga, Zabit Tusha, Besnik Kica

Elbasani:

Roza Gjergji, Qemal Bicaku, Rapush Kabashi, Pëllumb Bici, Xhevat Osmani

Përmeti:

Ylli Mullaraj, Isuf Beja, Ylli Tuci, Fatmir Cenko

Partizani:

Qazim Lico, Azem Hyka, Kujtim Onuzi, Spiro Ciko, Aleksander Kapo, Eduard Sheldija, Skënder Serani, Uran Gashi, Hasan Duro, Fejzi Lico, Stefan Grillo

Skrapari:

Budjon Nasha, Ylli Shaka, Përparim Myftari, Fatmir Spahiu

Kukësi:

Berzat Mane, Ymer Aliaj, Kasem Krasniqi, Muharrem Manaj

Korca

Tefta Zguro, Koço Qafëzezi, Lame Nika, Genc Lika, Anesti Qirio, Ferdinand Koça, Llazi Teneqexhi

Studenti:

Andon Tapia, Kozma Grillo, Vasil Vreto, Mustafa Selenica, Tefta Zguro, Zenel Kokomiri, Agim Tabaku, Vladimir Memisha, Vasillaq Papuciu.

Tirana:

Mihal Bozdo, Astrit Omeri, Mario Trinkera, Shefki Juma, Romeo Manxhari, Niko Petro, Niko Stamo, Sulejman Poda, Mit'hat Fagu, Ismail Hoxha, Aleksandër Bojaxhi.

Berati:

Jani Qendro, Toli Biqyku, Arqile Shyti, Vullnet Zylyftari, Koçi Maqina, Kastriot Hoxha, Stefan Kule

Valbona:

Petrit Doci, Kujtim Matoshi, Nuredin Seci, Hazir Malaj, Hajdar Hasa.

Shkodra:

Agim Haxhia, Ahmet Osja, Hasan Temali, Luigj Malaj, Kujtim Gjylbegu, Gëzim Oruçi, Gjon Simoni.

Shënim: Lista si më sipër bazohet në botimin “Bulletin për aktivitetin Alpinistik të vitit 1977”, botim i vitit 1978.

Nuk janë përfshirë të gjithë alpinistët e listuar në buletin.

Nuk janë përfshirë alpinistët që unë i di që kanë ndëruar jetë.

Përgatiti, Aleksandër Bojaxhi; shtator 2012

Kalendari kombëtar i veprimtarive alpinistike për vitin 1989

A. Sezoni dimëror

Ngjitjet e kategorive të ulta: 3 deri 9 shkurt

1. Në zonën e Valbonës: Kastrioti, Minatori T, Valbona, Vllaznia, Labinoti.

Shtabi drejtues: Azir Malaj komandant

Ethem Loçi komisar

Drejtues togash: Aleksandër Sinani, Iljaz Shuli, Kujtim Ibrahim

Pjesëmarrësit më dt 1 shkurt të ndodhen në Bajram Curri

2. Në zonën e Bogës: Partizani, Tomori, Skënderbeu, Flamurtari, 31 Korriku.

Shtabi Drejtues: Eduard Sheldia komandant

Petrika Janaqi komisar

Drejtues togash: Aleksandër Tafili, Xhevair Bozaxhi, Hasan Duro

Pjesëmarrësit më dt 1 shkurt të ndodhen në Shkodër.

3. Në zonën Ducaj: Tërbuni, Luftëtari, Korabi, 24 Maj, 5 Shtatori.

Shtabi Drejtues: Ylli Mullaraj komandant

Zabit Tusha komisar

Drejtues togash: Beslim Qypi, Pëllumb Muke, Fitimtar Myftari.

4. Në zonën e Ostrovicës: Apollonia, Studenti, 17 Nëntori, Dajti, Përparimi

Shtabi drejtues: Koço Ziso komandant

Flamur Muço komisar

Drejtues togash: Ilir Tapia, Leonard Rama, Ardian Kurti, Gëzim Hima

Pjesëmarrësit më dt 1 shkurt të ndodhen në Korçë

Ngjitjet e kualifikuara dimërore: 17 deri 26 shkurt

1. Në zonën e Livadheve të Bogës: Studenti, Tërbuni, Vllaznia, Labinoti, Minatori T.

Shtabi drejtues: Gëzim Oruçi komandant

Vladimir Memisha komisar

Drejtues togash: Arbër Kodra, Rahit Hila, Kastriot Çerkezi .

Pjesëmarrësit në dt 14 të ndodhen në Shkodër

2. Në zonën e Valbonës: Flamurtari, Partizani, Skënderbeu, Përparimi, 31 Korriku

Shtabi drejtues: Venigjar Velaj komandant

Ismail Domi komisar

Drejtues togash: Anesti Qirio, Vasillaq Papuçiu, Berzat Manaj

Pjesëmarrësit më dt 15 shkurt të ndodhen në Bajram Curri.

3. Në zonën e Qafë Pejës: Korabi, Tomori, 5 Shtatori, Kastrioti, Apollonia, Luftëtari.

Shtabi drejtues: Taxhedin Shehu komandant

Gramoz Shehu komisar.

Drejtues togash: Vilson Kore, Asllan Gjiza, Adil Manga

Pjesëmarrësit më dt 15 shkurt të ndodhen në Shkodër.

4. Në zonën Shtegu i Dhënve: 17 Nëntori, Dajti, Valbona, 24 Maj

Shtabi drejtues: Aleksandër Bojaxhi komandant

Sokol Hoxha komisar

Drejtues togash: Sokol Doko, Rustem Kurtsmajli

Pjesëmarrësit më datë 15 shkurt të ndodhen në Shkodër.

B. Sezoni Veror

Ngjitjet e kategorive të ulta: 5 deri 11 korrik.

1. Në zonën e Shtegut të Dhenve: Skënderbeu, Përparimi, Tomori, Flamurtari, 13 Korriku.

Shtabi drejtues: Petraq Kuli komandant

Mihallaq Çollaku komisar

Drejtues togash: Halim Musta, Jani Qendro, Berzat Manaj.

Pjesëmarrësit më dt 3 korrik të ndodhen në Shkodër.

2. Në zonën e Fushë Dënellit: 5 Shtatori, Dajti, 17 Nëntori, Vllaznia, Partizani.

Shtabi drejtues: Gëzim Oruçi komandant

Hasan Duro komisar

Drejtues togash: Dashamir Fejzo, Ardian Kurti, Agim Muça

Pjesëmarrësit më dt 2 korrik të ndodhen në Shkodër.

3. Në zonën e Korabit: Korabi, Luftëtari, Kastrioti, Apollonia, Labinoti.

Shtabi drejtues: Taxhedin Shehu komandant

Agron Shehu komisar

Drejtues togash: Adrian Sena, Agron Skënduli, Zabit Tusha.

Pjesëmarrësit më dt 3 korrik të ndodhen në Peshkopi.

4. Në zonën e Papingut (Strëmbec): 24 Maj, Studenti, Minatori T, Valbona, Tërbuni.

Shtabi drejtues: Vladimir Memisha Komandant

Ylli Mullaraj komisar

Drejtues togash: Maksut Fekushi, Aleksandër Sinani, Avdi Zholi.

Pjesëmarrësit më dt 3 korrik të ndodhen në Përmet.

Ngjitjet e kualifikuara Verore: 17 deri 26 korrik

1. Në zonën e Valbonës (Kroni I Rrogamit): Përparimi, Tomori, Korabi, Partizani, Kastrioti

Shtabi drejtues: Hazir Malaj komandant

Eduard Sheldia komisar

Drejtues togash: ismail domi, Jani Qendro, Fatmir Metko

Pjesëmarrësit të ndodhen më dt 15 korrik në Bajram Curri.

2. Në zonën e Valbonës (Mali i Valit): Flamurtari, Studenti, Apollonia, Vllaznia, Tërbuni.

Shtabi drejtues: Venigjar Velaj komandant

Kujtim Gjylbegu komisar

Drejtues togash: Beslim Qypi, Aleksandër Tafili, Odise Gjini.

Pjesëmarrësi më datën 15 korrik të ndodhen në Bajram Curri.

3. Në zonën e Livadheve të Bogës: Skëndërbeu, Labinoti, 5 Shtatori, 31 Korriku, Luftëtari.

Shtabi drejtues: Koço Ziso komandant

Vilson Kore komisar

Drejtues togash: Petrika Janaqi, Xhevair Bozaxhi,

Pjesëmarrësit më dt 14 korrik të ndodhen në Shkodër.

4. Në zonën e malit të Boshit (Gjelaj): Valbona, Dajti, 17 Nëntori, Minatori T, 24 Maj

Shtabi drejtues: Kozma Grillo komandant

Aleksandër Bojaxhi komisar

Drejtues togash: Sokol Doko, Flamur Muço, Rexhep Kurtmajli

Pjesëmarrësit më dt 15 korrik të ndodhen në Shkodër.

Veprimtaritë Kombëtare me alpinistët e rinj

A. Sezoni dimëror 15 deri 18 mars

1. Grupi i parë (në malin e Allamanit): 17 Nëntori, Labinoti, Apollonia, Flamurtari, Kastrioti

Drejtues të veprimtarisë: Shefki Juma, Kristaq Gega

Pjesëmarrësit të ndodhen në Burrel më datë 13 mars.

2. Grupi i dytë (në malin e Tomorit): Luftëtari, Tomori, 24 Maj, Skëndërbeu, 5 Shtatori

Drejtues të veprimtarisë: Stefan Kuli, Anesti Qirio

Pjesëmarrësit në veprimtari më dt 13 mars të ndodhen në Berat.

3. Grupi i tretë (në malin e Papingut): Partizani, 31 Korriku, Vllaznia, Minatori T.

Drejtues të aktivitetit: Eduard Sheldia, Rushit Reçi.

Pjesëmarrësit më dt 13 mars të ndodhen në Përmet.

4. Grupi i katërt (selishtë): Korabi, Valbona, Përparimi, Tërbuni.

Drejtues të veprimtarisë: Qemal Hakorja, Rakip Cenu

Pjesëmarrësit më datë 13 mars të ndodhen në Peshkopi.

B. Sezoni veror: 10 deri 12 korrik

1. Grupi i parë (Xhyrë): Kastrioti, Apollonia, Korabi, Tomori, Përparimi.

Drejtues të veprimtarisë: Qemal Hakorja, Arjan Sena

Pjesëmarrësit në veprimtari më dt 8 korrik të ndodhen në Librazhd.

2. Grupi i dytë në Qafë Shtamë: Luftëtari, Labinoti, 31 Korriku

Drejtues i veprimtarisë: Agron Skënduli

Pjesëmarrësit më datë 8 korrik të ndodhen në Krujë.

3. Grupi i tretë në Otovë: 24 Maj, 17 Nëntori, Tërbuni, Skënderbeu

Drejtues të veprimtarisë: Shefki Juma, Adriatik Fezga

Pjesëmarrësit më datë 8 korrik të ndodhen në Përmet.

4. Grupi i katërt në Poçem: Vllaznia, Valbona, Minatori T, Partizani, Flamurtari.

Drejtues të veprimtarisë: Albert Isai, Rahit Mema

Pjesëmarrësit në veprimtari të ndodhen në dt 8 korrik në Ballsh.

Veprimtaritë me Pionerët e Enverit

- a. Sezoni dimëror: 21 deri 23 mars. Brënda rrethit

- b. Sezoni veror: 3 deri 5 korrik. Brënda rrethit

Shënim nga AB:

1. Kalendar Kombëtar i veprimtarive alpinistike ndërtohet nga Komisioni Teknik brënda vjeshtës së një viti për vitin në vazhdim. Kjo bëhet kështu që stërvitja vjetore e ekipit të ndërtohet me kohë mbi bazën e kalendarit.
2. Ka patur ndonjë rast që një ekip ka ndryshuar zonën e veprimtarisë, sikundër edhe ndonjë rast të llojit kur dy ekipe këmbenin zonat midis tyre.

Viti 1992

Në muajin shkurt të vitit 1992 në vendin tonë erdhën dy alpinistë italianë. Ata u ftuan nga Komiteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve të vendit tonë. Për të pritur të ftuarit u cakrtuan Kozma Grillo dhe Vladimir Gjonaj (sekretar i Federatës për kohën). Italianët, napolitanë, ishin:

Xhuzepe Falvela, President i Komisionit Regjional të Kampanjës për Tutelën Malore; arkitekt 61 vjeçar, alpinist prej shumë vitesh, anëtar i klubit Alpin të Kampanjës.

Manlio Monriko, avokat 83 vjeçar, alpinist i njohur dhe shumë i dashuruar pas malit.

Miqtë, të shoqëruar, vizituan Razmën, Bogën duke udhëtuar nga Okoli tek mulliri, dhe kaluan natën tek familja e Rrok Lleshit. Më pas ata, gjithnjë të shoqëruar, vizituan Shqipërinë jugore.

Pas shtatë muajsh këta dy alpinistë erdhën me 22 napolitanë dhe ndoqën itinerarin: Durrës – Tiranë – Krujë – Shkodër – Bogë – Theth – Valbonë – Bajram Curri – Lushnjë – Sarandë – Himarë – Durrës.

Më pas, në vitin 1993, Kozma Grillo, në të njëjtin itinerar, drejtoi edhe alpinistët e Udines dhe të Bolonjës. Ndër ngjitjet shkëmbore që ata realizuan veçojmë atë në majën e Harapit, direkt nga Rrethi i Vishnjës si dhe disa ngjitje në brëndësi të kanionit të Gjipesë.

Një mbyllje e trishtë

Sa më poshtë janë marrë nga botimi “ALPINIZMI YNË (1936-1992) me autor Kozma Grillo, Tiranë 2009

..... Më 1990 u dha orientimi që kryetari I federatës së alpinizmit nuk do të jëtë më onorifik. Atë vit më zgjedhën mua. Sipas orientimit të dhënë, në majin e vitit 1994 u bënë zgjedhjet e reja. Çuditërisht veçmeje dhe sekretarit Agim Tabakju, kishin ardhur 5 vetë, të gjithë trajnerë. Më kujtohen: Sh.T., Z. K., M, L. M., R.L dhe një tjetër. Mbajta raportin, që përsa I takon veprimtarive ishte I mjerueshëm. Pa tjetër që fola edhe për vajtjet në Rumani, ardhjen e alpinistëve italianë, që po përktheja librin autobiografik të Mesnerit, etj. E kuptova që më ndiqnin pa interes. Diskutime nuk pati. Sipas rendit të ditës kaluam në zgjedhjet. Mga pesë që ishim tre propozuan: Sh T tha emrin e një biznesmeni të qytetit të tij që do të ndihmonte shumë financiarisht alpinizmin, ndërsa M.L. propozoi një alpinist (Z.J.) që punonte në doganën e Rinasit. Pas votimit të fshehtë rezultoi se të gjithë ne I kishim dhënë votat për doganierin, ndërsa biznesmeni I atij qyteti verilindor nuk kishte marrë asnjë votë, as nga ai që e propozoi. Siç e shihni, pa u vendosur tamam ekonomia e tregut, ne me intuidë e kishim kuptuar që doganierët do të pasuroheshin.... E mira e asaj mbledhje ishte se nuk vazhdoi as 20 minuta.

(Ironik Autori. Mlllef, them unë, sepse Autori e përjetoi për më shumë se 20 vjet alpinizmin doganierian. ab)

SHTESA

Disa mendime e shënime personale për argëtimet në natyrë në vitet si më sipër

Edhe në vendin tonë, sikundër në vendet e tjera të Evropës, turizmi malor (beshkataria – ab) duke synuar male gjithnjë e më të larta, dhe itinerarë gjithnjë e më të vështirë në rrugën drejt majave, lindi alpinizmin. Sot turizmi malor është bërë një sport masiv duke sjellë kështu dy vlera që lidhen fort me njëra tjetrën. E para, i mësuan shoqërisë njerëzore se ngjitja e malit është një argëtim i pasur me soditje, i shëndetshëm për lëvizjet që kërkon, si dhe për faktin se është njëherësh i gërshetuar edhe me vlera kulturore. Së dyti, u krijoi mundësinë banorëve të zonave malore të rrisin të ardhurat e tyre duke i shërbyer kësaj “industrie”, të re turistike dhe të panjohur më parë. Sot në vendin tonë kjo “industri” ka mundësuar zbutjen e shpopullimit të maleve.

Alpinizmi është sport shumë më i kufizuar në pjesëmarrës, sepse kërkon njerëz të përkushtuar për stërvitje. Nëse do të kërkojmë një pikë ndarje të beshkatariës (ai lloj turizmi malor që përfundon me ngjitjen e një maje mali) nga alpinizmi, duhet t’i referohemi shkollës sonë të klasifikimit të itinerarëve të ngjitjes. Shkolla jonë merr parasysh gjashtë shkallë vështirësie të itinerarit që ndërmerret për të arritur majën e një mali. Dy shkallët e para të vështirësisë së ngjitjes nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve teknike (karabina, plenga, etj) të domosdoshme për të organizuar sigurimin e vetes dhe sigurimin e shokut. Një gjë e tillë nevojitet për itinerarët e kategorisë së tretë të vështirësisë e lart (si edhe teknika të sigurimit, vetësigurimit, etj). Pikërisht këtu bëhet ndaja apo dallimi midis beshkatarit dhe alpinistit. Thënë ndryshe: ata që i ngjiten një maje mali sipas një itinerari të kategorisë së parë ose të dytë të vështirësisë, i ngjiten malit si beshkatarë. Ata që arrijnë majën e një mali sipas një itinerari të shkallës së tretë të vështirësisë (ose të katërt, ose të pestë ose të gjashtë) themi se i ngjiten malit si alpinistë. Dhe për të bërë një gjë të tillë alpinistit i duhen pajime të veçanta si dhe stërvitje të organizuar.

Beshkataria dhe alpinizmi janë argëtime, sporte, jo garuese. Komisioni Teknik (funksional deri në fillim të vitit 1991), organ këshillues për Kryesinë e Federatës së Alpinizmit, nuk ka patur vendime për sportistin/alpinistin më të mirë, apo ekipin më të mirë. Ka pas përcaktime të llojit “U dallua në këtë veprimtari alpinisti Filan Filani”, apo “u dallua në këtë veprimtari, apo gjatë këtij viti, ekipi i Klubit Sportiv Alpin Alpini”. Kjo për dy arsye: a) alpinizmi nuk është sport garues; b) **nuk ka patur kritere vlerësimi të llojit garues**. Por ka patur vlerësime apo komente përshkruese për një veprimtari apo itinerar të caktuar ngjitje drejt majës së një mali. Këto fakte nuk pengonin alpinistët që të shpreheshin për alpinistin më të mirë apo ekipin më të mirë, sipas rasteve, në opinionet e tyre personale që janë edhe subjektive.

Në organet e shtypit mund të gjenden edhe terma të vlerësimit si në sportet garuese, por kjo ka qenë një reklamë e kohës së partisë sepse në çdo fushë shtypi duhet të raportonte arritje dhe vetëm arritje nën udhëheqjen e PPSH.

Para L2B shoqëritë sportive për argëtime në natyrë, që u krijuan, ishin mbi baza vullnetare. Ato mbështeteshin financiarisht nëpërmjet një pagese nga anëtarët e saj (kuotë vjetore) si dhe nga individë me gjëndje më të mirë ekonomike. Pra të rinjtë, turista apo alpinista, argëtoheshin kryesisht me shpenzimet e tyre. Këto shoqëri sportive nuk kishin një organizim të centralizuar, nuk kishin një federatë apo shoqatë qendrore që të koordinonte veprimtaritë.

Shkollat, sidomos ato të arsimit të mesëm, ishin bërthama të përhapjes së llojeve të ndryshme të sporteve nëpërmjet veprimtarive që zhvillonin. Pati prej tyre që krijuan Trupa gjurmuesash.

Këto veprimtari pasqyroheshin edhe në mediat e kohës, gazeta dhe revista, si qëndrore ashtu edhe lokale. Këto të fundit nuk kam patur mundësi që t'i shfrytëzoj. Po ashtu veprimtaritë pasqyroheshin edhe në gazetat e shkollave, si p.sh Shkolla Teknike e Tiranës (Gazeta Laboremos), Shkolla Normale e Elbasanit (Gazeta Normalisti), etj.

Rol të veçantë në përhapjen e turizmit malor si dhe alpinizmit luajti lëvizja Gjurmusia Shqiptare, emërtesë kjo që përshtati për vendin tonë kuptimin e lëvizjes skautiste. Gjurmusia kishte një organizim të shkëlqyer, ishte e njohur që në fillim të viteve 20 nga qeveria jonë si dhe nga organizata botërore e skautizmit, si dhe botonte dy numura reviste (Gjurmusia Shqiptare) në vit. Pati fatin e keq, ngaqë një urdhër absurd (për mua – ab) i Mbretit Zog, largoi pjesën më të madhe të intelektualëve (ata që kishin detyra shtetërore dhe ushtarakët) të saj nga veprimtaritë.

Gjatë L2B veprimtaritë në natyrë pësuan rënie, por nuk u fikën. Madje, dalje të thjeshta në natyrë u shfrytëzuan për të ndërgjegjësuar rininë në luftën kundër pushtuesve. Në këtë periudhë, gjatë pushtimit Italian, u krijuan organizime me të rinjtë të ngjashme me Gjurmusinë, por në modelin Italian të skautizmit (Balilat). Kjo gjë u bë që ideologjia fashiste të përcillej, aq sa mundej, tek rinia shqiptare edhe nëpërmjet daljeve në natyrë. Nuk kam mundur të gjej material për balilat, por kam pas mësuar se alpinisti Eqerem Rreso i Gjirokastrës, i cili ngizi dhe ngriti ekipin e alpinistave Luftëtari i Gjirokastrës, ka qënë një Balilas.

Pas L2B kjo lëvizje për veprimtari në natyrë, shkoi në zero. Politika e partisë në pushtet i trajtoi veprimtaritë argëtuese të daljeve në natyrë edhe si kënaqësi të shtresave të pasura. Me sy tjetër u panë sportet e tjera, sidomos lojrat me top, të cilat janë edhe argëtim për sportdashësit që i ndjekin ato edhe për publikun që i ndjek ato në shkallare stadjumes. Por ishin mësuesit e edukimit fizik, më propagandues sportesh për këtë periudhë të pasluftës, nëpër shkolla që “lëvizën” spotret nëpërmjet programeve të edukimit fizik.

Në vitin 1949 gjenden dokumenta për rifillimin e veprimtarive në natyrë. Partia në pushtet, një nga një, filloi të nxisë spotret (fillimisht lojrat me top) dhe mori autorësinë e fillimit të sporteve nga e para (nga niveli zero). Kur unë u njohta me sportin e alpinizmit mësova se “alpinizmi është sport i viteve të Partisë”. Përfshirja ime në këtë sport bëri që të mësoj (pas vitit 1978) se ky sport nuk kishte për ditëlindje ditëlindjen e Partisë. Ka materiale për këtë që flasin më shumë nga sa kam sjellë në këto faqe dhe një historian i mirëfilltë që di të gërmojë nëpër biblioteka dhe Arkivin Shtetëror një ditë do të nxjerë në dritë, më shumë nga sa janë këtu, veprimtari turistike dhe alpinistike të para L2B.

Shkolla verore e alpinizmit në fshatin Theth, korrik 1956, me pjesëmarrës që e dashuronin sportin e alpinizmit, mundësoi jo vetëm njohjen e programuar të njohurive alpinistike, por u bë edhe një model dobibprurës për organizimin e shkollave të tjera, verore dhe dimërore, që mundësuan përhapjen dhe zhvillimin e alpinizmit në rininë tonë.



Ky pllakat edhe sot (11.11.2025) gjëndet në ish godinën e shkollës në Theth, pranë vendit ku ishte vendosur kampi i shkollës së alpinizmit. Megjithse pllakati u rinovua më 2016, ende egzistonte mentaliteti i dhumshëm që “alpinizmi është sport i viteve të partisë”.

Propaganda për të përhapur turizmin dhe alpinizmin u fuqizua pas mesit të viteve 60-të, por edhe më tej, në mënyrë të përsëritur. Synohej që çdo qytet të kishte ekip alpinistash. Dhe në një mënyrë apo një tjetër nga çdo qytet erdhën të rinj për të mësuar elementë teknikë të sportit të alpinizmit, por në disa prej tyre nuk ngizi ky sport.

Shtypi është një mundësi që na ndihmon për të mësuar rreth interesimit dhe zhvillimit të sportit. Nga një studim i bërë për numurin e artikujve në Gazetën Sporti Popullor midis viteve 1963 deri 1975 kemi këtë grafik të shpeshtësisë së shkrimeve sipas viteve:



Shohim që periudha me propagandën më të dendur për sportin e alpinizmit është nga viti 1964 (vit kur u krijua SHTASH) deri në vitin 1969 (vit kur kaloi me detyrë tjetër sekretari i shoqatës, Muharrem Sinoimeri)

Sinoimeri Muharem



Muharem Sinoimeri, ka lindur më 16-Mars-1931, në Gjirokastrë. Në moshën 14 vjeçare u shpërngul në Tiranë për të vazhduar studimet. Që nga kjo kohë ai jetoi për më shumë se 62 vite në Tiranë, duke u bërë kështu një “tiron” i vjetër. Muharemi mbaroi shkollën e mesme të Teknikumit të Fizkulturës "Vojo Kushi" në vitin 1951 dhe më pas përfundoi Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës në vitin 1961. Punoi fillimisht si mësues i edukimit fizik në Politeknikumin "7 Nëntori" në vitet (1958-1961), ku u dallua për mësimdhënien dhe për ngritjen e bazës materiale të lëndës së edukimit fizik. Por, veprimtaria e tij lidhet ngushtë me sportin ku ka shkëlqyer sidomos në drejtimin organizativ.

Punoi në degët e sporteve të volejbollit, gjimnastikës dhe notit në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës. Në vitin 1964 u krijua Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit, ku Muharemi u emërua sekretar i saj. Më pas, kësaj shoqate ju shtuan edhe sporti i çiklizmit si dhe ai i skive dhe u emërtua Federatë për këto sporte. U shqua në këtë detyrë për të planifikuar dhe organizuar punën, për sigurimin e bazës materiale të nevojshme për këto sporte; kontriboi në organizimin e seminareve kualifikuese për trajnerët e ekipeve të formuara si dhe në propagandimin e këtyre sporteve gjatë viteve 1964 – 1970.

Muharem Sinoimeri, pasi u lirua nga detyra e sekretarit të Federatës Alpinizëm Çiklizëm dhe Ski ka bërë punë të lavdëruar si shef i organizimit të kulturës fizike e sporteve, si sekretar i komitetit të BFSSH-së si dhe si sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar.

Vlerat organizative dhe përvojën e tij të pasur, ai e tregoi sidomos gjatë viteve (1974-1984) ku për 11 vite rresht drejtoi Klubin Sportiv "17 Nëntori" (sot KS "Tirana"), me detyrën e vështirë të kryetarit të institucionit (shef-it të klubit). Ky klub, ndryshe nga të gjithë klubet e tjerë sportivë në Shqipëri, ishte më masivi në atë kohë sepse në të përfshiheshin shumë ekipe sportive nga të gjitha moshat, si për femra edhe për meshkuj, por që në atë kohë u dallua dhe për numrin më të madh të titujve “kampion kombëtar” të fituar. Nga ky klub sportiv dolën shumë sportistë që bënë emër në këtë klub dhe në ekipet kombëtare. Me këto tregues, Muharremi ndjeu edhe kënaqësinë e meritave të padiskutueshme të tij.

Në kohën që Muharem Sinoimeri drejtonte Klubin Sportiv "17 Nëntori" u organizua aktiviteti më masiv dhe më i rëndësishëm kombëtar në Tiranë, Spartakiada e parë Kombëtare. Ky klub fitoi spartakiadën si dhe edhe më pas fitoi shumë kampionate kombëtare dhe kupa të Republikës për sporte të ndryshme, por edhe gara të veçanta për raste festash. Për herë të parë, ky klub u nderua me Urdhërin "Naim Frashëri" të

klasit të II. Sportistët, trajnerët, specialistët, punonjësit e tjerë dhe opinioni sportdashës i Tiranës ruajnë kujtime për punën e nderhme, serioze dhe profesionale të Muharemit. Duke kapërcyer mjaft pengesa të kohës, ai është treguar konsequent për mbrojtjen e ngjyrave të klubit dhe të interesave të veçanta të çdo sportisti.

Karakterin e tij ai e tregoi edhe kur u emërua drejtor i Shkollës së mesme sportive "Loro Boriçi" të Tiranës (1984-1991), shkollë ku ai mbylli edhe karrierën e tij të punës. Për meritat e tij, është dekoruar me medaljen “10 korriku” dhe me Urdhërin "Naim Frashëri" të klasit III dhe të II.

PËRKUSHTIME

Në fjalorin e gjuhës shqipe, i punuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (botimet TOENA 2002) nuk egziston fjala **dedikim**. (kjo fjalë është përdorur nga FSHALTM si dhe ndonjë shoqatë për të nderuar alpinistë të caktuar).

Në fjalorin e Arion Hysenbegas-it (fjalor i barbarizmave perëndimore në Gjuhën Shqipe dhe i fjalëve përgjegjëse shqipe) fjala latine Dedikim = kushtim; përkushtim.

Në fjalorin Latinisht-Shqip me autorë Henrik Lacaj dhe Filip Fishta; Dedicare = kushtoj.

Bajram Curri

Hajdar Halit Hasa

Alpinist i viteve 60-të, u bë pishtar i këtij sporti në Malësinë e Gjakovës. Ai vazhdoi pjesëmarrjen në veprimtari kombëtarëe alpinistike, me raste edhe i vetëm, deri në krijimin e ekipit të mirëfilltë Valbona, por edhe në vitet në vazhdim. Ishte trajneri i parë i një ekipi alpinistësh në qytetin Bajram Curri.

Berati

Petra Profi Kule

Alpinist i viteve 50-të e më tej. Krijoi dhe bëri të qëndrueshëm ekipin e alpinistëve Tomori i Beratit të cilin e drejtoi për shumë vite. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj, në drejtimin e veprimtarive alpinistike në shkallë kombëtare si dhe në masivizimin e ngjitjeve malore në rininë dhe klasën puntore të Beratit. Mori pjesë me sukses në veprimtaritë ndërkombëtare të kohës.

Dinamo

Z. Ali Sulejman Ago

Nga të parët alpinistë të përgatitur në shkollën e alpinizmit për brezin e ri të viteve 50 dhe 60 nga Luigj Shala. Ishte një nga ata alpinistët e kësaj shkolle që bënë të mundur krijimin e ekipeve alpinistike të qytetit të Tiranës me pjesëmarrjen dhe drejtimin e tyre.

Elbasani

Grigor Perikliu

Alpinist i viteve 50-të e më tej. Pishtar i sportit të alpinizmit në qytetin e Elbasanit. Dha ndihmesë për ta bërë të qëndrueshëm ekipin e alpinistëve Labinoti i Elbasanit si trajner për disa vite i këtij ekipi. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj si dhe në drejtimin e veprimtarive alpinistike në shkallë kombëtare.

Agim Rakip Kajanaku

Alpinist i viteve 60-të e më tej. Krijoi dhe bëri të qëndrueshëm ekipin e alpinistëve Labinoti i Elbasanit si

trajner i këtij ekipi. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj si dhe në drejtimin e veprimtarive alpinistike në shkallë kombëtare.

Fieri

Z. Aleksandër Stavro Bojaxhi

Alpinist i viteve 60-të e më tej. Krijoi dhe bëri të qëndrueshëm ekipin e alpinistëve Apollonia e Fierit. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj, në drejtimin e veprimtarive alpinistike në shkallë kombëtare si dhe në masivizimin e ngjitjeve malore me rininë shkollore. Kontriboi në seminarët kombëtare për kualifikimin e trajnerëve të ekipeve alpinistike si dhe me botime të literaturës alpinistike.

Gjirokastra

Eqerem Reso

U njoh me sportin e ngjitjeve malore në rininë e tij të herëshme, në kohën kur Shqipëria ishte nën sundimin Italian. Krijoi dhe drejtoi ekipin e alpinistëve Luftëtari i Gjirokastrës dhe bëri të mundur që ky ekip të forcohet e të zhvillohet.

Korça

Koço Kristaq Qafëzezi

Alpinist i viteve 50-të. U bë pishtar i përhapjes së sportit të alpinizmit në qytetin e Korçës. Pjesëmarrës në veprimtari ndërkombëtare të zhvilluara në malin Kaukaz si dhe në Alpet tonaa. U bë model frymëzimi për alpinistët e rinj të qytetit të tij. Mori pjesë me sukses në veprimtaritë ndërkombëtare të kohës.

Kruja

Xhemal Teta

Alpinist i nderuar në radhët e rinisë Krutane. Ishte profesori i fizikës që me punën e tij i dhuroi qytetit të tij ekipin e alpinistëve. Ai e bëri ekipin e alpinistëve Kastrioti i Krujës ekip të qëndrueshëm dhe e vuri në rrugën e forcimit.

Kukësi

Berzat Mane

Alpinist i nderuar në radhët e rinisë Kuksiane. Me përkushtimin e tij i dhuroi qytetit të tij ekipin e alpinistëve. Ishte Berzati ai që e bëri ekipin e alpinistëve Përparimi i Kuksit një ekip të qëndrueshëm dhe e vuri në rrugën e forcimit.

Partizani

Z. Qazim Enver Liço

Nga të parët alpinistë të përgatitur në shkollën e alpinizmit për brezin e ri të viteve 50 dhe 60 nga Luigj Shala. Ishte një nga ata alpinistët e kësaj shkolle që bënë të mundur krijimin e ekipeve alpinistike të qytetit të Tiranës me pjesëmarrjen dhe drejtimin e tyre.

Peshkopia

Taxhedin Shehu

Alpinist i viteve 50-të e më tej. Pishtar i sportit të alpinizmit në qytetin e Peshkopisë. Dha ndihmesë për ta bërë të qëndrueshëm ekipin e alpinistëve Korabi i Peshkopisë si dhe trajner për shumë vite i këtij ekipi. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj si dhe në drejtimin e veprimtarive në shkallë kombëtare. Dha ndihmesë në seminarët kombëtare për kualifikimin e trajnerëve të ekipeve alpinistike.

Përmeti

Ylli Fuat Mullarai

Alpinist i viteve 60-të, u bë pishtar i këtij sporti në qytetin e Përmetit. Ai vazhdoi pjesëmarrjen në veprimtari kombëtare alpinistike, me raste edhe i vetëm, deri në krijimin e ekipit të mirëfilltë të alpinistëve 24 Maji i Përmetit. I qëndroi gjithnjë alpinistëve të këtij ekipi si trajner dhe udhëheqës nëpër veprimtaritë kombëtare. Ishte trajneri i parë i një ekipi alpinistësh në këtë qytet dhe mbeti trajner deri në vitin 1992.

Puka

Z. Gëzim Abdulla Laçi

U njoh me sportin e alpinizmit në mesin e viteve 70-të në Tiranë dhe u bë pishtar i këtij sporti në Pukën malore. Krijoi ekipin e alpinistëve në qytetin e tij të lindjes, Tërbuni i Pukës, ekip të cilin e drejtoi gjatë një dhjetvjeçari dhe e bëri atë një ekip të qëndrueshëm. Studenti i Universitetit të Tiranës

Andon Ilia Tapia

Alpinist i viteve 50-të e më tej. Si pedagog i edukimit fizik në Universitetin e Tiranës ndikoi që ekipi Studenti i Universitetit të Tiranës, ekipi i parë i sportit të alpinizmit në vendin tonë, të bëhet i qëndrueshëm dhe bërthama e lëvizjes alpinistike për shumë vite. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj, përfshirë krijimin e kuadrove alpinistë të Universitetit tonë. Drejtoi veprimtari në shkallë kombëtare dhe u shqua si trajner me alpinistë të rinj. Kontriboi në seminarët kombëtare për kualifikimin e trajnerëve të ekipeve alpinistike. Ishte sekretari më njohës i këtij sporti që njohu Federatën e Alpinizmit. Mori pjesë me sukses në veprimtaritë ndërkombëtare të kohës.

Vasil Stambuli

Alpinist i viteve 50-të e më tej. Dha ndihmesë që të bëhet i qëndrueshëm ekipi i parë i alpinistëve në vendin tonë, ekipin Studenti i Universitetit Shtetëror të Tiranës. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj, përfshirë krijimin e kuadrove alpinistë në ushtrinë tonë. Drejtoi veprimtari në shkallë kombëtare si dhe krijoi dhe bëri të qëndrueshëm ekipin e alpinistëve Partizani. Kontriboi në seminarët kombëtare për kualifikimin e trajnerëve të ekipeve alpinistike.

Kozma Foto Grillo

Alpinist i viteve 50-të e më tej. Bëri të qëndrueshëm ekipin e parë të alpinistëve në vendin tonë, Studenti i Universitetit Shtetëror të Tiranës. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e

alpinistëve të rinj, në drejtimin e veprimtarive në shkallë kombëtare si dhe në rikrijimin e ekipit të alpinistëve Dajti të Rrethit të Tiranës. Kontriboi në seminarët kombëtare për kualifikimin e trajnerëve të ekipeve alpinistike dhe dha ndihmesë të madhe në propagandimin, nëpërmjet shtypit, të sportit të alpinizmit si dhe në botimin e literaturës alpinistike. Mori pjesë me sukses në veprimtaritë ndërkombëtare të kohës.

Znj. Tefta Nastas Zguro

Alpiniste e viteve 50-të, kohë kur ishte studente dhe më tej. Bëri të qëndrueshëm ekipin e parë të alpinistëve në vendin tonë, Studenti i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Me aftësi e shpirt të lartë sportiv u shqua në lëvizjen alpinistike dhe meritoi të nderohej si Mbretëreshë e Maleve. Gjithnjë e kujtuar dhe nderuar në lëvizjen alpinistike të vendit tonë si një yll për ta synuar për vlerat e saj sportive. Mori pjesë me sukses në veprimtaritë ndërkombëtare të kohës.

Shkodra

Z. Agim Ali Haxhia

Alpinist i viteve 50-të, u bë pishtar i këtij sporti në qytetin e Shkodrës. Ai vazhdoi pjesëmarrjen në veprimtari kombëtarë alpinistike, me raste edhe i vetëm, deri në krijimin e ekipit të mirëfilltë Vllaznia e Shkodrës, por edhe në vitet në vazhdim duke qenë traneri i parë i këtij ekipi.

Z. Hasan Osman Temali

Alpinisti Shkodran i viteve 60-të e më tej, që duke qenë trajner i ekipit të alpinistëve Vllaznia gjatë viteve 70-të e bëri këtë ekip të plotësuar dhe të qëndrueshëm. Ndihmoi anëtarët e ekipit që të rriten në kategori sportive duke e futur ekipin Vllaznia në grupin e ekipeve të konsoliduara.

Gjon Simoni

Alpinist i viteve 50-të. Përfaqësues i qytetit të Shkodrës ndër vite në sportin e alpinizmit. Gjatë kohës që punoi si instruktor i sporteve pranë Klubit Sportiv Vllaznia ishte shumë aktiv dhe dashamirës për të përshtatur për fjetje dhe transport fluksin e alpinistëve që niseshin nga Shkodra për në Alpe, si dhe në kthimin e tyre nga veprimtaritë alpinistike. Mirënjohje për dashmirësinë e tij ndaj alpinistëve!
Tepelena

Z. Rahit Zenel Hila

Mësuesi i shkollës në fshatin Progonat që me gjithë shpirt ju përkushtua sportit të alpinizmit. Krijoi ekip alpinistësh në fshatin e tij malor, ekip i cili përfaqësoi ndër vite me dinjitet Klubin Sportiv Minatori i Tepelenës. Ishte i vetmi sportist në Shqipëri që krijoi dhe drejtoi ekip sportiv në një fshat dhe përfaqësoi një klub sportiv në veprimtari kombëtare. Mirënjohje Rahit Hilës!
Tirana

Z. Astrit Omeri

Nga të parët alpinistë të përgatitur në shkollën e alpinizmit për brezin e ri të viteve 50 dhe 60 nga Luigj Shala. Ishte një nga ata alpinistët e kësaj shkolle që bënë të mundur krijimin e ekipeve alpinistike të qytetit të Tiranës me pjesëmarrjen dhe drejtimin e tyre.

Vlora

Vangjel Kozma Ristani

Alpinist i viteve 50-të e më tej. Pishtar i sportit të alpinizmit në qytetin e Vlorës. Dha ndihmesë për ta bërë të qëndrueshëm ekipin e alpinistëve Flamurtari i Vlorës si dhe trajner për disa vite i këtij ekipi. U shqua si drejtues në disa programe për certifikimin e alpinistëve të rinj si dhe në drejtimin e veprimtarive alpinistike në shkallë kombëtare.

Shënime:

Kam marrë parasysh, në paragrafët sa më sipër, alpinistë që bënë majë në sportin e alpinizmit të pas L2B. Ka prej tyre që u lidhën me malin që në rifillim të ngjitjeve malore pas L2B duke filluar nga viti 1949.

I kam vendosur sa më sipër përpara se të harrohen.

Nuk kam përdorur fjalën ZBOR, fjalë që për brezin tim domethënë = një kurs, një shkollë dy javore për të marrë njohuri teknike, etj lidhur me sportin e alpinizmit. Këtë fjalë disa herë më është dashur t'ja spjegoj brezit të sotëm. Do jetë e pakuptueshme në brezat e mëvonëshëm. Andaj kam përdorur togë-fjalëshin: programe për certifikimin e alpinistëve të rinj.

Sa më sipër janë ndihmesa ime. Mos i shikoni si përfundimtare. Ndryshoni/plotësoni ato që kam shkruar pa humbur thelbin e tyre.

Emrat si më sipër pa gjurmën Z përpara janë ish alpinistë të ndarë nga jeta.

Kozmai, Vasili, Andoni, Aleksandri, Tefta janë shënuar tek klubet/qytetet ku kanë marrë kategoritë ose titujt sportive dhe jo në klubet ku e kanë mbyllur karrierën e tyre sportive.

Disa alpinistë kanë edhe atësinë në emrin e tyre. Të tjerëve nuk ua kam gjetur atësinë.

Këto Përkushtime ju përcollën Presidentit të Federatës me e malin si më poshtë:

----- Forwarded Message -----

From: Aleksander Bojaxhi <zotieduk@yahoo.com>

To: artur guni <arturguni2005@yahoo.it>

Sent: Ëdnesday, November 15, 2023 at 04:51:20 PM GMT+1

Subject: Materiale Veteranesh

Jane te bashkelidhur.

AB

Shënim 1: paragrafi në krye të këtij materiali u shkrua për të skjaruar faktin që fjala DEDIKIM nuk egziston në fjalorët e konsultuar të gjuhës shqipe. Kjo fjalë ishte përdorur në pak raste në certifikata mirënjohje për alpinistë.

Shënim 2: materiali si më sipër ju dërgua me e-mail Presidentit të FSHALTM meqë e kërkoi. Mirëpo ai ndërroi mëndje dhe në takimin e organizuar nga Federata Shqiptare e Alpinizmit në Llogora në dt 27 Nëntor 2023, Presidenti nuk e mori parasysh.

Shënim:

Kam marrë parasysh, në paragrafët sa më sipër, alpinistë që bënë majë në sportin e alpinizmit të pas L2B. Ka prej tyre që u lidhën me malin që në rifillim të ngjitjeve malore duke filluar nga viti 1949.

I kam vendosur sa më sipër përpara se të harrohen plotësisht nga brezat e rinj.

Nuk kam përdorur fjalën ZBOR që për brezin tim d.m.th = një kurs, një shkollë dy javore për të marrë njohuri teknike lidhur me sportin e alpinizmit. Këtë fjalë disa herë më është dashur t'ja spjegoj brezit të sotëm. Do jetë e pakuptueshme në brezat e mëvonëshëm. Andaj kam përdorur togë-fjalëshin: programe për certifikimin e alpinistëve të rinj.

Sa më sipër janë ndihmesa ime. Mos i shikoni si përfundimtare. Ndryshoni/plotësoni ato që kam shkruar pa humbur thelbin e tyre.

Emrat pa gërmën **Z** përpara janë ish alpinistë të ndarë nga jeta.

Kozmai, Vasili, Andoni, Aleksandri, Tefta janë shënuar tek klubet/qytetet ku kanë pas marrë nderimet ose titujt sportivë dhe jo në klubet ku e kanë mbyllur karrierën e tyre sportive.

Disa alpinistë kanë edhe atësinë në emrin e tyre. Të tjerëve nuk ua kam.

Ky material u përgatit me porosi nga Presidenti i FSHALTM z. Artur Guni

Shënim i datës 15 Nëntor 2023

Aleksandër Bojaxhi

Komente për banorët e Alpeve Shiptare

..... Para fiseve printe bajraktari i cili nuk kishte të drejtën e kurrnji auktoriteti “primus inter pares”

Mbledhje e fisit veç vendoste. Bajraktari, që shpesh herë edhe ma i vorfni i katundit, veç lajmonte popullin për mbledhje e printe në çdo rasë. E populli vetë kishte fjalën e sejcili kishte të drejtën e lirin e mendimit e të bisedës.

Baldaci, njoftës i thellë i fiseve shqiptare shkroi në veprën e vet të pa mortëshme “L’Albania” kte: Alpet shqiptare inkuadruan fiset, psikologjia e të cilave ende i shmanget pjesës më të madhe të hulumtimit evropian, dhe të vetë shqiptarit jo-vendas, Duke qenë mezi në gjendje të depërtonte në karakteristikat e përgjithshme. Ky është me të vërtetë rajoni i lirisë dhe gjakut: Dashuria dhe vdekja. Për këtë arsye, fshatrat nuk grumbullohen kurrë, secila familje duhet të sigurojë, pavarësisht nga tjetra, për çdo nevojë, duke filluar nga ajo e mbrojtjes personale.

(Le Alpi Albanesi inquadrono le tribù le cui psicologia sfugge ancora nella sua massima parte all’ indagine Europea, e dello stesso Albanese non indigeno, potendosene appena penetrare i caratteri generali. quella e veramente la regione della libertà e del sangue: Amore e morte. Per questo i villaggi non sono mai agglomerate, devendo ciascuno famiglia provvedere, indipendentemente dall’ altra, a qualsiasi bisogno, cominciando da quello della difesa personale.)

Fuqia e trdicionit nder ta asht e çuditshme.

Trashigimi asht i shejtë. Vetë zgjidhin çashtjet e përditshme në bazë të kanunit tradicional që ç’do banues duhet ta dijë për mendësh e të jetë si avokat në të.

Prej tyne ende nderohen me veneracion të metat e zakonet pagane e s’guxon kush me vu dorë në ta. Mbi malet e tyne ende sot sillen zanat e shtoj-zo-vallet, e kangët e këcimet e tyne i ndijnë edhe i shofin me shiset e fantazis.

Prej një luginës në tjetren përpjeten vargjet e nalta që vshtirsojnë komunikacionin. Vargjet e gjata me maje të shumta e të kapuna dor për dorë, formojnë krahët e hyllit të vigantë.

Të gjithë këto krahë, dalin prej grupit ma të naltë të Majës së Liqenit e zhvillohen tue msye periferin e më një tue ulë kryet si në shej nderimi për qandrën e tyne që i lidhë dhe i ven në përpjekje.

Vetëm maja e Liqenit e ruen ket pamje të madhnueshme; ajo asht zemra e ktij sistemit: asht çelsi që i lidhë e i bashkon armonisht me formue me ta një pamje krejtë madhshtore e të rrall; asht neni që i ven në perpjekje vargjet me formue me ta një njisi të vertme.

RROK ZOJZI

Maja e Liqenit, thirret prej sllavëve, që d.m.th. liqèé, pse në kambët e saj gjindet një liqè.

Rrok Zojzi (1910-1995). Etnolog, professor. Lindi në Shkodër. u mor për shumë kohë me alpinizëm dhe propagandoi vlerat turistike të Shqipërisë së Veriut.

ARTIKULL

Revista Pedagogjike
Shkrim i datës 06.08.1925

Skautizma në botë dhe organizimi i sajë në Shqipni

Gjurmusia dhe roli i sajë në botë

Nuk mjafton qi njeriu të jetëm vetëm i ditun. Janë shumë njerëz, qi me anën e ditunis së tyne mërijnë me bamë shumë punë, por mbasi u mungon shëndeti, s'janë kursesi të zotët as për vehte as për punë. "Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë", thojshin Latinët e vjetër.

Prandaj, pra, në ket shekull, ku ka hy qytetnimi, shtetet e përparueme i kanë dhanë ransi të madhe gjurmsis dhe për ket qëllim shpenzojnë sasina të mdha të hollash.

Prindët e pasun, ashtu edhe të vobekët, në vendet e përparueme, u urdhnojnë fmijvet të vet, qi të marrin pjesë në gjurmsi; kështu në botë, mbas statistikave, gjenden ma se tre milion gjurmues. Dihet masandaj se në sportizëm gjurmsija.....

Përhapja e gjurmsis në Shqipni

Po dhe në Shqipni shofim me gëzim se gjurmsia dita me ditë asht tue përparuem. Në vitin 1920, kur Qeveria e jonë me një dekret ligjë e pranoj zyrtarisht organizimin e e gjurmuesvet shqiptarë, Këshilli ministruer dha një ndihmë prej 3 mijë fr. arë për organizimin e kësaj shoqërije me kaq randësi. Po n'at vjet vetëm qyteti i Tiranës me inisjativën e zonjushës Ëilliams, mundi me organizuem një trup gjurmues të parën herë në institutin e strehës Vorfnore të Tiranës.

Në të dytin vjet, Ministria e Arsimit tue çmuem randësin e kësaj shoqnije, lypi prej Qeveris s'Anglis një organizator, pa kaluem shumë kohë, organizoi kursin s.m. (mjeshtër gjurmuesvet), qi përbahej prej mësuesvet t'ardhun nga 2 prej çdo prefekturë. Po mjerisht ky qëllim nuk u krye e kështu 10 mij fr. arë që shpenzoi Ministria e Arsimit shkuen kot, se shumica nga ata mësues, mbas ktij kursi, nuk u interesuen aspsk për të përhapunit neper vende te ndryshme të Shqipnisë gjurmuesinë, e cila për një kohë të shkurtën, porsi një flagë bari, mbaroi tue lanë një shkendi vetëm në Tiranë ku dhe sot gjinden ma se 150 gjurmues.

Po prap ksivjet Ministria e Arsimit tue marrë parasyshtë se ishte i domosdoshëm riorganizimi i gjurmësis në Shqipni, shtoj në buxhetin e vet një shumë të hollash, për t'i a mërrijtë këtij qëllimi.

Dobinat qi ka sjellë ky organizim në vendin t'onë moralisht dhe fizikisht na japin shpresa të mëdha për kohën e ardhëshme të brezit të ri. Kjo dobi kuptohet prej udhtimesh, qi kan ba nëpër qytete e katunde, tue studjuem afisht vendet me randësi e tue u praktikuem për të qeverisunit nëpër male e pyje vehten e tyne simbas mirërritjes ma të re.

Nga kjo pra, merret vesht kjartas se qëllimi kryesor i gjurmësis asht t'i japin njerëzis djem të mbaruenm nga çdo pikpamje: Të ndershtëm, të bindshëm në ligjë, atdhetarë të flakët dhe të zotët për t'i shërbyem vehtës e njerzis në çdo rasë.

Shënim

Shih librin "Boiskautizma" mbas gjeneralit Englez Baden Pauelet prej S Papahristos; Drejt të Përgj. t'Arsimit.

Tiranë, 6-VIII-925

SH T O J C A II

Materialet sa më poshtë janë hedhur për të sendërzuar anë të veçanta të historisë së ngjitjeve malore si dhe daljeve në natyrë në vendin tonë.

Viti 1934

Ngjitja e parë në majën e Madhe (Valbonë) është bërë më 6 qershor 1934 nga një ekspeditë Austriako-Gjermane (gjatë viteve 30-të kanë ardhur në malet tona disa ekspedita të tilla).

Anëtarët e grupit ishin:

Prof. Dr Alfred Martin

Dr Bernhard Baner

Dr. Ludëig Obersteiner

Robert Huttig

Raimund Udy

Grupi realizoi traversën e plotë nga perëndimi në lindje.

N'atë kohë maja kishte emërtesën maja e Brijasit. Grupi e vlerësoi lartësinë e majës 2.620m

Burimi: komunikimi me Bullgarin Ivan Dinkob

Viti 1940

Botim nga: Dott. Luigi Santurini; Spedizione alpinistica italiana nelle Alpi Albanesi 1940 – XIX

Prime ascensioni compiute dalla spedizione Italiana Alpi Albanesi – 1940-XIX

Materiali si më poshtë na mëson për majat e ngjitura nga alpinistët Italianë nëpër vendin tonë. Lartësitë janë sipas shënimeve të tyre. Ata kanë patur edhe shoqërues vendas kudo nga kanë shkuar. Në këtë botim janë përmendur vetëm dy shoqërues në sejcilin prej dy rasteve të ndryshme.

- | | | |
|--------------|--|--------------------------------|
| 1) 1 qershor | Maja e Thatë, 2540 m, faqe jugore, | Ghiglione – Mazzoni – Zambelli |
| Filaferro | | |
| 2) 2 qershor | Monte Forato, 2397 m (Albania sett) kreshta Ovest, | Mazzoni – Filaferro |
| 3) 2 qershor | Maja Çaradakut 2200 m kreshta Ovest | Mazzoni – Filaferro |
| 4) 3 qershor | Dhamb i Dragonit 1844 m kreshta Ovest | Mazzoni – Filaferro |
| 5) 3 qershor | Maja Çardakut 2250 m tymtaja Nord-Ovest | Ghiglione-Dall' Amri-Zambelli |
| 6) 4 qershor | Maja Rabës 2233 m faqja veri-lindore | Mazzoni – Filaferro |
| 7) 5 qershor | Campanile Nord Maja Rabës, kreshta jug | Mazzoni-Santurini-Filaferro |

8) 5 qershor	Maja Çardakut 2250 m direct faqja	Ghiglione-Dall'Armi-Martina
9) 10 qershor	Maja Tomori, pika jug 2396 m	Ghiglione Monaco del Conve
10) 11 qershor	Maja Tomori, majat ndërmjetëse 2236, 2280, 2248 m, shpati lindor	Ghiglione
11) 22 qershor	Mali i Dejës, grupi qëndror 2250 m faqe JL	Ghiglione – Saturini
12) 24 qershor	Mali i Dejës 2250 m, faqe lindore	Ghiglione – Saturini
13) 25 qershor	Mali i Dejës grupi verior 2256 m tymtaja e madhe shpati JL	Ghiglione – Saturini
14) 3 korrik	Maja Ostrovica 2352 m, faqja JL, Faqekuqi	Ghiglione
15) 4 korrik	Maja Ostrovica 2290 m, faqja J, Fagiskuqit	Ghiglione
16) 7 korrik	Maja Nëmërçka, pika Papingut 2496 m, faqja JL	Ghiglione – Capi
17) 10 korrik	Maja Nëmërçka traversa nëpër kreshtë VJ dhe JV, 2450, 2496, 2195 m.	Mazzoni – Santurini
18) 11 korrik	Maja veriore 2450 m kanali verior	Mazzoni – Santurini
19) 12 korrik	maja Nëmërçka, pika veriore 2450 m kanali perëndimor, kreshta veriore	Mazzoni – Santurini
20) 13 korrik	Maja Nëmërçka, maja Stiatanikut, pjesa veriore. Maja Papingu kreshta V	Mazzoni – Santurini
21) 14 korrik	Maja Nëmërçka, maja Papingut 2496 m maja lindore.	Mazzoni – Santurini
22) 17 Korrik	Maja Harapit, 2216 m, këndi VL	Ghiglione – Chiocchetti
23) 17 korrik	Maja Shabores, 2104 m, ana VP	Ghiglione – Chiocchetti
24) 19 korrik	Maja Alis, 2466 m, faqe VL	Ghiglione – Chiocchetti
25) 20 korrik	Maja Shnikut 2554 m, faqja Lindoe	Ghiglione - Chiocchetti
26) 21 korrik	Maja Visensit 2517 m, tymyaja veriore	Ghiglione - Chiocchetti
27) 22 korrik	Maja Shtogut, 2246 m, faqe JL	Ghiglione - Chiocchetti
28) 22 korrik	Maja Kolaet 2198 m, faqe perëndimore	Ghiglione
29) 23 korrik	Maja e Kolaet 2333, faqe V kulmi perëndim	Ghiglione – Rasul
30) 25 korrik	Maja e Madhe 2012 m, faqe L masivi lindor	Ghiglione – Ganie
31) 30 korrik	Maja Tomori, pika V, 2417 m	Ghiglione – Santurini
32) 31 korrik	Maja Abas Ali, 2396 m,	Mazzoni – Santurini
33) 9 gusht	Maja Biga Gimaj 2232 m, faqja V	Mazzoni
34) 10 gusht	Maja Drënit, 2160m, faqja P	Mazzoni
35) 11 gusht	Maja Ershelit 2067 m, nga Qafa Ndermaje	Mazzoni
36) 12 gusht	Maja Troshanit, faqja perëndimore	Mazzoni
37) 13 gusht	Maja Boga nga Qafa Buni Thores	Mazzoni
38) 14 gusht	Maja Zorgit, 1664 m, VP	Mazzoni
39) 14 gusht	Maja Korabit, 2718 m, faqja J masivi në mes	Ghiglione – De Martini
40) 15 gusht	Maja Radomirës, 2751 m, faqe J masivi L	Ghiglione – De Martini
41) 15 gusht	Maja Zagora, faqja VL.	Mazzoni
42) 19 gusht	Maja Alis, 2436 m, faqja L.	Mazzoni – Santurini
43) 20 gusht	Maja Lagojvet, 2466 m, faqe P.	Mazzoni – Santurini

44) 24 gusht	Maja Bus Devrit, 1565 m, faqe JL.	Ghiglione
45) 30 gusht	Maja Tomorit maja veriore, 2417 m, faqe P.	Ghiglione – Mazzoni
46) 8 shtator	Mali Dajtit, 1611 m, nga Shkalla Tujanit.	Mazzoni – Saturini
47) 10 shtator	Maja Shkëlzeni, 2047 m, kreshta veriore	Ghiglione – Xhema
48) 12 shtator	Maja Hekurave, maja Maroces, 2561 m, faqja Veri Lindore	Ghiglione
49) 13 shtator	Maja Roshit, 2565 m, faqja JP.	Ghiglione – Gjok Nika
50) 14 shtator	Maja Gavnik, 2530 m, faqja VP.	Ghiglione
51) 16 shtator	Maja Lagojve 2466 m, faqe JL.	Ghiglione
52) 25 shtator	Maja Çardak i Shalës, 2104 m, faqe P.	Ghiglione-Mazzoni-Saturini
53) 26 shtator	Maja e Valit, 2257 m, kulmi verior	Mazzoni
54) 27 shtator	Maja Rogamit 2472 m, faqe JP	Ghiglione-Mazzoni-Saturini

KUJDES: nga ky informacion mësojmë se tashmë në vitin 1040 në malin e Dajtit kemi një majë mali me emrin e diktatorit pushtues:

8 shtator ngjitje në malin e Dakjtit, 1611 m, për la skala Shkalla Tujanit alla Cima Dux, e ngjitur nga Mazzoni e Saturini.....

Viti 1975

Letra e Ylli Mullarait drejtuar Aleksandër Bojaxhiut

Kjo letër është shkruar bazuar në kërkesën që i bëra (sikundër edhe shumë të tjerëve) lidhur me aksidentet në mal. Me të dhënat e mbledhura, në një seminar, referova në temën “Disa të papëlqyera në sportin e Alpinizmit”. Paraparkisht unë i dija përciptas sa më poshtë.

..... përse më shkruaje i kuptova dhe do të mundohem të të sqaroj duke ta shoqëruar edhe me fotografi pjesën e rrëzimit në shkëmbin e qytetit nga ana e poshtëme, tek fiku.

Ish ditë e shtunë mbasdite, rreth orës 16. Kisha bërë dy zборе: një dimëror në Razëm dhe një veror në Theth i vetmuar në vitin 1968. Po mundohesha që shokët (Nexhipin, Yllin dhe dy të tjerë, t’i përgatisja me ato që dija vetë; nga pasioni. Këtë ditë vendosa të bëj ngjitje ke guri. E fillova ngjitjen duke patur me vete këtë material teknik: 3 gozhdë të shkurtëra, 6 çelsa, 4 litar personal, 3 litar kolektiv.

Rrëzimi i parë

Ngjitjen e fillova vetëm duke më siguruar Nexhipi deri tek gropa e madhe. Pata siguri tek Nexhipi, por pastaj nuk po ma mbante. Zbrita prap poshtë dhe dërgova Yllin lart. Më hodhi litarin tjetër kolektiv të lidhur tek ato pemët. Atëherë vendosa të bëj plus sigurimit të Nexhipit edhe me nyjen e teleferikut që ndërtova në gjoks. Duke u ngjitur dhe duke e shtyrë nyjen e teleferikut lart. Mbas dy orësh munda të arrij në momentin më kritik. Edhe 10 cm doja që të kapesha në pjesën përfundimtare. Në këtë kohë çunat shikonin kurse unë nuk po gjeja asnjë pikë mbështetje. Këmba e majtë që ish mbështetur në një 2 cm vend filloi të më dridhej. Në kohën kur vendosa të ngjitem nëpërjet litarit dorën e djathtë e shkëputa nga pika e kapjes dhe e gjithë pesha i mbeti këmbës që ishte në falimentim. Në këtë moment të papritur unë ndodhem krejt mbi litarin e dytë ku kisha fiksuar teleferikun e gjoksit. Nga hutimi dorën e shtrengoja shumë fort në nyjen e teleferikut dhe nga pesha trupore fillova të rrëshqas poshtë duke i marrë me vete

edhe ato tre gozhdë dhe duke rrëshqitur pas shkëmbit. Kur u afrova tek fiku dora më dogji shumë. U kujtova për nyjen e teleferikut dhe menjëherë e hoqa dorën prej saj. Nyja veproi në çast dhe unë mbeta i varur dhe i pa dëmtuar, qoftë edhe nga ndonjë çjerreje (përveç dorës që mu dogj nga litari).

Evitimi i këtij rrëzimi do të ishte vetëm hedhja mbi litar që të vepronte nyja e teleferikut dhe mbasandaj ngjitja do të bëje me anën e tërheqjes së litarit.

Rrëzimi i dytë

Herën e dytë u rrëzova për gabim Teknik. Ti e di që aty duhet pa tjetër “kalaja”, pyka, ose shkalla. Unë nuk i kisha këto. Por përsëri vendosa: o ta ngjis o s’ka. Por prap dështova për 2 cm, sepse nuk më arrinin plotësisht majat e gishtave. Prap si herën e parë. Por këtë rradhë ju hodha nyjes teleferik. Pastaj më tërhoqën çunat. Për të evituar rrëzimin duhen: gozhdët duhen me të çara si klapa, pyka të holla dhe shkallë me 3-4 kate (shkallare-ab). Sigurimi duhet të jetë i nivelit më të lartë.

Po atë vit vajta në mal (Dhëmbel-ab) me grupin që kisha formuar. Midis tyre mora edhe disa të tjerë. Mora dy litarë kolektivë dhe një kazëm të vetme. Ngjitjen e bëmë me sukses. Në kthim e kishim më vështirë sepse bora ishte krejt e ngrirë dhe mbi të kish rënë rreth 10-15 cm borë e re krejt e butë dhe rrëshqitjet ishin të evitueshme. 200 metra nën majën e Dhëmbelit është një pllajë rreth 7-800 metra. Në kohën kur arritëm aty një nga çunat filloi të ankohej se rrëshqiste shumë. U detyrova t’i jap kazmën dhe t’i tregoj se si ta përdorë, ndërkohë i them se në rast se unë rrëshqas, ti nuk do vish mbas meje. Mbas pak unë rrëshqita rreth 2-300 metra; pa rrezik. Çunin sikur nuk e porosita, ai mu dha menjëherë mbrapa duke e mbajtur kazmën në dorë me majë drejt përpra. Në kohën që unë po shkundja borën pa u ngritur nga vendi, u mahnita kur më doli maja kazmës tek veshi. U revoltova dhe e qëllova çunin. Në fakt faji ishte i imi. Se litarët i kisha, por mungonte eksperiencia.

Sandri, me ngjitjet që bëra në Paping kam kaluar fare mirë. Kam studiuar me imtësi disa itinerarë verorë dhe dimërorë të cilat të nxjerrin fare shkurt nga fshati Kaluth në majën e Papingut.....

Të lutem interesoju që ajo puntoria të më shkruaj për çantat dhe dyshekët alpinë. Ju a kam bërë edhe zyrtarisht kërkesën, por nuk kam marrë përgjigje.

Përmet 13.10 1975

Viti 1984

Mbi organizimin e punës me ekipet e alpinizmit të sistemit zinxhir në Klubin Sportiv 17 Nëntori i Tiranës

Referim nga Aleksandër Bojaxhi në seminarin e organizuar në KS 17 Nëntori në vjeshtën e vitit 1984

Puna me sistem ekipesh në klubin tonë, për sportin e alpinizmit, ka filluar në vitin 1977. Fillimisht me ekipin e të rinjve. Ky ekip mori formë të rregullt në vitin 1978. Pas dy vitesh u konsolidua edhe ekipi i alpinistëve pionerë.

Me ngritjen e tre ekipeve u krijua një situatë e favorëshme për ngritjen e nivelit të punës dhe rritjen e cilësisë sportive. Për ne tre trajnerët lindën detyra për të konsoliduar punën brënda ekipeve, për harmonizimin e veprimeve për kalimet e sportistëve nga njëri ekip në tjetrin, rrugët e seleksionimit dhe zgjedhjes së elementit, përpilimin e programeve stërvitore për çdo ekip, të tilla që të kishte kalim gradual njohurish nga një ekip në tjetrin, si dhe krijimin e një mjedisi stërvitor të përshtatshëm

Për zgjidhjen e këtyre problemeve krijuam këshillin e trajnerëve me pesë vetë (tre ne, Mario i Pallatit të Pioneerëve dhe Dashi i Shtëpia e Pioneerit – Kombinat). Si këshill vendosëm disa parime që kanë të bëjnë me problemet kryesore, të cilat askush nga ne nuk i shkel. Kjo ka ndihmuar mjaft për të patur harmoni në punë midis trajnerëve.

Veprimet tona me elementin

- Elementi në ekipet e pionerëve vilet nga shkollat dhe sheshet e lodrave. Gjatë vrojtimeve fëmijët nuk e dinë se ne interesohemi për ta, që të mos u krijojmë shqetësime emocionale. Fillimisht merren ata që kanë tregues fizikë të mirë. Tërhiqen në klub pasi merret mendimi i tyre, i mësuesve të edukimit fizik, i shkollës dhe i prindërve. Tërhiqen më shumë nga sa na duhen.
- Rreth një muaj këta stërviten. Pas kësaj mbajmë aq sa na duhen nga ky kontigjent për të zëvendësuar ata që kalojnë në ekipin e të rinjve plus një deri tre të tjerë që zëvendësojnë atë pjesë të ekipit të cilët stërvitja dhe jeta kolektive që kanë kaluar në ekip flasin se nuk kanë të dhëna për tu bërë alpinistë të ardhshëm.
- Për elementin në ekipin e pionerëve nga ne kërkohen plotësimi sa më i mirë i këtyre cilësive:
 1. Proporcionalitet në zhvillimin trupor dhe në gjymtyrë.
 2. Qëndrueshmëri të kënaqëshme.
 3. Lëvizshmëri në kyçe.
 4. Dëshirë apo kënaqësi për alpinizmin.
 5. Përparim të mirë në mësim.
 6. Sjellje e disiplinë të kënaqëshme.
 7. Aproximim për tu marrë me alpinizëm nga shkolla e familja.

Këto janë parimet e para për të filluar sportin e alpinizmit. Pas kësaj këta kalojnë tek mjeku dhe pajisen me bazë materiale minimale për stërvitje.

- Elementi në ekipin e të rinjve vilet nga ekipet e pionerëve (tre ekipe: Klub 1, shtëpi pioneri 2). Në rast se vjelja rezulton e pamjaftueshme, elementi është vjelë edhe nga vitet e para të shkollave të mesme. Kur pretendentët janë të shumtë, bëhet përzgjedhja e tyre, në procesin stërvitor gjatë muajit shtator (ka patur raste deri në fund të muajit tetor).
- Për elementin në ekipin e të rinjve veç kërkesave që janë në ekipin e pionerëve janë edhe këto kërkesa suplementare: 1. Minimizimin e ngarkesës emocionale nga efekti i thellësisë. 2. Rrjedhshmëri në veprimet teknike. 3. Cilësi intelektuale për specifikat e alpinizmit, 4. Stabilitet në perspektivën e jetës me sportin (këtu konsiderohet familja).
- Elementi i ekipit të të rinjve që do të kalojnë në ekipin e të rriturve caktohet nga trajneri i të rinjve në marrëveshje me trajnerin e të rriturve. Rekomandohen 1 a 2 më të mirët, perspektiva e tyre si alpinistë të jetë më e mirë se niveli mesatar i alpinistëve të rritur. Kur i riu arrin moshën 17 vjeç aktivizohet në 1 ose 2 veprimtari (në çdo sezon) të njëpasnjëshme për ngjitje të kategorive të ulta. Për këta, pas çdo veprimtarie merret edhe mendimi i ekipit mbi sjelljen, disiplinën, frymën e kolektivitetit, cilësitë teknike e fizike në aktivitet, etj. Ky diskutim gatuhet edhe me mendimin tim dhe të alpinistëve të “vjetër” të ekipit që shoqërojnë veprimtarinë, dhe po të jetë se ekipi e aprovon futjen e alpinistit në ekip, atëherë kjo bëhet fakt i kryer. Alpinisti më i ri në ekip zëvendëson alpinistin më të vetër ose atë me rrezultate më të ulta në veprimtaritë e fundit, apo të parregulltin në stërvitje.

- Mbi bazën e këtyre kriterëve dhe ecurie në sot nga 11 alpinistë që ka ekipi, 9 prej tyre janë të ardhur nga ekipi i të rinjve të klubit tonë dhe kanë moshën nga 18 deri në 23 vjeç dhe kategori sportive si më poshtë: 2 kandidat për Mjeshtër Sporti; 3 me kategori të parë sportive; 3 me kat të dytë sportive; 1 me kategori të tretë sportive
- Kjo moshë e re në ekip faktikisht është mund i një pune të studjuar disa vjeçare, me synime të qarta prej vitesh që na jep kënaqësi sot për faktin se në veprimtaritë ekipi paraqitet dëshirëplotë për ngjitje, stërvitje e pjesëmarrje. Ky ekip është edhe rezultat i një pune të studjuar e të kujdesëshme në veprimtari për efektivitet e rendiment në ngjitje nga ana time si trajner si dhe e alpinistëve më të vjetër në ekip si: Marjo Trinkera, Dashamir Fejzo, Romeo Manxhari si dhe trajnerëve Andon Tapia (ekipi të rinjve) e Shefki Juma (ekipi Pionerve).
- Fryma e kujdesit të trajnerëve dhe alpinistëve për të patur një ekip të mirë të fortë teknikisht është kuptuar drejt edhe nga alpinistët më të rinj të ekipit dhe sot edhe tek ata ndjehet kujdesi për të ruajtur me dinjitet ngjyrat e ekipit në veçanti dhe të një sporti të shëndetëshëm në përgjithësi.
- Si këshill trajnerësh kemi vendosur që në ekipin e të rinjve të preferohen së pari alpinistët nga ekipi e pionerëve të klubit, kurse në ekipin e të rriturve vetëm ata që vinë nga ekipi i të rinjve të klubit tonë. Këtë e kemi bërë jo vetën sepse sot ekipet ndihmojnë njëri tjetrin me elementë, por edhe që elementi i një ekipi më poshtë (në moshë) të shohë perspektivën të hapur për të kaluar në ekipin më lart.
- Sot sistemi ynë i ekipeve ndihmon plotësisht njëri tjetri dhe në dimrin e vitit 1985 në ekipin e të rriturve do jetë një anëtar, do jetë i pari, që vjen nga ekipi i pionerëve të Klubit tonë.
- Në punën tonë ka ndikuar pozitivisht edhe përpilimi i planeve stërvitore të tilla që ngritja e nivelit teorik e tekniko- taktik të fillojë dhe të mbarojë në kufij të caktuar, në mënyrë që kalimi i alpinistit të fillojë e të mbarojë në kufij të caktuar në mënyrë që kalimi i alpinistit nga njëri ekip në tjetrin të mos sjellë shqetësime për punë të diferencuar. Po kështu ne kemi punuar edhe për tregues të veçantë të stërvitjes. Në normat fizike kemi patur parasysh “kërkesat bazë” të kontrollit të gatishmërisë fizike të përpunuar nga qendra e Mjeksisë Sportive Shqiptare duke marrë parasysh vlerësimet në tabelë me notën tetë e lart.
- Kemi vendosur norma teknike: pionerët të njohin të gjitha pajisjet (por jo specialet), të dinë tetë lidhje, të kacavaren mirë me 3 pika mbështetje dhe sigurim nga lart, të kenë njohuri mbi mënyrën e kacavarjes, të përdorin kazmën, të njihen dhe të veprojnë për kalimin e natës jashtë.
- Të rinjtë të njohin të gjitha pajimet (por jo përdorimin e atyre speciale), të dinë të gjitha lidhjet, të dinë të kacavaren mirë në të tre pozicionet në litar (ngjitje me treshe në një litar) pa sigurim nga lart, të kalojnë natën në borë, etj.
- Dhënia e literaturës turistike dhe alpinistike çdo alpinisti ka ndikuar pozitivisht (lexime individuale si dhe lexime letrare, i tregimeve, përktihimeve, informacioneve shkencore, ditarëve). Më plotësisht kjo ndjehet në ekipin e të rriturve.
- Si këshill trajnerësh mblidhemi hera herësh për të diskutuar për planet stërvitore para se t’i përfundojmë ato, mblidhemi për të diskutuar për mbarëvajtjen e elementit nëpër ekipe, ecurisë së stërvitjes si dhe për të konsoliduar normat teknike apo fizike të cilat besojmë se gjatë këtij viti do i fiksojmë përfundimisht mbi bazën e përvojës që kemi. (kur them mblidhemi kam parasysh faktin se i këmbejmë këto tema gjatë ose pas stërvitjes. Ne kemi të njëjtin mjedis të bollshëm për çveshje e veshje, si dhe stërvitor. Që të tre ekipet. Me raste për të gjitha problemet si më sipër mbajmë edhe dokumentacionin e analizave).

- Si grup trajnerësh pak kemi punuar për stërvitjet e hapura, për t'i patur ato si piknisje diskutimi rreth trajtimit metodik të stërvitjes.
- Kemi punuar mirë për të shfrytëzuar literaturë për ngritje ideo-profesionale. Për ngritjen ideoprofesionale jemi ndihmuar edhe nga seminarët dhe mbledhjet që ka organizuar klubi si dhe në materialet që kemi përkthyer vetë apo përgatitur vetë për sezonet shkencore.
- Në ekipet tona rëndësi i jepet forcimit të kolektivitetit në ekipet e pionerëve dhe të të rinjve. Për këtë kryesisht punohet në drejtim të ndjekjes së përparimit të tyre në mësim, sjelljes në familje, shkollë e jashtë sajë dhe sidomos mos braktisjes së shkollës (po braktisën shkollën nuk kanë vend në ekip).
- Me ekipin e të rriturve kujdesi veçohet në marrjen pjesë të ekipit në gëzimet dhe hidhërimet e sejcilit, apo edhe të alpinistëve të ekipeve të tjera sipas rastit, me vajtje kolektive në teatro, kinema, interesim për probleme në punë etj.
- Me forcë, sidomos me ekipin e të rriturve, insistohet për sjellje të kulturuar, për fjalor të zgjedhur në biseda, mjedise sociale e kudo, për vlerësim të mundit dhe punës në stërvitje e aktivitet të sejcilit, madje edhe të ekipeve të tjera, për komunikim e krijim lidhjesh edhe me alpinistë nga ekipet e tjera, për ndihmë në materiale e pajime teknike të ekipeve të tjera apo alpinistëve të veçantë. Me këto ne synojmë që të kemi ekip jo të veçuar nga sukseset dhe shqetësimet që ka lëvizja jonë alpinistike, që të mos arrijnë alpinistët tanë në vetëkënaqësi e tu duken atyre arritjet më të mira se të të tjerëve (jo gjithnjë).
- Për të patur kolektiv të shëndoshë, ne kolektivitetit i veçojmë vemendje edhe gjatë periudhës së veprimtarisë.
- Tek ne gjithnjë, me rradhë, caktohet një tërheqës i djetave dhe njëkohësisht arkëtar i ekipit. Ai bashkë me një alpinist të dytë bëhen ekonomatë, punë të cilën e kryejnë deri në fund të veprimtarisë. Ushqimi organizohet gjithnjë, dhe për çdo gjë kolektiv. (pasi mrren djetat, ekonomati i jep sejcilit pjesëmarrës në veprimtari, një sasi të caktuar lekës për "pare xhepi". Ne mbyllje të veprimtarisë ndahet barabar leku që ka mbetur). Për problemet e shërbimeve ditore në jetën kolektive në mal, marrin pjesë të gjithë, duke futur edhe trajnerin. Neglizhimin më të vogël në parimet e jetës kolektive në stërvitje dhe veprimtari kushdo e ka të qartë se ne e dënojmë rreptë (theksoj se dënimet/verejtje janë tepër të rralla).
- Në veprimtari dokumentimi i ngjitjes shoqërohet me vajtje në majë me stampë e pllakat (e vogla) të ekipit.
- Punë të gjatë dhe të vazhdueshme kemi bërë dhe bëjmë për të siguruar bazën maateriale-teknike për aktivitet.
 1. Së pari kemi ngulmuar të ruajmë e mirëmbajmë sa më gjatë materialet që kemi duke zbatuar me rigozitet normativat shtetërore për afatet e shfrytëzimit të tyre.
 2. Në zgjatjen e afateve për shfrytëzimin e bazës materiale ka ndikuar fakti që ekipi I çdo grupmoshe ka materialet e veta.
 3. Njëherësh ne çdo vit interesohemi për të furnizuar magazinën qendrore, ose për prodhimin e e atyre materialeve që pas 1 apo 2 vjetësh do të kemi nevojë.
 4. Lidhur me fondet që duhen për to nga ana e klubit kemi patur gjithnjë mbështetje. Këtë mbështetje e kemi siguruar sepse ne në asnjë rast, prej vitesh, nuk kemi lënë shteg të dyshojnë se ne abuzojmë me bazën materiale, apo e keqpërdorim atë. Në klubin tonë sportiv ne ndjejmë e shohim se kemi mbështetje kryesia dhe administrate e tij kujdesin; shohim që kanë mbështetje për sportin tonë.

5. Për sa u tregua më sipër, për mendimin tonë, janë probleme me rëndësi të veçantë mbasi, ndonëse nuk kanë të bëjnë fare direct me stërvitjen dhe aktivitetin, janë domosdoshmëri që sigurojnë mbarëvajtjen e tyre.

Për stërvitjen kemi siguruar mjedisin këtu përreth (në stadium, kodrat e liqenit) dhe në malin e Dajtit.

Këtu përreth për të tre ekipet sigurohen kushte të mira për përgatitjen teorike, fizike, fizike speciale dhe pjesërisht teknike. Për përgatitjen e plotë teknike shfrytëzohet mali i Dajtit.

- a. Në përgatitjen ideo-politike të tre ekipet ecin sipas planit të unifikuar stërvitor.
- b. Në përgatitjen teorike në teknikë, taktikë dhe organizim, punohet mbi bazën e temave të përgatitjes, sipas planit. Temat zhvillohen në dhomën tonë (klasa në dhomën veshje - çveshje) sipas planit stërvitor. Për pjesëm më të madhe të temave teorike kemi bazë materiale si dhe harta, busulla, skica, fotografi të zonave të Alpeve dhe kartelat me ngjitjet e realizuara për çdo alpinist.
- c. Mbi këtë bazë materiale dhoma jonë përdoret jo vetëm si dhomë për çveshje-veshje dhe materialit teknik të stërvitjes (baza materiale që përdoret për aktivitet mbahet në magazinën qendrore të Klubit dhe tërhiqet 7-10 ditë para nisjes për aktivitet) dhe si klasë mësimore.
- d. Në përgatitjen fizike ne kemi kushte të plota për ta kryer atë sipas kërkesave të programit unik të stërvitjes. Për këtë shfrytëzohet terreni natyror përreth si dhe ambientet stërvitore egzistuese (poshtë shkallëve të stadiumit ishte palestra). Po kështu shfrytëzohet edhe një minimum baze materiale që mbajmë në dhomën tonë.
- e. Në përgatitjen teknike, këtu rreth nesh shfrytëzojmë kushtet që kemi, duke aplikuar kacavarjet në mure, në të dala, në parete, pemë etj, si dhe ngjitje e zbritje me litar. Kurse përgatitjen fizike speciale e realizojmë plotësisht në mjedisin përreth.
- f. Plotësimet në përgatitjen teknike dhe taktike i kryejmë në poligonin shkëmbor në Dajt, si dhe gjatë ngjitjeve në majat e malit të Dajtit.
- g. Plogonin shkëmbor e kemi të piketuar (shënuar) për itenerarët që ngjiten; të llogaritur në metra sejcili itenerar dhe të vlerësuar në shkallë vështirësie çdo fragment. Kjo na krijon mundësi që në çdo stërvitje (kryhen ditore dy në muaj) sejcili të marrë ngarkesë (mbi bazë të programit për punës që merr sejcili në një fletushkë standarte apo formular) dhe llojshmëri relievi në procesin stërvitor.
- h. Edhe itenerarët e marshimeve për në majat e mali të Dajtit janë të skicuara dhe të llogaritura në km dhe shkallë vështirësie. Një gjë e tillë na jep avantazhe në trajnerëve për stërvitje në baza shkencore, mbasi e llogarisim ngarkesën në marshime në km/orë e në kacavarje në m/orë. (X këtu futet materiali).
- i. Në veprimtari ne kemi marrë pjesë duke zgjidhur me kohë problemet që kanë të bëjnë me meremetimet dhe plotësimet e bazës materiale, si dhe me kompletim edhe suplementar me ushqime.
- j. U kemi dalë përpara problemeve që lidhen me masat organizative nëpërmjet mobilizimit të të gjithë anëtarëve të ekipit. Për këtë dy ditët e fundit të stërvitjes nuk bëhet stërvitje dhe kjo është e pasqyruar edhe në programin stërvitor. (këtu të jepet lista orjentuese për gjithshka).
- k. Para nisjes në veprimtari me ekipin trajtohen dhe saktësohen edhe problemet e aspektit taktik për disa anë të veprimtarisë. Bie fjala për vendosjen bazë të litarëve të punës (dysheve), renditjen e ngjitjeve sipas ditëve të veprimtarisë, rradhën e iteneraarëve që do të ngjisim, etj. Për këto gjithnjë marrim parasysh edhe programin e veprimtarisë që përpilon Komisioni Teknik dhe e dërgon Federata, pa të cilin këto probleme taktike nuk mund të paravendosen.

- l. Në veprimtari, ne si trajnerë të tre ekipeve synojmë të marrim pjesë me çdo kusht, dhe njëkohësisht të kryejmë ato ngjitje që na e lejon përvoja (mosha). Në raste të tjera ne marrim pjesë në drejtimin e ngjitjes (këtu - tabelat). Në këtë mënyrë ne jemi më të afirmuar me rezultatet, aftësitë dhe cilësitë e çdo alpinisti. Synojmë që në veprimtari alpinistët të marrin ngarkesën maksimale fizike dhe tekniko-taktike dhe të jenë të gjallë në jetën kolektive, korrekt me higjenën sportive, etj.
- m. Gjatë aktivitetit çdo ditë, para mbrëmjes, analizojmë punën e bërë duke diskutuar çdo gjë që i vlen ngritjes së tyre teknike dhe kualifikimit (ngritjes në kategorit sportive).
- n. Në veprimtari synojmë që alpinistët të kryejnë punë të pastër me malin dhe shkëmbin, të jenë të sigurtë në ngjitje e në raportime dhe kemi arritur në bindjen se alpinistët tanë janë edukuar për të ushtruar alpinizëm të mirëfilltë. Pas përfundimit të veprimtarive zhvillohen analiza ku rihen problemet që na dalin për rritjen e cilësisë sportive.
- o. Sa herë na janë bërë ftesa, nga klubet e tjera, për veprimtari lokale u jemi përgjigjur bazuar në mundësitë financiare të Klubit tonë për të na mbështetur. Kështu kemi realizuar veprimtari me alpinistë të Vlorës, Kurujës, Dibrës, etj dhe këto kanë qenë me interes për alpinistat tanë.
- p. Edhe vetë organizojmë veprimtari, më të shpeshta me ekipin e pionerëve (me vetë fondet e tyre) të cilat kanë rritur interesin e tyre dhe dashurinë për malin e alpinizmin, si dhe forcojnë jetën kolektive (marsit dhe janarit).
- q. Prej vitesh alpinistët tanë i nënshtrohen rregullisht vizitës mjeksore në klub para çdo veprimtarie. Lidhjet me mjekun e klubit janë gjatë gjithë vitit (raste të traumave). Për të tre ekipet, çdo anëtar ka kartelë mjeksore në dhomën e mjekut, me matjet e kontrollet e kryera.
- r. Kemi aplikuar, me aq sa ka qenë e mundur, vajtje në zonën e veprimtarisë para se ajo të fillojë, për aklimatizim, duke shfrytëzuar ditët që na jepen për grumbullim para veprimtarisë. Kjo ka ndikuar për mirë si në drejtim të futjes në veprimtari që në ditën e sajë të parë ashtu edhe në rritjen e përvojës me malin. Për plotësimin me ushqime për këto ditë, shfrytëzojmë si kuotën prej 100 lekë ashtu dhe grumbullimin e ushqimeve të 2-3 rradhëve të fundit të trajtimit ushqimor (kush nuk e ka nuk paguan gjë sepse çdo gjë është kolektive).
- s. Sigurisht, ndjekja që i bëjmë ne si trajnerë punës tonë ka sjellë rezultate të mira. Këto ne i konsiderojmë si fillime të një pune shkencore me sistemin e ekipeve tona të cilat duke i zhvilluar e çuar më tej do e rrisin cilësinë në sportin tonë. Këtë material që u referuam ne e konsiderojmë si një fillesë të diskutimit për të cilin jemi mbledhur. Padyshim, duke diskutuar edhe trajnerët e ekipeve të tjera, reciprokisht të gjithë, do shtojmë përvojën e punës për të na ndihmuar në realizimin sa më mirë të detyrave që na ka shtruar Partia dhe Kongresi i saj i tetë.


Aleksandër Bojaxhi

Një orjentim partiak

Komisjoni Teknik i sportit të alpinizmit që në krijimin e tij ishte “truri” i Kryesisë së Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar (më vonë u quajt Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Çiklizmit). Në krijimin dhe mbledhjen e parë të këtij komisioni ishin: Muharem Sinoimeri, Myftar Marku, Agim Kajanaku, Aleksandër Bojaxhi dhe dy a tre të tjerë.

Pas kësaj mbledhje në komision, gjithnjë, ka qënë anëtar një o më shumë nga këta alpinistë: Minella Kapo, Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Petraq Kule, Aleksandër Bojaxhi, Taxhedin Shehu. Aleksandër Bojaxhi në periudhën 1976-1977, për rreth dy vjet, u përjashtua nga ky komision për arësye me “politikë në biografi”.

Që në fillim të viteve 80-të u pa qartë se cilësia në sportin e alpinizmit ishte rritur dhe erdhi një ditë që ky komision mendoi që struktura e organizimit të veprimtarive duhej të përmirësohej. Andaj u përgatit materiali që t’i referohej Kryesisë struktura e re. Materiali ishte në dy faqe të plota. Na u kthye, me një shënim në pjesën e pasme të faqes së dytë, ku shkruhej:



Fotokopje e shënimit se si duhej të “sheqerosej” kërkesa që të shkonte më lart për aprovim.

Ja se çfarë shkruhet në shënimin si më sipër:

Rritja e nivelit cilësor të alpinizmit ka ardhur si rezultat i kushteve të mrekullueshme që ka krijuar Partia dhe shteti ynë socialist si dhe puna e mirë dhe e vazhdueshme që kanë bërë dhe e bëjnë sportistët dhe trajnerët në procesin stërvitor. Këto rezultate janë arritur edhe në sajë të një drejtimi e organizimit më të mirë në hartimin e strukturës së aktiviteteve kombëtare.

Duke pasur parasysh detyrat e mëdha dhe të rëndësishme që i dalin sektorit të fiskulturës në tërësi si dhe sportit të alpinizmit në veçanti për të çuar më parë cilësinë e këtij sporti kemi menduar që që për vitin 1985 të jetë ky ndërtim i kalendarit të alpinizmit:

- 1 -
- 2 -
- 3 -
- 4 -
- 5 -

Më poshtë të shënohen dhe shpenzimet sa arrijnë ose uljen bëhen edhe arësytet pse duhen bërë.

Pas konsultimeve në Komisionin Teknik KG dhe AB u caktuan të përgatisin dhe dorëzojnë në federatë strukturën. Ja ajo:

FEDERATA E ALPINIZMIT DHE E ÇIKLIZMIT KOMISJONI TEKNIK I ALPINIZMIT

MBI STRUKTURËN E AKTIVITETEVE ALPINISTIKE

Ashtu si çdo lloj tjetër sporti, si rrjedhim i kushteve shumë të mira që ka krijuar shoqëria jonë socialiste, në alpinizëm janë shënuar një sërë arritjesh si në drejtim të masivizimit ashtu dhe të cilësisë. Në arritjen e këtyre rezultateve ka ndikuar pasioni i të rinjve tanë për të ushtruar këtë sport me karakter të theksuar ushtarak dhe përpjekjet e trajnerëve të ekipeve. Në këtë kuadër nuk mund të lëmë pa përmendur edhe strukturën e ndërtimit të këtij sporti. Kjo strukturë është e tillë:

1. Struktura e ekipeve:
 - a. Ekipet e pionerëve (mosha 10-14 vjeç), çdo rreth ka një ekip.
 - b. Ekipet e të rinjve (mosha 14-18 vjeç), çdo rreth ka një ekip.
 - c. Ekipet e të rriturve (mosha 18 vjeç e lart), çdo rreth (ose klub sportiv) ka një ekip.
2. Struktura e aktiviteteve kombëtare:
 - a. Ekipet e pionerëve nuk kanë asnjë aktivitet kombëtar.
 - b. Ekipet e të rinjve zhvillojnë dy aktivitete në vit (dimërore e vërore) nga tre ditë secili – gjithësej gjashtë ditë.
 - c. Ekipet e të rriturve zhvillojnë dy aktivitete brenda vitit (sezoni veror e dimëror) nga 10 ditë – gjithësej 20 ditë.

Qysh nga viti 1978 lëvizja alpinistike po zhvillohet në bazë të kësaj strukture, e cila ka ndikuar në përgatitjen e elementit të ri qysh në moshë të vogël. Kjo praktikë ka bërë që ekipet e të rriturve të pajisen me element të përgatitur fizikisht dhe në një farë shkalle edhe teknikisht.

Kongresi i 8-të i Partisë shtroi detyrën e rritjes cilësore të sportit tonë. Kjo detyrë qëndron edhe para sportit të alpinizmit. Realizimi i kësaj detyre kërkon, midis të tjerave, edhe studimin e strukturës egzistuese. Pa mohuar vlerat pozitive të strukturës së tanishme, nga studimi ynë rezulton se duhen bërë ndryshimet e nevojshme në këtë strukturë, në mënyrë që kjo t'i përgjigjet sa më mirë rritje cilësore të alpinizmit, të mënjanojë zbrazëtitë dhe mangësitë që janë vënë re brenda këtyre viteve.

Të metat kryesore të strukturës egzistuese konsistojnë në:

1. Numurin e vogël të ditëve që alpinisti shkon në mal; numuri i pakët i ditëve të aktivitetit zyrtar, dhe
2. Në mos organizimin në bazë shkencore të procesit stërvitor të ekipeve të të rinjve, ku aktivizohen të rinj me diferencë moshe deri 4 vjet, kur dihet zhvillimi i vrullshëm i njeriut në këtë periudhë të jetës.

Për rritjen cilësore të alpinizmit do të ndikojë fuqimisht edhe ndërtimi i strukturës së tij në këtë mënyrë:

1. Struktura e ekipeve
 - a- Ekipet e pionerëve (10 – 13 vjeç), 1 ekip për çdo rreth ose klub sportiv.
 - b- Ekipet e para të rinjve (14 e 15 vjeç), 1 ekip për çdo rreth ose klub sportiv.

- c- Ekipet e të rinjve (16, 17, 18 vjeç), 1 ekip për çdo rreth ose klub sportive.
- d- Ekipet e të rriturve (19 vjeç e lart) 1 ekip për çdo rreth ose klub sportive.
- 2. Struktura e aktiviteteve kombëtare
 - a- Ekipet e pionerëve të zhvillojnë brënda vitit një aktivitet 7 ditor.
 - b- Ekipet e para të rinjve 2 aktivitete nga 4 ditë; gjithsej 8 ditë.
 - c- Ekipet e të rinjve 2 aktivitete nga 5 ditë, gjithsej 10 ditë.
 - d- Ekipet e të rriturve brënda një viti:
 - a- Dy aktivitete nga 10 ditë = 20 ditë.
 - b- Dy aktivitete nga 3 ditë = 6 ditë

Gjithsej 26 ditë

- 3. Një herë në dy vjet të organizohet një aktivitet 2 ditor ku çdo klub do të përfaqësohet me 2 alpinistët më të mirë për të realizuar ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë.
- Në bazë të strukturës që argumentojmë shtohen shpenzimet me gjithsej rreth 100.000 lekë.

Miratimi i kësaj strukture diktohet nga këto argumenta:

- 1. Elementi përgatitet në vazhdimësi, duke filluar nga mosha e re.
- 2. Rritet numuri i ditëve të qëndrimit të alpinistëve në mal (ditët e aktivitetit zyrtar), që janë treguesit e nivelit cilësor të alpinizmit. Në këtë masë eliminohet në një farë shkalle e meta kryesore e lëvizjes sonë alpinistike, koha e pakët e alpinistëve në mal.
- 3. Krijohen mundësi për ndërtimin e procesit stërvitor në baza të vërteta shkencore, rritet shkalla e kualifikimit të alpinistëve brënda grup moshave, punohet më mirë me alpinistët e moshës së re.

Aplikimi i kësaj strukture lidhet drejtpërdrejt me:

- 1. Përmirësimin e programeve stërvitore egzistuese.
- 2. Rritjen e numurit të trajnerëve, që do drejtojnë ekipet.
- 3. Pasurimin e përsosjen e bazës materiale në procesin mësimor-stërvitor.
- 4. Kualifikimin e vazhdueshëm e sistematik të trajnerëve.
- 5. Nxjerrjen e një buletini dy herë në vit.
- 6. Organizimin e drejtimin më të mirë të aktiviteteve kombëtare.

Mësimet e partisë e të shokut Enver Hoxha, përvoja e grumbulluar në vendin tonë, dashuria e brezit të ri për alpinizmin, përbëjnë garancinë për rritjen cilësore të alpinizmit me aplikimin e kësaj strukture të re.

Kozma Grillo

Aleksandër Bojaxhi

Shënim: faktikisht gjatë viteve 80-të ekonomia jonë kombëtare filloi një rënie të pakthyeshme. Në fillim të viteve 80-të u fol për klasa sportive më fort se kurdoherë tjetër. Për trajnerët e alpinizmit në përgjithësi dhe për këto klasa në veçanti u botua dhe një tekst mësimor (Alpinizëm me autorë K. Grillo e A. Bojaxhi), por në fakt mjaft ide zhvillimi mbetën në letër.

Shënime për historikun e alpinizmit

Nga blloku im-ab

1956

Korrik; është ngjitur Jezera nga 18 pjesëmarrësit e shkollës verore të Thethit. Korrik 1956.

Nëntor

Nisen alpinistë për për në majën Jezercë. Mot i papërshtatëshëm. Merr pjesë edhe Sovjetiku Romanenko. Mj Sporti në alpinizëm. Ai njihej me Minella Kapon që në B.Sobjetik. Nuk u priu moti dhe meqë Romanenkos i mbaronte leja e qëndrimit (lidhej edhe me biletën e prërë të fluturimit me avjon për në Bashkimin Sovjetik), u kthyen.

Morrën pjesë: Andon Tapia, Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Minella Kapo, Romanenko.

.....
....

1959

Mars. Synohet ngjitja në Jezerë. Nga Shkodra janë 7 djem (ndër ta edhe Gjon Simoni e Vehbi Seiti) dhe tre vajza; plus Vasil Stambuli dhe 3 studenta me të. Pati divergjenca në grup gjatë ngjitjes ngaqë u lodhën vajzat. Vajtën deri tej Jezera e Vogël, dhe u kthyen.

1959

Veprimtari Ndërkombëtare (16-30 korrik)

Ekipi Çekosllovak (nga qyteti Brno)

5. Milan Lasak
6. Alica Losakova
7. Jozef Mazanrek
8. Anton Tapia shoqërues dhe anëtar nga ekipi Shqiptar në këtë veprimtari.

Ekipi Gjerman:

- | | |
|-------------------------|------------|
| 10. Dürichen Harry | 19.10.1910 |
| 11. Däveritz Karl | 27.09.1940 |
| 12. Grabs Christov | 25.06.1935 |
| 13. Gladum Alexander | 07.03.1937 |
| 14. Heineman Rolf | 09.01.1937 |
| 15. Lóbe Harald | 17/02.1937 |
| 16. Schmidt Ekehart | 18.10.1935 |
| 17. Schönberger Günther | 04.02.1936 |
| 18. Stengel Konrad | 16.08.1938 |

Ekipi Shqiptar

9. Minella Kapo
10. Vasil Stambuli
11. Vasil Vreto
12. Belul Hatibi
13. Tefta Zguro
14. Andon Tapia
15. Grigor Perikliu
16. Vangjel Melengu

Korrik 1959

Shkuan në Kaukaz, në Kampin alpin (dhe shkollë alpinizmi) Alibeg:

1. Luigj Shala
2. Petraq Kule
3. Kozma Grillo
4. Thoma Vasili
5. Koço Qafëzezi

Më pas më 1960

Shkoi në Çeki (Brno)

1. Andon Tapia

Shkuan në Gjermani

1. Minella Kapo
2. Tefta Zguro
3. Vasil Vreto

Nëntor 1959.

Synohet Jezerca nga një grup ku është drejtues Andon Tapia. Dështuan.

.....

1960

- Janar. Synohet Jezerca. Drejton ngjitjen Minella Kapo. Marrin pjesë 10-12 alpinistë. Nuk realizohet.
- Nga data 15 Nëntor deri në datën 15 dhjetor organizohet në Alpe një veprimtari gjatë të cilës u arrit të ngjiten 11 maja. Pjesëmarrës: Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Petraq Kule, Mustafa Selenica.

.....

1962

Tregon Mihal Bozdo. Mali Tomor. Dt 21 u nisëm tetë veta nga Tirana. Në Berat vizituam kështjellën.

Dt 22 shkuam në fshatin Tomor i Madh.

Dt 23 ora 04:00 u nisëm nga shtëpia e fshatarit, morrëm djathtas, shpella e zezë, shpella e kuqe, një shkëmb vertikal me ngjitje shumë të vështirë. Në orën 08:00 arritëm në një stan veror ku ngritëm çadrat. Bëmë zjarr.

Dt 24. Ora 09:00 udhëtim. Lamë sendet e tepërta dhe çadër. Ora 12 jemi në majën e pllajës. Bora e re 0.5 metra. Ora 12:30 nisemi e marrim majtas për në majë. Kalojmë honin dhe dalim matanë. Ecim traversë më pak se 1 km. Lamë çantat dhe u nisëm për në majë. Pas 200 m dolëm në kurriz/kreshtë dhe lëvizëm të siguruar me kazëm. Kur ngulje kazmën ajo dilte në anën tjetër të kurizit. Gjithsej 3 orë. Ora 16:30 ishim në majë. Qëndruam pak. Fotografuam. Nuk shkruajtëm emrat sepse i kishim duart të ngrira.

U lidhëm shpejt në një litar dhe zbritëm shpejt për rreth 2 km nga ana e Gramshit. Pastaj majtas lart për tek çantat. U ndamë në dy grupe. Tre veta u nisën majtas për të fiksuar/vendosur litarin, sepse në një vend duhej të ngjiteshim me sportive, të tjerët shkuan të marrin materialet. Kur arritëm në kuriz pamë poshtë një hije të zezë që lëvizi. Ishte ujku. (Mihali ishte tek treshja të cilëve ju shfaq ujku).

Kishte mjegull dhe ishte errësuar. Treshja krijoi një farë platforme dhe priste të sulmonte ujku. Ai nuk lëvizte. Për një moment menduan se është gur dhe nuk ja varën, por pritën shokët. Ata humbën gjurmët dhe udhëheqësi i grupit u vajti në ndihmë. Kjo ndihmë ndodhi sepse ishim të bindur se ajo gjë e zezë 30 m poshtë nesh ishte gur/shkëmb.

Kur arriti grupi i dytë njolla e zezë lëvizi. Të trembur mbërthyem kazmat. Pritëm rreth dy orë e pastaj u nisëm me kujdes e ngadalë. Kaluam 200 m dhe ujku na ndiqte. Filluam të ngjitemi vertikalisht. Edhe ai u ngjit, pastaj ndaloj dhe u zhduk njëherë e përgjithmonë. Me peripeci u ngjitëm në zonën midis dy greminave tek honi i pllajës. Për 30 minuta siguronim nga sipër, por nga ana e Beratit kishte filluar një tufan i tmershëm. Si duruam?!?! Ganiu thërriste: ore ecni se u hodha në greminë. Kur arritëm në brezin e gjërë ora ishte 20:00. Bora e mjegulla bëheshin një dhe nuk shikoje. Tentativat për të ecur ishin të kota. Atëhere ngulëm kazmën dhe zbritëm matanë kreshtës, anë ku nuk ndjehej tufani. Aty ngulëm dy kazma, lidhëm litarët dhe hapëm një gropë të madhe në borë.....

Veli Mullaraj, pedagog në fakultetin ekonomik në kohën e kësaj historie ishte një nga pjesëmarrësit në këtë ngjitje (Mihal Bozdo, Veli Mullaraj, Qazim Liço....), më ka thënë, kur e takova në korrik 2023, se “e gjithë ajo histori ishte alucianion që na u shkaktua nga lodhja”.

.....

Shkolla verore në Theth. 16-30 korrik 1956

Janë 17 vetë. Organizohet ekskursion një ditor: Kampi Theth – Shtegu Dhenve – Maja Kalasë – Qafa e Mark-Zagorës – Radohimë dhe kthim. U nisëm më 02:00 pas mesnate dhe në 04:30 pamë lindjen e diellit.

.....

Ndoshta në vitin **1958**; treguar ???

Dy ditë më parë u nisëm katër vetë: unë (??), Vasili, S. Cane dhe H. Brahimi si skuadër shpëtimi për të kërkuar grupin (që u vonua për kthim) të udhëhequr nga K. Grillo. U nisëm nga kampi e shkuam në Harap, në Rrethin e Vishjes. Ora 23:00. Thirrëm dhe asgjë. Arritëm në kamp ora dy pasmesnate.

Të nesërmen ora 11:00 arriti Kozmai e grupi i tij. Ishin për tu ngjitur në Jezerë dhe kishin kaluar nëpër itenerarin kurizor. Kishin edhe dy vajza: Prancera Çela dhe Bahrije Dulli.

.....

1963

Shkollë alpinizmi e organizuar nga Organizata e Bashkimeve Profesionale

Theth 16 – 30 korrik

Në mbarim të programit pjesëmarrësit fituan titullin “Kandidat Instruktur i Ri”

Pjesëmarrësit:

- | | |
|-------------------|--------------------------|
| 1. Ramazan Maçi | nga fabrika e qelqit |
| 2. Bahri Çiço | nga kombinati tekstileve |
| 3. Mihal Gjini | nga uzina Enver |
| 4. Fadil Bega | nga fabrika e këpucëve |
| 5. Shefqet Caslli | nga kombinati ushqimor |
| 6. Ferit Gjinia | nga Misto Mame |
| 7. Fatmir Pega | nga uzina Partizani |
| 8. Kristo Krisiko | nga uzina Porcelani |
| 9. Xhuli Pojani | nga N.I. Kimike |
| 10. Sinan Gorenca | nga Ofiçina Gjeologjike |
| 11. Servet Muka | nga N.Sh.O.A. |
| 12. Eftim Stavri | nga Kërraba |
| 13. Ramazon Tresa | nga Kamza |

Në shkollën e alpinizmit në Theth (16-30 Korrik) nga Tirana morrën pjesë:

- | | |
|------------------|----------------------------|
| 1. Mit'hat Fagu | nga Universiteti Tiranës |
| 2. Nadide Didazi | ng Fakulteti Mjeksisë |
| 3. Xhovan Kajana | “ “ |
| 4. Genc Kurti | “ “ |
| 5. Mihal Bozdo | nga Fakulteti Inxhinjerisë |
| 6. Spiro Cana | “ “ |

.....

1964

Shkollë alpinizmi në malin e Dajtit (16-29 janar 1964)

Shkollë alpinizmi ku pjesëmarrësit si më poshtë fituan titullin Kandidat Instruktur i Ri

- | | |
|------------------|-----------------------|
| 1. Zydi Mazreku | nga komb Josif Pashko |
| 2. Enver Krujani | nga Uzina Enver |
| 3. Nazmi Pullaja | nga Komb Misto Mame |
| 4. Servet Muka | nga N.Sh.O.A. |
| 5. Abdyl Shehu | nga Uzina Gjeologjike |
| 6. Ferit Xhulli | nga N.Sh.G. |

1964

Shkolla alpinizmit organizuar nga Bashkimet Profesionale

Theth 16-39 korrik 1964

Pjesëmarrës nga Tirana

- | | |
|----------------------|---|
| 1. Mit'hat Fagu | nga Universiteti |
| 2. Kristo Krisiko | nga Porcelani |
| 3. Agim Canaimeri | nga Josif Pashko |
| 4. Muhamet Karakashi | nga Klinika Dentare |
| 5. Vehip Dajaka | nga uzina Gjeollogjike |
| 6. Llazi Çela | nga Ndërmarrja e Ndërtimeve 21 Dhjetori |

1964

Ekspedita me 12 alpinistë për studimin e Alpeeve

Nga ditari i Mihal Bozdo (me profesion inxhinjer mekanik). Për veprimtarinë verore të vitit 1964 Mihal llogarit/nxjerr se: kemi udhëtuar 9 ditë; punuar/ngjitur gjashtë ditë; kemi pushuar katër ditë.

Këto ditë të llogaritura në orë pune: udhëtuan 50 orë nga të cilat 14 orë me kafshë barre. Kemi transportuar mesatarisht 30 kg sejcili dhe kështu kemi kryer një punë prej 8.5 ton/km.

Kemi përshkruar rreth 200 km rrugë dhe kemi bërë 38 itenerarë të ndryshëm. Nga këto 6 të kategorisë së parë, 11 të kategorisë së dytë, 8 të kategorisë së tretë, 10 të kategorisë së katërt, 3 të kaategorisë së pestë (kjo veprimtari kishte si synim të ngjitesh në itenerarë të ndryshëm për të përcaktuar zonat me vlerë alpinistike në Alpet tona).

Të dhëna lidhur me kategorizimet në sportin e Alpinizmit

Ligj Shala	kuadër i kategorisë së I-rë	1964	qyteti Tiranës
Vasil Stambuli	kuadër i kategorisë së II-të	1964	qyteti Tiranës
Avni Zajmi	“ “ “	1964	qyteti Tiranës

.....

.....

Myftar Marku	17 Nëntori	kat II-të	viti ??? (duhet të ketë qenë 1964 -ab)
Mihal Bozdo	“	“	“
Niko Stamo	“	Kat III-të	“
Kristaq Korçari	“	“	“

Kategori sportive në vitin 1964

1. Luigj Shala Mj Sporti 17 Nëntori
2. Mihal Bozdo Kat II-të “
3. Astrit Omeri “ “

Në vitin 1964 në Shoqatë, në rang kombëtar, figurojnë pesë Mjeshtër Sporti; tetë alpinistë të kategorisë së parë, 10 alpinistë të kategorisë së dytë

Alpinistë të qytetit të Tiranës dhe kategoria e tyre sportive gjatë viteve si më poshtë:

.....

.....

1965

16-29 janar; shkollë alpinizmi

1. Astrit Omeri (viti lindjes 41) në grupun special. Morri “Instruktor I Ri I Alpinizmit”
2. Ismail Hoxha (viti lindjes 45) Morri “Alpinist I R.P.Shqipërisë”
3. Maridon Hito (viti lindjes 41) morri “Alpinist I R.P Shqipërisë.
4. Instruktor Vasil Stambuli nga qyteti Tiranës

1965

Nga ditari i Ismail (Hysni) Hoxhës

31.7.65. Ka marrë pjesë në veprimtari (ekskursione e marshime) para kësaj date. Hotel “Teuta” në Shkodër nga jashtë duket jo i mirë por është i këndëshëm dhe i freskët. Sportelisti, një maskara, na mori/vodhi një bukë. Pasdite u lamë në Bunë dhe shëtitëm me motobarkë deri në Shirokë.

1.8.65 Grupi alpinistëve është me 26 veta. Midis tyre është një femër, Roza Gjergji e Elbasanit. Rruga automobilistike shumë e keqe. Makina ngec ngaqë i bllokohet motori për arësye të temperaturës së lartë dhe ngarkesës që ka. Ne ecim pjesërisht në këmbë.

Në Fushë të Okolit bëhet ndrimi i makinave. Vjen një nga Thethi. Ngelën pa hipur 9 veta. Do vi makinë tjetër për ta. Në Fushë të Okolit është fresk; fryn erë, shushurijnë pyjet e reja të ahut. Nuk ka ujë.

Pasi kaluam Qafë Thoren makina ndalet dhe Gori me shoferin gjuajnë me gurë për thëllëza.

Uji i Thethit i lehtë dhe nuk të ngop kurrë. Arritëm në 15:45. Me Mihalit vajtëm në lumë për troftë. Nuk zumë gjë. Natën ra shi.

2.8.65 Dyqanet e Thethit të mbyllura. Sorollatemi. Nuk e dimë se kur do të largohemi nga Thethi për në Qafë Pejë.

Nuk nisemi nga Thethi sepse na nxjerr pengesë posta kufitare. Niset Myftar Marku për në Shkodër (për të rregulluar punën e lejes kufitare). Mbasdite lojë me letra. Genci (Kurti) dhe Stefani (Grillo) bëjnë bishtani dhe u ecën loja. Kampi i punëtorëve në Theth nuk na fut në forcë (për ushqim) sepse vetë kampistat janë shumë veta për personelin e guzhinën që të gatuj edhe për ne. Një pjesë u materialeve dhe ushqimeve janë jashtë sepse nuk na merr/nuk na nxe çadra.

Datë 3.8.65 Shokët janë në ngjitje. Unë kam ngritur një tendë me degë me gjethe pemësh dhe ri në hije.

Dt 4. U nisëm nga Thethi vonë, ora 11, sepse nuk gjetëm mushka. Gjatë udhëtimit mbajta një çantë të vogël shpine. Qafë Peja u kalua me vështirësi sepse na u desht që të lehtësonim mushkat e t'i mbajmë ne pajimet. Djersët shkojnë curril.

U vendosëm pranë Postës Kufitare. Jemi katër vetë në një çadër (kemi dhe një gjirokastrit). Nuk janë bërë si duhet verifikimet e pajisjeve alpinistike nga drejtuesit (gjirokastriti ka ardhur pa çadër.

Dt 5. Dielli na zë vonë ngaqë jemi në gropë. Fillojmë ngjitjet të ndarë në tre grupe: Peshkopia me udhëheqës Taxhedinin, Berati me Petraqin, Tirana me Astritin. Dy gjirokastritët u ndanë në litarë pune një me Beratin e një me Tiranën. E fillojmë të fundit ngjitjen. Ndërkohë Petraqi ka bërë $\frac{1}{4}$ e rrugës. Lidhemi: Astriti, Mihali, Vilsoni dhe unë. Fillojmë një ngjitje që duket e thjeshtë. $\frac{1}{2}$ e rrugës bëhet me lehtësi sepse ka pika kapje dhe pjerrësi ?? gradë. Sapo mbaron kjo pjesë fillon një shumë e vështirë. Del përpara Mihali sepse Astriti lodhet. Mihali kalon në ngjitje 90 gradë dhe dridhet i tëri. Kërkon litar sepse nuk i mjafton që të bëjë sigurim. Kalon Astriti përpara. Edhe ai dridhet. Vilsonin e zbresim sepse do vonoheshim. Kalova unë. U dridha sepse këmbët sa mbështeteshin pak. Kur arrita tek shokët dhe hodha vështrimin poshtë, nuk dukej baza e nisjes. Pra pjerrësia e itinerarit ishte shumë e madhe. Ora është 17:30. Pra kaluam shtatë orë e 30 minuta në shkëmb. Nga mëngjesi jam pa ngrënë dhe nuk kam uri. Zbritëm në kamp. Grupet e tjera kanë zbritur para disa orësh. Kur ne po ngjiteshim kaloi grupi i Kozmait që shkonte për në Qafë Dobraçe – Shnik. Petraqi për nesër do që të niset për Nenz ose Jamë. Treshja jonë nuk është dakort. Duam që të pushojmë dhe të lahemi në liqenin e Qafë Pejës.

5.8.65. Sapo u zgjuam Petraqi lajmëron që të nisemi. Përgatitemi pa qef. Kemi tërë atë ngarkesë në kurriz. Nisemi në 09:35. Djerasa del nga i gjithë trupi. Në fillim e ngatërojmë rrugën për në Qafë të Langojve. Kthehemi dhe pasyaj ngjitemi mirë. Në qafë pushojmë pak e pastaj zbresim. Çanta godet me forcë në shpinë. Përpara është Petraqi, i vogël në trup, por shumë i fortë. Pas 30' takojmë një grup barinjsh. Vendi është shumë i mirë, por pa ujë e pa dru. Ngarkohemi edhe një herë për të arritur tek stani i Jonuzit, rreth 10' tha Astriti (!!).

Kaluan shumë minuta. Po ngjisim një të përpjetë shumë të fortë. Çantat na rëndojnë si kurrë më parë. Jemi tepër të lodhur dhe kjo bën që shokët të inatosen me Astritin që na tha 10'. Për pak sa nuk u zu Cokja (Sejfulla Myftari) me Astritin. I ndau Petraqi. Nga qafa e të përpjetës pamë stanin poshtë. Petraqi na bëri mbledhje: nuk dua zënka. Poshtë ngremë çadrat dhe shplodhemi. Uji shumë i ftohtë, akull fare, dhe shumë afër.

6.8.65. Pushim. Çadra është shtrëmbëruar sepse gjatë natës e kemi shtyrë me këmbë. Jemi katër veta në të. Pasdite zbresim poshtë dhe Astriti takohet me fshatarë të njohur. Petraqi bën fotografi. Na falin 15-20 kg patate. Në rrugën e kthimit për në kamp marrim dru për zjarr. Vangjeli hera-herës bën shaka. Astritit nuk i pushon goja. Është pajtuar me Caken e Beratit. Çakja nuk para flet; mundohet që të tregojë trupin që e ka të lidhur e me muskuj. Në mbrëmje bëjmë zjarr të madh ku fusim edhe patate për t'i pjekur. Këndojmë dhe rrimë deri natën vonë.

7.8.65. Nisemi ora 07:00. Vendi ngjitjes një orë e 30 minuta larg dhe do të takohemi me grupin e Taxhedinit i cili e pati vazhduar rrugën deri në Brizhdol.

Arrijmë deri tek malet e ngjitjeve. Ndahemi në grupe: Taxhi nuk duket. Ngjitem me Astritin dhe Mihalit. Jemi grupi më i mirë: hamë, flemë, rrimë e ngjitemi bashkë.

Ngjisim një kodër ku rrëshqasin shumë gurë. Përpara Astriti. Dalim në shkëmb shumë të thërmuar. Që litari të mos na rrëzojë gurë nuk lidhemi. Duar e këmbë i vendosim me shumë kujdes. Pjerrësia është shumë e madhe.

Dalim në një majë djathtas së cilës ngrihet një majë më e lartë. Majtas male jashtëzakonisht të thepisur. Disa qindra metro gremenë. Përballë maja të tjera me pllaka shkëmbore, majat e të cilave duket se do të shëmben me një tërmet. Në njërën prej tyre duket piramida që ndan R.P.SH. nga R.P.F.J.

Maja ku ne qëndrojmë është shumë e hollë dhe nga çdo anë ka pjerrësi të madhe. Rrimë mbi të shaluar si në kuriz të një kali. Na ka kapur frika të treve e nuk na i mban të lëvizim nga maja. Qëndruam mbi një orë. Biseduam dhe bëmë fotografi. U mësua dhe na kaloi frika. Në orën 12 fillojmë ngjitjen drejt një maje djathtas. Udhëheq Mihali në itinerarin më të vështirë nga dy itinerarët e mundëshëm. Unë jam i dyti dhe shikoj vetëm këmbët e Mihalit, shkëmbin dhe qiellin e kaltër. Vazhdojmë dy orë dhe pastaj Mihali ngecet. Nuk ka vend për gozhdë/plenga dhe për pika kapje. Tenton tre herë. Astriti rri në hije të një shkëmbi dhe dridhet nga të ftohtit. Mihali do që të tentojë edhe një herë por ne nuk e lejojmë. Zbresim. Duhet akoma kujdes. 30'. Mihalit i mbeti mëndja aty: si nuk u ngjit?!

Takuam grupet e tjera. Vangjeli kishte bërë një ngjitje shumë të vështirë. Pamë grupin e Peshkopisë që zbriste nga maja e Hellit. Ferhati rëshqiti dhe u rokullis disa dhjetra metra dhe u vra në një cep shkëmbi.

8.8.65. Sot jam roje. Grupet u nisën. Në orën 10 u dukën dy vetë në qafën që na lidh me Dobraçen. Pas 30' arritën në kamp. Ishin Myftari dhe një vlonjat. Biseduam dhe pas 4-5 orësh u larguan. Grupet kishin bërë ngjitje.

9.8.65. Sot pushim. Astriti, Petraqi, Vangjeli e Mihali shkuan tek bleta. Fshatarët flisnin se ka në dy vende bletë në shkëmb. Nesër do të shkojmë në Dobraçe (shkëmbim zonash midis dy grupeve). Mblodhëm të gjithë drutë dhe i dogjëm. Jonuzi, një bari 15 vjeçar, këndoi këngën e Bajram Currit dhe të Ago Ymerit; i ra edhe fyellit. Është djalë shumë i zgjuar. Shumë keq që nuk e vazhdon shkollën. E ëma është një materialiste shumë e madhe.

10.8.65. Ngarkuam çantat në mushkën e Jonuzit. Të tjerët janë nisur. Qafa Dobraçës shumë e përpjetë pas 100 metrash. Mushka hedh shkelma. Nuk bënë asnjë hap përpara. Për fatin tonë të mirë po vinin një djalë shumë simpatik, Gjon Mirashi 18 vjeçar dhe një vajzë e vogël, Zana, të dy me nga një mushkë. Mësuam që të dy shkonin në shkollë. Zana në klasë të dytë. Shkollën e kishin shumë larg nga fshati i tyre. Pas dy orësh arritëm në Qafë Dobraçe.

11.8.65. Bëjmë ngjitje në Majën e Madhe, në itinerarin e Gencit (Kurti). [aty, tek kampimi, i ka pritur Myftar Marku, inspektor pranë Shoqatës, i cili tashmë i njuh itinerarët që bëri /realizoi aty grupi me komandant Kozma Grillo]. Shkëmbi fillon i thjeshtë por pas 5 metrash del një pllakë 3 metroshe krejt e sheshtë, pa pika kapje. Astriti që udhëheq ngec këtu. Pas katër përpjekjesh më së fundi arrin të ngjitet deri tek një pishë. Ngul një plengë dhe vazhdon. Në një zgavër pushon 30 minuta. Ngjitet rishtaz e pas 40 min arrin të sigurohet dhe të na sigurojë edhe ne.

Niset Mihali. E kalon me shumë vështirësi pllakën, dhe pas disa pushimeve të shkurtëra arrin tek Astriti. Unë kalova lehtë: mora djathtas pllakës. Pastaj rifilloi Mihali. Na ndihmon nga sipër Petraqi që ka lëvizur nga itinerari i tij. Në ora 14:00 kalojmë zonën e rezikëshme dhe të dy grupet ngjitemi në majën e malit. Qielli vrënjtet dhe fillon shi. Në orën 15:10 jemi në majë. Bëjmë fotografi. Zbresim shumë shpejt. Astritin e vrasin këpucët dhe mbetet pas. Për 30 min arrijmë tek çadra. Shokët na përgëzojnë. Disa grupe kanë mbetur pa bukë. Natën ndenjmë shumë vonë. Dru ka shumë dhe zjarri është shumë i madh. Ferhati na kënaqi me shakatë e tij.

12.8.65. Dita e fundit e veprimtarisë. Astriti nuk vjen për ngjitje. I dhëmbin këmbët. Myftari sot do të bëjë ngjitjen e parë dhe shkon me Petraqin. Nisen ora 7:30. Majat janë një orë larg. Kalojnë përmes një pylli të bukur me pisha e me lëndina me bar të njomë në mes. Majat janë pranë dhe formojnë një hark. Itenerarët janë afër me grupin e Vangjelit. Na ndan një lug bore që përfundon në një greminë. Ngaqë nuk mundemi ta kalojmë lugun, i ngjitemi majës së Vangjelit. Sapo fillojmë ngjitjen dëgjojmë zig-zagun e Peshkopisë. Qeshim.

Ngjitemi në shkëmbin ku është grupi i Vangjelit dhe udhëheq Vilsoni (Kore), pas një insistimi të gjatë për të udhëhequr. Shkëmbi ka shumë plasa por nuk i mban fare plengat. Udhëheqim me rradhë me Mihalin. Bashkohemi në një pikë me Vangjelin dhe pastaj ndahemi përsëri. Pas katër orësh dalim në një qafë. Maja është mbi kokat tona. Shplohemi e diskutojmë: vendosim të ngjitemi. Unë udhëheq. Kaloj pjesë me bar, me tymtajë, përsëri bar. Shumë vende të bukura. Arrijmë në një majë të vogël. 30-40 metra më tej është maja kryesore por e vështirë për ta arritur. Ora është 14:30. Po ta ngjisim do të vonohemi shumë për të shkuar tek çadrat. Fillojmë zbritjen dhe për një orë e 30 minuta jemi në kamp. Hamë makaronat e përgatitura nga Astriti. Misha futet në çadër për të shkruar ditarin.

Natën rreth zjarit. Hëna është pesëmbëdhjetëshe. Është fresk. Asnjë grup nuk ka bukë. Fshatarët na sjellim bukë misri. Një 15 vjeçar, sapo mësoi që nuk kishim bukë, vajti me vrap në stan dhe solli një çyrek buke. I erdhi keq që nuk kishim thënë më parë se do na sillte më shumë.

Shënim: të thëna nga Ismail Hoxha.

- Në korrik 1964 ka qenë në Jezerë. Këtë vit nuk e mban mënd nëse ka qenë në shkollën e alpinizmit apo në kampin e punëtorëve me fletë kampi.
- Ka qenë në kamp në Theth në 1962 ose 1963 dhe: i kërkova Petraq Kules të vija në Jezerë ku dhe u ngjitëm.
- Pjesëtar i Pallatit të Pionerëve nga viti 1959 ose 1960; me instruktor Luigj Shalën.
- Nëntor 1966 dështuam në Radohimë (ishte edhe mjeku ortoped Pëllumb Karagjozi).
- Duhet të ketë qenë edhe në një shkollë verore alpinizmi, ndoshta në 1963. Ishte edhe Kozmai edhe Genc Kurti.
- Si anëtar i ekipit 17 Nëntori ka qenë në Korab (janar 1966); Astriti, Ismaili, Mihali (?).
- Si anëtar i ekipit 17 Nëntori në Tomor. Viti (?). Ismaili, Niko (Kondili), Astriti.
- Janar 1965. Shkolla e alpinizmit në Dajç: Marjo (Hito), Ismaili, Astriti.

.....
.....
Shënime nga të Kristaq Korçarit

- Ka qenë anëtar i rrethit të turizmit pranë Pallaatit të Pionerëve që në krijim, në vitin 1957. Ishin edhe Maridon Hito, Kujtim Dobrolishti, Astrit Omeri, Hysni/Ismail Hoxha, Qazim Liço, Ali Ago
- Në malin e Dajtit shkonte si amator në vitet 1958-1960.
- Ka qenë në Razëm në vitin 1966 në shkollën e alpinizmit me Astritin, Kristo Krisikon, Vlash Prifti, Kujtim Dobrolishti (?), ndoshta edhe ndonjë tjetër.
- Në 26 prill 1966 veprimtari lokale me rastin e festës së Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Në ngjitjen në Masdejë morrën pjesë: K Korçari, A Omeri, K Dobrolishti, Ladi ???, dhe arsimtari në Ulëz (I ardhur aty nga Tirana) Ali Braho. U ngjitën në majën e Dejës bashkë me një fshatar.
- 1967 (kur u sëmur Kozmai). Ngjitje dimëroore në Jezerë. Ishin: Kiçka (Kristaq Korçari), Kujtim Dobrolishti, Niko Stamo, Ladi ???, Qazim Liço.
- 1967 Shkollë verore. U ngjitën Jezera, Poplluka, Alia. Pjesëmarrës: Kristaq Korçari, Mihal Bozdo, Astrit Omeri, Natasha Bandilli, Kujtim Dobrolishti.
- 1968 Janar. Veprimtaria për ngjitjen në Majën e Madhe, Shnik. Dështoi për arësye atmosferike. Gjashtë anëtarë të ekipit përfunduan në spital me ngrirje në gjymtyrë. Morrën pjesë në shkollën dimërore në Razëm: K. Korçari, K. Dobrolishti (u trajtuam për pushim pasi dolën nga spitali), Agim Mema.
- Në shkollën verore në Theth morrën pjesë: Niko Kondili, Sulejman Poda, Përparim Kadriu, Mikel Shoshi, Niko Stamo, Qemal ????. Në verë K. Korçari mori pjesë në ngjitjet verore.
- 1969. Shkolla dimërore në Razëm. Pjesëmarrës: K. Korçari, Kujtim Dobrolishti, Agim Mema, Shefki Juma, Sulejman Poda.

1966

Ngjitje në Korab me rastin e 11 Janarit (Dita e Shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë në datën 11 Janar 1946).

Kur arritëm në Peshkopi vajtëm në shfaqje, në Estradë. Në sallë, në një sobë në mes të sallës, spektatorët piqnin gështenja. Ne ishim me kokore dhe doreza. Temperatura -12°C. Na përshëndetën me këngë Melita Shehu dhe Fatmira Beqo. Kur u kthyem për në hotel rrugës ndeshëm në shumë vende me akull. Ismaili (Hysniu) u rrëzua dhe dëmtoi gjurin.

Kur u kthyem nga maja sekretari i parë i partisë së qytetit shtroi banket për ne.

1966

Maja e Hekurave, 10 mars.

Mihal Bozdo tregon. Në udhëtimin Shkodër – B Curri, gjatë gjithë rrugës kam parë qindra maja malesh dhe kodrash të larta. Nuk kisha parë kurrë më parë një kompleks kaq të dendur majash. Rruga gjarpëronte në shumicën e këtyre majave (Mihali më 1961 ishte kthyer nga Çekosllovakia ku ishte student në degën e inxhinjerisë mekanike dhe u kthye (n) si të gjithë studentët e tjerë dhe përfundoi studimet në Universitetin e Tiranës).

10.03.1966 Ora 01:30 pas mesnate u nisëm nga Dragobia për në majë. Hëna ndriçonte. Në orën gjashtë ishim në Zallin e Motinës. Kishin shkarkuar shumë orteqe. Sasia e borës dhe madhësia e njërit prej tyre më habiti tepër.

Ishim 44 veta. Ora nëntë pushojmë dhe lëmë çantat. Mjegulla dëndësohet. Ora 10 Vasil Stambuli mendon që të kthehemi të gjithë në fshat. Vangjel Melengu nuk do. Debat 10 minuta e vendoset që ngjitja të vazhdojë. Më 11:30 kthehen Vasili (u sëmur), Muharrem Sinoimeri (në këtë kohë sekretar i Shoqatës) dhe tre të tjerë. Ekipi i Kukësit u kthye që në fillim sepse një anëtar i tyre i ngrinë këmbët dhe e transportuan. Pas 15 minutash pararoja has një vend të vështirë. Astriti e Mit'hati nuk donin të vazhdonin. U kthyen shumë. Mbetën: V. Melemgu, V. Ristani, Genc Kurti, M. Marku, T. Shehu, A. Kajanaku, Flamur Milova, Hiqmet Kuka, Mihal Bozdo. U futën në itinerar të vështirë. Ora 14:00 ishim në majë. Aty filloi erë e fortë. Edhe mjegull. Kërkuam rrugë ndryshe për kthim. Zbritëm nga u ngjitëm. Ora 21:30 arritëm në bazën e nisjes. Pra pas 19 orësh. (këtë histori Mihali ma ka tregouan edhe më vonë; herë tjetër-ab).

Shkollë alpinizmi Theth 15-30 korrik

Pjesëmarrës:

1. Aleksandër Bojaxhi; anëtar shtabi
2. Astrit Omeri; (Komandant toge; anëtar shtabi

Grupi special:

1. Niko Stamo
2. Ali Ago
3. Zejnulla Strazimiri

Pjesëmarrës:

1. Vlash Prifti Fabrika Porcelanit; Tirana
2. Viliam Kosturi Tirana
3. Maridon Hito Rrethi Tiranës
4. Kristo Qendro Pedagog në Instituti i Lartë Bujqësor

1967

Shkolla dimërore e Alpinizmit në Razëm (1-14 shkurt 67)

Komandant: Vasil Stambuli

Pjesëmarrës:

1. Myftar Marku 17 Nëntori; fitoi titullin “Instruktor i Alpinizmit”
2. Qazim Liço Klubi Dajti
3. Yzedin Milla Klubi Dajti
4. Maridon Hito Klubi Dajti

Vladimir Uli klubi 17 Nëntori fitoi titullin Turist i R. P. Shqipërisë

Vlash Prifti klubi 17 Nëntori fitoi kat II sportive dhe Kandidat Insrttraktor i Ri

Kristo Krisiko “ “ “ “ “

Astrit Omeri “ “ “ kat I sportive dhe Instruktor i Alpinizmit

Zejnulla Strazimiri “ “ “ Kat III sportive dhe Instruktor i Alpinizmit

Ilia Terpini dhe Petrit Omeri; punonjës të Kinistudio Shqipëria e Re; ju dha titulli Alpinist i R.P Sh.

1967

Theth; shkolla verore 16-31/07/67

Nga 17 Nëntori

Mihal Bozdo; Komisar i veprimtarisë dhe drejtues toge

Kujtim Dobrolishti fitoi kat III sportive

Kristaq Korçari “ “ “

Mihal Bozdo fitoi kat I sportive

Agim Memaa fitoi Alpinist i R.P.Sh.

Shënim: nga shkolla/kursi i Thethit u largua me vendim të shtabit, për mungesë korektësie, Astrit Omeri.

1968

Shkolla dimërore e alpinizmit në Razëm 1-14/02/68

Mario Trinkera i klubit Dinamo; mësues i edukimit fizik

Agim Mema fitoi kandidat instruktor i alpinizmit

Kujtim Dobrolishti “ “ “ “

Kristaq Korçari “ “ “ “

Shkolla verore Theth 16-30/7/68

Ekipi 17 Nëntori

1. Kristaq Korçari komandant i togës V-të
2. Niko Kondili
3. Mihal Shoshi
4. Përparim Kadriu
5. Qemal Kelmeksi

1969

Shkolla dimërore Razëm 1-14/02/69

17 Nëntori

1. Kristaq Korçari
2. Mihal Bozdo kom toge
3. Shefki Juma
4. Përparim Kadrija
5. Sulejman Poda

(shënim: në këtë veprimtari Zejnulla Strazimiri vjen në veprimtari si anëtar e ekipit të Partizanit).

Shkolla verore Theth 16-31 korrik 1969

Pjesëmarrës nga 17 Nëntori:

1. Kujtim Dobrolishti
2. Shefki Juma

3. Budion Meçe
4. Mit'hat Fagu (komandant toge)
5. Mario Trinkera (nga klubi Dajti) – (komandant toge)
6. Kujtim Dobrolishti (komandant Toge)

1970

Shkolla dimërore – Voskopojë 16-30 janar 1970

1. Mihal Bozdo
2. Kristaq Korçari
3. Abduraman Kuka
4. Sotira Dori
5. Luljeta Spahiu

Nga Dajti: Kujtim Dobrolishti; Sulejman Poda

Shkolla verore Thath 16-27 korrik 1970

Nga Klubi Dajti: Mario Trinkera; Vladimir Memisha

Nga 17 Nëntori:

1. Kristaq Korçari
2. Sulejman Poda
3. Abduraman Kuka

1965

- | | |
|------------------------|-----------|
| 1. Luigj Shala | Mj Sporti |
| 2. Mihal Bozdo | kat I |
| 3. Astrit Omeri | kat I |
| 4. Myftar Marku | kat II |
| 5. Zejnulla Strazimiri | kat II |

1966

- | | |
|------------------------|---|
| 1. Mihal Bozdo | kat I |
| 2. Astrit Omeri | kat I |
| 3. Myftar Marku | kat I |
| 4. Zejnulla Strazimiri | kat II |
| 5. Ismail Hoxha | kat II |
| 6. Niko Stamo | kat II |
| 7. Qazim Liço | kat II (lëviz në përfaqësi: Dajti, Dinamo, Partizani, 17 Nëntori) |

1967

- | | | |
|------------------------|--------|----------------|
| 1. Mihal Bozdo | kat I | |
| 2. Astrit Omeri | “ | |
| 3. Myftar Marku | “ | |
| 4. Zejnulla Strazimiri | kat II | |
| 5. Ismail Hoxha | “ | (shkon ushtar) |
| 6. Niko Stamo | “ | |
| 7. Kujtim Dobrolishti | “ | |
| 8. Qazim Liço | “ | (klubi Dajti) |

1968

- | | |
|------------------------|-------|
| 1. Myftar Marku | kat I |
| 2. Astrit Omeri | “ |
| 3. Niko Stamo | “ |
| 4. Zejnulla Strazimiri | “ |
| 5. Kujtim Dobrolishti | “ |
| 6. Kristaq Korçari | “ |

1969

- | | |
|------------------------|--------|
| 1. Myftar Marku | kat I |
| 2. Mihal Bozdo | “ |
| 3. Astrit Omeri | “ |
| 4. Niko Stamo | “ |
| 5. Kristaq Korçari | “ |
| 6. Zejnulla Strazimiri | kat II |
| 7. Ismail Hoxha | “ |
| 8. Kujtim Dobrolishta | “ |
| 9. Sulejman Poda | “ |

1970

- | | |
|------------------------|-------|
| 1. Myftar Marku | kat I |
| 2. Mihal Bozdo | “ |
| 3. Niko stamo | “ |
| 4. Kristaq Korçari | “ |
| 5. Zejnulla Strazimiri | “ |
| 6. Roza Gjergji | “ |
| 7. Hysni Hoxha | “ |
| 8. Kujtim Dobrolishti | “ |
| 9. Sulejman Poda | “ |
| 10. Shefki Juma | “ |
| 11. Mikel Shoshi | “ |

Shënime për veprimtari me alpinistë nga Tirana

Alpe. 1964; 1-15 gusht ekspedita në Alpe

1. Mihal Bozdo 17 Nëntori
2. Astrit Omeri 17 Nëntori

Tomor, 29 nëntor 1964 ngjitje në majën Çuka e Tomorit; kat III-të A e vështirësisë. Pjesëmarrës:

1. Astrit Omeri
2. Niko Stamo
3. Ismail (Hysni) Hoxha

Tomor, 11 shkurt 1965. Kat vështirësisë IV-A; maja 11 Shkurti. Pjesëmarrës:

1. Astrit Omeri
2. Genc Langu
3. Kujtim Loshi
4. Kujtim Dobrolishti

Poplluka. 7- 8 mars 1965. Maja 8 Marsi

Pjesëmarrës, Astrit Omeri

Ngjitjet e kualifikuara verore në Alpe. 1-15 gusht 1965

Pjesëmarrës:

1. Mihal Bozdo
2. Astrit Omeri
3. Ismail Hoxha

Korab. 29 nëntor 1965. Kat vështirësisë së itinerarit IV-A

Pjesëmarrës:

1. Myftar Marku i deleguar nga Shoqata
2. Qazim Liço
3. Ali Ago
4. Niko Stamo

Korab, 11 janar 1966

Pjesëmarrës:

1. Myftar Marku i deleguar nga Shoqata
2. Astrit Omeri
3. Mihal Bozdo
4. Mit'hat Fagu (njëherësh operator nga Kino Studio)
5. Ismail Hoxha (nuk u ngjit)

Mali Hekurave 10 mars 1966 (maja e Paqes)

Pjesëmarrës:

1. Myftar Marku
2. Mihal Bozdo

Morrën pjesë 46 veta. Morri pjesë edhe Astrit Omeri si zv/komandant i togës së parë por nuk u ngjit. (Hollësi për këtë veprimtari na ka lënë Mihal Bozdo në kujtimet e tij (ab).

Jezera. 7-8 mars 1967 vështirësi IV-A. pjesëmarrës:

1. Niko Stamo
2. Kristaq Korçari
3. Vladimir Memisha

Në ngjitjet e kualifikuara në vitin 1966 (1-15 gusht) u bënë ngjitje në këto maja: Çet-Harushe, Gryk e Hapt, Brijaset, Ali, Vali. Ngjitjet mungojnë (nuk i dorëzoi Kozmai). Morrën pjesë: Astrit Omeri, Ismail Hoxha, Niko Stamo, K. Krisiko, Mit'hat Fagu.

Në vitin 1967 me rastin e festës së 1 Majit dhe Kongresit të VI-të të Organizatës së Bashkimeve Profesionale Shoqata organizoi ngjitje në malet: Nëmërçkë, Dejë, Tomor, Shkëlzen, Ostrovicë.

Ngjitjet e kualifikuara 1-15 gusht. Zona: Prozhëm, Nikvoç, Qafa Lagojve. Nga qyteti Tiranës morrën pjesë: Ali Ago, Myftar Marku, Niko Stamo, Maridon Hito, Qazim Liço, Zejnulla Strazimiri.

Në festat 28 e 29 Nëntor 1967 Shoqata organizoi ngjitje në malet Çikë, Tomoricë, Sopot.

Maja e Madhe (mali Shnikut) në 500 vjetorin e vdekjes së Skëndërbeut, janar 1968. Nga ekipi i Tiranës morrën pjesë: Niko Stamo; Astrit Omeri; Kujtim Dobrolishti; Kristaq Korçari. Maja u ngjit në tentativën e dytë në 29 janar ku Niko Stamo mori pjesë si zv/komandant i ekipit.

Nga 27 mars deri 4 prill 1968. Ngjitjet dimërore mungojnë (d.m.th. se mungojnë pjesëmarrësit si dhe ngjitjet e kryera nga sejcili). Nuk i ka dorëzuar Kozmai

Ngjitjet nga 1-14 gusht 1968 figuron që ka marrë pjesë Kristaq Korçari. Ngjitjet e kryera mungojnë.

Marrin pjesë edhe Mit'hat Fagu kurse Mario Trinkera, Maridon Hito dhe Eqerem Prokopuca përfaqësojnë ekipin e Dajtit. Mungojnë ngjitjet.

Në janar 1969 Shoqata organizoi ngjitje në malin e Gjallicës dhe në Tomor.

Batër të Martaneshit 3-8 shkurt 1970

Ngjitje të kualifikuara.

Pjesëmarrës: Kristaq Korçari, Shefki Juma, Mikel Shoshi.

Me rastin e festave të nëntorit. Viti 1970.

- Tomor. 28 nëntor 1970. Nga ekipi Dajti marrin pjesë: Mario Trinkera dhe Vladimir Memisha

- Në Valamare dt 28 merr pjesë Mit'hat Fagu
- Në malin e Dejës ngjiten: Kristaq Korçari, Sulejman Poda, Shefki Juma. Astrit Omeri.
- Në majën e Dritës marrin pjesë: Shefki Juma, Sulejman Poda, Mikel Shoshi.

Theth 16-29 korrik 1971. Në shkollën verore të alpinizmit në Theth marrin pjesë: Romeo Manxhari, Ylber Juma, Sulejman Elmazi.

Alpinistë të 17 Nëntorit të kategorizuar në vitin 1971

- | | |
|--------------------|-------------|
| 1. Astrit Omeri | k mj sporti |
| 2. Myftar Marku | kat I |
| 3. Kristaq Korçari | “ |
| 4. Shafki Juma | Kat II |
| 5. Agim Mema | Kat III |
| 6. Abduraman Kuka | “ |
| 7. Sulejman Elmazi | “ |
| 8. Romeo Manxhari | “ |

Ngjitje verore 16-29 korrik 1971 zona e Shtegu Dhenve

	I5/3	I6/3	I7/3	I9/3	I10/4 (I d.m.th. itenerari)
Romeo Manxhari					
Ylber Juma	“	“	“	“	“
Sulejman Elmazi	“	“	“	“	“

Drejtues Mario Trinkera nga Klubi Dajti

U realizua edhe ngjitja në Jezercë, plus në Popllukë nëpërmjet kalimit kurizor

Kujdes: mungojnë ngjitjet e kualifikuara në 1971

Mars 1971

Shënime nga Aleksandër Bojaxhi.

U nisëm nga Boga për në Alpe. Marshonim drejt Shtegut të Dhenve. Dikush vjen i nisur me urgjencë nga fshati. Na dha lajmin se nga Tirana na kërkohet që urgjentisht të kthehemi. Më vonë mësuam se arsyeja ishte: meqenë se në zonën e Peshkopisë, në një veprimtari lokale me nxënës shkolle, i kishte rrëmbyer orteku dhe dy alpinistë që drejtonin grupin, Allaman Hoxha dhe Flamur Shehu, kishin ndëruar jetë.

Përbërja e grupit që u kthye ishte:

- | | |
|-----------------------|-----------|
| 1. Aleksandër Bojaxhi | Apollonia |
| 2. Nasi Shtëmbari | |
| 3. Vullnet Kalemi | |
| 4. Eqerem Shehu | |
| 5. Qazim Liço | Partizani |

- | | |
|------------------------|----------|
| 6. Robert Llabani | |
| 7. Skënder Seriani | |
| 8. Piro Liko | Studenti |
| 9. Vullnet Zylyftari | |
| 10. Islam Rudaku | |
| 11. Vangjel Haxhinasto | Dinamo |
| 12. Gëzim Bundo | |
| 13. Kristaq Gjini | |
| 14. Njazi Paçrami | Vllaznia |
| 15. Gëzim Uruçi | |
| 16. Taxhedin Shehu | Korabi |
| 17. Ferhat Sela | |

.....

Mars 1974 (nisja nga Shkodra dt 4)

Përbërja e grupit që ndoqi itinerarin: Bogë – Theth – Qafë Boshi – Bosh – Zhabore – Krasniqe – Brijas – Valbonë.

- | | |
|------------------------|---------------|
| 1. Petraq Kule | Tomori |
| 2. Vangjel Melengu | |
| 3. Vullnet Zylyftari | |
| 4. Tili Biqiku | |
| 5. Jani Qendro | |
| 6. Aleksaandër Bojaxhi | 17 Nëntori |
| 7. Astrit Omeri | |
| 8. Kristaq Korçari | |
| 9. Mario Trinkero | |
| 10. Qazim Liço | Partizani |
| 11. Vladimir Memisha | |
| 12. Fejzi Liço | |
| 13. Hasan Duro | |
| 14. Koço Ziso | Skënderbeu |
| 15. Lame Nika | |
| 16. Artan Tartari | Operator TVSH |

.....

Gëzim Oruçi

Intervistë me Gëzim Oruçin në Strëmbec, rrëzë malit të Nemërçkës më 23 korrik 1977.

Në qëndër të masivit të Nemërçkës bënë ngjitjen e parë Azem Hyka me Vasil Stambulin. Morrën masa që të flejnë një natë në shkëmb ngaqë faja e ngjitjes është disa qindar metra e lartë dhe nuk është bërë kurë kacavarje në këtë faqe mali.

Pas kësaj ngjitje, kësaj faqeje i hynë edhe një dyshe beratase (Petraqi dhe Vangjeli) si dhe dyshja shkodrane Gëzim Oruçi Kujtim Gjylbegu.

Gëzimi

Me gjithë ato çanta të bëhet ngjitje është e vështirë.

E filluam ngjitjen tek Këmba e Elefantit ende pa ngrënë mëngjesin. U ngjitëm katër litarë; shumë e vështirë nga traversa e sipër.

Nga litari i parë në të dymbëdhjetin ngjitje ka pak si dhe ka traversë. Është e kategorisë së tretë, por thellësia.....

Litari i 13-të ka një të dalë negative pesë metroshe, por ka pika të sigurt kapje.

Litarët nga 14 në 20 vetëm ngjitje vertikale me gurë të shkoqur dhe me bar. Nuk ka pika kapje të sigurt. Si vështirësi arrin kat IV.

Litari 21 ka traversë me zhur; pa siguri; do kujdes.

Litari 22 ka ballkon (të dalë) rreth 3.5 m. Fillimi ka pika kapje. Dalja jo. Arrin kategorinë VI të vështirësisë.

Litarët 27 deri 29 janë traversë me shkëmb monolit jo me shumë kapje dhe me borë dhe zhavor.

Litari 30 ka një ballkon 2 metrosh me pika kapje të sigurt dhe me dalje në bar. Ky të fut në lugun e shpellave që fillimisht nuk duken për arësye të pjerrësisë që janë me bar.

Këto pjerësi: e para me dalje të vështirë, e dyta del afër shpellës dhe është e lehtë si vështirësi. Këtu mbaron litari i 34-të. Tek shpella shkëmbi është monolit dhe plenga u ngul shumë mirë. Nga shpella në majë ngjitja është e vështirësisë së tretë. Prej këtu e në majë janë gjashtë litarë. Ne mbajtëm lidhur dy litarë.

Kur dolëm në majë të malit u takuam me Petraqin dhe Vangjelin.

Kujtim Gjylbegu. Intervistë me Aleksandrin në vitin 1977, Strëmbec - Përmet

Lindi në vitin 1948.

Është punëtor, brigadier në fabrikën e shtyllave të centrifuguara. Ka mbaruar shkollën e mesme industriale pa shkëputje nga puna në Shkodër. Ka filluar sportin e alpinizmit në vitin 1968. Në ekip me Agim Haxhia dhe Njazi Paçramin. Mori pjesë në shkollën e alpinizmit në Theth me instruktor Qazim Liço.

Shkon dy vjet ushtar.

Ka rifilluar veprimtaritë alpinistike. Për ngjitjen në Masdejë; ka qenë bashkë me ekipin e 17 Nëntorit dhe me atë të Fierit. Figuron me kategori të dytë sportive.

Tregon:

Tek shpella në mes të malit të Harapit jemi futur brënda dhe kemi ecur/shëtatur 3h e 30', por nuk i gjetëm fundin. Humbëm rrugën në mes të honeve dhe thellimeve dhe së fundi shohim lart një dritë si një yll. Drejtohem për atje duke u ngjitur, edhe me zvarritje, dhe dalim jashtë. E shohim veten në mes të faqes jugore të Harapit. Që aty me dulfer, me sportive dhe duke u kapur nëpër pisha zbresim poshtë.

Për ngjitjen në masivin qëndror të Papingut: Kam besim në forcat dhe aftësitë e mija. Aty ku dështojnë të tjerët kam dëshirë të sulmoj e ta provoj. Nuk kam ndjenja egoje. Sulmoj i matur. Për ngjitjen në Masiv (është fjala për ngjitjen në qendrën e faqes së Papingut me bazë nisje Strëmbecin-ab) e diskutuam natën. E kishim pyetur Vasilin (i cili u ngjit aty 1-2 ditë më parë me Azemin). Ka shumë alpinistë që kanë kategori të larta megjithëse janë fare të rinj. Unë kam ngelur me kategori të dytë. Dëshiroja që me këtë ngjitje të tregoja se çfarë mund të bëj. Ndjeva frikë tek ballkoni/sqeta në honin (kalimin) në bllok nga kreshta. Po të rrinim akoma këtu do të ngjisnim edhe ekipin (është ngjitur dyshe: Kujtimi-Gëzimi). Nuk është shumë e vështirë, por ka emocione. Gëzimi ka një guxim, kurajo e fantazi të tepruar.

Mihal Bozdo ishte student në Çekosllovakia. Shteti i ktheu në atdhe në vitin 1961 dhe ai përfundoi vitin e fundit të studimeve (që i mbeti pa e përfunduar) në vitin 1962 në Universitetin e Tiranës

Mihal Bozdo më tregoi:

1964. Përfaqësova klubin 17 Nëntori bashkë me Astritin. Mendoj se jam njohur me të kur bënim stërvitje në stadium (Qemal Stafa) me studentin. Nuk mbaj mënd që 17 Nëntori të ketë patur ekip.

Kur arritëm në Brizhdol (ekspedita e Alpeve), sapo arritëm na vunë nofkën “Lakuriqët” meqë ne rrinim me pantalona të shkurtëra dhe me ose pa kanotjere. Menjëherë barinjtë kërkuar të shkonim në mal për tre dhi të mbetura atje. Shkuam të nesërmen meqë e kishim ditë pushimi. Dhitë nga sipër ishin ulur në një lug me bar, lug që përfundonte në një pllakë shkëmbore horizontale e cila vinte e ngushtohet në zero dhe ishte rreth 15 m e gjatë. Kjo përfundonte në një hon gjindra metra të thellë. U ul për tek dhitë Mihali. Tre dhitë ishin në fundin e këtij relievi dhe aty nuk kishin se si të rrotulloheshin që të ktheheshin. Kishin tre ditë aty. Ishin shumë të trëmbura. I tërhiqi një e nga një dhe i furti në lug ku i shtynte me gjoks ngase ishte i lidhur/siguruar me litar dhe që i tërhiqej nga sipër. Dhitë e trembura përthyenin këmbët dhe mbështeteshin në gjunjët që të mos i ngjiteshin lugut.

Të nesërmen në të gjithë bjeshkën u përhap lajmi se “lakuriqët” i nxorrën dhitë. Kështu u krijua opinion i mirë për alpinistët dhe i mbanin me qumësht dhe prodhime qumështi, si dhe me patate të qëruara e të pjekura me kaki (saç).

Nga qendra e punës kishte presion që ta linte sportin e alpinizmit. Që të linte gjurmë të këtij sporti, aty ku punonte, krijoi një ekip alpinistësh (një gjë e tillë jepej edhe si orjentim nga lart; d.m.th nga Partia-ab) për sportet. Mirëpo kjo punë nuk eci megjithëse ai dërgoi djem e vajza të uzinës ku punonte në shkollat e alpinizmit, si dhe organizoi aktivitete me këtë ekip të Uzinës Mekanike E.H. Bërthamë të ekipit të uzinës kishte Qazim Liçon (alpinist nga shkolla Luigj Shalës). Në ekip ishte edhe Gjergj Duka të cilin e kishte vazhdimisht në sy Mihali.

Kujtime nga Qazim Liço

Në shkurt të vitit 1963 ka qenë me mua (ab) në Tomor. U financua nga Universiteti. 17 Nëntori nuk kishte ende ekip. U njoh nga 17 Nëntori vetëm Astriti dhe Myftari.

Nga 1-15 gusht 1963 merr pjesë në ngjitjet verore. Drejtonte Andon Tapia. E financoi Universiteti. U bënë tre ngjitje; dy të kat III të vështirësisë dhe një e kat IV të vështirësisë në Vishens.

Në gusht 1965 vjen nga ushtria. Mblodhi shokë kryesisht nga grupi i Luigjit: Ali Ago, Niko Stamo, Kujtim Loshi, etj.

Kur u organizua ngjitja në Korab, Qazimi caktohet përgjegjës ekipi. Ishte edhe Myftar Marku që u caktua përgjegjës i gjithë grupit: ekipet 17 Nëntori plus Korabi. U bënë nëntë vetë dhe të gjithë u ngjitën në majë. Në fund të 60 -tës ndodhi ndarja.

Ditarin e Luigj Shalës e ka një ish instruktor i Komitetit Qëndror të Rinisë (i ngjan Kozmait).

- U zunë me Astritin sepse Astriti kërkonte të ishte gjel; sepse pa ardhur në ngjitje kërkonte merita, si dhe pa punuar.
- Si alpinista arritën të kenë në dispozicion në Kampin Dajt një dhomë, të cilën e shfrytëzonte Astriti e Petriti (vëllai i Astritit).
- Luigj Shala i paska lënë porosi Lame Konomit (kryetar i Komitetit të Fiskulturës për qytetin e Tiranës) që Astriti, Marjo e Qazimi të quhen një në çdo veprim e drejtim se ndryshe do zihen e përçahen.

Shënime të nxjera nga libri i rekordeve të SHTASH Deri në vitin 1971

Të nxjera nga unë, ab.

Turizëm

Ekskursion Turistiko Alpinistik në Shqipërinë e veriut. Nga 1-10 korrik 1965.

Itenerari: Tiranë – H.E.C. Shkopet – Kurbnesh – Lurë – Liqenet e Lurës – Zall Dardhë – Peshkpi – Kukës – B. Curri – Dragobi – Valbonë – Theth – Shkodër – Tiranë.

Shtabi drejtues: Luigj Shala (komandant), Myftar Marku (i deleguar i Komitetit Shtetëror të Sporteve), Thoma Munjaku (Komisar), Ismet Bellova (për propagandën), Profit Cani (për ndihmën mjeksore).

Në këtë veprimtari: M. Marku, I. Bellova dhe Muharem Sinoimeri (sekretar i SHTASH përfaqësonin Komitetin e Fiskulturës).

Pjesëmarrës nga 17 Nëntori: Luigj Shala, Mikel Shoshi, Kujtim Kodra, Petrit Omeri, Sami Kokona, Petraq Lubonja.

Ekskursion në Rivierë (3-12 shtator 1966)

Iteneraari: Vlorë – Llogora – Dhërmi – Himarë – Borsh – Lukovë – Nivicë Bubar – Sarandë – Butrint.

Shtabi:

- | | |
|----------------------|---|
| 1. Myftar Marku | Komandant |
| 2. Agim Kajanaku | Zv/Komandant; Komandant i togës së parë |
| 3. Vangjo Boboshtica | Komandant i togës së dytë |
| 4. Lluka Heqimi | Mjeku i grupit |
| 5. Perlat Xhiku | Komisar |

Përfaqësues nga Tirana: Myftar Marku, Lluka Heqimi, Luljeta Marku

Përfaqësues nga Fieri: Miti Zhabiaku, Kastriot Janku (??), Vero Niku

Marshim turistik kombëtar me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut (3 deri 10 shtator 1967)

Itenerari: Tiranë – Krujë – Lezhë

Shtabi:

1. Agim Kajanaku
2. Myftar Marku
3. Vangjel Ristani
4. Andon Tapia
5. Shkumbin Ramadani

Përfaqësues të 17 Nëntorit:

1. Myftar Marku
2. Mikel Shoshi
3. Fejzi Liço
4. Niko Kondili

Takimi kombëtar i pionerëve turistë në Lurë (3 deri 10 korrik 1967)

Merr pjesë nga Tirana grupi turistik i Pallatit të Pionerëve

Drejtues: Astrit Omeri i dekleguari i Ministrisë; Qazim Liço drejtues i grupit të Tiranës

Takimi kombëtar i pionerëve turistë në Lurë (3 deri 13 korrik 1968)

Itenerari: Tiranë – qëndrin tek Liqenet e Lurës – Fushaliqe – Peshkopi – Tiranë

Shtabi drejtues:

- | | |
|-----------------------|--|
| 1. Aleksandër Bojaxhi | Komandant |
| 2. Myftar Marku | Zv/Komandant dhe Komandat i togës parë |
| 3. Emin Çomo | Gjeograf |
| 4. Gjyljana Bakrina | Mjeke |

Ekipi Tiranës: Kujtim Onuzi; Jorgaq Grabocka, Petrit Elmazi, Dhimitraq Londo, Astrit Bajrami, Thoma Xhaxhka, Kujtim Sala, Ruslanda Ura, Maruska Arza, Irfan Musollaj.

Ekipi Fierit: Fetah Lame (instruktor), Eqerem Shehu, Vladimir Mane, Albert Isai, Ilirjan Sulaj, Liri Kola, Miranda Nushi.

Copëza Ditarësh

Ndonëse ditarët që kisha në blloqe të caktuara i kam përmbledhur në formën e një botimi dhe tashmë ato gjenden tek Bibloteka Dixhitale në faqen e ShBA Tirana në rrjet (ëëë.shbat.org), duke rëmuar dokumentat e mia dalin gjëra të pahedhur në atë botim. Meqë janë, po i hedh që, nëse kërkohen, të gjenden sa më shpejt e më mirë.

Tomori

Ishte muaji shkurt I vitit 1963. Ishte një dimër me reshje të shumta, me përmytje dhe dëme në ekonomi. Katër studentë: Stefan Grillo, Genc Kurti, Xhovan Kajan dhe unë, si dhe Qazim Liço I financuar nga Klubi Sportiv Studenti u nisëm për në majën e Tomorit.

Pas vështirësive të kohës për transport arritëm në Gramsh. Nuk kishte urë për të kaluar lumin aty (Holta?) dhe meqë lumi kishte shumë ujë makina na la pa hyrë në Gramsh. Hoqëm këpucët dhe përveshëm

pantallonat për të kaluar lumin dhe kur u futëm në qytet shkuam në një lulishte. Gjatë kohës që u rregulluam për marshim u mbledhën mjaft njërëz të cilët na pyesnin se “çfarë minerali do të zbulonim”. U nisëm për në Dardhë të Tomorit. Udhëtuam më shumë zbathur se mbathur me këpucë, sepse përrenjtë e shumtë që derdhen në Devoll ishin ujëplotë. Moti ishte i zymtë: retë e rënduara uleshin deri poshtë duke na zbrazur hera herës shi. Kjo natyrë e “qulltë” dhe ky mot i zymtë nuk na pezmatonte, sidomos mua dhe Gencin që e kishim këtë ngjitje si ngjitjen e parë në këtë majë. Rugës takuam një fshatar, i cili pasi u njoh me synimin tonë, na këshilloi që natën ta kalonim në fshatin Kushovë. E dëgjuam këshillën e tij ndonëse udhëtimi ynë, që filloi në Gramsh në orën 13:00 do të përfundonte në orën 21:00. Më kujtohet se pak para se të arrinim në fshat forcat më shterruan. Nuk po kisha fuqi të hidhja hapin dhe më merreshin mentë. U dëshpërova sepse mendoja që nuk isha për ngarkesën fizike që kërkonte veprimtaria.

Me ndihmën e shokëve arrita në fshat. U sistenmuam në një shtëpi ku pritja e banorëve na joshi me mikëpritjen që na përcollën. Kur hëngrëm darkën e ndjeva veten shumë mirë dhe e kuptova që raskapitja më kishte ardhur nga të pangrënët. Mëngjesin e pata ngrënë herët në axhensinë e makinave dhe pas kësaj kisha lëpirë dy a tre karamelle.

Të nesërmen pasi u ndamë me shumë përzëmërsi me pjesëtarët e familjes u drejtuaam për në Dardhë. Arritëm me kohë për të vazhduar më tej dhe për të fituar sa më shumë lartësi. Ju drejtuam një lugu të pyllëzuar në mesin e të cilit kalonte një përrua. Gjetëm një stan të ngritur dhe aty vendosëm që të kalojmë natën.

Kur u zgjuam, e vetmja orë që kishim, ajo e Gencit, kishte mbetur. U përgatitëm për udhëtim dhe Genci e kurdisi orën, kur u nisëm, dhe e vuri shtatë. Ta kishim për të matur orët e udhëtimit.

U nisëm. Moti na dukej (ndoshta nga dëshira) se do përmirësohej. Kjo kundërshtojë nga fakti se bora ishte e qullët dhe nuk të mbante. Kaluam një pyll me pisha të rënduara nga bora që ishte mbi to dhe e çanim me vështirësi shtegun/rrehen drejt majës. Lagështira në ajër dhe temperatura e lartsisë bënë që ne të na mbërdhijnë shumë skajet e gjymtyrëve. Vendosëm të lëviznim përpara me sa më shumë energji. Porse sa më shumë fitonim lartësi aq më e madhe bëhej zhytja jonë në borë. Filluam të ngrejmë borën me gjunj dhe pastaj e ngjeshnim për të hedhur hapin. Kur arritëm mbi lugun në qafën e majës ora e Gencit shënonte 14:00. Ne na ishte edukuar rregull që kur nuk arrin majën deri në këtë orë “Kthehu!” Dhe ne u kthyem.

Nëmërçka

Për veprimtarinë në malin e Nëmërçkës kam shkruar në botimin “Nëpër Bjeshkët e Namuna” (Nëmërçkë 1977). Por duke lexuar sa më poshtë e shoh me vend të hedh disa faqe nga ditari (të cilat nuk janë në botimin si më sipër) për të përcjellë kryesisht ndjesitë për faqen shkëmbore qëndrore të atij mali; ato që shikojnë Vjosën.

Kur erdhën në Komisionin Teknik të Federatës së Alpinizmit fotot e faqes shkëmbore, u mendua që kishim një thesar të panjohur për kacavarje shkëmbore. Zhgënjimi ishte i madh, sepse shkëmbi aty “nuk mbate plengë/gozhdë” gjë që krijonte pasiguri për të ndërmarrë itenerarë për kacavarje. Ajo veprimtari u krye, por koha tregoi se ne nuk e përsëritëm ribërjen e një veprimtarie të dytë në atë faqe shkëmbore.

18 korrik 1977, Sopot - Strëmbec.

Dje u nisa nga Përmeti me ZUK-un (një lloj kamionçine) me materialet. Shkarkuam në buzë të rrugës nga ku fillonte ngjitja për tek vendi i cakuar për kampim. Isha me Pullumb Llabonishtën. Menjëherë pas nesh erdhi autobuzi i linjës Përmet – Çarçovë dhe la ekipin e Përmetit (24 Maj). Kaloi edhe gjysëm ore dhe erdhi një autobus me alpinistë, i cili u kthye për në Përmet që të bënte një rrugë të dytë me alpinistë. Aty u mbledhëm dhe u vendos që të përgatiteshim të niseshim për tek vendi i kampimit në këmbë sepse mushkat e premtuara për transport materiale nuk po dukeshin. Sapo mbaruam mbledhjen erdhi Eqerem Shaba (Sekretar i Federatës) dhe Et'hem Bejko (Shefi i Klubit Sportiv në Përmet) dhe na njoftuan se mushkat janë duke ardhur. Ata si dhe Marjo pas pak u larguan me ZUK-un.

Mushkat i morrën një nga një ekipet dhe më në fund ngelën përmetarët, Koço, unë, Kiçka, Arjani dhe Romeo. Prita deri në orën 16:15, kohë kur arriti edhe Çimi (Shkëlqim Terpo). Çimi një ditë më parë, teksa autobuzi ndaloj për pushim në Ballësh, shkoi për t'i çuar ca ushqime vëllai të tij ushtar atje. Autobuzi (shoferi) nuk e priti. Kish gjetur makinë dhe në ora 12:30 pas mesnate kishte arritur në Tepelenë dhe kishte kaluar natën tek "Hotel Jashta". I propazova grupi të mbetur që të nisemi.

U nisa vetë. Kisha një peshë që nuk e kisha mbajtur ndonjëherë. Pas meje u nisën edhe përmetarët. Pas një ore arritëm në fshat. Tentuam të marrim kafshët që ktheheshin nga lart por kafsharët u larguan. U nisa përsëri dhe mbi fshat takova Ylli Mullarain (trajneri i ekipit të Përmetit) që po kthehej. Më propozoi që të mos vazhdoja më tej, por unë ika duke pushuar hera herës. Humba rrugën, por gjithsesi vazhdova. Ecja me temp të lartë e me shpirt nëpër dhëmbë. Bëja edhe pushime. Hëngra ca pjeshkë nga çanta e fruta zarzavateve. Isha ende pa ngrënë drekë.

Para se të arrija "kataraktin", një copë rrugë e bëra duke mbajtur njërën çantë, kthehesha dhe merrja tjetrën. Mbi katarakt lashë çantën e fruta zarzavateve dhe kur dola sipër ujit arriti Niko (kur isha poshtë u nisa fjalë pjesës së ekipit që të uleshin për të ndihmuar) që vajti dhe mori çantën. Pas pak arriti/u ul Shefkriu dhe më pas Dashi të cilit i lashë çantën time. Arritëm tek kampimi pak pas orës tetë. I raportova Minellës për gjendjen poshtë. Më la porosi që pas 30 minutave të mblidheshin ekipet. Në mbledhje ndamë zonat e punës për ngjitjet që do kryheshin nesër. Shili arriti me shumë vonesë.

Sot u ngritëm në orën gjashtë. Vendi duket se ka itenerarë të gjatë dhe të vështirë. U rrjeshtuam, u lexua urdhëri i ditës, etj, dhe në orën nëntë u nisëm. Kur ju afruam shkëmbenjtë ata na u dukën plot me itenerarë edhe të vështirë edhe të lehtë, por të mundëshëm për tu realizuar. Kjo gjë i dha kurajo të gjithë grupit. Unë Shefkriu, Dashi, Niko dhe tetë gjirokastritë ishim bashkë. U dhashë shpjegime për mundësitë e ngjitjeve dhe pas kësaj ju afruam më shumë shkëmbenjtë. U ngjitëm nëpër një lug plot gurë e që aty nga afër pamë gjithë itenerarët si dhe ata përballë. Ngado gurë të gatëshëm që të bien! Të hyn frika nga gurët. Vajtëm deri afër kreshtës, por kudo itenerarët ishin me rrezik për rënie gurësh. Eqerem Reso, Niko e Dashi mbetën poshtë. U kthye kjo ditë në ditë vrojtimi. Zbritën në kamp në orën 16:30 ku na prite sallata dhe sallami të përgatitura nga Dashi. Filluam të sistemojmë vendet e çadrave, por na thirrën për mbledhje. Të gjithë diskutuan me frymën e pamundësisë për ngjitje prej rrezikshmërisë së gurërënies. Dukej sikur Minella nuk e dëgjonte këtë frymë. Andaj dhe u vendos që nesër të bëjmë ngjitje me bazë treshe. Ndërkohë në kamp arriti pjesa e alpinistëve që ngeli dje poshtë si dhe një pjesë e ekipit të Beratit.

19 korrik

Zgjohe mi ora pesë. Kam fjetur keq gjatë pjesës së dytë të natës. Përgatitemi për nisje. Ora 06:15 rrjeshtohemi. Nisem tërë mërzi. Nuk dimë se çfarë të bëjmë. Lloji i shkëmbit nuk garanton besim në sigurimet. I ndaj treshet si të mundem. Vetë me Dashin dhe Shefkiun marrim për nga tymtaja/oxhaku në të djathtë. Kur po afriheshim që sipër tij u shëmb një shkëmb i madh i cili rrëzoi edhe borë. Ishte kjo një përshëndetje vulgare e itenerarit që do synonim. Dhe që sigurisht hoqëm dorë prej tij. Do të merrnim djathtas por u bindëm se oxhaku i madh na u duk i lehtë. Ju futëm, por shkëmbi ishte mjaft i keq. U tërhoqa i dëshpëruar. Më duket ky vend i tillë që po rrimë kot. Tërë ky cirk vigan me 92 burra (alpinistë) sot duket i heshtur. Sikundër rezultoi edhe nga analiza e kësaj dite në darkë, ngjitjet u bënë pa përdorur gozhdë. Kur u kthyem në kamp u lamë dhe u pastruam dhe përgatitëm drekë e darkë bashkë dhe hëngrëm mirë. Për nesër nuk e di se çfarë të bëjmë. Kam kërkuar të ngjitemi në Paping.

20 korrik

Në orën gjashtë u rrjeshtuam. Neve si ekip na jepet pushim. Grupet që erdhën dje bënë ngjitje. Berati u ngjit nga Shtegu Qorres (diagonalja). Tropoja e Shkodra nga diagonalja nën të. Një treshe e Beratit kaloi matanë nga lindja dhe u kthye ora 18:00 kur në kamp lexohej Gazeta. Bisedova me Minellën për ngjitjet dhe për llojin e shkëmbit. Më pas bisedova me Kozmain. Po më dhemb pak gjuri dhe është ënjtur. Nesër unë, Dashi, Shefkiu përsëri do shkojmë në oxhak; Romeo, Çimi dhe Niko në Paping, majë, nga shtegu gomarit; kurse Arjani e Kiçka nga shtegu i Qorres.

21 korrik

Nisemi ora 06:30. Kiçka, Arjani, Çimi, Niko e Romeo janë për ngjitje dy ditore nga qafa e Gomarit. Kiçka do që t'i dalin nga Shtegu Qorres meqë andej do kalojnë ekipet e Studentit dhe Partizanit. Ndërhyj edhe unë tek Minella por ai nuk pranon. Së fundi u nisën. Ne të tre tentuam tek oxhaku. Avancova traversë rreth një litar e gjysëm por pasi u largova edhe 15 metra ngula tre plenga/gozhdë shkëmbi të pasigurta dhe u kthyem. Për të realizuar edhe zbritjen e Dashit e bëmë litarin dysh duke e kaluar në një lak me litar personal (6 mm). Në fund mezi e hoqëm litarin duke e tërhequr derisa u këput litari i lakut. Unë e Shefkiu gjatë tërheqjes së litarit ramë në një ortek zhavori. Pas kësaj unë dhe Shefkiu tentuam ngjitjen tek lugu i borës. Ishte ftohtë, u llangagjosëm dhe u kthyem. U futëm më pas tek lugu i mesit. Shefkiu udhëheqës. Rishtaz u kthyem. Shkëmbi është fare i pasigurtë për të ngulur plenga (për të organizuar sigurimin) por i pasigurtë edhe për pika kapje. Të vjen turp kur shikon se nuk i ngjit dot këto shkëmbej kaq të thjeshtë sepse nuk ke besim tek sigurimet. Kur u kthyem takuam korçarët që gjatë gjithë ditës na kishin parë nga hijet që kshin zënë. Në mbledhjen e mbrëmjes Minella na ofron për ngjitje një “katarakt” ku u ngjit Petraqi. Është i vështirë. Do vemi.

22 korrik

Nisemi për tek shkëmbejtë përbri “kataraktit”. Është shkëmb monolit dhe i vështirë. Pasi udhëhoqa mbi gjysëm litari nuk e ndej veten mirë: më kalojnë djersë, herë të ngrohta e herë të ftohta, kam dhimbje koke dhe kam ndjenjën e të vjellit. Zbres dhe futet Shefkiu udhëheqës. Arrijmë deri tek lugu i pyllit. Dashi nuk pranon që të ngjitemi më tej. Zbresim.

Janë nisur katër korrierë që kërkojnë Taxhedinin. I ka vdekur vëllai dhe duan ta njoftojnë. Ai kthehet vonë nga mali dhe niset.

Mbasdite u kthyen grupet nga marshimi dy ditor. Edhe Shili, i cili na u shfaq në dylbi këtu poshtë bashkë me Azemin në shkëmb.

23 korrik

Sot nuk shkuam për ngjitje sepse jemi edhe pushim edhe dezurn (roje) për kampin. Me këtë rast poqëm në hell qingjin që blemë dhe që na i ropi Vilsoni (V. Kore i ekipit të Gjirokastrës).

Bisedova me Shilin dhe Azemin për ngjitjen që realizuan. Një lloj interviste.

Intervistova Gëzim Oruçin.

Intervistova Kujtim Gjylbegun

25 korrik

Bëmë ngjitje në ullukun lindor. Ishte i kategorisë IV të vështirësisë. Ishte itinerar i gjatë. Para nesh u ngjitën aty pesë alpinistët e Kukësit. Nga ne Unë, Shefkiu plus Niko, Çimi, Romeo. Erdhën edhe M. Hito dhe M. Kapo. Erdhi edhe K. Korçari me Kozmain. Dashi u kthye sepse e zuri barku.

Para se të dilnim në majë Romeon e preu barku dhe kur po çvishej i fluturoi pagurja e ujit.

Vajtëm në majë e prej aty në një majë tjetër rreth 12 muinuta më larg. Vajta me Nikon. Zbritjen e bëmë nga faqja që shikon Vjosën. Mblodhëm çaj. Na zuri shiu dhe u futëm nën ca bredha që kishte pylli. Në pyll kishte ca lule të bukura, të kuqe dhe si zymbyla. Të rralla. Humbëm rrugën dhe kur e gjetëm pamë se ajo vazhdonte në një shteg të rrahur mirë, shumë të vështirë në një hon mali. Pas kësaj dolëm tek kanali e prej aty arritëm në kamp të raskapitur, por gjetëm një menu të pasur të përgatitur nga Dashi për të dy çadrat tona.

26 korrik

Me Vasilin dhe Azemin nisem për tek koridori qëndror. Ngjitemi për 15 litarë dhe arrijmë lart në ora 17:00. Pas gjysëm ore fillojmë zbritjen andej nga u ngjitëm. Litarin e fundit e zbritëm në orën 12:30 pas mesnate, nën dritën e fenerëve të shokëve që na erdhën për ndihmë.

27 korrik

Bëjmë analizën e veprimtarisë. Vërehet një farë egoje midis ngjitësve të masivit qëndror. Më pastër qëndrojnë Azemi e Kujtim Gjylbegu. Është interesante se pas nesh shokët që ngjitën lugun fjetën jashtë. Kozmait i humbi paketa e cigareve gjatë ngjitjes dhe tre fijet e fundit të shkrepes që i mbetën i vlejten për të ndezur zjarr. U ndez fija e fundit.

Seminar me trajnerë dha alpinistë 17-19 qershor 1977

Nën patronazhin e K S Partizani

Pjesëmarrës:

1. Vasil Stambuli	Partizani
2. Minella Kapo	
3. Eqerem Shaba	
4. Seit Foçi	Inspektor
5. Muhamet Terihati	Shefi K S Partizani
6. Viron Velaj	Flamurtari
7. Pullum Llabonishti	Part
8. Servet Aliko	Flam
9. Azem Hyka	Part
10. Mario Hito	Stud
11. Aleksandër Kapo	Parti
12. Koço Ziso	Skënd
13. Grigor Perikliu	Lab
14. Xhevat Osmani	Lab
15. Kristaq Korçari	17 N
16. Vladimir Memisha	Studen (largohet dy seanca)
17. Aleksandër Bojaxhi	17 N
18. Gëzim Uruçi	Vllaz
19. Hasan Temali	Vllaz
20. Agron Kore	Luft
21. Ranazan Cenko	Luft
22. Spiro Ciko	Part
23. Fatmir Metko	Part
24. Edmond Bani	Part
25. Berzat Mane	Përparimi i Kukësit
26.	Përp
27. Agim Tabaku	Korabi (lufta e klasave e hoqi nga pedagog fiskulture në Universitet)
28. Petrit Xhindolli	Part
29. Eduard Sheldia	Part (erdhi në seancën e dytë)

Hyrja në seminar:

- Fjalën e rastit e mbajti Muhamet Terihati.
- Dy fjalë nga Eqerem Shaba. Ndërkohë thotë se drejtues i këtij seminari do të jetë Minella Kapo. Pastaj del/largohet bashkë me Terihatit.

Referati nga Minella Kapo

- Ngre problemin që çdo klub sportiv apo rreth të ngrejë ekipin e alpinizmit
- Nuk ngriti problemin e shoqatave lokale.
- Ngre problemin e klasave sportive në shkolla dhe ekipet e të rinjve (Unë ndjej e shoh se fjalët thuhën kurse punë dhe programe nuk ka).
- Aktiviteti dimëror:

- a. Ndhimoi në cilësi seminari i organizuar në Peshkopi
- b. Nuk u bënë si e sa duhet kontrollat e pajisjeve të ekipeve pjesëmarrëse.
- c. Në veprimtarinë me kat sportive II dhe III nga dita e kontrollit rezultoi se përgatirja fizike ishte e mirë kurse ajo teknike keq.
- d. Nëpër rrethe të organizohen veprimtari lokale dhe aty të fitohet kategoria e II sportive.
 - Klubi sportiv të ketë evidencë për alpinistët dhe veprimtaritë e tyre lokale si dhe për fitimin e kategorisë së III sportive.
 - Nga raporti (MK) del se i jep rëndësi dokumentacionit që plotësohet nga komandanti i veprimtarisë.
 - Ngre problemin e sigurimit të ushqimeve që para nisjes në veprimtari.
 - Nuk përmend faktin që televizioni nuk paraqiti veprimtarinë por paraqiti tjetër gjë dhe e shiti për veprimtarinë e kryer.
 - Nga aksidenti ndodhur me kategoritë e dyta mendoj që jo çdokush mund të jetë komandant. Ka rregulla për instruktora.
 - Unë mendoj që raporti i Minellës të botohet.
 - Në diskutimet e dala (prej pyetjeve) del problem i kategorisë, ngjitjeve dhe kartelave. Dikur botoheshin rezultatet. Përse nuk botohen sot?
 - Për Besnik Kicën, është në parim gabim andaj të hiqet (???ab).

Fjala Agim Tabaku

- Gabimet janë thjeshtë teknike (unë them jo. Janë edhe taktike dhe organizative ab).
- Analiza të forta në rrethe. Do vi komunikata jonë. Shoku i dëmtuar është shumë mirë (do jetë fjala për Rushit Reçin-ab).
- Atë që ndodh në alpinizëm duhet ta themi me sinqeritet të plotë.
- Kontrollat për bazën materiale të ekipeve duhet të jenë të himta.

Fjala Azemi

- Si zbatohen vendimet e kongresit të shtatë të PPSH në alpinizëm.
- Liberalizmi fillon nga Federata
- Të kontrollohet tjetri nëse është i aftë që të drejtojë.
- Kategorizimi të jetë kolegjal.
- Të krijohet libri i analizave mujore në Klub.
- Të shkruhen karakteristikat e çdo alpinisti.
- Vuajmë për sinqeritet.

Lista alpinistash

Studenti

1. Minella Kapo
2. Kozma Grillo
3. Vasil Stambuli
4. Andon Tapia
5. Aleksandër Bojaxhi
6. Vasil Vreto

7. Tefta Zguro
8. Mihal Bozdo
9. Genc Kurti
10. Agim Tabaku
11. Xhelil Bakiri
12. Stefan Grillo
13. Mustafa Selenica
14. Roza Gjergji
15. Flamur Milova
16. Zenel Kokomiri
17. Janaq Ziso
18. Hysen Xhaja
19. Mira Hyseni
20. Përparim Vula

17 Nëntori

- | | | |
|------------------------|--------|---|
| 1. Myftar Marku | Kat I | |
| 2. Mihal Bozdo | “ | |
| 3. Astrit Omeri | “ | |
| 4. Niko Stamo | “ | |
| 5. Maridon Hito | “ | (është me ekipin Dajti por ka qenë edhe me 17 N edhe me Studentin). |
| 6. Qazim Liço | “ | “ “ “ |
| 7. Zejnulla strazimiri | Kat II | |
| 8. Ismail Hoxha | “ | |
| 9. Kujtim Dobrolishti | “ | |
| 10. Kristaq Korçari | “ | |

.....

.....

Ekspedita dimërore shkurt 1972

Ditari i Aleksandër Bojaxhi

Datë 1 shkurt. U nisëm nga Tirana për në Shkodër dhe aty para dite erdhën ekipet e 17 Nëntorit, Elbasanit dhe Kukësit. Nga ekipi i Kukësit Tasini ndënji në Tiranë (mënyra për të shkuar në Shkodër n'ato vite, ishte duke ardhur fillimisht në Tiranë - ab) për të blerë materiale për ekipin. Mbasdite erdhën tre veta nga ekipi i Partizanit. Kështu, në Shkodër, u bëmë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| 1. Aleksandër Bojaxhi | 17 Nëntori |
| 2. Kristaq Korçari | |
| 3. Dashamir Fejzo | |
| 4. Sulejman Elmazi | |
| 5. Grigor Perikliu | Labinoti i Elbasanit |
| 6. Robert Bici | |
| 7. Isuf Dine | |
| 8. Vladimir Kodra | Partizani |
| 9. Robert Llabani | |
| 10. Bashkim Beqiri | |
| 11. Berzat Mane | Përparimi i Kukësit |
| 12. | |
| 13. Tasim Skënderi | |

Ndër këta, Tasimi, përgjegjës i ekipit të kuksianëve, nuk u paraqit fare.

Gjatë ditës në Shkodër blemë disa artikuj ushqimorë: unë, Sula e Dashi blemë këpucë qyteti Fjetëm herët.

Datë 2 shkurt. Në orën 07:30 u grumbulluam tek axhensia e autobusave. Takova Idrizin (drejtorin e kampeve të Thethit e Razmës) dhe më dha një letër për Ndue Pal Drenin, i cili përgjigjet për kampin e Thethit.

Pas shumë peripecishë u regullua makinë për në Bogë (nuk ishte ditë që kishte linjë Shkodër-Bogë). U nisëm ora 09:00.

Arritëm Bogën ora 11:00. Blemë ca bukë misri. Makina na la tek Kisha sepse nuk shkonte ma tej (bora në rrugë fillonte në Ducaj). Marshuam deri tek çesma ku hëngrëm drekën (në këmbë). Filluam marshimin dhe u ndalëm në të përpjetën mbi Fushë të Okolit, ku ngritëm çadrat dhe kaluam natën.

Datë 3 shkurt. U zgjuam ora tre pas mesnate. Në orën katër unë, Ladi dhe Berzati formuam kreun e kolonës dhe u nisëm. Mësuam që nga ora nëntë temperatura arriti në -9°C. Megjithatë bora ishte mjaft e butë. Aty nga ora 10 filloi ngjarja e tretë për tu shënuar në këtë fillim veprimtarie: e para ishte dje. Uturimat e orteqeve që binin na shoqëruan gjatë gjithë udhëtimit, deri ora 15:00. E dyta ishte sot kur u ngritëm: Kiçkës i kishin ngrirë mustaqet. E treta tani: Berti, Isufi të ekipit të Elbasanit dhe dy kuksianët kthehen sepse nuk duan të vazhdojnë.

Ora 11:00 arritëm në Gropën e Portës. Hëngrëm drekën. Gjatë udhëtimit takuam dy fashatarë që zbrisnin nga Shtegu të mbathur me rathë bore. Pas pushimi vazhduam dhe tek pishat për në Shteg na arriti operativi (officer i sigurimit në zonë) i Bregut të Lumit. Në 14:30 ishim në krye të Shtegut dhe në 17:30 në kampin e Thethit. Nuja nuk ishte aty. Me Nikollë Markun u nisa për tek shtëpia e Nues. E gjeta

shtëpinë vetë sepse Nikolla u ndal në shtëpinë e tij. Më futën në shtëpi ku më bënë dy kafe me të cilaat më erdhi shpirti në vend dhe piva pak ujë të vokët. Më pas u nisëm. Nuja mori një fener dhe ½ litër raki. Tek kampi takuam Dashin, Sulën, Kiçkën të ngrirë nga të ftohtit. Ishte ora 19:30. U futëm brënda dhe u sistemua. Pas një ore erdhën edhe të tjerët të cilët kishin qëndruar në një shtëpi aty afër për tu ngrohur. Pasi morrëm nga Nuja nga 5 batanie dhe nga dy çarçafë sejcili shkuam nëpër dhoma e fjetëm.

Datë 5 shkurt.

Dje koha ishte shumë e mirë. Pushuam në Theth. Ndue Pal Dreni na rregulloi dritat (për arësye të inondave atmosferike Thethi ishte pesë ditë pa rrymë elektrike). Rregulluam zjarr në shtëpinë e Tones (shtëpia është pjesë e kompleksit të kampit të Thethit). Të gjithë zbritën në qendër ku edhe hëngrën drekën. Unë qëndrova në kamp. Të gjithë u kthyen në orën 14:00. Rregulluam çantat për nesër por nxorrëm prej tyre darkën dhe mëngjesin që do të konsumonim. Më vonë, nën një zjarr të mirë hëngrëm darkë dhe pimë pak raki. Thirrëm edhe Nduen. Në orën 20:30 u ngritëm për të fjetur.

Sot u ngritëm pak para orës katër pas mesnate. U bëmë gati, por kur dola jashtë binte borë. I ktheva shokët dhe u futëm përsëri nëpër shtretër. U ngritëm në orën 7:30 dhe në orën tetë u nisëm ndonëse moti nuk ishte i mirë. Tek marshonim, hera herës binte borë. Tek shkolla pushuam pak. Na mudoj rruga mbi shpellën e Rrathëve. Trualli ishte i ngrirë dhe me plot orteqe të rëna këtu e atje, të vegjël e të mëdhej. Kaluam të siguroar në një segment që zgjati mbi 10 litarë. Punuan mirë në këtë segment Ladi dhe Berti. Pak dashi dhe unë. Ishte akull dhe lëviznim çdo dy vetë të lidhur në një litar

Në orën 17:30 arritëm tek stanet pa dalë tek Fusha e Dnellit, ku dhe po shkruaj ditarin. Këtu janë dy stane shumë pranë njëri tjetrit dhe në njërin prej tyre po thahemi. Mendojmë të flegjmë tek stani tjetër. Nuk jemi dhe aq të lodhur. Më shumë kohë na hëngri relievi i ngrirë se sa gjatësia e itinerarit.

Datë 6 shkurt.

Mbrëmë fjetëm tek stani që ishte krejt i mbuluar me borë. Çunat hapën vetëm një vrimë për tu futur në derë e brënda. Nga mëngjesi mbërdhimë pak. U ngritëm në orën 4. Kaluam tek stani tjetër ku shkrimë borë, hëngrëm mëngjesin dhe në orën 6 u nisëm. Bora të lëshonte shumë dhe ashtu sikundër për të dalë në Shtegun e Dhenve, fillimisht marshonim pa çantat. Bashkimi i Partizanit na mërzi shumë. Shijua bukuri të mëdha. Në mëngjes ngjyrat e gjalla e të bukura të majave të maleve (violet, portokali ...) si dhe e gjithë lugina e Dukagjinit e mbuluar me re a mjegull dukej si det që formonte fjarde. Në orën 16:30 arritëm në lindje të malit të Boshit, në një gropë që ka pranë edhe Boshin edhe Zhaboren. Ngritëm çadrat dhe u futëm të gjithë brënda. Tani sejcili ha nga pak dhe bie heshtja. Kiçka po i "shërben" stomakut. Pa arritur tek kjo gropë e kampimit, pamë gjurmë të gjatë. Gori, gjahtar i regjur, tha se është gjurmë ariu që ka ndjekur dhinë e malit.

Datë 8 shkurt.

Dje u ngritëm në orën 5:30. Morëm pak ushqime dhe u nisëm për në Bosh. Bashkimi dhe Gori nuk erdhën sepse u kishin ngrirë këpucët. Komandant ngjitje caktova Kiçkën, por ky ishte shumë i lodhur dhe rrinte në fund të grupit. E përpjeta e fortë drejt majës na lodhi. Kaluam ca pjesë të ngrira shumë të vështira. Nga maja vazhdimisht na vinte mjegull dhe era na hidhte borën e himët. Majën e sulmuam nga ana lindore. Kur arritëm në pjesën e sipërme, ngjitëm majën djathtas, pastaj morëm kreshtën për në majën e mesit. Ishim Bert Llabani, Dashi dhe unë. Ishte Berti përpara kur kreshta kërciti si bostan dhe u çka. Ndalëm dhe

donim të ktheheshim. Unë vazhdova dhe mora pak djathtas. Por prap kreshta mori çarje. Atëhere vendosëm dhe u kthym. Arritëm në kamp të raskapitur. Nuk kishim fuqi as të hanim. Ishte ora 10:30. Pasi pushuam pak bëmë banjo dielli, hëngrëm, fjetëm pak dhe shkrimë borë duke tundur paguret e mbushura pjesërisht me të. Më pas Dashi dhe Ladi vajtën tek një shkëmb ku dilte ujë. Pastaj ata thirrën Kiçkën dhe Sulën dhe na mbushën paguret. Ramë për të fjetur pas orës 18:00.

Sot u ngritëm në 5:30 dhe aty nga ora 06:30 u nisëm i gjithë grupi. Edhe sot moti është i mirë, por duket se do jetë dita e fundit me mot të mirë. Dëbora vazhdimisht na lëshon shumë. Diku, mes dy shkëmbejve, futa Ladin që të na udhëhiqte për tu ngjitur, por lugu ishte i papërshtatëshëm. Pastaj futa grupin në një lug orteku i cili kishte shkarkuar. Rezultoi lug i vështirë që gabimisht e kaluam pa sigurim. Ishte rreth 300 metra i gjatë. Kaluam në ca segmente ku bora kish rrezuik të shëmbej. Sula u lodh dhe filloi të ankohej që i futa aty. Ishte fat që kisha veshur/mbathur kthetrat dhe i rija Sulës nga mbrapa që po të rrëshkiste ta mbaja disi.

Së fundi arritëm në një vend më të mirë. Aty dola unë përpara por qëlloi një pjesë bore tepër e thepisur. Sipër saj u mblodhëm të gjithë. Hëngrëm pak ushqim dhe u nisëm përsëri. Pas mbi 300 metra udhëtëm u ndalëm dhe vendosa të ngjitemi në një majë, e djathta e Krasniqes. Ladi, Sula, Bashkimi nuk erdhën sepse ishin shumë të lodhur. Pasi u shkëputëm, me radio i njoftuam që ata të lëvizin e të çajnë borën në drejtim të synimit tonë për kampimin e ri. Më së fundi ne arritëm në majë, e cila ishte thuajse e rafshtë. Bëmë thirrjet zig-zag tre herë në drejtim të Valbonës si dhe dhamë sinjal me radio (aty punonte grupi tjetër - ab). Por, asgjë. Pastaj vetëm unë me Dashin (të tjerët ishin të lodhur) u ngjitëm në majën e fundit të Brijasit. Shokët na pritën dhe më pas vahduam të gjithë kthimin. Vazhduam dhe kaluam disa vende të vështira. Më së fundi arritëm në një qafë që unë besoj se është e Vashkiefnit. Me Kiçkën bëra ca fjalë për caktimin e vendit për çadrat. Ai po grindet si shumë sot. Ndoshta nga lodhja. Tani që po shkruaj ai fle. Hëngri përpara të gjithëve dhe tani po fle i pari. Ne bëmë një zjarr me degët e një pishe të vetmuar dhe u thamë si dhe shkrimë ca borë. Tani të gjithë janë në çadra. Janë të lodhur dhe kanë dëshirë të ulen në ndonjë fshat(!?). Morali ka rënë me sa duket ngaqë nuk e kanë parapërgatitur veten për një mundim kaq të madh. Për ditët e mëpasme kam ca mendime që më ziejnë që të ndryshoj itinerarin. Moti do më bëj që të vendos.

Data 10 shkurt

Më duket sikur kanë kaluar disa ditë. Ndoshta nga që po pushojmë mirë. Dje në mëngjes kur u ngritëm horizonti kudo ishte i nxirë (sidomos perëndimi). Lindja ishte disi e pastër. Por shpejt u mvrejt. Filloi të fryjë dhe të bjerë borë. Ngritëm shpejt çadrat dhe u nisëm për në Qereç (mjegulla nuk na mundësonte të shikonim për të dalë në anën e Valbonës – ab). Rrugës na zuri mjegull shumë e dendur. Kur u hap për një moment u duk qartë se ne ishim 4-500 metra poshtë majës (mendoj se ishte Brijasi - ab). Na humbi kot maja! U ulëm shumë poshtë dhe në pyll humbëm rrugën për arësuye të mjegullës. Pritëm ca kohë dhe më pas u orientuam. Ndoqëm përroin në të djathtë. Njerëzit ishin shumë të lodhur. Bënim pushime të shumta, hanim dhe kërkoni ujë për të pirë. Pasi udhëtua edhe rreth dy orë hasëm në gjurmë njeriu. Falë këtyre gjurmëve, përmes mjegullës, arritëm në Qereç! Mos ishte ajo gjurmë kushedi se si do ishte fati ynë për të arritur në Qereç. Me të pyetur gjetëm shtëpinë e Kryetarit të Këshillit të fshatit. Na priti e shoqja e tij sepse kryetari ishte në mbledhje. Lamë aty çantat. Shkuam tek dyqanet dhe blemë bukë misri. Aty takuam mësuesin e fshatit, Nikë Vuksani (Çokaj), i cili na ndihmoi që të blenim ç'të mundnim në dyqan. Pastaj

Nika na mblodhi rreth zjarrit në shkollë. Aty erdhi, më vonë, edhe Kryetari i Këshillit të fshatit si dhe banorë të tjerë. U vendos që ne të 17 Nëntorit të sistemohemi tek Nika, kurse të tjerët tek Pjetri.

Tek Nika kaluam orët e mbetura të ditës shumë mirë. Janë njerëz shumë mikpritës e të mirë. Fjetëm në orën 22:30.

Sot u ngritëm paksa vonë. Ndejtëm në dhomë deri ora 11 dhe pastaj vajtëm tek Shpella e Zezë. U futëm aty me Nduen, Vatën e të tjerë. Ishte diçka e bukur dhe interesante. Zumë edhe një lakuriq nate kur u kthym. Morëm dru, në kthim, për në shtëpi. Mbasdite vajta dhe takova shokët tek Pjetri. Bashkimi ishte i sëmurë. Në darkë erdhi motra e Nikës me të shoqin. Luajtëm domino. Na ikën dritat. Fjetëm; ishim të këputur për gjumë.

Datë 11 shkurt

U ngritëm mënge. Mbrëmë hëngra shumë dhe pata gjumë jo të mirë. U përgatitëm për udhëtim. U ndamë shumë përzëmërsisht me njerëzit e shtëpisë dhe në orën 9 u ndamë tek shkolla shumë përzëmërsisht me Nikën.

U nisëm të gjithë bashkë. Ecëm shumë kohë në mjegull pa parë asgjë nga elementët e relievit ku kaluam: Muljan, Ptushën, Qafën e Kolqit, e së fundi u ndalëm në lagjen Selimaj të Gegë Hysenit në shtëpinë e Rustem Osmanit. Po kalojmë mirë dhe tashti pas darkës po bisedojmë e po ngrohemi.

Daatë 13 shkurt

Dje u nisëm aty nga ora 8 nga dyqani i fshatit. U ndamë aty me Rustemin dhe një fshatar na përcolli deri afër rrugës së makinës. Pritëm për makinë por edhe ato të pakta që kaluan nuk na morën. Nga ora 14:30 u nisëm me autobusin urban për në Fierzë me qëllim që të zinim vendet dhe të shikonim vendin e hidrocentralit. Rruga ishte shumë e keqe. Vëndi i hidrocentralit ishte një grykë e thellë. Ora 18:00 ishim në B. Curri. Në hotel takuam grupin tjetër që kishte një orë që kishte ardhur nga Valbona. Ky grup kishte mundur të ngjitet tek Gryk e Hapt atë ditë që ne ishim në Krasniqe -Briaset. Pasi kishin vajtur në Rrogam ishin nisur për në B. Curri.

Sot po kalojmë ditën me pastrime e shëtitje në qytet. Biletat për nesër i premë.

Të dhëna mbi kohëzgjatjen e disa itinerarëve
(Për persona të stërvitur për ngjitje e zbritje në male)

Kampi i Punëtorëve Theth – Kroni i Shtrazëss	45’
Kroni i Shtrazës – Shpella e Pejës	45’
Shpella e Pejës – Posta Kufitare Verore	1 orë
Posta Kufitare Verore – Maja e Prozhmit dhe kthim në postë	3-4 orë
Shpella e Pejës – Gropat e Bukura	1 orë
Gropat e Bukura – Jezerë	3 orë
Jezerë – Gropat e Bukura	1-2 orë
Kampi i punëtorëve – Burimi pranë Qafës së Valbonës	1 orë e 45’
Burimi – Qafë Valbonë	45’
Qafa e Valbonës – Buni (burimet) Valbonës	45’
Buni Valbonës – Gjellaj/Rrogam	30’
Gjellaj – Fusha e Gjesë	25’
Fusha e Gjesë – Buni Ziçit	1 orë
Buni i Ziçit – Gropa e tretë	1 orë 30’
Gropa e tretë – Gropa e sipërme (aty ku kthehesh për Gryk të Hapt)	15’
Gropa e sipërme – Qafa e shtegut për majën Eklips	35’
Qafa e Shtegut – Fusha e Gjesë	1 orë e 30’
Fusha e Gjesë – Buni Valbonës	1 orë e 30’
Buni Valbonës – Qafa Valbonës	50’
Qafa Valbonës – Kampi punëtorëve Theth	2 orë
Fusha e Okolit – Theth	deri 3 orë

Fusha e Okolit – Gropa e Portës	mbi 1 orë
Gropa e Portës – Shtegu i dhenve	mbi 15’
Shtegu i Dhenve – Kampi Punëtorëve Theth	mbi 45’
Kampi i Punëtorëve – Qendra e Thethit	30’ (kthimi 40’)
Qendra e Thethit – Ujvara në Grunas	45’-60’
Qendra e Thethit – Qafa e Thores (liqeni)	mbi 3 orë
Liqeni i Qafë Thores – Gropa e Portës	30’
Kampi i Punëtorëve – Shtegu i Dhenve	1 orë e 15’
Gropa e Portës – Gropa e Radohimës	1 orë e 30’
Gropa e Radohimës – Radohimë	1 orë
Qafa e Majave Binjake – maja Binjake (cilado prej tyre)	deri 30’
Qendra e Thethit – Gumnarë (Shpella e Rrathëve)	50’
Gumnarë – Fusha e Dënellit	1 orë e 10’
Fusha e Dënellit – Qafa e Boshit	1 orë
Qafa e Boshit – Lugbat	deri 4 orë
Lugbat – Gavën	1 orë e 15’
Gavën – Qafa e Majës Eklips	1 orë e 30’
Qafa e majës Eklips – Qafa e Shtegut (për të ra në Valbonë)	1 orë


Marrë nga ditarët e Aci-t (Aleksandër Bojaxhi)

.....

Në vitin 1978 ose 1979 në një seminar për kualifikimin e trajnerëve u paraqit edhe materiali i përgatitur si më poshtë.

Në atë seminar, në hyrje të referimit, theksova se alpinistët sa më shumë ngjitje bëjnë aq më shumë përvojë fitojnë; aq më shumë kuptojnë se trimëria e tepruar është marrëzi, aq më shumë kuptojnë se vështirësia dhe rreziku nuk rrinë bashkë.

Sigurisht që puna për t'i mbledhur, ndonëse e thjeshtë në dukje, ka vështirësi sepse kërkon të takohesh me alpinistë për të mësuar dhe sqaruar ndodhitë e pakëndëshme. Dhe përvoja e mbledhjes së tyre tregoi që secili i spjeron, me raste edhe i justifikon/i përligj sipas mënyrës së tij. Shpesh ndodhitë ndërthuren me momente psikologjike dhe në këto raste është dashur të takohen disa nga pjesëtarët e avarisë. Kjo ishte e vështirë për arësye kohore, por tek e fundit këtu do rradhiten ndodhitë. Gjithësesi punën e regjistrimit të ndodhive të pakëndëshme alpinistike e quaj të filluar. Po rendis ato ndodhi personale edhe të të tjerëve që i kam vlerësuar si më të vlefshme për përvojë për lëvizjen alpinistike. Uroj që kjo punë e filluar të plotësohet hera herës.



Viti 1951

Në muajin gusht organizohet ngjitja në majën e Hekurave. Ishte koha dhe ishin vite kur çdo veprimtari sportive në mal konsiderohej alpinizëm. Veprimtaria kishte shpirt gare; kush do të ngjitet i pari në majë. Në ngutje e sipër dikush (lart) "lëshon" një gur që godet (poshtë) pjesëmarrësin Arben Kalaja. Ky ndërroi jetë.

1953

Me rastin e 11 janarit organizohet gara alpinistike (kështu quhej) Sheshi Skënderbej – mali i Dajtit. Një pjesëmarrës ndërën jetë në Fushë Dajt. U tha që “e pati nga ngrirja”. Në këto lloj garash pjesëmarrësi firmoste për dakortësinë për pjesëmaarje. Nuk organizohej, ose kërkohej document për kontroll mjeksor.

1956

Mali Korab, muaji shkurt. Tregoi Taxhedin Shehu

Zajmet Elezi dhe Taxhedin Shehu verbohen nga sytë (konjuktivit demeti) për mungesë të syzeve mbrojtëse nga rrezatimi diellor.

1959

Shtegu i Dhenve. Muaji gusht. Tregoi Andon Tapia

Po ngjiteshim dy dyshe në dy litarë të ndryshëm, Andoni dhe tre alpinistë nga Çekosllovakia (ne për shkurt, si çekët dhe sllovakët, i thërrisnim çekë (mes tyre ishte një femër). Ngjiteshin në shkëmbejtë në të majtë të Shtegut. Zuri shi I rrëmbyer dhe e ndërpreme ngjitjen. Tek ktheheshin Andoni udhëhiqte. Në një vend të zbritjes Andoni futet në një lug duke u shkëputur paksa nga tre çekët. Gjykoi se lugu ishte më i thjeshtë dhe më i shkurtër për zbritjen. Çekët nuk e ndoqën. Ai zbriti shpejt dhe në mbarim të zbritjes u fut nën një strehë shkëmbore për tu mbrojtur nga shiu. Pas dy a tre minutash qetësie Andoni dëgjon që çekët po e thërrisnin (Andoni ka mbaruar studimet për edukim fizik në Çekosllovakia). Ai nxjerr kokën në drejtimin nga vinin thirrjet dhe shikon treshen që fillon të komunikojë me të.

- O Shën Mëri! Gjallë qënke!!..
- Përse, si është puna, u përgjigj ai
- Sapo kalove ti në lug ra rrufeja; goditi një shkëmb dhe copat e tij u vërvitën në lug. Thamë se me siguri do të të kenë goditur!

Unë, tregoi Andoni, as pashë e as dëgjova gjë. Isha i motivuar të largohesha sa më shpejt nga shiu.

MORALI i rastit.

Për sigurinë në mal thënia “Shpejtësia ëshë shpesh baraz me Siguri” është e vërtetë për rastin.

1959

Valbonë. Maja e Brijasit. Tregoi Andon Tapia

U nisëm për ngjitje në majën e Brijasit, unë, Vangjel Melengu dhe tre alpinista çek (në fakt ata ishin sllovakë të klubit alpin të Bërnës). Lartësia e pjesës qëndrore të shkëmbit ishte e tillë që grupi u përgatit disi edhe për të kaluar natën diku në faqen shkëmbore.

Kur e ndërpreme kacavarjen e ditës së parë ishte errur. Tre çekët që kishin edhe përvojë më të mirë se ne gjetën një vend dhe ranë për të fjetur. Por edhe Andoni me Vangjelin në terr bënë si bënë dhe gjetën një vend për të fjetur.

Natën Vangjeli zgjon Andonin. Nga lart vazhdimisht binin gurë dhe gjendja ishte shqetësuese për të. Ata të dy ishin të lidhur me litar dhe të siguruar me kunja/plenga të ngulura në shkëmb. Andoni vazhdoi gjumin, por tashmë me copa. Ai e dinte se në errësirë nuk kishin se çfarë masash të tjera të merrnin. Porse Vangjeli mbeti i shqetësuar dhe nuk fjeti më. Kur u gdhi ata panë se po flinin sipër tapës së një tymtaje/kamine/oxhaku.

Vazhduan ngjitjen, por fakti se ishin të pangopur me gjumë, fakti që kishin marrë masa për të fjetur në shkëmb por nuk kishin marrë masa me ushqime të mjaftueshme, si dhe droja nga rënia e gurëve bënë që ata të mos kishin më gjallërinë e duhur për të shkuar më tej. “E lamë për hijë gjë daljen në majë. Kishim edhe shqetësimin se pasi të dilnim në majë, nga do të ktheheshim?” Me këto fjalë e mbylli tregimin Andoni.

Si përfundim: grupi nuk ishte i plotësuar me ushqimin; nuk kishte studjuar itinerarin dhe nuk kishte njohje për rrugën e zbritjes. Po të dilnin në majë, zbritja në itinerarin e ngjitjes do zgjatej më shumë orë/kohë nga sa orë dritë kishin përpara.

Përfundimi: Nuk duhet të niset alpinisti në një itinerar pa i studjuar dhe peshuar të gjitha kërkesat që do realizimi i tij (ngjitje e zbritje).

1959. maja Vishencit. Muaji Korrik. Tregoi Vasil Vreto

Kryhej ngjitje në pjesën jugore të Vishensit, në një faqe shkëmbore të lëpirë. Në litar janë dy gjermanë dhe Vasili në mesin e litarit. Për dy hove çdo gjë kaloi mirë. Në hovin e tretë gjermani filltar (udhëheqës i itinerarit) me emrin Jorg, heq këpucët dhe futet në një pjesë të lëpirë me një sqetë në të. Ai u mundua shumë, por më së fundi ai i doli sqetës majtas, “rrëshqiti” barkas dhe doli mbi sqetë! I erdhi rradha Vasilit të fillojë kacavarjen. Kur arriti tek sqeta u mundua shumë por nuk mundi ta kalonte. Vendosi të bënte sikundër bëri Jorg. Kur mori të “rëshqasë” barkas, fluturon e bie 4 metra poshtë e ngelet i varur në kunj/plengë. Nuk e humbet toruan. I hipën një fuqi e forcë morale e tillë që i kapur mbas litarit ngjitet deri sipër tek Jorg. I treti i litarit në këtë pjesë u ngjit si kovë sepse ishte i dobët nga krahët.

Si përfundim: në stërvitje duhet që kacavarsi të ushtrohet në rënie. Kjo ndihmon që në raste të ngjashme gajtë kacavarjes të mos humbasë toruan.

1959. Maja Vishensit 2.517 m. Tregoi Vasil Vreto.

Muaji korrik. Në kthim nga ngjitja në majën e Vishensit duhej të kalohej një sipërfaqe jo e vogël me borë të ngrirë. Kalojnë nëpër këtë borë me rradhë Vasil Stambuli, Vasil Vreto, Andon Tapia. Edhe duke rrëshqipur edhe duke u përplasur por pa dëmtim serioz. Kur fillon zbritjen Tefta Zguro, edhe ajo rrëshqet. Ajo përplasat tek shokët që e prisnin poshtë borës së ngrirë, por dërmohet dhe gjakos nofullën në thërmaqkat/valin që fillonte pas borës.

Si përfundim: të gjithë këta ishin të mbathur me këpucë atlete dhe ky pësinm nuk ka nevojë për komente. Atletet nuk janë këpucë për relief të mbuluar nga bora apo akulli.

1959

Maja e Harapit.

Në veprimtarinë me alpinistë gjermano lindorë, Koço Qafëzezi i afrohet, me grupin e tij, itinerarit ku do të fillonte kacavarja. Duhej të kalonte një sipërfaqe bore të ngrirë. Ishte i mbathur me këpucë atletike. Rrëshqet dhe përplasat fort me shputat në një shkëmb. Shëmbet keqas. Përfundon në spital në Shkodër.

Përfundimi: lloji i këpucës duhet t’i përshtatet reliefit. Për rastin nuk kishte sigurim me litar dhe sejcili ngjitej si të donte.

1959

Mali i Valit. Sezoni veror. Tregoi Vasil Vreto

Në një tymtajë/kamina/oxhak të këtij mali ngjiten dy gjermanë dhe Tefta Zguro. Lidhen me dy litarë të njëpasnjëshëm 40 metroshtejçili. Gjatë ngjitjes hera herës binin gurë (val = gur që bien ga mali - ab). Kur ende nuk ishin ngjitur mjaftueshëm, një gur i madh bie përpara fytyrës së Teftës dhe këput litarin. Dëmtim nuk patën. Treshja e alpinistëve ndërpret ngjitjen dhe kthehet.

Përfundimi: nuk duhej të ishin futur për kacavarje në këtë mal, emri i të cilit, Valit, domethënë mali i gurëve që bien.

Edhe rrëzë malit të Alisë (ana e Valbonës) kemi një lug të rrezikshëm nga rurërenia, “Lugun e Valit”. Gjermanët kanë synuar edhe ngjitjen e faqes jugore të malit të Harapit. Itenerari që morën kishte gurërenie. Në këtë rast ata u kthyen që në metrat e para të kacavarjes.

1960

Qafa e Zhabores. Dhjetor. Tregoi Kozma Grillo.

Katër alpinistë të shquar për kohën: Kozma Grillo komandant, Vasil Stambuli. Petraq Kule, Mustafa Selenica pasi kishin bërë disa ngjitje në Alpe, disa ditë pa ndërprerje, ulen nga Qafa e Zhabores për të dalë në Rrogam. Itenerarin e zbritjes nuk e njohin, andaj ecin me kujdes. Jo rrallë kur alpinistët janë të lodhur në momente kritike të komunikimit bëhen të paduruar. Janë çaste kur kapitja dhe makthi për të arritur në bazën më të afërt e lënë pas gjakftohtësinë dhe ulin kujdesin për tu siguruar. Me ta ndodhi një gjë e tillë. Mustafai punonte i lidhur në një litar me Petraqin. Fillojnë të bëjnë fjalë dhe Mustafai zgjidhet nga litari. Petraqi alarmohet /shqetësohet dhe njofton me zë emocional:

- Kozma, Mustafai u zgjidh nga litari. Kozmai me Vasilin që ishin përpara në këtë zbritje ndalën. Lodhja i kishte kapluar edhe këta të dy dhe kjo bëri që Kozmai të ulurijë në mënyrë të pa kontrolluar, të pazakontë për natyrën e tij:
- Xake! (bunimi për Mustafanë – ab). Lidhu! uluriti ai.

Kjo ulurimë nuk ishte urdhër për të sepse nuk kishte urdhër që të thyente/ndryshonte lodhjen dhe tensionin nervor të asnjërit prej tyre (shokëria e tyre ishte superiore). Kjo ishte një klithmë e jashtëzaakontë e dalë në një moment nga gjoksi i një alpinisti në një moment psikologjik të veçantë që vuri në lëvizje vetëdijën e Xakes për tu lidhur. Pas kësaj edhe Mustafai vazhdoi zbritjen i suguruar. Pas minutash Mustafai rrëshqet. Ishte teren me akull dhe Mustafai fluturoi në një vend të pjerët që mbaronte me një humnerë në pyllin mbi shtratin e sipërm të lumit të Valbonës. Një pamje tronditëse për grupin dhe një klithmë tjetër e Kozmait: Petraq siguro!

Kazma e Petraqit hyri thellë në borën e ngrirë dhe Xakja u siguraa!

Ky është një rast i një jete të shpëtuar e cila kish nevojë të shpëtohej me klithma jo të zakonata, mbasi lodhja dhe tensioni i zgjatur nervor nuk i linin vend arësyes.

Përfundimi: dita e punës duhet të llogaritet mbi bazën e kapacitetit fizik të grupit. Përgjithsisht dëmtimet dhe veprimet e gabuara, për arsye të mospërgatitjes së duhur fizike, ndodhin në fillim dhe në fund të ditëve të veprimtarisë.

Kalimi i Shtegut të Dhenve në udhëtimin dimëror Bogë – Theth e tregoi qartë shëmbullin. Sa e sa alpinistë kanë humbur ekujlibrin e janë rrëzuar në këtë shteg i cili përdoret ditën e parë të veprimtarisë dhe ditën e fundit, në atë të mbylljes të veprimtarisë. Sa të tjerë vendosin pikën e pestë në borë dhe e kanë lënë veten të lirë nën ndikimin e forcës së gravitetit. Sa e sa të tjerë i kanë lëshuar rancat e shpinës ose i kanë tërhequr zvarrë ato! Alpinizmi të kërkon të aftë fizikisht dhe psikologjikisht nga dita e parë e deri në ditën e fundit të veprimtarisë.

1960

Maja e Papllukës, 2569 m. Tregoi Vasil Vreto

U organizua ngjitja e parë në maajën e Papllukës. Ecnim në lugun poshtë majës, megjithëse nën borën e butë kishte akull dhe borë të ngrirë. Ecnim njëherësh bashkë dhe fare të shkujdesur në drejtim të sigurimit, unë Shpresa dhe Gori. Pa prituri para nesh ngrihet një tym (bore), si një mjegull (bore). Ne filluam të çvendosemi poshtë për dhjetra metra dhe kur çdo gjë u qetësua ne mësuam se ndodheshim disa dhjetra më poshtë nga vendi ku pamë “tymin”. Ne na kishte marrë orteku, shënja e parë e nisjes së tij kishte qenë tymi. Fatmirësisht kjo situatë përfundoi me një tronditje të treshes, tronditje që kaloi shpejt në gjendjen normale të sejcilit për të vazhduar dhe për të arritur majë.

Dy përfundime që lidhen më sigurinë gjatë ngjities:

1. Nuk duhet të udhëtohet në një lug bore (apo gurësh) sepse ai është rrugëkalimi I mundëshëm i ortekut.
2. Në rast se nën borë kemi akull ose borë të ngrirë, siguri nëpërmjet litarit është i domosdoshëm.

1960

Tregoi Taxhedin Shehu.

Alpinistë të qytetit dhe nxënës të shkollës Pedagogjike nisen për Korab për nder të 29 nëntorit. Një nxënës ngrin. Kalon pa ndjenja. Mungesë përgatitje fizike. E fërkojnë nga organi seksual dhe deri në kokë. Shpëtoi.

Ngjitje lokale në Korab. 29.11.1960

Tregoi Taxhedin Shehu

Alpinistë të Peshkopisë dhe nxënës shkolle i ngjiten malit. Ushtarë nga Posta Kufitare i ishin dhënë grupit si shoqëruesë. Rrëshqet njëri ushtar dhe shkon rreth 100 metra poshtë. E mori veten pas 4 orësh.

Koment: ushtarët e pikave kufitare malore nuk kishin në programet stërvitore dhënien e njohurive për lëvizjet në tokën e mbulluar me borë dhe akull dhe as kishin kthetra etj.

1960

Ngjitje, në sezon veror në Çekosllovakë. Tregon Andon Tapia

Kthehesha nga ngjitja me një çek. Për të shkurtuar rrugën po ecnim në një borë të butë. Pjerrësia e terrenit erdhi dhe u shtua dhe nga bora kaluam në akull. Çeku ndaloi dhe mbathi kthetrat. Unë nuk i vura. Vazhduam zbritjen. Unë rrija prapa çekut, jo më shumë se një metër pas tij. Pasi bëra disa hapa rrëshqita. Tek rrëshqita u kapa tek këmbët e çekut. Ai në çast e kishte siguruar shumë mirë veten dhe më mbajti edhe mua.

Koment: unë e neglizhova relievin. Çeku jo, madje ai me kujdesin e tij për veten më mundësoi që të “gjeja” siguri tek ai.

1960

Në takimin ndërkombëtar me alpinistë të Republikës Demokratike Gjermane. Sezon veror. Tregoi Vasil Vreto

Ekipi ynë, Minella Kapo, Tefta Zguro, Vasil Vreto dhe trajneri i ekipit të rinjve të R. D. Gjermane nisen për ngjitje. Vasili kërkon të udhëheqë itenerarin. Edhe Minella kërkon të njëjtën gjë. Kështu që u ndanë në dy litarë: Vasili me gjermanin në një litar dhe Minella me Teftën në një litar tjetër.

Ngjiten në të njëjtin itenerar. Fillimisht Vasili me gjermanin kurse Minella e Tefta pas disa minutash. Itenerari u bë i vështirë nën një ballkon (e dalë) që për tu ngjitur mbi të më shumë se çdo gjë të ndihmonte shtatlartësia. Kur i erdhi rradha Minellës për të dalë mbi ballkon, ai rrëshqet dhe bie. Tefta nuk i kishte sistemuar si duhet litarët kur u nis Minella. Asaj litarët i ishin ngatëruar tek këmbët. Me rënien e Minellës litari tërhiqet dhe merr me vete edhe Teftën. Bien të dy dhe ngelen të varur në një plengë. U dëmtuan që të dy, por në mënyrë të veçantë Tefta, të cilës ja mobilizuan këmbën me allçi. U ndihmuan që të ulen poshtë nga dy alpinistët e tjerë të cilët po i prisnin në majë të shkëmbit ku ishin ngjitur.

Koment: Tefta tregoi moskujdesje për mënyrën se si duheshin sistemuar litarët para se të nisej Minella. Por edhe ky duhej të kishte hedhur një sy tek litarët që kishte poshtë vetes. Kacavarja kërkon që dyshja ose treshja e ngjitjes të jetë gjithnjë e kujdesëshme për çdo çast të saj; pra kërkon kujdesje kolektive.

1963

Ngjitje lokale në korab

Tregoi Taxhedin Shehu

Ishte një ngjitje lokale në malin e Korabit.

Rrëshqet një nga ushtarët që i ishte dhënë grupit si shoqëruas dhe shkon rreth 100 m poshtë...

Ju dha ndihma, por për 4 orë ushtari mbeti pa ndjenja. Ndihma mjeksore ju dha në Postën Kufitare. U bë mirë dhe pëfundoi po n'atë postë shërbimin ushtarak.

Koment i përsëritur: ushtarët e pikave kufitare malore nuk kishin në programet stërvitore dhënien e njohurive për lëvizjet në tokën e mbulluar me borë dhe akull dhe as kishin kthetra etj.

1963

Veprimtari lokale në Korab. Një ushtar rrëshqet rreth 100 metra. Nuk kishin litar. Ndënji pa ndjenja për katër orë. E shoqëruan dy pjesëmarrës të veprimtarisë poshtë ku dhe erdhi në vete. Erdhi mjeku i zonës.

Koment i përsëritur: ushtarët e pikave kufitare malore nuk kishin në programet stërvitore dhënien e njohurive për lëvizjet në tokën e mbulluar me borë dhe akull dhe as kishin kthetra, etj.

Maja e Vishensit, 2.517 m. Tregoi Andon Tapia

Në pjesën lindore të malit organizohet një ngjitje shkëmbore me të gjithë pjesëmarrësit e ngjitjeve shkëmbore të asaj vere. Bëheshin gjithsej 10-12 vetë dhe drejtoheshin nga alpinisti Andon Tapia. Grupi kishte alpinistë të rinj, me shkolla alpinizmi të plotësuar, por pa përvojë ngjitjesh të mirëfillta. Por përveç Andonit grupi kishte edhe alpinistë të tjerë që kishin përvojë për kohën, si Tefta Zguro dhe Mustafa Selenica. Në ngjitjet e kësaj vere të gjithë alpinistët, të grupuara në një litar me nga tre veta, futeshin në të njëjtin itenerar të gjithë. Konkretisht treshja Andon Tapia, Tefta Zguro dhe Mustafa Selenica do të futej (fillonte itenerarin) e para dhe pas tyre do ngjiteshin një nga një treshet e tjera.

Kur treshja e parë kishte bërë një farë përparimi në drejtim të majës, rreth një litar mbi udhëheqësin e treshes (filltarin), pra mbi Andonin, ndjehet/kuptohet se një shkëmb i madh me përmasat e një tavoline, rrëshqet. Ai fluturon në ajër dhe godet një shkëmb rreth 10 metra në krah të Andonit. Shkëmbi u coptua

dhe copat fluturuan nga të gjitha anët. Njëra nga ciopëzat godet Andonin në vetullën e majtë dhe i shkaktoi rrjedhje të madhe gjaku. Ndërkohë u krijua një ortek gurësh i cili mori drejtimin dhe u fut në lugun ku ngjitej Tefta. Atë e goditën disa nga këta gurë, por pa e dëmtuar. Kur Tefta u ngjit deri tek Andoni, ajo vuri kujen teksa e pa atë të gjakosur. U krijua panik, më i theksuar tek treshet e tjera, sepse treshja e parë e vazhdoi ngjitjen dhe arriti majën, kurse të tjerët jo.

Për këtë rast të papëlqyeshëm mund të themi se:

1. Rënia e gurëve ishte diçka e pa shmangëshme nga alpinistët.
2. Mungesa e kaskave/helmetës (asnjë në grup nuk kishte) ishte një minus i madh. Vetëm FATI bëri që dëmtimi nga gurët të shihej si asgjë për tu shënuar (se dhe gjaku në vetullën e Andonit pushoi shpejt).
3. Mungesa e një paketë të ndihmës së shpejtë është e pa përligjur.
4. Është gabim taktik futja e të gjithë alpinistëve në të njëjtin itinerar.
5. Përbërja e grupit me alpinistë heterogjenë në përgatitje dhe përvojë është edhe gabim taktik edhe gabim Teknik.

MORALI i rastit. Nuk kishte nevojë për fjalë kjo ndodhi. Kishte nevojë për një vendim i cili u bë pjesë e rregullores: në një itinerar ngjitet jo më shumë se një litar me alpinistë, derisa ata të kenë mbaruar punën.

1964

Maja e Jezerës. Lartësia 2.694 m. tregoi Kozma Grillo.

Me rastin e 23 nëndorit, dita e formimit të Rinisë Komuniste Shqiptare, nisen drejt majës së Jezerës katër alpinistë me komandant Kozma Grillo. Moti është me një ditë shumë të nxehtë për stinën. Ngjiten të zhveshur nga mesi e lart që të nxihen nën rrezet e diellit. Pasi kalohet traversa e Jezerës së vogël, si me magji moti mjegullon, shpejt ngrihet era, fillon bora dhe të katër anëtarët e grupit ndjejnë të ftohtë të tmershëm. Braktisin menjëherë synimin. Filluan zbritjen. Tendën e gjetën të ngrirë, sikundër edhe çdo gjë tjetër aty. Trupi i tyre tashmë ishte në një temperaturë ndoshta rreth 20°C më të ulët brënda një kohe shumë të shkurtër. Po i afroreshin Qafës së Pejës thuajse të ngurosur nga të ftohtit. Tendën e tërhiqnin zvarrë sepse nuk u punonin duart për ta palosur dhe për më tepër ajo që në kthim ishte e ngrirë. Mjegulla e dëndur nuk u mundëson që në Qafën e Pejës të futen në shtegun e zbritjes. Sorollaten për të gjetur shtegun për gati një orë të ngrirë për vdekje nga të ftohtët. Era për një çast u hapi luginën e Thethit nga mjegulla. Në këtë moment Kozmai arriti të orjentohej dhe ata ulen deri në lagjen Okol. Ishin të ngrirë në gjymtyrë dhe trup, por fshatarët dhe kufitarët e patrullës që u gjendën aty i ndihmuan dhe ata u ringjallën pa patur asnjë cem.

Përfundimi: ky është rast që nuk di se çarë të thuash. Më kapriçot e natyrës mos e paç fat të ndeshesh. Grupi alpinistëve nga fshatarët mësoi një përvojë të tyre: në Qafë Pejë në nëntor fryn era e parë e dimrit e cila e ndron menjëherë motin. Kur je jashtë kjo erë është e vetmja gjatë gjithë dimrit që mund të të shkaaktojë vdekjen ngaqë trupi është i papërgaatitur për zbritjen e papritur të temperaturës dhe njeriu gjendet pa veshjen e duhur për ta përballuar

Personalisht në moshë të re kam perjetuar rritjen e nivelit të ujit në lum (kjo ndodh edhe me përroin) kur diku, qoftë edhe disi larg bie një shi lokal. Tregimi i Kozmait më mësoi se edhe malet kanë një orë të keqe: erën e parë dimërore të muajit nëntor.

1965

Shkolla e alpinizmit në Dajt (sezoni dimëror). Toga e drejtuar nga Vasil Vreto po punonte zbritjen Dylfer. Në kohën që zbriste Mehmet Malaholli (Elbasanas) litarët e zbritjes lëvizën një gur i cili ra drejt e në kokën e MM i cili po zbriste/ulej. MM ju çka koka dhe humbi ekujlibrin dhe ndjenjat. Zbriti duke u përdorur litari i sigurimit nga lart dhe e nisën drejt e në spital.

Ky dëmtim nuk do të kishte ndodhur nëse vendi i lëshimit/uljes me litar do ishte pastruar nga gurët e lëvizëshëm, si duhet. Thanë se e kishin pastruar, por ajo që ndodhi tregon se pastrimi nuk ishte i duhuri.

1965

Çuka Partizane. 2.396 m. tregoi Aleksaandër Bojaxhi

Shoqata (SHTASH) ishte në vitin e dytë të krijimit të saj dhe e nisur nga dëshira e mirë për të përhapur ngjitjet alpinistike malore, nisi kërkesën që nga çdo qytet të marrin pjesë sa më shumë të rinj për të ngjitur Çukën Partizane. Për pjesëmarrje u dalluan Berati si dhe Elbasani me 12 të rinj të cilët erdhën në mal të veshur me tuta, madje disa prej tyre me këpucë futbollit në mungesë të këpucëve të malit.

Për drejtimin e veprimtarisë u caktua një alpinist Beratas i cili ishte njohës me përvojë të itinerarit të ngjitjes. Në nisje patëm mot me shi dhe mjegull. Më sipër filloi të fryjë erë dhe në një lartësi të caktuar rënia e shiut u kthye në rënie të një borë kokrizore. Sa më lart që ngjiteshim aq më e dendur u bë mjegulla, edhe më e fortë era, e cila e fluturonte keqas borën e ta përplaste në fytyrë.

Më kujtohet që ndërkohë që po ecja në borë të ngrirë, me dy anëtarë të ekipit të Fierit (dy muaj më parë kisha filluar punë si mësues në gjimnazin e Patosit), po qëndronim në fund të kollonës. Papritur, me vrull për teposhtë, fillojnë të vinë pjesëmarrës në këtë veprimtari, me vrap dhe të gëzuar.

- Ku po shkoni!, pyes i habitur ata që më erdhën pranë.
- Kanë dhënë urdhër të kthehem. Nga mjegulla është humbur drejtimi.

Ishte një vrapim jo në kollonë, por frontal dhe në kaos të plotë. Në çast ndaala dhe mbajta dy shoqëruesit e mi, të cilët ishin dy mundësa të mirë/cilësore që drjtuesit e Klubit Aplollonia mi kishin dhënë për numur, që të plotësohej kërkesa që i kishte ardhur klubit nga lart për tu përfaqësuar. U thashë që ne do të qëndrojmë në fund të grupit në këtë zbritje. Mjegull ishte, por besoj se distanca e “kollonës” që zbriste, nga i pari tek i fundit (trashja jonë) ishte e madhe.

Gjatë zbritjes, në distanca të ndryshme nga njëri tjetri, hasëm një alpinist të Beratit, gati të ngrirë por të pafuqishëm që e ndihmuam me masazh, portokalla dhe me “fjalë të ngrohta”. E vumë në lëvizje me hap të pranueshëm. Më tej takojmë tre alpinistë të Elbasanit. Njëri prej këtyre kish pirë konjak që të nxehej (!!!!) dhe ishte shtrirë në një ferrë për gjumë, ndonëse bora binte. Një i dytë (Dyli) ishte i ngrirë. Qurrat nga hunda i vareshin deri në mjekër. Ja zgjata mëngët e tutave dhe ja kalova dotën e majtë e pastaj të djathtën para hundës dhe ja fshiva qurrat. Pastaj i bëmë masazh dhe e rrafëm pak që të nxehej. U përmend. Por nuk kish fuqi të lëvizte. E morrëm të tre, jo nga një herë, me rradhë në kuriz. Pastaj....

E çarë do kishte ndodhur sikur edhe ne tre që mbyllnim kollonën të ishim ulur me vrap, në hesapin tonë?...

Përfundimi: ky ishte një organizim skandaloz që në nisje të ekipeve. As përgatitje fizike e pjesëmarrësve, as përgatitje teknike, as veshje, as... Masivitet absurd!!!

Dhe diçka shumë e rëndësishme: komandant grupi nuk caktohet një person që njeh itenerarin. Ai duhet, por ky rast tregoi se njohja e itenerarit nuk është aspak kërkesë që personi të “dekretohet” komandant i grupit.

Ky rast u bë temë e një diskutimi në Shoqatë.

1967

Maja Jezerës 2.694 m

Alpinistët në veprimtarinë e sezonit veror fillojnë zbritjen nga maja. Një i ri nga Berati shkau në borë; doli nga shpati i borës dhe pasi bëri dy salto në ajër bie dhe nuk lëviz në tërmaçka/val me vetull të çarë keqas. Një i ri i ekipit të Studentit i afrohet me shpejtësi për ta ndihmuar. Kur e sheh me gjak beratasin, i bie të fikët.

Përfundimi: me alpinistët e rinj në ngjitje duhet të tregohemi shumë të kujdesëshëm. Në këtë rast i vetmi mjet sigurimi ishte kazma. E pamjaftueshme për rastin.

1968

Maje e Shtegut të Dhenve 2.315 m. Tregoi Aleksandër Bojaxhi

Në synimin e realizimit të një ngjitjeje në itenerar të kategorisë së gjashtë të vështirësisë Aleksandër Bojaxhi dhe Petraq Rista, të dy të ekipit Apollonia e Fierit, në kuadër të stërvitjeve për tu nisur për kacavarjet mbi Qafë Pejë caktojnë një itenerar në një faqe shkëmbore dhe në pjesën e më të nxehtë të itenerarit, filltari lodhet nga krahët dhe bie. Ndjekësi punoi mirë me sigurimin e shokut dhe dëmtimi i Aleksandrit ishte minimal me përjashtim të kokës (ishte pa kaskë/helmet; nuk kishte dhe nuk ishte kërkuar ky artikull) mbasi i ran ga lart majthi/çekani i tij dhe e gjakosi.

Përfundime: Aleksandri mori përsipër rolin e filltarit për të gjithë itenerarin sepse Petraqi ishte alpinist i ri. Dy partner me përvoja ekstreme është gabim të futen në itenerar të vështirë. Plus, filltari duhej të ishte më aktiv, më i shpejtë në veprime tek metrat ku u shpëput nga shkëmbi.

Vazhdim për kuriozitet: ky itenerar u tentua edhe një vit më vonë. Por kur dyshja e kaloi pikën e nxehtë si më sipër, moti u prish keqas dhe ata u detyruan të zbtasin/lëshohen poshtë nëpërmjet litarit, ndonëse në metrat e fundit u lagën si ajo punë, madje edhe më tej, deri në kampin e Thethit.

Përsëri një vit tjetër më vonë ngjitja u realizua nga treshja Aleksandri, Nasi Shtëmbari dhe Vullnet Zylyftari. Përsëri moti u keqësua, pasi kaluan pjesën e nxehtë, dhe ata disi i shpëtuan rrebeshit duke futur kokat nën një shkëmb, Por më tej, rrugës për në majë filltar u bë Vullneti: duke qënë trupmadh për atë strehë shkëmbore, mbërdhiu dhe rinisi ngjitjen.

Kur arritën në majën e Shtegut, doli dielli dhe na ngrohu dhe na thau kënaqshëm.

1968

Po këtë ditë më Rabë, në Çardakun e Bogës, u ngjitën Vangjel Melengu, Petrika Janaq dhe Agim Tabaku. Ngjitja zgjati shumë dhe kthimi nga maja u bë natën. Tek zbrisnin, në pyll buzë një honi bie Petrika dhe dëmtohet rëndë.

Përfundime: kur një itenerar realizohet për herë të parë duhet të peshohen shumë mirë të gjithë element që i kërkon itenerari. Kjo gjë nuk u bë. Ekipi minimalisht: duhej të ishte nisur më herët dhe të ndalonte dhe të mos udhëtonte natën. Nuk kishin ndriçim për natën.

1968

22 dhjetor 1968. Tashmë ishte krijuar bërthama e ekipit alpinistik Apollonia e Fierit. Katër nga anëtarët e ekipit siguruan leje për largim nga puna me synim që të kalohej kreshta e malit të Tomorit nga maja jugore, 2396 m në majën veriore, 2416 m.

Ekipi arriti majën jugore, kaloi një orë të këndëshme në strehimin e ushtrisë në këtë majë (repart ndërlidhje) dhe mori rrugën e kreshtës. Fjetën në kreshtë dhe të nesërmen teksa udhëtonin, Petraqit, teksa ecte mbi borë pranë një formacioni shkëmbor, këmba e majtë i zhytet tërësisht në borë dhe godet me tërë peshën trupore gjurin në një të dalë shkëmbore nën borë.

Rezultati i kësaj të papriture: Petraqi u bë çalaman, me dhimbje të gjurit dhe me paaftësi për të mbajtur rancin e tij.

Katërshja braktisi synimin dhe morri rrugën e kthimit. U ul në një stan, nën vijën e borës, mbi fshatin Ujanik.

Pëfundimi: nuk duhet të marshohet pranë zonave borë-shkëmb. Në këto relieve, vende vende, nën borë shkëmbi i ngrohur nga rrezet diellore, shkrin borën në sipërfaqen e saj dhe krijon zgavra bore.

1969

Prill. Maja e Hekurave, 2.5671m. Tregoi Shefki Juma.

Një grup alpinistësh të udhëhequr nga Mj Sportit Kozma Grillo nisen nga fshati Bogë dhe kalojnë përmes Alpeve duke ngjitur një sërë majash. Kishin kaluar ditë ndër male dhe tani do ngjiten në majën e malit të Hekurave (maja e Paqes). Arritën në Qafën e Droçes të lodhur. Tashmë janë në etapën e fundit të ngjitjes: nga qafa për në majë, kreshta apo sikundër e quajmë rëndom, kurizorja për në majë. Prijnë rrugën alpinistë të ndryshëm duke u ndëruar në krye njëri pas tjetrit. Më në fund shfaqet maja, por deri atje është një kreshtë e akulltë. Komandanti urdhëron: Lidhuni! Alpinistët nxjerin litarët dhe më së fundi të gjithë janë të lidhur nga dy ose nga tre në një litar kolektiv (40 m). Vjen radha të kalojë edhe litari ku është i lidhur komandanti i grupit të renditur në litar: i pari Kristaq Korçari, i dyti Shefki Juma, i treti vetë Kozma Grillo. Pasi Kristaqi filloi marshimin dhe ndali kur u hap litari midis tij dhe Shefkiut, ai nguli kazmën në borën e ngrirë dhe kaloi litarin në pozicion sigurimi. Niset Shefkiu. Ky, pasi bën disa hapa rëshket dhe shkon teposhtë në një pjerrësi që është rreth 300 metra e gjatë... Por i siguruar si duhet nga të dy shokët e litarit ai ndalet. Nguli kazmën dhe hodhi 1 a 2 hapa duke u siguruar që është në pozicion të mirë. Dihaste dhe ngriti kokën duke ju drejtuar komandantit:

- Kozma! E di se çfarë thashë me vete pak më parë?
- Hë, çarë – e pyeti Kozmai.
- Ama dhe ky komandanti ynë, për këtë vend këtu na thotë të lidhemi!?

MORALI i rastit për një alpinist: Kuptimi i vështirësisë nuk duhet ngatëruar kurrë me atë të rrezikut!

Maja Rabës. 9 gusht. Tregoi Aleksandër Bojaxhi

Në një faqe shkëmbore të majës së Rabës së Bogës (Çardakut) në itinerar të vështirësisë mesatare (3-4) ngjiten Mario Trinkera filltar, Egerem Prokopuca dhe ?????? ndjekës. Itinerari ishte premierë. Grupi humbi/kaloi shumë kohë në ngjitje dhe në majë ariti natën. U ulën deri në lartësinë rreth

2.000 metra dhe aty pranë një zjarri që ndezën kaluan natën. Kjo natë kaloi e papëlqyer jo vetëm për treshen e alpinistëve por edhe për shokët në kampin alpin që i humbën nga sytë kur ra muzgu.

Përfundimi: itenerari që kryhet për të parën herë duhet të studjohet plotësisht dhe të mendohet edhe për orët e kthimit. Në rregulloren e sigurimit Teknik thuhet që, grupi duhet të braktisë synimin e ngjitjes së majës në dimër në orën 14:00 dhe në verë në orën 16:00.

1969

Muaji maj. Shkëmbi Përmetit. Tregoi Aleksandër Bojaxhi

Në anë të qytetit të Përmetit dallohet një shkëmb rreth 30 metra i lartë. Në maj të vitit 1969, ditën e festës së 24 Majit, dyshja Aleksandër Bojaxhi - Maridon Hito, sipas shortit, do fillonte ngjitjen në këtë shkëmb. Në pikën më të nxehtë të itenerarit, ndërkohë që filltari siguronte ndjekësin, ky bie. Dy plenga/kunja të sigurimit për të ndërtuar “ulsen/karigen” nga filltari shkulen nga shkëmbi. Por pikat e tjera sigurorese e bënë punën e tyre dhe dëmtim nuk pati. Ku ishte gabimi?

Që të bjerë alpinisti dhe të mbetet varur, kjo është normale. Çështja është se nga nevoja për bazë materiale ka marrë rrugë, aty ku ka patur mundësi, që alpinistët të prodhonin vetë bazë materiale. Më shumë se çdo gjë kunja/plenga. Për rastin në fjalë këto nuk ishin të duhurat.

Në sportin tonë gjatë stinës së verës dhe jo vetëm, në pajimet e ekipeve shikon plenga/kunja nga më të habitëshmet, majtha/çekanë nga më fantastikët, kazmat alpine, etj. Mendoj se megjithë se këto materiale po na shërbejnë për të realizuar ngjitjet, Shoqata (Shoqata Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar) duhet të vërë dorë për standardizimin e prodhimit të pajimeve alpinistike, në pamundësi për t'i sjellë ato nga jashtë.

Po në këtë shkëmb alpinisti YM tenton që të ngjitet në një kohë që ai nuk e kishte përvetësuar teknikën e kacavarjes. Ai kishte marrë pjesë në një kurs (zbor) alpinizmi. Kështu, nga dëshira për tu ngjitur në shkëmbin e qytetit të tij, ai merr një litar të cilin e lidh në përmjet dhe i kërkon një shoku të tij që t'i bënte sigurim nga poshtë. Ishte dëshira e tij që të ngjitej dhe kur arriti në metrat e fundit dhe mendohej se “ja hodhi”, ai bije duke mos patur pika ndërmjetëse sigurorese. Ai jeton dhe është mes nesh falë një fiku që ka mbirë natyrshëm në rrëzë të shkëmbit. YM ra ne fik dhe veç tronditjes dhe ca gërvishjeve nuk pësoi gjë.

Përfundimi: nëse në rastin e parë e papëlqyera ndodhi sepse cilësia e bazës matëriale ishte jo ajo që e kërkonte relievi, në rastin e dytë ishte ngutja, dëshira për një arritje tej aftësive teknike. Dëshirat përtej aftësive fizike dhe teknike të çojnë në aventurë/trashndeshje.

Shënim dt 25.10.2025 (ab). Kjo histori ka të vërteta brënda. Por në kohën e diktaturës, kohë kur janë hedhur këto shënime, nuk mund të tregoja thelbin e dështimit të dyshe AB e MH.

Me Ylli Mullarain, para marrjes së kësaj letre, isha takuar gjatë një veprimtarie dhe nga biseda për dështimin e tij, si dhe përshkrimin që më bëri për pjesën e nxehtë e lart të itenerarit, mësova se ngjitja do jetë pa probleme nëse mrrerren një a dy pyka druri si dhe shkallare.

Këto pajime nuk ishin në arsimnalin tonë atëhere. Në vend të shkallës ne hipnim në supet e njëri tjetrit. Rastet për përdorimit të pykave i zgjidhnim me kunja më të trashta apo dhe me bërjen e dy kunjave horizontalë bashkë.

Nejse. Unë, me shoqëri, realizova/prodhova dy shkallë: njërën me dy shkallare (druri) tjetrën me tre (sot: në anglisht: aiders = capan me dy ose tre shkallare). Po kështu dhe dy pyka me trshësi të ndryshme dhe në pjesën e trashë të tyre me nga një vrimë ku kalonte litari 6 mm. Litari lidhej lak që shtrënguar/apo liruar lunate rrolin e veshit ku futej karabina. Këto sjime i mësova nga literatura BRSS e kohës.

Koha tregoi se ne na kishin thirrur për dekor në Përmet. Qyteti duhej të gëlonte nga veprimtaritë që u organizuan me rastin e Jubileut të festës së 24 Majit. Ishim ftuar nga Shoqata jonë një numur i kufizuar alpinistësh nga ekipe të ndryshme. Vinte e gjithë Byroja Politike e PPSH për festën. Na kontrolluan dhe mbasdite vonë u përpilua një listë me emrat tanë, etj, dhe ju dorëzua ekipit që siguronte Byronë.

Na porositën që të mos lëviznim nga çadrat deri në një urdhër të dytë. Çadrat tona ishin jashtë qytetit dhe pranë Guri të Qytetit (atëherë kjo pjesë konsiderohej “periferi”)

Në mëngjes na thonë të marrim ndonjë litar e ca pajime dhe të vendoseshim diku midis çadrave dhe Gurit. Kështu dhe bëmë.

Pastaj na jpin urdhër që të fillojmë ngjitjen. Mua më kishte rënë shorti që të isha litari i parë. Vetëm dyshja jonë u lejua të lëvizë dhe mora të shkoj në çadër që të marr pajimet si më sipër. Por dikushi aty më thotë me zë të lartë NDAL. Nejse, ndala dhe komunikova dhe i spjegova nevojën që kisha për dy lloje pajimesh që ishin në çadër që më duheshin për të ngjitur Gurin. Nuk më lejoi të shkoja. Ku ishim ne e ku ishte Byroja Politike (në qendër të qytetit). Ishte një absurditet që të më pengonin. Përfaqësuesi i Shoqatës më tha të filloj “se ka rëndësi të kuptohet se veprimtaria jonë filloi”.

Zëmërthyer fillova ngjitjen dhe, pasi kalova ca kohë tek pika e nxehtë dhe nuk përparaja më tej, vjen urdhëri që ceremonia në qytet mbaroi dhe ne alpinistat mund të lëviznim si të donim, por aty rrotull. Pas dyshes sonë rradhën për ngjitje e kishin beratasit. Fillova zbritej dhe njëherësh komunikova me Petraqin dhe i tregova ku ishin pajimet që kisha përgatitur.

Dyshja beratase Toli Biqiku dhe Petraq Kule ishte dyshja që për herë të parë u ngjit mbi Gurin e Përnertit nëpër itenerarin në fjalë.

1969

Maja e Alisë 2.471 m. Fillim i sezonit veror.

Një grup alpinistësh zbresin majën nëpërmjet koridorit të Alisë. Ende ka borë që në një farë mënyre i mban gurët e koridorit “të lidhur”. Por në shumë vende ata dalin mbi borën e ngrirë. Rrëshqet njëri prej tyre dhe i merr të tjerët përpara. Të gjithë këta troshiten dhe gërvishten nëpër gurët e koridorit.

Morali: në koridore (veçanërisht në të Alisë) alpinistët duhet të qëndrojnë sa më pranë me njëri tjetrin. Kështu, guri që merr rrokullimën do ketë fuqi të ulët goditëse tek shoku më poshtë. Duhet që njëherësh alpinistët të kenë kaskë/helmetë.

Gjatë stërvitjeve vjetore duhet të ketë edhe tema praktike që alpinisti të mësojë të rrëshqasë në akull dhe borë të ngrirë i veshur me këpucë. Dhe duhet që gjithnjë të jetë me kazëm.

1969 Nëntor

Ishte fundi i muajit dhe bora e fillim dimrit kishte kohë që kishte rënë në atë mal. Nga ana e Liqenit të Ponareve do ngjisnim majën e Hekurave (mali i Marroces). Ishim **ekipi i Fierit, me shumë pak përvojë**, si dhe **ekipi i Tropojës** në përberjen e të cilit **shumica vinin për të parën herë në një veprimtari alpinistike**. Në ekip edhe dy vajza.

Ndërronim njëri tjetrin për çarjen e dëborës. Pas një ore ngjitje të lodhëshme, relievi u alternua me një brez dëbore të ngrirë që në vazhdim u pasua me akull! Akull në këtë muaj!?... Në mal të papriturat nuk mungojnë dhe për djall ne **nuk kishim marrë kthetra!**

Me ndihmën e kazmës alpine filluam të hapin quka për vendosjen e këmbëve. Bëra gabim dhe **nuk udhëzoja që të lidheshim me litar** e të përparonim nëpërmjet sigurimit të njëri tjetrit. Për një moment puna për hapjen e qukave, rrjeshtimi i grupit dhe sfondi malor, të gjitha së bashku, krijonin një pamje e cila ja vlente të fiksohej në aparatin fotografik. U shkëputa për të fotografuar dhe mora për në anë të shpatit për të dalë në një brinjë ku mendoja se ishte vend i mirë për të fotografuar. U kapa në një shkëmb dhe u tërhoqa pas tij. Nga forca e peshës sime **shkëmbi u shkul!** Ai kishte qënë i rrethuar me akull dhe kështu **nuk pata mundësi që të dalloja se në fakt kishte qënë gafërr, një gur i madh**, që kishte ngecur në brinjë. Mora të tatëpjëtën me shpinë mbi akull dhe për një çast tërë inat ktheva kokën për të parë gafërrin e mallkuar: i tmerruar shoh se edhe ai po rrokulisej, mbi mua, e madje po më afrohej. I dhashë trupit përpara me shpresë se do të shtoja shpejtësinë e rëshqitjes por kjo bëri që çanta e shpinës të më kërcejë mbi zverk dhe të rrokullisem me dy salto në ajër. Në salton e dytë tek isha kokëposhtë pashë se ‘ndjekësi’ u ndesh në një xhungë akulli e u nda në dy copa që morën drejtime të tilla që unë mbeta në mes të tyre e pra edhe jashtë rrezikut që të ‘kapesha’ e goditesha prej tyre. Kisha shpëtuar për mrekulli nga goditja por jo nga rrëshqitja. Më duhej të frenoja por **kazma më kishte fluturuar nga dora** në salton e dytë. **Isha në mëshirë të fatit** ngase po shkoja drejt një gremine dhe çdo tentativë që ndërmerja për të frenuar ishte pa fryt. Anova paksa trupin djathtas duke mbledhur njëherësh këmbën e djathtë. Kjo më mundësoi që të marr të kthyer djathtas e të kaloj jo më shumë se dy metra buzë greminës e më pas trajektorja e rëshqitjes më largoi gjithnjë e më shumë drejt terenit më të favorshëm e jashtë çdo rreziku.

Së fundi frenova e ndala: mbas akullit erdhi dëbora e ngrirë dhe themrat, të cilat i përdorja gjatë gjithë kohës pa rezultat për te frenuar në akull, këtu dhanë rezultat. Ndënja vetëm një çast i shtrirë e i lëshuar në dëborë për të mbledhur vehten dhe më pas u ngrita ndënjur. Vërtet që kisha shpëtuar për mrekulli! Ngita kokën lart nga shokët e thirra: Lidhuni e sigurohuni me litar!, gjë që duhej ta kisha bërë me kohë.

Hoqa çantën e shpinës nga krahët dhe u ngrita në këmbë. Pashë me kujdes sipër: mbi 200 metra kisha fluturuar teposhtë me shpejtësi rrufeje. Ende po rëshqisnin drejt meje sende të dala nga çanta: furça e dhëmbëve, elektriku i dorës, aparati fotografik, dorezat, kokorja. Dhe më e habitëshja, Sabahu i shtrirë sa gjatë gjërë ishte pak mbi mua! Sikundër më spjegoi më vonë, ai duke parë se po shkoja drejt humnerës, ishte sulur që të më dilte përpara duke skiuar, për të më ndaluar ose për të më ndëruar drejtimin e rëshqitjes. Meqë **nuk dinte të përdorte kazmën** për kësi rastesh, mëndja i kish thënë që ta mbante atë midis shalëve andaj dhe me të humbur pak ekuilibrin ai dëmtojë kofshët me teshun e majën e kazmës si dhe u rrokullis mbi akull deri sa ndali në dëborë. Komunikuam dhe meqë nuk kishte gjë shqetësuese, të dy filluam të ngjiteshim lart duke mbledhur njëherësh materialet e shpërndara.

Skena e sapo mbyllur e rëzimeve shkaktoi tronditje dhe shqetësime thuajse tek kushdo andaj dhe me tu bashkuar me grupin nuk komentova gjë. Fakti që nuk kishim kthetra bëri që gjithkush të tërhiqet nga synimi për të ngjitur edhe ato pak metra që tashmë kishin mbetur deri për në majë. Ndërkohë arriti edhe Sabahu i cili nga dëmtimet e pësuar lëvizte ngadalë. Sadria u kujdes që ta mjekojë kurse unë, pasi u lidha me litarin që më lëshuan nga lart, arrita tek një qafëz ku Shemshedini më siguronte në të vetmin vend ku mund të rrije ndënjur.

U lidha me litar, sigurova mirë aparatin fotografik dhe i them Shemshedinit duke e parë drejt e në sy, “Po nisem.” Ai nuk foli por pasi kisha hapur gjurmët e para duke thyer me kazëm akullin, më thotë: “Sandër, te po bjen prap!” Meqë ai po më siguronte, ja ktheva: “A po ke hallin se po të marr me vehte?”

Megjithatë ai kuptoi ironinë e përzjerë me humor, buzagaz ma ktheu tek i nguli më mirë themrat në qukat e hapura në pozicionin sigures: “Jo, jo! Mundet me ndodhë e merr një shkamb tjetër me vedi por jo mue. Vazhdo se nuk të lëshoj!”

Vazhdova të hap qukat e të shoqëroj me bisht të syrit trajektoren e copave të akullit që shkëpusnin goditjet e kazmës: ato më bënin të kjarhtë trajektoren që do të kisha edhe vetë nëse do të humbisja ekuilibrin. Ato shkonin drejt e poshtë tek një curr prapa të cilit qëndronin Miranda, Sadriu Isufi e Sabahu. Qukat i punova të mëdha e të afërta me njëra tjetrën në mënyrë që, në mungesë të kthetrave, të lëvizja me tërë shputën e këmbës.

- Edhe gjashtë metra litar të kanë mbetur për të vazhduar. - u dëgjua thirrja e fortë e siguresit tim. Meqenëse në zonën përfaqë meje nuk kishte asnjë mundësi sigurimi u pozicionova mirë dhe kërkova e

prita që të shtohet një litar i dytë në atë siguruesin. Gjithkush u angazhua në zgjatjen e litarit sigurues e shumë shpejt u dëgjua “E ke gati. Vazhdo!” Dhe vazhdova. Qëlluan të ishin edhe 15 metra punë me akullin dhe më pas vinte dëborë e përshtatëshme për gjurmë dhe ecje të sigurtë. Shpejtova hapat dhe arrita tek ata hunj që formonin një shënjë për topografët. Në gjithë lartësinë e kësaj shënje era e kishte ngjitur dëborën me konfiguracione nga më të çuditëshmet. Ngula fort kazmën në dëborë e thirra duke u drejtuar me pamje tek grupi, “Të bëhet gati e të niset tjetri.” Në çast erdhi përgjigja nga Shemshedini: “**Ulu tash se nuk asht ka vjen kush.**” Ndonëse i habitur për atë që dëgjova, nuk fola. Për pak kohë u mora me fotografime: fotografova kazmën time në anë të piramidës së drunjtë, gjurmët e arritjes në majë si dhe pamjet përreth. Pas pak lëshova në drejtim të shokëve një, “Ee” për të parë se çfarë reagimi do të merja, dhe kur dëgjova “Nisu!”, fillova një ulje tepër të kujdesëshme.

Sa më sipër është nxjerrë nga ditari im. Gabimet e mia si drejtues janë shënuar në tekst **bold**. Por nuk është shkruar fakti që unë u ndjeva fajtor dhe fajtori u ngjit I vetëm sepse demoralizoi të tjerët.

1970

Radohima. Tregoi Piro Liko

Ngjitej normalisht. Në krye të itinerarit mbërthen për pikë kapje një gur. Dhe fluturon poshtë me gur në dorë duke rrëshqitur në pjerrësi bore. Nuk pati dëmtime serioze. Pati tranditje.

Përfundimi: ishte humbje e vëmendjes. Pikat e kapjes dhe ato të mbështetjes duhen kontrolluar para se të kalosh peshë në to.

1971

Mali Robdeshit në lindje të Peshkopisë. Muaji shkurt. Tregoi Taxhedin Shehu

Dy alpinistë të ekipit të alpinistëve Allaman Hoxha dhe Flamur Shehu, një ushtar i shërbimit kufitar dhe 14 nxënës të shkollës Pedagogjike të qytetit nisen në muajin shkurt që të ngjiten në majën e malit. Arrijnë në shpat të malit që ishte i çveshur nga bimësia. Grupi ishte pa kasma, pa sigurim me litar dhe duke lëvizur në kolonë të “ngjeshur” pranë me njëri tjetrin. Lloji i terrenit dhe pesha e njerëzve në segmentin e borës ku marshonin krijuan ortek dhe 15 prej tyre i vë përpara orteku. Ajo që rezultoi në fund ishte se dy alpinistët që ishin në krye të kullonës, dhe që i përfshiu boshti i ortekut, ndëruan jetë.

Rastet e pa pëlqyerave në lëvizjen malore masive, diletante në njohje me malin, elementët atmosferikë në mal dhe kalimit të relievit, ndodhin më së shumti në Peshkopi e Berat. Këto qytete, të pozicionuata pranë maleve me joshje për ngjitje, mali i Korabit dhe mali i Tomorit, kanë më shumë veprimtari masive dhe për pasojë kanë më shumë të papëlqyera gjatë veprimtarive. Shkaqet e kërtyre të papëlqyerave janë kryesisht tre:

1. Grupet krijohen me të rinj e të reja pa përgatitjen e duhur fizike;
2. Grupi nuk ka përvojën e duhur për veprimtarinë që ndërmerr;
3. Besimi i tepruar në mundësinë e arritjes së qëllimit nga drejtuesit e grupeve.

Ka ardhur koha që Shoqata të mendojë se si duhet të veprohet që kjo lëvizje malore të kontrollohet për:

- a) drejtuesit e veprimtarive masive si dhe
- b) për të caktuar itinerarët e ngjitjeve që janë, mundësisht, pa probleme lidhur me sigurinë e jetës.

Të përgjithëshme

Shumë nga të papëlqyerat që ndodhin japë si pasojë e mungesës së bazës materiale. Në muajin shkurt 1956, kohë kur për të parën herë u ngjit nga alpinistët shqiptarë maja e Korabit, Taxhedin Shehu dhe Iqmet Elezi verbohën nga mungesa e syzeve kundër rezatimit diellor. Dhe lista e verbimeve vazhdon me alpinistë të tjerë. Kështu i ndodhi Lamë Nikas nga Korça më 1970. Po këtë vit Gazmend Shaba i Klubit Partizani nga dhimbet e syve largohet nga veprimtaria dhe shkon në Tiranë ku shtrohet për dy javë në spital. Një student në vitin 1969 verbohët në atë masë sa nuk mundet të lexojë dhe detyrohet të braktisë studimet. Në vitin 1972 një tjetër alpinist i KS Partizani, për tre ditë mbeti i verbër dhe me dhimbje të tmershme në sy. Vangjel Melengu në vitin 1968 për disa ditë mbetet i verbër nga rezatimi në borë.

Edhe sa të tjerë duhet të verbohën që alpinistët të kujdesen që të bëhen me syze?

Sa këmbë e duar alpinistësh kanë ngrirë deri më sot? Kujtojmë se në janar 1968 nëntë nga 11 alpinistët e grupit për të ngjitur Majën e Madhe u shtruan në spital për ngrirje. Prej këtyre gjashtë më rëndë: njërit i prenë një gisht këmbë dhe të tjerët kanë edhe sot në këmbë e duar kanë shënjat e ngrirjes dhe megjithatë këpucë e doreza me cilësi minimale alpine ende nuk kemi. A mundet të kërkojmë me të këtilla kondita të bazës materiale cilësi sportive?

Sa e sa herë në kacavarjet shkëmbore kërcasin gurë në kokat e alpinistëve në mungesë të helmetës. Fatmirësisht deri tani nuk ka ndodhi fatale.

Shpesh alpinistët vuajnë për ujë në stinën dimërore sepse nuk kanë primuse/furnelë për të shkrirë borën. Le pastaj që gjatë dimrit kanë vetëm ushqim të ftohtë, me raste të ngrirë dhe me ujë të akullt, borë ose heje akulli shuajnë etjen.

Sigurisht që të gjitha sa më sipër ndikojnë negativisht si në shëndetin e alpinistit ashtu dhe në sigurinë dhe cilësinë sportive.

KËTU mungon një faqe e origjinalit.

Të mëvonëshme

1971

Maja Harapit. Itenerari Veri-Lindor. Tregoi Aleksandër Bojaxhi

Rrjeshtimi në litar: Nasi Shtëmbari filltar, ndjekës Vangjel Zeno dhe Aleksandër Bojaxhi. Të tre anëtarë nga ekipi Apollonia e Fierit.

Në hovin e tretë të ngjitjes Nasi del nga guva dhe kapet në pllakën e rradhës duke u ngjitur me sukses dhe duke ngulur kunjat siguruese. Papritur atij i shkulet nga shkëmbi pllaka ku ishte mbërthyer për të kryer një lëvizje të matejshme dhe fluturon në ajër. Pas 4-5 metrash mbeti i varur në kunj/plengë. Në moment e mbledh veten dhe vë të gjitha forcat që të ngjitet në pikën ku u shkëput nga shkëmbi. Dhe thirri: Vangjel fikso litarin – dhe me një dorë e tërhoqi atë duke mbajtur pjesën e tërhequr me dhëmbë derisa ndjeu që litari u tendos. Pastaj i kapur pas litarit u ngjit deri në pikën ku ndodhi shkëputja. Nguli një plengë/kunj dhe i shndehur/shtensionuar shkoj nëpër mëndje momentin e shkëputjes. E gjithë kjo ndodhi për të, sikundër tregoi, si një moment i vetëm, sepse ai ishte i mobilizuar në synimin që “riparimi” të bëhej sa më i shpejtë.

Përfundimi: ngjarja tregoi se Nasi veç përgatitjes së mirë fizike kishte edhe përgatitje të mirë psikologjike si dhe bindje që siguruesi ishte i besueshëm.

Rastet e shkëputjes së alpinistit nga shkëmbi janë jo të pakta. Zorr se gjen alpinist të kualifikuar që të mos jetë shkëputur nga shkëmbi. Refleksi i reagimit dhe aftësitë e fituara me përvojë për të vepruar janë vendimtare. Stërvitja se si të orientohemi kur shkëputemi nga shkëmbi (edhe për rrëshkitjet) është e nevojshme.

Në këtë ngjarje, pas rigrupimit të tretë, kur fillon Aleksandri (mbyllës në litar) kacavarjen, nga lart i vjen një copë pllake shkëmbore në madhësinë e një disku të atletit që e flak atë. Në momentin që ai e pa atë, Disku” ra në kaskë. Ishte e para herë në jetën e tij sportive që ai ngjitej me kaskë.

Përfundimi: në ngjitjet alpinistike mbajtja e kaskës është mëse e nevojshme; është domosdoshmëri.

1971

Kalaja, Shtegu Dhenve. Tregoi Aleksandër Bojaxhi

Dashamit Fejzo sapo mbaroi kacavarjen në një itenerar të shkallës së tretë të vështirësisë, zgjat dorën dhe tërhiqet për të dalë sipër në Kala të Shtegut. Nuk e kuptoi, por ai kishte kapur një gur dhe fluturon me të në dorë poshtë. Për fatin e tij bie në një pjerrësi që i “zbuti” goditjen. Dëmton shputat e këmbëve dhe njërën themër. U transportua në krahë dhe me kafshë barre në Bogë. Më tej bashkë me ekipin e tij u nisën për në Shkodër.

Komenti: pikat e kapjes dhe të mbështetjes duhet të kontrollohen para se të kalohet pesha trupore në to.

1971

Shtegu i Dhenve itenerari tetë (I8). Tregoi ekipi 17 Nëntori

Në momentin që DK do bënte rigrupim kupton që nuk i mjafton litari që ka. E tërheq atë për të marrë litar por ndodhi që atë e tërhoqi litari. Shkëputet nga pllaka shkëmbore dhe ngelet i varur në litar por pozicioni i tij në shkëputje ishte i tillë që mbeti lavjerës dhe u përplas me faqen e shkëmbit. Nga goditja në shkëmb

ju thye kocka e kofshës dhe pati vështirësi të rikuperohej. Pati probleme të zgjatura pas operacionit të dytë me të cilin i hoqë pjesën metalike të vendosur për lidhjen e kockave.

Përfundim: Ky rast lidhet me mosnjohjen e gjatësisë së mjaftueshme të litarit për të kaluar nga një pikë siguruese në tjetrën.

1977

Bridashe 24.03.77. Tregoi XYZ

Gjatë zbritjes nga maja e Bridashit, në një vend disi problemati në aspektin Teknik, dy drejtuesit e togave, YM dhe QB, vendosën që të zbrisnin njëra pas tjetrës duke lidhur dy litarë një pas një në sigurimin e zbritjes. U kundërshtua kjo mënyrë, si e gabuar, por drejtuesi arritën ta bindin masën. Ishe lajthitja më pa mend që ka ndodhur në lëvizjen alpinistike

Kur alpinistët e kreut të zbritjes kishin arritur në një vend të sigurt, rrëshqet në zbritje e sipër një alpinist i Vlorës që ishte pak më lart dhe merr me vete gjithë ekipin. Ky ekip merr me vetë edhe katër ekipet e tjera të këtyre dy togave. U krijua një lëmsh me njerëz dhe litarë që po shkonin drejt greminës. Ajo që i shpëtoi nga fatkeqësia ishte rastësia (ishin alpinistë nga Vlora, Përmeti, Peshkopia, Elbasani). Dy veta patën dëmtim serioz.

E përsëritur:

E tregoi Xhevat Osmani (KS Labinoti Elbasanit)

Ngjitja për në majën e Bridashes filloi në datë 24.03.1977. Kaluam nëpër ulluk ndërmjet dy pishave të mëdha dhe ngjitëm/kapëm majën e parë rreth orës 12:30. Prej kësaj arritëm majën e dytë të Bridashës në orën 14:30 dhe pas kësaj arritëm në majën kryesore të Bridashes.... Mbasi pushuam pak, rreth orës 15:00, filloi zbritja.

Zbritja do të bëhej nga shtegu i fshatarëve që përdorej gjatë verës tek kullosnin bagëtitirë. Koha ishte shumë e mirë por kjo rezikonte shkrirjen e borës dhe mundësinë për ortek. Në këtë kohë dy komandantët (ishin bërë bashkë dy toga) bisedojnë që për zbritjen, nëpër këtë shteg të vështirë, pa u dëmtuar, duhej që të lidheshin bashkë të gjithë litarët që kishim (njëri pas tjetrit). Në fillim nuk pranua sepse mund të rezikoheshim të gjithë. Por pasi na u bë e kurtë me argument se pasi të ulet trashja e parë, meqë nuk e njohim vendin, e siguruar nga ne të tjerët, u bindëm. Kështu si u tha dhe u zbatua. Këtë urdhër e dhanë YM dhe QB, i cili fillimisht kundërshtoi, por më pas u pajtua me këtë vendim të gabuar (lajthitje).

Fillimisht u zbatuan të gjitha rregullat, duke mbajtur distancë, duke bërë zig-zage dhe me qetësi (pa bërë zhurmë). Porsa mbaroi zbritja e lugut, ku i ruheshim aksidentit të mundëshëm, dhe filluam të dalim në shkam (vend pa borë); I pari Ylli, I dyti Zabit Tusha, I treti Xhevat Osmani, në kohën që thamë me vete se shpëtuan, rrëshqet komplet ekipi i Vlorës, duke marrë me vete ekipin e Përmetit dhe të Peshkopisë dhe kur ata arrijnë tek ne, ata kishin marrë shpejtësi aq të madhe sa sigurimi ishte i pavlefshëm.

Pashë me sytë e mi katastrofën e madhe. Njëzet e ma tepër alpinistë, të gjithë djem të rinj, po i drejtoheshin humnerës. U ba një lëmsh i pazgjidhshëm njerzish, litarësh dhe kazmash alpine (aq sa më vonë e këputëm litarin sepse nuk shqiteshim dot). Më vonë, nuk mbaj mend shumë, por ne rrokulliseshim dhe rrëshqisnim si top Në momentin përfundimtar, kur prisnim me sy hapur vdekjen tpinë, katastrofën

e madhe, litari na frenon në vend. U shkundëm nga bora dhe pamë me sytë tanë se ishim një metër larg greminës që mund të ishte afërsisht 200 metra e thellë.

Sigurimi ynë nëpërmjet litarit, sikundër u mësua më vonë ishte bërë nga dy alpinistët e fundit të kollonës dhe të ekipit të Labinotit, Kujtim Hoxha dhe Seit Gajdja. Nga ky aksident dolën të dëmtuar dy alpinistë të ekipit të Vlorës. Mbas kësaj që ndodhi u mblodhëm, i dhamë ndihmë shokëve të dëmtuar dhe zbritëm nëpërmjet një ulluku tjetër dhe rreth orës 20:00 mbritëm në kamp.

Marrë nga ditari i një alpinisti Firma (duket se është firma e Xhevat Osmanit).

Koment: lidhja e dy litarëve bashkë ishte lajthitje.

Plus. Në vitin 2023 gjatë një dreke me alpinistë elbasanas, në Elbasan, Seit Gajdja më tha: Profesor, nuk i majta ata unë me Kujtimin. I majti fërkimi i litarit me trungun e pishës ku ishim ne, të majës së litarëve. Kur pamë se çfarë po ndodhte poshtë nesh, u hodhëm në anën tjetër të trungut në pozicion sigurimi (ab).

1977

Në dimrin e vitit 1977 ndodhi e papëlqyera më e “madhe” pa fatalitet në historinë e alpinizmit tonë. Një grup alpinistësh, teksa ngjiteshin në majën e Jezerës, nga ana perëndimore e saj, rrëshkasin dhe dëmtohen. Më rëndë Rushit Reçi. Po e sjell këtë ndodhi të papëlqyer me dy letra që më erdhën nga pjesëtarët e këtij aksidenti.

Aleksandër!

Jam shumë mirë me shëndet, ashtu edhe shokët. Përsa i përket Rushitit, dje bisedova në telefon dhe është duke u përmirësue (ishte ende në spital – ab).

Lejen e kufirit po ta dërgoj me letër prurësin (*nuk e kuptoj përse-ab*) dhe njëkohësisht po të tregoj se si ndodhi ngjarja.

Në orën 05:00 jemi nisur nga Posta Verore 6 dibranë, 3 shkodranë dhe Vullneti i Beratit, me të gjitha pajimet me vete: litarë, kazma, kthetrat, karabinat. Në orën 07:20 u lidhëm rrëzë Jezerës (nga ana e Popllukës) në një litar me synim ngjitje në një itenerar të vështirë: Rushiti, Taxhi, Dulla, Vullneti. Ecnim me sigurim dhe duke hapur shkallare me kazëm dhe duke futur kthetrat dhe kambën thellë.

Në kohën kur po ngjiteshim në majë, Rushiti u ngjit traversë nga akulli dhe ypi (hipi) sipër në afërsi të majës. Në kohën kur unë po prisja të më siguronte Rushiti dhe unë të avancoja më sipër. Kur ngrej kokën shikoj Rushitin të palosur me kokën mbrapsht po fluturonte drejt shkamt. S’kam pas kohë të lajmëroj shokët por jam hedhun në drejtim të shkamt duke e zanë me trupin tim me qëllim që koka dhe trupi i Rushitit të mos bien në shkamb por në trupin tim. Mbasi trupi i Rushitit bie në trupin tim, e mbërthej me të majtën dhe me njëbrem (??) në akull, rrëshqitja që e madhe. Deri në një farë vendi Rushitin e kam pasur unë në kohën kur litari ka shkuar në maksimum tek Dulla më ka dhanë kolpo në gjoks dhe në këtë kohë Rushiti mu largue nga durët dhe pastaj kemi tërheqë njeni tjetrin (është fjala për Taxhedinin, Dullën dhe Vullnetin, sepse Rushiti ishte i palidhur). Në shumë moment kam veten në pozicion frenimi, pra tërhiqim njëri tjetrin. Në fund e kam parë veten. Mirë por krahun e djathtë nuk e lëvizja. I kem thanë Vullnetit ti qisi gjuhën Rushitit; u munduem por nuk mundëm, pastaj i kemi fut kazmën (në gojë –ab) dhe i kemi qit gjuhën. Pastaj kemi zbrit.

Kjo qe e gjitha. Minella, Kozmai e Shili janë interesue dhe kanë lujtun rolin e hetuesit. Thuaj dhe atyre se unë nuk do të vdisja, se mundem t'i tregoj vetë se si më ndodhi.

Për fat të gjithë shokët janë mirë dhe do të sqarojmë punën në Komitet të Fiskulturës, Ministri të Arsimit, dhe deri tek shoku Enver, sepse mjaft kanë shkruar me intriga.

Në fund e kam parë veten mirë por krahun e djathtë nuk e lëvizja.

Të përshëndes, Taxhi

.....

Letra për Aleksandrin e postuar nga Vullnet Zylyftari më 10 janar 1978

I dashur Aleksandër!

Dëshiroj që letra ime të gjejë mirë me shëndet ty dhe gjithë familjen tuaj!

Ka kaluar një kohë e gjatë që kur duhej t'i përgjigjesha letrës tuaj duke menduar që Komisioni Teknik dhe Komiteti (Kryesia-ab) i Shoqatës duhej të na thërriste, edhe sikur me paret tona, mua dhe Avdullah për aksidentin. Nuk iu përgjigja në kohë letrës. Pastaj çdo gjë shkoi sipas rurtinës të zakonshme; u bë dhe u vendos pak në mënyrë tendecioze.

Aksidenti ndodhi më 9 mars ora 8 e 55'. Një ditë para aksidentit u thirrëm ne si përgjegjësa ekipi (isha unë për Beratin sepse Petraqi qëndroi në Theth).

Në shtab Vasili, Kozmai, Azemi, etj. U diskutua për ngjitjet dhe ushqimet. U vendos që unë, Taxhedini, Gëzimi të zbrisnim në Theth për ushqime, mbasi nuk na duheshin ato ngjitje (për efekt të ngritjes në kategori sportive – ab).

Megjithatë Taxhedini tha se “unë nuk e lë pa bërë Jezercën” se ajo ngjitje i kish mbetur.

Vasili tha që “djema nesër ora 5:00 në ngjitje me Taxhin për Jezercë, Papllukë, Ali”.

Me të nesërmen u nisëm për rrugë të tre së bashku me tre alpinista të shkodrës dhe gjithë ekipin e Peshkopisë. Unë kisha qejf të ngjitesha me Dullën se e kish për herë të parë Jezercën në dimër.

Kur ndahej (grupet për ngjitje – ab) ngjitja për Jezercë u ndamë në dy grupe. Pesë vetë: unë, Gëzimi, Taxhedini, Rushiti dhe Avdullah për Jezercë dhe grupi (pjesa) tjetër për Papllukë.

Filluam ngjitjen nga ana jug-lindore. Në verë i jemi ngjitur bashkë nga ana ku shkëmbejtë janë blloqe blloqe si mur. Gjatë rrugës Gëzimi u grind me Avdullah; Rushiti mu ankua se “më mbërdhijnë këmbët”, dhe e gjati vetë arësyt duke më thënë se “i ka, shtrënguar fort kthetrat”.

Vazhduam lugun deri rëzë shkëmbejve, ecëm pa u lidhur me litar. Dukej rreth 80-100 m që të ngjiteshim në majë. Itenerarin e kish studjuar Taxhi dhe e udhëhiqte Gëzimi. Në realitet ne duhej të ecnim pak më djathtas, të futeshim në lugun e madh. Aty u futëm në një lug të vogël që kishte ngjitje të kategorisë IV shkëmbore. U ngjit Gëzimi me ndihmën e kazmës. Rushiti kërkoi të lidheshim; u lidh vetëm Rushiti dhe e

siguronte Gëzimi. Lugu ishte si oxhak dhe si i tillë rëzonte gurë. Gëzimi e Rushiti qëndronin në një vend të sheshtë 1x0.8 m. Gëzimi kontrolloi rrugën dhe tha “Unë kaloj”. Rushiti tha me gjysëm zëri “kalohet”.

Duke e parë situatën Taxhedini urdhëron Rushitin të zgjidhet dhe sigurohemi ne të tre. Rushiti thotë – “po ne çfarë të bëjmë”? Taxhedini përgjigjet: “do të hedhim litarin nga lart”.

Ndërkohë rrëzë shkëmbit lëviza unë i pari sa më lejonte litari dhe bëra sigurimin për shokët, të rregullt. Bora për çudi rrëzë shkëmbit ishte e shkrifët, siç duket rëzohej nga lart ngaqë nuk e zinte dielli. Për çudi e lëviza kazmën disa herë deri sa gjeta një vend që bora kishte taban. Ndërkohë lëvizi Abdullahi. Bërtet Gëzimi.

“O Taxhedini! ejani shpejt se ky nuk po qëndron. O Rushiti, Rushiti çfarë bën”? Në fillim unë nuk pandeha se do binte, se e pashë vendin; të paktën në këmbë qëndroje pa u mbajtur. Kur thirri “o Rushiti” ngrita kokën. Gëzimi ishte rreth 1.5 m më lart (meje) por 0.5 m larg Rushiti seç belbëzonte. Gëzimi e kishte kapur prej jake të peliçes. Taxhedini gjindej më afër tij, rrëzë lugut, 3-4 m rrëzë shkëmbit që kishte hipur Rushiti, ku fillonte oxhaku i cili është rreth 3 m i lartë.

Taxhedini shkëputet me shpejtësi dhe në momentin që ai (Rushiti) bie, e pret duke i rënë shpatullat e Rushitit mbi supin e djathtë të tij (Taxhedinit). Rushiti u shkëput me kuriz, (kështu që) edhe i lidhur të ishte për efekt të qendrës së gravitetit dhe asaj (dhe faktit) që ne nuk kishim kunj për të siguruar, do vdiste, por amortizimi i goditjes duke rënë në Taxhedinin ai i shpëtoi vdekjes. Rëshqitja (vazhdojnë në letër 5 fjalë të pa lexueshme).

Ndër kohë u bërtita. Avdullahi e kishte kaluar litarin rreth kazmës dhe ishte ngjeshur mbi kazëm. Vendi shumë i pjerrët, rreth 75 gradë pjerësia, largësia e rrëshqitjes rreth 20 m nga Avdullahi e shkëputën nga bora me gjithë kazëm si një masë. (Një çast) më vonë e njëjta gjë ndodhi edhe me mua. Pësova një tendosje të fortë dhe pastaj fluturova. Fakti që ju shmangëm humnerës gjatë rrëshqitjes për efekt të pjerrësisë së malit gjë që e vërteton ajo që duart e djathta na u dëmtuan më shumë se në momentin që isha në ajër unë e lëshova kazmën që kisha para gjoksit, ajo u rrotullua. Kur do kemë rënë të tokë (borë të ngrirë ose akull – ab) do të më jetë këputur rrip që e kisha futur në dorë.

Në mënyrë instiktive kam bërë edhe shumë akrobacira gjatë rrëshqitjes sa qëndronim në lug atje Taxhedini pasi ngrejme kokat se ishim të katër përmbys,

Ndihmojmë Rushitin të cilit i bëmë frymëmarrje sepse ishte i asfiksuar, gjuha i kishte kaluar poshtë. I thyem dhëmbët e parë (për ti nxjerë gjuhën – ab), i stabilizua frymëmarrjen, pastaj unë e mora në prehër për ta ngrohur por ai mblidhte trupin dhe vinte duart në stomak.

Ndërkohë erdhi ndihma e grupit tjetër, e shokëve që ishin nisur më vonë, e ulëm (Rushitin) në Theth. Edhe Gëzimi kishte zbritur kur erdhën shokët e tjerë.

Unë mendoj se sikur të kishim pritur sa të zbriste Rushiti me Gëzimin mundet që do e eliminonim rrezikun. Por për efekt shpejtësie ne manovruam ndryshe duke menduar se nuk i bie të fiktit kur udhëton të paktën 3.5 orë. Se ne do i lëshonim litarin nga lart, e shumta pas 15 minutash. Ai këmbët i kishte të thata sepse bora ishte e ngrirë

Por duke qenë se Rushiti nuk ishte në rregul fizikisht ndodhi aksidenti dhe se kur Rushiti ngacmohej ose vihej në provë i bieka të fikët, sikundër na tregoi më vonë i vëllai.

Në këtë ngjitje meqë u grind Dulla me Gëzimin unë nuk ndërhyra në itinerarin që u fut Gëzimi, në lug, gjithashtu duke menduar se do e kalonim shumë shpejt shtegun për t'i ngjitur dhe as më shkonte ndër mend se mund t'i bjerë të fikët Rushitit të cilit i tregova si të ngjitej me shpinë në oxhak/tymtqjë (është fjala për teknikën e ngjitjes së këtij relievi) që unë (do) e kisha më lehtë se jam i gjatë. Por duke parë se kishte akull u ulëm poshtë.

Po kështu si unë jemi gjendur të katërt përveç Rushitit që iku pas Gëzimit dhe nuk e ndjeu dobësinë e trupit të vet.

Për ngjitjen e vitit 1974 në kalimin e Gavnit të famshëm ishte në këtë formë. Komandant P. Kule, i deleguar (nga Federata) A. Tabaku. Në fushën e Dënellit ndodhi ajo që ndodhi: u dogj çadra e tre alpinistëve tanë dhe u dogj pak në dorë Nëndor Veleshnja. Vazhduam të njëjtin itinerar si vitin e ardhshëm (viti 76-ab). Ngritëm çadrat në Gropat e Zhaborës. Kur filluam rrugën për në Majën e Pilafit (Krasniqe) (shënim: kur një majë, nga rënia e borës, konfigurohej pa pjesë shkëmbore, alpinistët e quanin maja e pilafit) me të kaluar të qafës së parë që ulej në Rrogam ishte një shpat i pjerrët. Unë kalova i pari duke pasur edhe intuidën, nga rruga që kemi bërë bashkë, se ku do dilja.

Unë me Tolin u shkëputëm rreth 300 metra ku dëgjojmë debat midis Vangjelit e Agimit dhe Nëndorit. Ky i fundit pasi e mori vesh se ku të zbret ai lug tha “unë nuk shkoj më tej se më dhëmb dora e djegur” (pati frikë)

Agim Tabaku atë vit, si edhe më vonë, nuk e ndjente mirë vetën fizikisht. E shfrytëzoi rastin për tu kthyer në lug duke thënë se duhet të shoqërojnë dy veta Nëndorin dhe në këtë grindje bëri fjalë edhe Petraqi. Nga sa më tha Petraqi, Agimi si i deleguar urdhëroi të ngjitet maja e Pilafit pa të bëhet ardhje po këtej.

Vangjeli udhëhoqi ngjitjen e majës dhe (kështu) nuk u realizua itinerari (i ndërmendur për të dalë në Valbonë – ab).

Acj, më ka dënuar shoqata për një vit nga aktiviteti se shkodratët thanë që tregoni që ishit të lidhur të katër se e fusni në burg Gëzimin.

Gabimi im nuk do thellohej sikur të kishim ardhur në Tiranë, të tre meqë ishim të saktë. Por Vasili së bashku me të tjerët ngarkuan njërin me faj por nuk nxorrën konkluzione të sakta, por i vrasin njerëzit shpirtërisht duke fantazuar mos realitetin. Edhe QP që tregon për punë ambicje duke na ngarkuar me diçka të drejtë por mbrapa krahëve.

I bëj të fala të gjithë të shtëpisë.

Të fala,

Vullneti

Në këtë veprimtari unë nuk mora pjesë. Arësyeja ishte histori e llojit “lufta e klasave e ndezur nga dy alpinistë jashtë klubit tonë, MV dhe MM.

Në “studimin” tim për të pakëndëshmet në sportin e alpinizmit më duhej kjo e papëlqyer, andaj shkruajta letra në individë të ndryshëm. Dy kryesoret janë si më sipër.

Këto letra të mundësojnë të kuptosh se çfarë ndodhi dhe përse ndodhi.

Koment: nuk duhet vënë pasioni përpara mundësive fizike e psiqike për të shkuar në mal. Ky rast është tipik, për mua, që të kuptosh se ekipi nuk është më i fortë se më i dobëti i ekipit.

Ndodhia ishte e pakëndëshme në instancat e larta të partisë, etj. Kjo pakëndje përcillej deri në Shoqatë e për pasojë në Kryesinë e saj si dhe në Komisionin Teknik. Dhe gjithnjë duhej gjetur një “fajtor” dhe duhej të kishte dënime. Sepse, sipas psikozës që të përcillte kupola e PPSH, tek ne vetëm mrekulli positive ndodhin.

Kjo histori mua më tegon se Gabimi Njerëzor është gjithkund i mundëshëm. Alpinistët, si individë dhe si ekip duhet të jenë syapur që të mos u ndodhë gabimi.

Dënimet si mësipër janë, për mua, negativitete. Si mund të dënosh ti shokët e Rushitit që përjetuan gjithjen dhe pasojat negative të saj, kur vetë pjesëtarët e vuajtën këtë në mal dhe më pas e vuajnë në jetë. Në vend që të gjëndet një gjuhë qetësuese për gjëndjen psiqike dhe emocionale të tyre për atë që ndodhi, ata marrin në Tiranën shtetërore edhe dënime!!

Lista për të punuar materialin për avaritë në alpinizëm përmban 47 enra që janë intervistuar. Në material janë thënie të një pjese të tyre si dhe tregime nga ta dhe të tjerë.

Sa më poshtë nuk kanë qenë të regjistruara në materialin për seminarin.

1978

Kthim nëpërmjet Shtegut të Dhenve. Tregoi A B

Grupi me 13 alpinistë që realizoi ngjitje në Jezerë, Papllukë dhe Ali kthehet në kampin e Thethit. Të nesërmen në mëngjes alpinistët pjesëmarrës në këtë veprimtari kaluan Shtegun e Dhenve. Për ata që nuk kishin dijeni për pjesëtarët e grupit, natën para se të flinin, në mëngjes mësuam se 7 prej tyre janë të verbuar. Mendoni se me sa vështirësi marshoi grupi me shtatë të verbuar për në Bogë. Dhe gjithë kjo e keqe erdhi nga neglizhimi për të marrë syze për mdrojtjen e syve nga rrezatimi diellor.

1980

Maja Kollatës, muaji shkurt dt 10-11.

Shkroi në ditar Niko Petro

Në orën 3:15 (pas mesnate) vjen Haziri. Ai, pasi ne u kthyem nga Roshi, kish vajtur në postën kufitare që të lajmëronte komandën që ne u kthyem nga maja. Ata aty i thanë se një grup alpinistësh (K.Z, A. Q., A. R, K. G, S. A, M. H.) kishin mbetur në majën e Kollatës. Këta kishin dashur të kthehen shpejt për të parë ndeshjen e futbollit dhe për shkurt, nuk kishin ndjekur rrugën e ngjitjes por kishin tentuar që t'i binin

shkurt. M.H, në tentativë për të kontrolluar vendin, rëzohet dhe vritet (duke çarë kokën), humbet ndjenjat, por e kaloi rrezikun dhe arriti të kthehet në Valbonë. Të tjerët mbetën lart në mal. Në Valbonë ky i thotë komandantit të postës që “kemi kaluar kufirin”. Kjo alarmoi komandantin që lajmëroi Degën e Punëve të Brendshme në B. Curri.

Përfundim: gabime njerëzore, ngutje, mburrje që “kemi kaluar kufirin dhe ja ku jam”. Një lëmsh i tërë që përfundoi pa të arrestuar, pa dëmtime (veç kokës që ja bëri koka) dhe një ankthi në një natë të ftohtë në mal. Fat i madh që moti ishte pa erë!

17 tetor 1982

Në datën 17 tetor u organizua ceremonia e hapjes së sezoni për ngjitjet në malin e Dajtit. Në këtë ceremony, sikur edhe në rastet e tjera organizoheshin veprimtari të ndryshme sportive nga sportistë të klubeve sportive të Tiranës, si dhe të rinj që vinin nga institucione të ndryshme. Ekipit tonë të alpinistëve i ishte cakruar detyrë të bënte lëshime/zbritje me litar nga taraca e e sipërme e godinës që ishte mbi Fushën e Dajtit. Anëtarë të ekipeve të të rinjve dhe të të rriturve të Klubit Sportiv 17 Nëntori, para fillimit të ceremonisë, kryen nga një ose dy lëshime/zbritje me litar, për “nxemje”.

Në këto zbritje, kur i erdhi rradha alpinistit SM u këput litari dhe ai ra në sheshin e taracës së godinës në pozicionin që kishte gjatë lëshimit. Pati shumë fraktura, më të shumtat në të dy krahët.

Me vullnetin dhe inteligjencën e tij të veçantë bëri mrekullira individuale, ortopedike, etj dhe i riabilitoi në maksimum krahët. Pas reabilitimit u muar me skijim.

Komente: në klubin tonë sportiv, me në krye Shefin e Klubit MS, pati interesim dhe mbështetje që të gjenim se përse u këput litar. Unë isha “specialist” në këtë përpjekje.

1. Ne nuk kishim asnjë literaturë për vetitë fizike të litarëve sintetikë. Ne dinim që ata mbanin ngarkesë deri në dy ton dhe që kishin elasticitet të mjaftueshëm.
2. Në bibliotekën kombëtarë, nga literatura për materialet sintetike (nylon, perlon, etj), mësova se ato dëmtohen nga rrezatimi diellor dhe lagështira. Litarët tanë, pas përdorimit, magazinoheshin në kushte shumë të mira.
3. Shkova tek ndërmarrja import-eksportit për tu interesuar nëse materialet tona, konkretisht litari, a kishin fleta me instruksione që i shoqëronin ato? Nuk ma hapën derën.

Në këto kushte ne, për të qenë të “larë” me ndërgjegjen tonë filluam t’i testonim, pas kësaj ngjarje. Këtë e bëmë, madje në një rast në prezencë edhe të Shefit të Klubit, duke i tërhequr, i gjithë ekipi, një e nga një pasi i lidhnim në njërin skaj.

Pasi kalojë viti e më shumë, nga bisrdat me alpinistë mësova se para se të ndodhte fatkeqësia si më sipër, kishin ndodhur tre raste të këputjes së litarit.

Rasti i parë kish ndodhur me treshen kryesore të alpinistëve vlonjatë, duke zbritur me litar tek Kalaja. Rasti i dytë me pionerët (para të rinjtë) e Pallatit të Pionerëve Tiranë. Instruktori nxori (për kohëzgjatje) litarin më të ri që kishte dhe i vuri fëmijët gjashtë nga gjashtë në lojën e tërheqjes së litarit. Nuk fitoj asnjëra anë: litari u këput dhe të gjithë fëmijët ranë me fundin e kurizit në tokë.

Rasti I tretë nuk më kujtohet.

Askush nuk i kishte treguar më parë këto ndodhi të pakëndëshme!Me një litar të ri

Ishte viti 2005 kur unë bleva një litar. Fleta shoqëruese e tij kishte një “leksion” të tërë për gjithshka që lidhej me atë litar. Detaje edhe kur i vjen koha që nuk duhet përdorur.

U tmerova nga ato që lexova, sepse kujtoja përdorimin e litarit në “kohën time!”

E përktheva materialin dhe ja kalova Federatës dhe kujtudo alpinisti që takova, me thirrjen “zhdukni nga ekipet e alpinizmit litarët që mund tu kenë mbetur që nga koha e monizmit”.

Anekdotat Alpinistike

1.

Eqerem Bej Vlora (1985-1925) ishte një Princ i mirëfilltë nga Vlora, nip i Ismail Bej Vlorës (Ismail Qemalit). Edukimin e lartë e mori në Austri, ku mori edhe edukim për argëtime në natyrë.

Në tetor të vitit 1906 ky Princ bashkë me shpurën e tij u ngjit në Malin e Tomorit. Ngjiti edhe Çukën e Tomorit (2.396 m) edhe majën e Tomorit (2.416 m).

Kur Princi po ulej nga mali për të kaluar natën tek beu i fshatit Zaloshnjë, në këtë familje, njëri nga pinjollët e mikëpritësit të tij i tha:

- Zotëri! Përse bledh këtyre maleve të egër? Qëndro në shtëpi. Është më mirë.
- Dëshiroj t'i njoh këto vise – ju përgjigj Princi. Por pinjolli e kundërshtoi duke i thënë:
- Mos o bej! Unë të dija për burrë të mënçur, por ti nuk qënke i tillë

Princi e anashkaloi këtë kundërshti sepse kuptonte që mendja e këtyre malësorëve nuk mund ta rrokte se ç'kërkonin maleve këta njerëz të pajisur me arësye, ndërkohë që mund të rrinin për shtatë palë qefe pranë vatrës së ngrohtë. *Në fakt ky ka qenë një mentalitet që ndeshej rëndomë, kudo, në fshatrat malorë të Shqipërisë deri sa erdhi koha kur malet u kuptuan si vënde argëtimi edhe nga malësorët.*

2.

Alberti I (1875-1934) ishte Mbret i Belgjikës. Ai ishte edhe një alpinist entuziast dhe i sprovuar. Një ditë ai u ndesh në mal me një alpinist tjetër i cili i tha:

- Ngjani jashtëzakonisht me mbretin e Belgjikës!
- Ma kanë thënë edhe të tjerë këtë fjalë – u përgjigj mbreti, - më bezdis shumë kjo ngjashmëri!

Marë nga Daye, Vita e morte di Alberto I; në librin Anekdotat të Ihsan Çabej.

3.

Grigor Perikliu (1922 – 1998) ishte një alpinist i shquar i pas L2B, dhe për disa vite edhe trajner i ekipit të alpinistave Labinoti të qytetit të Elbasanit.

Në një veprimtari kombëtare të sezonit veror, kur alpinistët ishin mbledhur për të përcaktuar itinerarët e ngjitjeve, dikujt i ra në sy mungesa e Grigorit në ekipin elbasanas dhe pyeti:

- Po Gori (emri i shkurtuar i Grigor Perikliut), përse mungon?
- Ka rënë në burg – përgjigjet, me pamje serioze, një elbasanas për humor.
- Si ka mundësi kështu Gori?! Si ndodhi?!
- Ai është magazinier i kripës në qytetin tonë – u spjegoi elbasanasi duke e mbajtur veten se mos e kapte gazi – dhe i ka zënë kripa krimba.

Fillimisht pjesëmarrësit shprehën habi dhe hutim, por pas një çasi shpërtheu një e qeshur kolektive.

4.

Hazir Malaj dhe Hajdar Hasa, për një ngjitje që do të bënin në zonën e Kllogjes, pak larg nga kampingu, i bënë materialet teknike gati dhe i futën në një ranc sulmi (ranc/çantë e vogël me të cilën barteshin materialet, uji dhe ushqimi i ditës) gjithëshka që do u duhej për të nesërmen për atë ngjitje, kohë para se të flinin.

U nisën herët në mëngjes dhe kur arritën tek itenerari që do të ngjisnin hapën rancin dhe nxorrën ushqimet e paketuara për të ngrënë mëngjesin.

Pasi e bën ritualin ushqimor filluan të nxjerrin materialin teknik dhe për habinë e tyre mungonte litari kolektiv (litar 40 metrosh me Ø 11 mm). Habia nuk zgjati ma shumë se dy tre sekonda dhe Hajdari I bie ballit (me pëllëmbë).

Mos! – tha ai. - Mbrëmë nuk po më zinte gjumi dhe nxora litarin për ta përdorur si n'krejsë (jastik) – shpjegoi ai i dëshpëruar.

E humbën atë ditë për të realizuar veprimtarinë e menduar dhe u mjaftuan të ndërmarrin një itenerar për në majë të një mali aty pranë, itenerar që nuk kishte nevojë për litar për sigurim.

5.

Një treshe alpinistash filloi ngjitjen me kacavarje të një itenerari që fillimisht u duk i thjeshtë. Pasi filltari (udhëheqësi i itenerarit) kaloi me lehtësi metrat e para, itenerari erdhi e u vështirësua dhe i tillë dukej se do ishte vazhdimi.

GU ishte i treti në litar dhe pa se si e kaluan itenerarin dy nga shokët e tij. U frikësua dhe mendoi një bishtani që e zbatoi.

Filloi kacavarjen, për disa metra të fillimit hoqi plengat që ishin vendosur për sistemin e sigurimit dhe para se të takohej me shokun e tij të mesit të litarit, në moment të përshtatëshëm, hodhi majthin (çekiçin) dhe thirri:

- Më ra majthi (çekiçi)!

Me një majth të vetëm treshja nuk mund të vazhdonte ngjitjen. Organizuan uljen/lëshimin me litar dhe braktisën synimin.

Është pa kuptim të komentojmë veprimin sportiv të këtij alpinisti!

6.

Një moti pesë alpinistë u strehuan në një familje malsorësh në Alpe në një mot me erë dhe rreshje. Ditën e parë dhe të dytë, për të vrarë kohën, por jo vetëm, ata prenë dru për familjen dhe sistemuan çfarë mundën rreth shtëpisë duke ndihmuar kështu familjarët me punët e vogla të familjes. Ditën e tretë të qëndrimit aty nuk kishin se si ta kalonin ditën, por gjetën një mënyrë për të kaluar dy a tre orë. Vendosën të lanin kokën ngaqë e ndjenin se u kishin marrë lyrë. Vuri sejcili sipas rradhës tenxheren mbi furnelën me vajguri për të ngrohur ujin. Pastaj ndihmonin atë që lante kokën. Njëri nga shokët ishte tullac dhe i la rradhë katër të tjerëve që të lanin ata të parët kokën. Pasi u lanë katër shokët, edhe tullaci mori tenxheren me ujë dhe e vuri mbi furnelë. Menjëherë njëri nga flokëlarët i thotë:

- Çfarë do bësh me gjithë atë ujë?!
- Do laj edhe unë kokën – përgjigjet tullaci.
- Jo mor, jo! Ty të mjafton një xhezve ujë. Mos na shpenzo kot vajgurin - i thotë njëri me shpoti.

Tullaci u vrejt, u ngrys, por shpejt u qesh dhe u përgjigj:

- Ju, jo vetëm që latë flokët, por ju edhe i bëtë masazh kokës. Edhe unë do i bëj si ju tre masazhe me shumë sapuni kokës. Dhe i bëri në një mjedis ku e shoqëruan shpotitë.

7.

Çështje e vërteta, alpinistët gjithnjë kanë patur vështirësi komunikim në orët e para të takimit me malsorët. Dialektet e tiranasve, p.sh., kishin “distancë” me dialektet e veriorëve. Por përvoja tregonte që vështirësitë ishin në orët e para të bisedave, shumë - shumë, me alpinistët e vjetër, edhe dita e parë e komunikimit.

Në një takim mirseardhje të një grupi alpinistësh në një shtëpi malsori, që në fillim të bisedës, i zoti i shtëpisë i drejtohet më të vjetrit në atë grup, FD:

- A e njeh një Shend Dega andej nga Tirana?

Por FD kjo pyetje i tingëlloi: A ka shpend të egra andej nga Tirana?, dhe ju përgjigj:

- Me thanë të drejtën, në Tiranë nuk ka shpend të egra, por në malin e Dajtit kemi kafshë të egra, si lepura, dhelpra...

- Asht rob mor lum miku! Asht rob Shpend Dega! E ndërpreu malësori.

Plasi e qeshura. Kaq u desht për ta kuptuar drejtë pyetjen FD si dhe shokët e tij.

Ky moskuptim dialektor e ëmbëlsoi që në fillim komunikimin atë natë, në dhomën ku ishin mbledhur alpinistët, malësori, si dhe 3 malsorë të tjerë që erdhën për të nderuar fqinjin e tyre në mikëpritje....

8.

Në shkurt të vitit 1965 alpinistët që u ngjitën në majën e malit të Korabit u kthyen në fshatin Radomirë. Ngjitja dhe zbritja nga maja i kish lodhur dhe Kryetari i Këshillit të fshatit së bashku me tre këshillëtarë u morën me ndarjen e alpinistëve për t'i vendosur nëpër familje për të kaluar natën.

Ishte errur kur arriti tek porta grupi me katër tiranas ku i kishte drejtuar kryetari. Por aty ishin dy porta krejt të ngjashme që i ndante vetëm një kollonë e përbashkët. Trokitën tek njëra portë dhe kur doli i zoti i shtëpisë alpinistët i thanë se i kishte drejtuar aty Kryetari i Këshillit për të kaluar natën.

I zoti i shtëpisë mbeti për një çast i habitur por dhe në çast me mirësi i drejtoi për në shtëpinë e tij. I futi në një dhomë të madhe dhe u kërkoi që të futeshin aty me gjithë rancat/çantat e tyre.

Hynë dhe për habinë e tyre panë se në dhomë ishin mbi 20 bura që bisedonin, por që shpejt njëri pas tjetrit e lanë dhomën dhe aty mbetën vetëm alpinistat.

Si gjithnjë filluan bisedat me të zotin e shtëpisë dhe dhoma e ngrohtë dhe rancat e hequra nga shpina i bënë alpinistët që të shpërfaqnin tërë gjallërinë që i karakterion.

Shpejt erdhi ushqimi, darka, e shërbyer nga gratë, dhe në softën e madhe u la edhe një shishe me raki. Buka, ushqimi, u hëngër por rakia u prek pak ngaqë ata ishin të lodhur.

Orët kaluan dhe para se të shtroheshin për të fjetur, AA e pyeti të zotin e shtëpisë nëse çiftelia e varur në murin e dhomës ishte funksionale apo dekorative. Ishte funksionale dhe biseda mori udhë të tillë që alpinisti Ali Ago tregoi edhe aftësitë e tij modeste për të ekzekutuar dhe kënduar me këtë instrument. Dhoma u gjallërua nga zërat e alpinistëve, por lodhja bëri që ata të linin këngën dhe të shtroheshin për të fjetur.

Të nesërmen në mëngjes Kryetari i Këshillit ishte i pari që u ndodh në sheshin ku do grumbulloheshin grupet e alpinistëve para nisjes për në Peshkopi. Sejcili grup vinte dhe menjëherë shprehte përshtypjet e bukura të mikëpritjes. Por kur erdhi grupi për të cilin folëm dhe tregoi se si e kish kaluar mbrëmjen, Kryetari i Këshillit i ra ballit:

- Mos! – tha ai. Dhe vazhdoi.
- Paskeni trokitur në derën e gabuar.
- E pse? pyetën thuajse njëzëri anëtarët e grupit.
- Sepse në atë portë, ngjitur me dhomën tuaj, ishte dhoma e grave që ruanin dhe vajtonin djalin e tyre 16 vjeçar që ka ndruar jetë.

Ra heshtje! Sejcili anëtar i katërshej së alpinistëve në fjalë ndjehu pendesë. Por dhe kuptoi si rrallëkush se çfarë do të thotë pritja e mikut për një familje malësore.

9.

Dikur në fshatrat rreth Alpeve nuk kishte bujtina apo restaurante. Alpinistët vinin në Alpe për të realizuar ngjitjet e tyre duke marë “shtëpinë” me vete. Llogarisnin udhëqimet ditë më ditë deri për ditën e fundit. Mirëpo ka pas ndodhur që mjeti që do t’i transportonte për në Shkodër të mos vinte ditën e caktuar, por të nesërmen. Dhe kështu ndodhi një herë që autobusi për alpinistët, mirë që erdhi të nesërmen, por erdhi të nesërmen mbasdite vonë. Kish alpinistë që kishin një ditë të tërë pa futur gjë në gojë. Dhe i vetmi vend ku kishte restorant, pa hyrë në Shkodër, ishte Kopliku.

Alpinisti BA, hyn në restorant dhe shikon që në menu kishte vetëm dy artikuj: peshk dhe kos. Hëngri dopio peshk dhe e mbylli darkën me një dopio kos.

Në Shkodër pati fatin që të flejë në Hotel Turizmi në një dhomë teke. Meqë kishte kohë që flitej se kur ha peshk dhe kos është mundësia të helmohesh (dhe vdesësh), BA në një fletë letre, para se të shtrihej në shtrat, shkruajti me gërma të mëdha:

MBRËMË, PËR DARKË, KAM NGRËNË DOPIO PESHK DHE DOPIO KOS.

Të nesërmen para dite, i ngopur me gjumë, BA udhëtoi si gjithë të tjerët për në Tiranë.

10.

Një ditë dimri, kur u ul grupi i katër alpinistëve në restorantin e Hotel Turizmit në Peshkopi, pas kthimit nga ngjitja e suksesëshme në malin Korab, TA pasi pa menunë, i thotë kamarjerit që kishte mbi kokë për të marrë porosinë.

- Më sill gjithë gjërat që ka menuja.
- Si, sii? – u habit kamarjeri.
- Të gjitha që ka menuja. Kam tre ditë pa ngrënë!

Në fakt nuk kishte tre ditë pa ngrënë, por hëngri; hëngri sa deshti dhe la atë që nuk mundëte më.....

Nga anekdotat e studentëve që u krijuan në shkollat alpinistike në malin e Dajtit me personazh të madhin alpinist Vasil Stambuli.



Në foto Vasil Stambuli dhe Mustafa Selenica duke mbërthyer kthetrat para ngjitjes së parë dimërore në majën e Jezercës. 10 Mars 1960. Fotografoi Minella Kapo.

Letër nga Mustafa Selenica

I nderuar Sandër!

Të falenderoj që më përmëndje në botimin tënd “Nëpër Bjeshkët e Namuna”. Vetëm një njeri si ti që ke jetuar në gjirin e alpinistëve, që ke jetuar me vështirësitë e maleve, dashurinë dhe solidaritetin e alpinistëve, si dhe humorin e pandarë edhe gjatë vështirësive Ndryshe nuk kishte si të bëhej “paraqitja dinjitoze” e komandantit të kufirit (*e ka fjalën për një histori të botimit që ka brënda shqetësimin për shokët e vonuar me shtirjen e një ballafaqimi me patrullën kufitare. Nga një anë Mustafa Selenica dhe Vasil Stambuli, të shqetësuarit për shokët dhe në anën tjetër Kozma Grillo e Petraq Kule, pretendues si patrullë kufitare*).

Nga takimi me ty dhe me Profesor Andon Tapia më lindi dëshira për të hedhur në letër kujtimet e mia për alpinizmin, sigurisht ashtu kalimthi, me stil telegrafik, që mund të vlejë për historikun, të paktën për ato 5-6 vjet që jam marrë unë.

Më rrëmbyen shpejt kujtimet dhe përjetova emocione, madje më duket sikur ca skena kishin ndodhur dje. Natyrisht u përlota, sidomos për Shilin, por sigurisht edhe për jetën studentore të papërsëritëshme. Edhe tani me lot në sy jam.....

Të përshëndes me një “mir u pafshim së shpejti!!”

Në lëvizjen alpinistike, në periudhën 1956 deri 1990, ing. Vasil Stambuli ishte një alpinist i spikatur. Trup sportiv madhështor, karakter tradicional pozitiv, alpinist klasi dhe zemër ar.

Ishte minoritar. Kishte theks në shqipen e tij të folur, theks që i jepte “kripë” bisedave me të. E simpatizonin të gjithë alpinistët studenta, në kohën kur vetëm Universiteti i Tiranës kishte ekip. Më pas edhe të alpinistët e klubeve sportive, dhe më gjërë. Kozma Grillo, në botimin “Alpinizmi Ynë” e ka përshkruar Shilin sikundër e ka njohur dhe sikundër dinte ai.

Në kohën që Vasili ishte student disa histori të tij të zakonëshme, studentët alpinistë të shoqërisë së tij më të afërt, i zmadhonin dhe i përpunonin, por ai nuk prekej. I pranonte dhe buzëqeshte dhe kështu të mundësonte momente humorit të këndëshëm.

Alpinistë më bashkëkohas të viteve studentore të Shilit ishin Kozma Grillo, Andon Tapia, Minella Kapo, Mustafa Selenica, Tefta Zguro, Vasil Vreto, etj. Unë u njoha me të gjatë shkollës së pestë alpinistike dimërore në malin e Dajtit, në vitin 1962. Mjeku Mustafa Selenica (Xakja), Vasil Stambuli dhe Minella Kapo ishin tre alpinistat e parë që ngjitën në sezonin dimëror majën e Jezecës, Mëcekun e Alpeve Shqiptare (10 Mars 1960).

Në letërkëmbimin me Mustafa Selenicën (Xaken), ndër të tjera, ai më thotë:

“Nga takimi me ty dhe me Profesor Andon Tapia, më lindi dëshira për të hedhur kujtimet e mia për alpinizmin, sigurisht me stil telegrafik, që mund të vlejë, për ato 5-6 vjet që jam marrë unë me alpinizëm. Më rrëmbyen shpejt kujtimet dhe përjetova emocione, madje më duket sikur ca skena alpine kishin ndodhur dje. Natyrisht u përlota, sidomos për Shilin; por sigurisht edhe për jetën studentore të papërsëritëshme”.

Më tej Xakja më shkruan për kujtimet e tij me Shilin.

“Edhe kur ja përmëndnim bëmat (*të zmadhuara e rregulluara për humor – ab*), ai qeshte dhe nuk zemërohej kurrë sepse ishte i sigurtë që e donim. Edhe për këto që do kujtoj në këtë letër, megjithëse u

bënë vite që na ka lënë përgjithmonë, atje ku është, do kënaqet dhe do na falenderojë që e kujtojmë me mall!”

Dy ngjarje në fshatin Poliçan.

1. Realiteti: Vasili shkon në fshat dhe për të ndihmuar gjyshen dhe ndër të tjera, një ditë shkon në pyll dhe bën për të një gomar me dru.

Si u bë anekdotë ky realitet: Shili vete me gomarin e gjyshes për të bërë dru në pyll. Atje vuri re se një ujk, më i madh se gomari, po zvaritej fshehurazi që t'i hidhej në qafë. Shili ja kuptoi qëllimin ujkut dhe shpejt mori një dru nga të prerët në dorën e majtë dhe me dorën e djathtë nxorri kamën nga brezi. Kur ju hodh ujku për ta ngrënë, ai i futi drurin në gojë ujkut dhe kamën ja nguli me forcë në zemër. Dhe ujku ra në tokë pa frymë.

2. Realiteti: Teksa ecte në fshat me një shkop në dorë i del një gjarpër. Pati kohë ta qëllonte me shkop por nuk arriti ta godasë dhe ai u largua dhe u fsheh në ferrë.

Si u bë anekdotë ky realitet: Teksa ecte Shili në fshatin e gjyshes, kuptoi se do e sulmonte një gjarpër i gjatë një pash. Ama, një pash me pashin e Shilit! Ky gjarpër ishte i llojit “gjarpër shigjetë”, që po të goditi në kokë, e çpon kokën dhe të del në fund të trupit. Shili sa e pa gjarpërin, mori një rasë guri dhe e vendosi në kokë pikërisht kur e sulmoi gjarpëri, i cili goditi rasën dhe u bë copë-copë.

3. Një realitet, rast në mal. Ndodhi që një natë Shili, Tefta Zguro (në mes) dhe Minella Kapo fjetën në të njëjtën çadër.

Si u bë anekdotë ky realitet: Në Theth i ra rasti Shilit të flinte në një çadër me “shokun Menela” dhe Tefta “Zhguron”. Mirëpo Tefta nuk fjeti në mes, por në anë të çadrës, nga ana e “shokut Menela”.

Shili u ofendua nga kjo sjellje e Teftës dhe të nesërmen e kërcënoi: “Dëgjo moj Tefta Zhguro! Këtu në mal të kam si motër, por kur të vemë në Tiranë, do ta ha atë syrin e zi që ma ke si uliri!” (pjesa e fjalisë “do ta ha atë syrin e zi që ma ke si uliri!” u përpunua që të përsëritej në mbyllje të shfaqes reale si në vijim-ab).

Në fakt Shili nuk hëngri gjë sy por historia e më poshtme u lidh me sa më sipër.

4. Për të kuptuar sa më poshtë duhet të dini se: në shkollat e alpinizmit, çdo togë (grupim prej 12-15 studentë me në krye një instruktor), caktohej dezhurn dhe kishte detyra, që me sa mbaj mend, ishin si më poshtë:
 - Kujdesej që të zbatohej orari ditor i veprimeve.
 - Kujdesej që guzhina dhe menca të kishin personel të plotësuar si dhe mjaftueshëm dru zjarri.
 - Të organizonte mbrëmjen e argëtimit dhe shfaqje me aktorë anëtarët e saj pas darkës, etj.

Çfarë ndodhi. Toga “speciale” (toga që kishte studentë që nuk vinin për herë të parë në shkollën e alpinizmit) atë darkë organizoi mbrëmjen e vallzimit. Ishte koha kur shtypi në vendin tonë fliste e shkruante për Jetin, njeriun e borës. Shili nuk la kazan, kusi e tigan pa ju marë lyren dhe sidomos blozën për të lyer me to trupin dhe fytyrën. “Kompletohet për të dalë në sallën e mbrëmjes argëtuese me të mbathura dhe me një postiqe dhije rrotull mesit (*mendoni “stafin studentor” të make up – it në dhomën e Shilit*).

Pa pritur Shili hyn në sallë, ku studentët argëtoheshin, duke u hedhur me të dy këmbët e me duart të shtrira përpara e duke ulurit Uuuu!.....Uuuu!.... Uuuu!

Ato vajza që ishin në sallë u trëmbën (më saktë bënë sikur u trëmbën, sepse kishte nga ato që e kishin përgatitur skenarin) dhe u mbledhën në një qoshe.

Shili vajti drejt tyre, rrëmbeu me “kthetrat” e tij Tefta Zhguron, e hodhi në sup dhe me vrap e çoi nga sallë në guzhinë ku i paskësh thënë: “Do ta ha atë syrin e zi që ma ke si uli”.

Për qenin e tij, Sparti

Dueti: Ky Vashili ka një qën,
Alpinist atë e bën,
E merr pas at’ malukat,
Që nga menca në shtrat.

Shili:

Jasu Shparti zemra ime,
Të kam rritur me thërimë,
Heq nga pjata gjysmën time!

Shilit nuk i delnin tre pjata!

Dhe për mbyllje një hamëndja ime. Ja përse Shili i kish vënë qenit emrin SPART-i.

Dihej që Shili ishte minoritar. Por një ditë e pata pyetur: Shili, me origjinë, nga je ti?

Përgjigja e tij, e përcjellë me krenari ishte: “Jam Skipëtar i kulluar nga Sparta!” JO fjalë, POR edhe Shqiptar edhe Spartan!



Vasil Stambuli dhe Aleksandër Bojaxhi në Runicë, shkurt 1975

Farkë e Madhe, 06.11.2025 Aleksandër Bojaxhi

F U N D